Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi

D I J A

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 16/2017, viti XV, Ulqin
Numri 1 doli më 2003

Redaktor
Gazmend Çitaku

Redaksia
Dr. Gani Karamanaga
Dr. Simë Gj. Dobreci
Dr. Maksut Haxhibrahimi
Dr Bahri Brisku
Ma Liridona Sinishtaj
Mustafa Canka
Edita Nimanbegu
Jaho Kollari
Ali Llunji – Prishtinë
Gjovalin Çuni – Shkodër
Ali Gjeçbritaj

ISSN:2336-9310: Dija
COBISS.CG.ID 22278416

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.
Është themeluar më 12 nëntor 2002, në Ulqin.
U riregjistrua: Ministria e Punëve të Brendshme,
Podgoricë, Vendimi nr. 6308, më 13.02.2013.

Ky numër u botua me ndihmën e:
- Kryetarit të Komunës së Ulqinit, z.Nazif Cungu
- Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave në MZ
- Barnatorja PHARMALIFE

Ai që vë intelektin mbi dëshirat është më i lartësuar se engjëjt,
ai që vë dëshirat mbi intelektin, është më pak se një kafshë
(Xhelaledin Rumi)

PËRMBAJTJA

LETRARE

POEZI

IN MEMORIAM
Dritëro AGOLLI (1931-2017)
Njeriu dhe koha 13

POEZI PËR DRITËRO AGOLLIN
Odise PLAKU
Dritëro 14
Rozana RADI
Dritëro 14
Hajredin KOVAÇI
Një shkronjë u këput 15
Gëzim HADRIBEAJ
Dritero Agolli 15
Xheladin A. ÇITAKU
Dinjitetshëm 16

POEZI SHQIPE
Martin CAMAJ
Gjarpri e grueja 17
Frederik RRESHPJA
Nëna 17
Ali PODRIMJA
Meditim per Zotin 18
Agron TUFA
Sonet 18
Jaho KOLLARI
Institucioni 19
Xhevahir SPAHIU
Fjala... 21
Linditë Ramushi DUSHKU
Baladë 21
Elona ÇULIQI
Nji poezi e gjatë për nji lutje t'shkurtë 22

Shaban OSMANAJ
Malli i Ulqinit 23
Halil MATOSHI
NANA dhe lufta e saj Titanike për BEBEN e saj 24
Ali GEJÇBRITAJ
Flejnë kujtimet në qenien time 25
Argëzon SULEJMANI
Dy mijë e tridhjetë 26
Edmond TUPJA
Kaq i lodhur 26
Skënder OSMANI
Muranë kafkash 27
Alda MERINI
Kam nevojë për poezinë 27
Eri OMARI
Vajza e vogël e liqenit 28
ENEA RUÇI
Nënës 29
Arian LEKA
Trokitje në mur 32

POEZI E BALLKANIT
Mladen LLOMPAR (1944-2017)
Qetësi tmerruese 33
Radovan ZOGOVIQ
Ardhësit – Këngët e Ali Binakut
Kënga e njëmbëdhjetë 34
Darko Petar SHTIVIÇEVIQ
Melodia për dashurinë 35
Arsen DEDIQ
Çfarë më bën të lumtur 35
Boris BILETIQ
Mjellma në park 36
Enes KISHEVIQ
Shpejt fshehu në mua 37
Enes HALILOVIQ
Murimi 37

POEZI BOTËRORE

John ASHBERY
Vetëm duke ecur përreth 39
Erik Axel KARLFELD
Sytë e tu 40
Atahualupa YAPANQUI
El arriero 40
Azis NESIN
Heshtja 41
Antonio SANGERVASIO
Më dashuro 42

Fli harap i vogël 43
Nick CAVE
Ku rriten trëndafilat e egër 44
Silvia PLATH
Limiti 45
Marcello BARBUSCIO
Mirë u pafshim e dashura ime 45
Benard IGHNER
Çdo gjë duhet ndërruar 46

PROZË

Bahri Brisku
Votimet e montuara në Zogaj dhe Pistull (rrethi i Ulqinit) 47
Hajredin PUFJA
Kanga e dashunis së shkurtë 51
Vildana Dibra - ZHUBI
As falje nuk t'kërkova 54
Gazmend ÇITAKU
Bukurina 58

PROZË BASHKËKOHORE MALAZEZE

Zuvdija HOXHIQ
Të gjithë të mitë 60
Senad KARAGJUZOVIQ
Dhoma prej gurit të kaltër 68

PROZË BOTËRORE

Paolo COELHO
Sekreti i lumturise.... 71
Dino BUZZATI
Dëshira të gabuara 73

ESE

Jovan NIKOLAIDIS
Shqiptarët dhe unë 75

EX-LIBRIS

Gëzim PUKA
Disa arsye të mira pse duhet lexuar
"Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun" 81
Rrustem BERISHA
Zëri këndimtar i Shestanit 85
Gjekë GJONAJ
Copëza të bukura të jetës së Ulqinit, të shkruara
me ndjenjë të thellë shpirtërore 91
Dimitrov POPOVIQI
Disa fjalë rreth romanit "Të gjithë të mitë"
të shkrimtarit dhe Akademikut Zuvdija Hoxhiq (Berisha) 93
Gerta BANDILLI
"Të prekësh Ulqinin në vargje poetike 97
Asllan BISHA
Zëri i detit, zëri i Hajro Ulqinakut 99
Murat GECAJ
Me dashurinë për njerëzit dhe kujdesin ndaj shëndetit 101
Jaho KOLLARI
Edhe një bojë njeriu 104

LIBRI

Gjovalin ÇUNI
Një vështrim bibliografik mbi veprën e Frang Bardhit 106
Adriana HOXHA
A është Mjeda përkthyesi më i mirë i "Mbretit të Tulës"? 112

Gëzim PUKA, Ylber DYLI
Arsimi në gjuhën shqipe në Anën e Malit
(Republika e Malit të Zi), mes vështirësive dhe sfidave 117
Eljon DOÇE
In memoriam- Umberto Eco 125

HISTORIKE
Pierfranco BRUNI
Italo-shqiptarët ishin një popull apo qytetërim? 129
Arjan Th. KALLÇO, Emilio BENVENUTO
Nëse historia ndryshon gjithmonë pardon 135

GJEOGRAFI
Maksut XH. HAXHIBRAHIMI
Veçoritë hidrografike të Lumit Buna 147
Nexhat AVDIU
Veçoritë gjeografike të Liqenit të Shasit 168

SOCIALE
Majlinda KURT
Dhuna nuk ka arsyetim – refuzo abuzimin 177
Arlinda SUKALIQI
Këshilla të arta për të rritur fëmijë të edukuar 182

TRADITË
Gazmend ÇITAKU
Detaria e Ulqinit 184
Muhamet NIKA
Gjurmë lashtësie në dasmën e Anës së Malit 191
Ali GJEÇBRITAJ
Simboli i gjrpërit në shtëpitë e Krajës - Ora e shtëpisë 201
Ali BARDHI
Simbolet dhe motivet në gurvarret e Anës së Malit-Ulqin 204

ARKITEKTURË
Korab KRAJA
Ubla e Krajës – Monument mijëvjeçar 215
Suada ISMAILAGA
Shtëpia e Pashës dhe Beledia 240

PORTRET
Mustafa CANKA
Kadi Mujali - jeta e kushtuar besimit dhe mësimit 247
Gani KARAMANAGA
Kulla e Hoxhë Bushatit 249

IN MEMORIAM
Rudi (Ruzhdi) Goga (1948-2017) 253

LETRARE

POEZI

IN MEMORIAM

Dritëro AGOLLI (1931-2017)

NJERIU DHE KOHA

Vërtitet një re e zezë mbi botë
e zezë si unë
leh natën një qen i tërbuar nën portë
tërbuar si unë
zvarritet një gjarpër nga rrugë e vithisur
një gjarpër si unë
kalojnë në shtigje plot njerëz të krisur
të krisur si unë
lëkunden në qoshe të rrugëve kurvat
lëkunden si unë
bërtasin lypsarët si kafshët në guvat
në guvat si unë
kërcejnë majmunët në pyjet e xhunglat
majmunçë dhe unë
jeton botë e çmendur me vallet dhe plumbat
e çmendur si unë
tmerrohet njeriu kur lind mbinjeriu
tmerrohem dhe unë
kur vdes mbinjeriu merr zemër fatziu
marr zemër dhe unë.

POEZI PËR DRITËRO AGOLLIN

Odise PLAKU

DRITËRO

Tani do të vijë veç lejleku i mallit,
në shtëpinë tënde atje në Menkulas,
Do të dëgjohet trokitja e sqepit,
në të rrënuarin oxhak të fëmijërisë.
Do të marrësh rrugën në shtigje lufte,
a në zabele, a në të pluguarën arë.
Do të biesh kroit etjen për të shuar,
për miqtë e vjetër ke dhe për të qarë.
Me vete mos kërko t'i marrësh të gjitha,
të madhen peshë na ke lënë ti pas.
Nuk i nxë dot as ky tren e as kjo anije,
e kurrësesi t'i marresh ne një traste.
I zgjuar dole dhe mendje pa pyetur u dhe,
kur ngushtë veten zinin të kërkonin Dritëro.
Thinjat të nxorën a vetes ia bëre havale,
ç'tu desh të merresh me të gjallët si ne.
Në oborre të reja do të ndihet kolla jote,
nga rafte librash do na pyesësh ‘’Si je?’’.
Lejleku mallit kur të fluturoj nëpër qiell
do sjellësh lajme e do të marrësh nga ne.

Rozana RADI

DRITËRO

Po të kërkoj tani në raft
Te librat që mbajnë emrin tënd,
Ti je poeti i shpirtit të marrë
Në çdo varg e në çdo shkronjë.
Këtu do t'jesh,,,

Hajredin KOVAÇI

NJË SHKRONJË U KËPUT
(Dritëro Agollit)

Në gjerdanin e artë të alfabetit shqip
një shkronjë u këput
Ti s'i sheh dot disa si vrapojnë
të shkruajnë me ngut!
Mirë bëre që vdiqe, o poet
shumë shkuan deri në bibliotekë!
Sot të lexuan
edhe ata që s'të duan!
Unë s'pata rast të dal me Ty në fotografi
s'ka rëndësi
unë të kam në shtëpi!

Gëzim HADRIBEAJ

DRITERO AGOLLI

Lajmi i hidhur mori dhenë,
Kombi ra në zi,
Toka u drodh uji u turbëllua,
Ylli i jetës u shua.
Pena mes gishtave të rreshkura,
Ja kalon edhe jataganit të Skënderbeut,
Luftoi mes rrëbeshëve dhe kurrë nuk ra,
Legjenda u shkrua.
Gërmat e fjalët të qëndisura me fije ari,
Vargun tënd të magjishëm përshkuan,
Një lumë i tërë që qarkoi Shqipërinë,
I folë tërë Arbërisë.
Ti ishe shpresa e vegjëlisë,
Shërues i mirë i karaktereve të ligj,
Sundove si mbret i mirësisë,
Dhimbjet nën lëkurë mëmëdheut ja more.

Ku ka si ty, me rrënqethet mishi,
Kur dëgjoj vargjet e thurura nga ju,
Kjo magji e veprës tuaj,
Është burimi i jetës sonë,
Testamenti i pashkruar,
O i madhi Dritëro.

Xheladin A. ÇITAKU

DINJITETSHËM

*
Jetën pranove shtruar ashtu siç motet e sollën
jo në revan, me tërsllëmë, që t`buçisnin çastet
kultivuar n`hulli t`arsyes ç`farë kohët mbollën
pa lënë shpirtin t`shfrenuar nga egot e rastet
*
Shtruar hodhe shikimin në gjerësi ndjenjash
nëpër udhët e bredhjes cimbisur përjetimesh
vijëzove në skica vargjesh e tufëza rrëfenjash
ylberë t`ngjyruar hijshëm e shtigje kujtimesh
*
Trokun e mendimit, n`dallgë vitesh, e bëre zap
që t`mos vërshojë turbullt në vrullet hapërdare
që n`kthjelltësinë e qiellit, dielli të rrezojë prap
të përndritë virtytin e t`gremisen veset hileqare
*
Në rrëke stinësh, qetësisht, uraganët i sfidove
në hapa dinjiteti përshkuar horizonte agimesh
n`trille maskimesh t`hipokrizisë s`u ngatërrove
në kumte pompoze as në karnevale mashtrimesh
*
Pozuar përditshëm në thjerrëza tiparesh të jetës
si fanar i përjetshëm orientimi, ti Dritëro Agolli
në dallgëzime furtunash s`ishe disident i vetvetes
dinjitar i pathyeshëm ndër stuhi, ti djalë Devolli…

POEZI SHQIPE

Martin CAMAJ

GJARPRI E GRUEJA

Ajo mbramë harroi trupin e vet
Zbuluet
E në mëngjes e gjeti pikturë të varun
Në murin e gjanë dhetë pashë:
E kqyri dhe e kqyri e u zhduk.
Petkat e saj teren buzë detit
Me këmishën e gjarpnit mbi gurë.
Shtërpia tha se vjen prap,ajo, po
Deri mbasdite.
Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun
Doli prej nëngurit
E iu zgërdhesh vetmisë ndërsy,
Veshi këmishën e vjetër e shkoi
Me fjetë

Frederik RRESHPJA

NËNA

Ka filluar të plaket nëna.
Fytyra e saj po mbulohet me rrudha.

po mbulohet me një pleqëri të bukur.
Që është kjo rrjetë e bukur që hedh mbi nënën time.

Dhe duart që më mbanin tani jan rënduar.
Po ska gjë. Nga shpirti i saj
Zgjaten duar të tjera që më mbajn pezull

Ecën ngadal nëpër dhomë.
Nganjëher më pyet për librat që po shkruaj
por smë ka pytur kurr pse se kam shkruar asgjë për te

Se nëna e di
Fjalen e parë në botë ia thash asaj
Dhe fjalën e fundit në botë do ia them asaj

Ali PODRIMJA

MEDITIM PER ZOTIN

Mirë që imzot
është i bardhë
dhe e shoh
edhe në ëndërr
I zi të ishte
do të harroja
se kam pasur perëndi
e atdhe ndonjëherë
Mirë që tim zoti
lëkura i ndrit
e nuk më frikëson
as kur floku i skuqet
`i herë ndoshta zbardh
edhe fqinji të ketë
një zot të bardhë
e kopenë në vathë
Po tim zot atëherë
mes mumieve si ta dalloj
apo edhe më në shpinë
rrasën e varrit të bart unë

Agron TUFA

SONET

Kupën e kujtimit tënd ku ta fsheh e ku ta hedh?
Bëj ta flak e bëj ta thyej, bëj ta lë e më rrënqeth.

Kupa e kujtimit tënd valon shkumë dashurie
M'u ka ngri si një servis mbushur pije çmendurie.
M'u ka ngri në doren time ky bardhak i fildishtë,
I hedh zjarrit, zjarri digjet si në ethe kaltërsisht.
Nuk e pi kujtimin tënd. Kupa le ta pasqyrojë
Sonte qiellin lakuriq edhe hënën e pagojë.
Le të rëndet e përlotur përmbi kupën e mallkuar
F'tyra ime ndër reflekse zbehtësisht e vizatuar.
Kupa e kujtimit tënd më s'do mbushet kurrë me ty.
Bëj ta flak e bëj ta thyej, bëj ta pi e dot s'e pi.
Do të rend pra krejt i marre me servisin e hënuar
Gjersa shkuma nëpër kohë do jetë tretur, avulluar…

Jaho KOLLARI

INSTITUCIONI

nëse s´ta kam shtrirë dorën
s´do të thotë se s´kam shfaqur dëshirë të njohtohemi
ne zatën njihemi qëmoti
si të palindur
si fëmijë
si të rritur
si të vdekur...
ne kaherë kalbemi e qelbemi
dhe njeri-tjetrit ia përgënjeshtrojmë të vërtetën
ma more dritën e syrit
prekjen e dorës
dhembjen e shpirtit
më bëre shtatore
nuk guxoj të lëviz me sy
me duar
me flatrat e kujtesës...
të dal në rrugë është sikur të dal mendsh
asgjë të huaj s´posedoj
e veten s´e njoh
më humbet kryet nën bisht
ta fsheh fytyrën nga bota

e bisht s´kam
vjen ti dhe gjatë e gjatë më kundron
gjendja ime të mbush kënaqësi
dhe largohesh pa bërë zë
ku flet i vdekuri
të betohem s´kam thënë asgjë të keqe për rrugët
e di
do të çoja pluhur
tani mund të përdorësh sharje të njëanshme
të përdorësh fjalë të thjeshta
-fjalë pompoze
mund të dalësh nga vetja
të marrësh çfarëdo forme
po formën e njeriut aman mos e merr
edhe në këtë fundshekull
brendia ime është ngërthim labirintesh të hatashme
lehtë humbet e s´gjen rrugë për dalje
them ruhu nga kolla
nga gjaku e këlbaza që pështyhej
them hap sytë kur të kapërcesh rrugën
hija jote mund të ta thejë qafën
-mëkati yt
nuk të them se të dua
se mund të jem kundër vetes
nuk të them
të urrej
se s´do të mund të jem kundër teje
nuk them ç´më thua ti mua
se do ´ përsëriten fjalët e rënda...
herë unë eci përpara
herë ti ecën përpara
-rrugën e kemi ndarë mdyshë
ti s´ke më çfarë të nxjerrësh
unë s´kam më çfarë të fsheh
bota dëgjon heshtjen tënde
dhe britmën time
dhe kënaqet...
(1988)

Xhevahir SPAHIU

FJALA...

I thanë fjalës: tani je e lirë
Po fjala s'kish fuqi t'u thosh: nuk më duhet
E ç'më duhet
kur s' u thashë atëherë kur duhet?
Kam mbetur pa krahë,
Kam mbetur pa qiell,
Jam jetë pa ëndërr,
Jam ëndërr pa jetë.
I thanë fjalës: je e lirë
Vështirë, tha fjala sa vështirë
Të besosh se je e lirë;
Pasi ke ngrënë rrokjet e tua,
Pasi ke mbetur cung
Dhe liria bëhet burg.
I thanë fjalës: liria jeton.
Fjala ua ktheu:
S'jam si Kostandini që pas vdekjes udhëton
I thanë fjalës: ti je liria
Për ta kuptuar këtë duhet fare pak
Ajo e besoi,
Ajo hapi gojën,
Por në vend të tingujve
Prej saj doli gjak

Linditë Ramushi DUSHKU

BALADË

Thua se bota u krijua me buzët e mia
se ne u ngjizëm
aty ku hëna e kishte lënë përgjysmë
rreth-plotësinë
se të thash
këmbët

shtati dhe gjoksi
bymosen nën këtë hije të rënd korriku.
Ti mbështjellur këmbësh
rrije gjurmëve të mia
edhe atëherë kur heshtja piqej
...Po, hajt
se edhe bota u krijua nga buzët tua
atëherë kur hëna e la pergjysmë rreth-plotësimin.
I vrullshëm ish ai gusht
si të jet korrik i sotit
që sjell vërdallë
prushin e puthjeve më të zjarrta të botës.
Thua se bota u ngjiz nga ne të dy
ashtu edhe siç u ngjiz
nga dy
një si unë e ti!

Elona ÇULIQI

NJI POEZI E GJATË PËR NJI LUTJE T'SHKURTË

Shoh njerëz
fytyrat e të cilëve nuk i njoh,
por ia di tana brengat,
ia kam tha lotët e nji nate
ma parë,
e për kyt kam dëshmi
mângt' e ditës halà t'njomta.
Ndi hapa njerëzish
që nuk i njoh,
e megjithatë ia di destinacionet,
rrugët e përshkueme me kambët rr'shqan
drejt askundit, drejt askushit
që i mshon fatit tyne
me një çekiç prej akulli,
duke ia dimnu stinët.
Shoh buzëqeshje t'ngrime
diku n'mes qiejve të trazum t'syve
dhe shpresave dekuna t'buzëve,

e mue më mjafton me mbyllë sytë
e me përfytyrue amëlsinë e tingullit t'zânit
kur syve dân qielli e ringjall jetën.
Shoh njerëz,
që në fund të ditës
i çojnë si vakt fëmijëve n'shpi
nji thërrim' natë,
por me nji hanë t'plotë që ia mbush barkun
me shpresën se dita tjetër ka me i sjellë nafakë t're.
Shoh pleq,
ngarkue me barrë hallesh n'shpindë,
që i hapin sytë duke falenderue Zotin
që ia mbajti frymën edhe nji ditë,
dhe erren duke u lutë për pak dritë.
Përditë
mbledhi vedin n' nji lot n'zgrip t'synit,
a ndonji fjalë që e merr era e harrohet.
Mandej tretem n'qiejt prej mermeri
që m'zbardhen duerve si bora e parë e dimnit,
për me e rigjetë vedin
n'nji gotë ujë,
ku, aty, andrrat pijnë
nga rranjët e nji luleje me emënin “Nesër”;
qetësisht i psherëtij vedit:
paska pasë qiell edhe për lutjen teme.

Shaban OSMANAJ

MALLI I ULQINIT

Ruaje këtë melodi biri im
Është Ulqini, Ana e Malit
Zëri i babait fytyra e nënës
Ruaje këtë melodi biri im
Është era e truallit
Logu i kreshnikëve
Shija e kripës
Lulet mbi varre
Ruaje bir pashë ata sy.

Halil MATOSHI

NANA dhe lufta e saj Titanike për BEBEN e saj
- në vend ngushëllimi për Xheraldina Maria-n –

E njoh nji grue - Nosit lasgushian - që heq nga vetja copa mushknishë e mëlçie me e ushqye zogun e saj n'flat'rim...
Shkul veten - jep asaj - me e mbajtë të gjallë, në jetë!
Që s'fle me ditë e netë të tana me i sjell pak gjumë BEBES së saj!
Që grith qiellin për me i sjell fresk BEBES kur ka zjarmi!
Hap flatrat dhe merr za nga tan zogjt e rruzullimit me ia këndu NINULLAT ma t'bukura e me ia ndjell gjumin...
E njoh nji NANË që e bante dyfish ma vigane luftën e BEBES së saj!
Me jetue!
E njoh nji NJERI që asht shkri për NJERIUN: Xheraldina Maria, Xheraldina Rexhepi!
Dhe BEBA iku në qiell dhe NOSITI ende heq e jep: FRYMËN E SAJ - që kujtimi i BEBES me rrnue si sinonim i luftës titanike për jetë!!!
Lamtumirë REBEKA!
FORCË për NANËN!
Ajo tash të buzqeshë nga naltë Xheraldinë, ajo tash - jam i bindun - ka me u kujdes për ty;
Ajo asht ENGJËLLI Yt që të rri pranë; të jep bukë e ujë kur ke uri; të mbulon kur nerth; të ngushëllon kur vuen; të shoqnon kur vetmon...
Ti nuk je vetem Xheraldina Maria.
E sheh nji qytet i tanë janë me Ty - sepse BEBA ishte luftëtarja e këtij qyteti - sinonim shembullor i luftës për jetë!
BEBA asht përzie me ajrin dhe aromat e luleve në Kosovë!
BEBA po flen, mos e zgjoni!
Edhe ashtu tre të katërtat e njerzimit në çdo kohë janë në gjumin final!
Dhëmbjen ndajmë me Ty!
U prehtë në paqe REBEKA - Juve u mbuloftë Hyu me hirin e bekimeve!
Sot duhet me ba gajret!

Ali GEJÇBRITAJ

FLEJNË KUJTIMET NË QENIEN TIME

Në qenien time flejnë shumë kujtime
Nga mendja s'më hiqën majat me borë
As udhëtarët e vonuar të kohës
Si sot më duken se ma bëjnë me dorë.
Anija në Va të Shitarit në lindje të ditës
Merrte me vete pjesë të jetës tonë
Hudhëm këtu llokume e kokrra sheqerkash
Fiq të tharë e gjethe ullinjësh
Atë ditë që u nisëm për Kosovë.
Në vetën time mbaj poçin me vajguri
Në Va të Sjerçit e mbusha me dritë
Unë me pëndë bojë e bishtagyp
E motra qëndiste deri natën vonë
Pajën stoliste, thurrëte kurorë.
Në Radio Tirana çdo të hënën mbrëma
Kangë shkodrane, labe, polifoni
Valle përcjellë me fyell e qifteli
Degjonim tok krye m'krye.
Në kujtimet e mija, në trurin tim
Është gdhendur trungu i sharruar për dysheme
E në majat e kulmit të shtëpisë
Dru gështenje stolisin kullat e lirisë.
Jeta është udhëtim këtë e di
Më çoi në shtigje ëndrrash
Jo sa isha i ri por edhe tash në pleqëri
Atëbot nuk shkrova, më shumë ëndërrova
Sot po shkruaj por ëndërra mbetet ëndërr
Në qenien time është ngulitur thellë
Kujtesa e kohës dhe shpirti i trazuar.

Argëzon SULEJMANI

DY MIJË E TRIDHJETË

Mbahuni, gropa e hapur në dy mijë e dhjetë
Në mes të dy lagjeve Ulpianë e Dardani
E mundi Kodrën e Diellit në kaq pak vjetë
"Maja e Zhgënjimit" - 999 metër lartësi.

Thuhet grithjet e njoma t'i ketë lënë një ushtarë
Përpara se ballë të hapte në Luftat e Lindjes
Shpresës e gjithçkaje aty u paska hapur varr
Që jo vonë do të gdhinte një mal prej ikjesh.

Kur netëve të marsit toka po çohej peshë
E kontinent i vjetër s'po flinte, po çmendej
Evropianët paskan zbritur si prej reshë
The Mountain of Disappointment papushim po rrjepej.

Paskan gjetur jetë cule pleqësh e femijësh
Betime ushtarakësh, mësuesish e mjekësh
Shpresë të rëndë së kalburi për Librin Gines
Këngë e himne të shqepura në copa zhele...

Mbajë rendorin 2030, majave të Prishtinës.

Edmond TUPJA

KAQ I LODHUR

Kaq i lodhur isha në shpirt
Sa gjumi më kapi në çast
Kur hapa sytë në ëndërr
Isha bërë velë e bardhë

Befas deti u mbush me brirë
Dhe mua më futën në një shportë
Pluskoja lidhur me zinxhirë

I dënuar të mbytesha në port

Pastaj më lyen me të zezë
E më gjymtuan bujarisht
Një lot lëshova në zgjim e sipër
Kaq i lodhur isha në shpirt

Skënder OSMANI

MURANË KAFKASH

Në lima të Ulqinit
Kafka njerëzish
Ngacmojnë syrin

Kalaja e vjetër
Është regjur në kohë
Duke numëruar vdekjet
E ruajtur trollin nën këmbë
Nga deti që mba gjithë një gojë hapur

Shkulen sytë nga mllefi
I asaj plage të vjetër mijëvjeçare

Alda MERINI

KAM NEVOJË PËR POEZINË

Unë nuk kam nevojë për para'
Unë ka nevojë për ndjenja
Për fjalë,për fjalë të zgjedhura me mençuri,
pë lulet që thonë mendim,
për trëndafiat që thonë prani
për ëndrrat që banojnë në pemë
për këngët që bëjnë të vallëzojnë statujat,
për yjet që mërmëritin për veshët e të dashuruarve

Kam nevojë pë poezinë,
për këtë magji që djeg peshën e fjalës
që zgjon emocione dhe ngjyra të reja.
Poezia ime është e shpejtë si zjarri
kalon nëpër gishtat e mi si në një rruzare.
Unë nuk lutem, sepse jam poete e fatit të keq,
që hesht, në kohën e dhimbjeve të forta
jam poetja që bërtet e që luan me klithmat e veta,
jam poetja që këndon e nuk gjen fjalë,
jam kashta e thatë mbi të cilën rreh tingulli
jam ninulla që bën fëmijët të qajnë,
jam kotësia që lejon të bjerë
veshjen metalike të lutjes së gjatë
të hidhërimit të së shkuarës që nuk sheh dritë.

Eri OMARI

VAJZA E VOGËL E LIQENIT

Dishroj me andje
Me kenë vajza e vogël e liqenit
Bijë e lotusit
Dishroj me andje
Me u përkund valëve të tij
Bijë e dritës
Dishroj me andje
Me kenë vetëm fllad
E me mbështet sytë
Përjetësisht thellësive të tij
Vetëm sytë
Mrenda tyne asht shpirti jem

ENEA RUÇI

NËNËS

I
Sikur të mundja nënë,
këtë letër
të ta lija poshtë jastëkut tim
qe të mos e merrte askush
veç teje.
Se unë e di,
ti çdo natë
e kërkon atje
kokën time,
edhe pse e pashpresë
prap' e kërkon...
se ku i dihet,
por ja që dihet nënë...
Më duhet të mos jem atje!

II
Motivi i vjetër
për një jetë të re më thërret
shtigjeve të mbijetesës.

Një lukuni e tërë
më shtyn me bërryla,
e në këtë garë përbindëshash
nuk ia vlejtka të dalësh i dyti.

Po ec...
Edhe pse të gjithë semaforët e botës
kanë ndezur të kuqen!
Ca qen të zinj po më ndjekin nënë...

III
U bënë vite pa shkruar për ty.
Me sa mbaj mend,
që nga koha e një "8 marsi"

kur unë s'kisha para
të të jepja qoftë edhe një lule
dhe zëvendësova njëfarësoj
dhuratën tënde.
Ti u mallëngjeve,
po a i dilet kështu nënë?!
Jeta kërkon shpagë!

Fletët e papaguara të faturave
u bënë sa një mal
po ti rri e qetë,
unë ende kam
më shumë dorëshkrime
sesa borxhe për të larë.

IV
Edhe kur të them se jam mirë,
ti nuk fle
se e ndjen që
nuk është aq e vërtetë,
dhe në të vërtetë,
s'është aspak!
Në një djep të gënjeshtërt
po më përkundin nënë,
e gjumin tim,
nga vdekja
një hap e ndan.

V
Nganjëherë
më duket sikur në faqe
kam shenjën mavi
të gishtërinjve të tu,
e teksa t'i përmend këto,
ti mendon me dënesë
se unë nuk rri dot
pa e shfaqur cinizmin
bashkë me format e ndërlikuara
të mizorisë sime

dhe trandesh...
si m'i nxënë vallë vargjet
të tilla kujtime?!

Jo nënë!
Unë sot
çfarë nuk do jepja
qoftë edhe për një pëllëmbë tënden,
e të ta puthja dorën
si një Krisht i droguar!

VI
Nëse një mëngjes
dëgjon diku
se kanë vrarë një njëzet e gjashtë vjeçar
në një rrugicë të fëlliqur,
mos u tremb,
unë nuk mund të vdes aq thjesht nënë!

Por sido që të ndodhë,
në një tjetër botë
unë patjetër,
sërish do jem me ty.
E në mos qofsha djali yt,
mund të jesh ti vajza ime.
(A nuk do ishte bukur?)

Dashuria ime për ty,
ashtu si e jotja sot
nuk do ketë asnjë çast karnavalesh,
por s'di në do të mundem
ta bëj tëndin
atë fustankën e bardhë
që është ekspozuar në *kid's shop*-in
e qendrës së qytetit...

Por, *sido që të ndodhë*...
mos harro se mirësia jote
do jetë preja më e çmuar e botës!

VII
Çfarë nuk po shpik sonte,
mjaft më me këtë lojë ëndrrash!
Kot bëj si i ditur nënë,
unë s'jam gjë tjetër
veçse një student i përjetshëm
që kurrë s'e mësova dot
teorinë e zëvendësimit tënd!

Arian LEKA

TROKITJE NË MUR

Burrat kur pijnë janë zogj shtegëtarë,
ëndërrojnë tjetër jetë, vende me këngë
Në llërë një tatù: gjarpër, sirena, dita e thirrjes ushtar
mbyllin veshët me duar, fshijnë tryezën me mëngë.

Ju nëna, ju gra, mos i prisni të kthehen
kaq shpejt prej mërgimit me mend.

Burrat kur pijnë bëhen palma,
tundin degët, por nuk fluturojnë.

Nizamë pendëthyer mbrrijnë veç në darkë
pa kujtesë, pa bëma, pa plaçkë
trokasin në mur, mbyllin kanat e parvaz
dhe luten që porta e kyçur të çelet prapë.

POEZI E BALLKANIT

Mladen LLOMPAR (1944-2017)
(Mali i Zi)

QETËSI TMERRUESE

iku nga ky vend
dhe u vendos në një hapsirë meritore

kurrë askush nuk do të kuptojë
çfarë ndodhi në netët e tija
se si e mbyste monotonia e epshit
dhe hidhërimit
për shkak të mërisë
me të cilën jetoi në përrallën e rreme

nuk i mjaftonte
që mashtirmi ishte hyjnor

i kaloi kujtesës
porsi një profet
i qetësisë tmerruese
të Trojës së vet

2.
ia shpallën mjerimin si e mirë e përgjithëshme
dhe me lehtësi të pakuptueshme i matnin
datat dhe hapsirat e tija
ishte cak i dështuar
që vazhdonte
të qëllohej me qetësi

dhe pa pendesë
e valixhe
shkon
nga ana tjetër e vetes tij të dikurshme

3.
arriti në natën e vonë
duke u shikuar në murin përballë
mos po njeh
fuqinë që ka pushtuar
dhe gjithmonë një çast para njohjes
i turpëruar heq dorë

(përktheu Gazmend Çitaku)

Radovan ZOGOVIQ
(Mali i Zi)

ARDHËSIT – KËNGËT E ALI BINAKUT

KËNGA E NJËMBËDHJETË

Fusha ka thithur borën si pogaça tablin.
Dhe- burra, mbi bukë betohen!-
në arat tona ardhësit plugje kanë pru,
nën themel po na lavrojnë.
Burra ndër ardhësa, burra nëpër ara,
ndalni plugjet nëpër braza,
mbani farën në grushte,-
ndëgjoni!
Ai plug, që u ngul në arat tona,
nuk është- plug,
s`është plug, as umi s`është um!
Ata kanë ngulur thikën midis nesh
në mishin *tonë* të tokës!

(*përktheu Esad Mekuli)*

Darko Petar SHTIVIÇEVIQ
(Kroaci)

MELODIA PËR DASHURINË

....Një pasion
në dëshirën për zjarrin e amshueshëm.
Një zemër që shpreson
për rrahje në ritmin e njejtë.
Një shpirt
me besim të ngulitur
për zgjim në agun e mëngjesit
me cicërrimen e zogjëve
me buzëqeshjen e diellit
pas gjith atyre errësirave
të humbura në valët e jetës....

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Arsen DEDIQ
(Kroaci)

ÇFARË MË BËN TË LUMTUR

Diku është një qytet
plot me drita
diku është një shtëpi
plot me hare

Një njeri aty jeton
emri i tij është një sekret
një fëmijë aty jeton
ai njeri me te loz

Një pamje plotësisht e vjetër
nëse tablosë i shtoj lule
por secila gjë e vogël
mjafton të kujtohem

Kjo është ajo që më bën të lumtur
kjo është ajo që më jep forcë

Detit lundron një anije
për në jug diku
me te lundrojnë jetët tona
gjithmonë në rreth

Por çdo gjë e vogël
në atë shtëpi mbrëmje e ngrohtë
dhe ajo jetë aq e vjetër
që ngadalë diku rrjedh

(përktheu Gazmend Çitaku)

Boris BILETIQ
(Kroaci)

MJELLMA NË PARK

vajza sikurse ti
nuk vdes me të njejten vdekje
dhe ende më flet
për trashëgimin
për rastin
i cili shkon aq larg
hidhe atë shenjë
dhe mos mu çudit
mos iu çudit mbulesës së territ
dhe maicës së kuqe
shëmbëlltyrës së zezë floknajë
bukurisë dhe mejkapit të tij
revolucionarit tënd
grise, hudhe!
të gjithë janë vrasës
dhe askush prej dedikimi,
posi
se rrethatakun kanë

bardhësi bore
mjellmë nga gjaku
në parkun imperija
të qytezës
ja
citova vajzën
e njejtë me ty
por vetëm të njejtë

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Enes KISHEVIQ
(Bosnje dhe Hercegovinë)

SHPEJT FSHEHU NË MUA

Shpejt fshehu në mua,
Unë do fshihem në ty,
Që të mos di se kush jam,
Që të mos dish kush je ti.
Futu e tëra në mua,
Jashtë dimëri po përgatitet,
Vdekja është duke na kërkuar,
dhe shiko të mos jemi....

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Enes HALILOVIQ
(Serbi)

MURIMI

Sepse ai është asi deti:
Sa më shumë të pishë absurdin e kripur
etja të bëhet edhe më e madhe.

Sepse ai është asi guri:
Kudo që ta hedhësh,

qëllon kokën e vet.

Sepse ai është asi varri:
Sido që të të varrosin,
mbin tërfili me katër gjethe.

Sepse ajo është asi shtëpie:
Kudo që ta ndërtosh,
themelin e ka të çarë, dritaren të verbër.

Sepse ai është asi libri:
Cilëndo fletë të shfletosh,
në të shkruan *Hape fletën tjetër*.

(*përktheu Qazim Muja)*

POEZI BOTËRORE

John ASHBERY

VETËM DUKE ECUR PËRRETH

Çfarë emri kam unë për ty?
Sigurisht nuk do të ketë ndonjë emër për ty
Në kuptimin se yjet kanë emra
Të cilat dikush ua dha. Vetëm duke ecur vërdallë.

Një gjësend kurreshtje për disa,
Por ti je shumë i zënë
Rreth fshehtësive të strukura prapa shpirtit tënd
Të thuash shumë dhe të bredhësh përreth.

Duke iu qeshur vetes dhe të tjerëve.
Kjo bëhet një lloj vetmie
Por njëkohësisht duke zhvendos
Mosproduktivitetin, ashtu siç e kupton ti edhe një herë.

Se rruga më e gjatë është rruga më efektive,
Ajo që sillet përreth ishullit, dhe
Siç duket ti gjithmonë udhëton në rreth.
Dhe tash fundi është afër.

Pjesët e rrugëve luajnë porsi portokalli i hapur.
Aty brenda është drita misteri dhe ushqimi
Eja shikoje.
Jo për mua për atë.
Por nëse unë jam ende aty, lejo që ta shohim njëri-tjetrin.

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Erik Axel KARLFELD

SYTË E TU

Sytë e tu janë zjarr dhe shpirti im rrëshirë dhe katran
largohu, arratisu nga unë para se të ndizem dhe digjem
Jam një violinë me të gjitha këngët e shpirtit tënd
ti mund ta bësh të tingëllojë-si të duash- kur të duash
Largohu, kthehu tek unë! Dua të digjem, dua paqe.
Jam dëshirë, nostalgji limitesh mes vjeshtës dhe pranverës.
Të panatyrshme janë vargjet, e ti lëri t'i këndojnë të dehur e të çmendur
Kthehu, ik nga unë! Si një mbrëmje vjeshte lërmë të digjem.
Gëzimi i stuhisë pushton banderolën e artë të gjakut
derisa të bëhet qetësi dhe rrjedha e meridianit të zbehë hapat e tu.
Ti, e fundit mike e rinisë sime të zjarrtë.

(përktheu Gerta Bandilli)

Atahualupa YAPANQUI (1908-1992)

EL ARRIERO[1]

Me rërën shtjellat e erës vallëzojnë ,
e me vezullimën e shtegut shkëmborë dielli luan
duke e robëruar kështu magjinë e udhëve,
arrierro ecë, arrierro vazhdon të ecë.

Prej ere si flamur mjegulle i valvitet ponçoja
fyejt e shkurrnajave e përshendesin në kalim
e ai, nëpër brigje bën te lëvizë kopeja,
arrierro ecë, arrierro vazhdon të ecë

Të gjitha hallet dhe e gjithë kopeja,
nisen për të njëjtën udhë
neve hallet na takojne ,
kurse lopët për të tjerët janë

[1] **arrierro –** Term origjinal hispanik që perkthehet ne shqipe si MUSHKAR ose ai që shkon e punon me mushka dhe që kujdeset për to.

Perëndimi i kuqrremt tregon se nata po afrohet,
e edhe pse terri shtegut shkëmbore shkëlqimin ia shuan,
ai bën kopenë të lëvizë e të mos ndalohet,
arrierro ecë, arrierro vazhdon të ecë.

Me shpresë që nata t'i sjellë një kujtim
dhe vetminë t'ia lehtesojë,
ashtu si hijet e brigjeve që njëra mbi tjetrën palosen,
arrierro ecë, arrierro vazhdon të ecë.

(përktheu nga spanjishtja Nora Lamoja-LABREUIL)

Azis NESIN

HESHTJA

Hesht! Mos folë
është një gjë e turpshme
Flake zërin
hesht, tek e fundit
nëse fjala është argjend
heshtja është ar.
Fjalët e para
që kam dëgjuar në vogëli
e qara, e qeshura, loja
më thoshin:Hesht!
Në shkollë ma fshehën
gjysmë të vërtetën, më thoshin
-ç'të intereson ty: Hesht!
Më puthi e dashura ime e parë
me të cilën u dashurova dhe më tha
-Kujdes, mos thuaj gjë: shshshsh
Hesht!
Flake zërin tënd
e mos folë: Hesht!
dhe kjo zgjati deri në fund
të njëzet viteve të mia

Fjalimi i madh
Heshtja e vogël
Të ketë të paktën
një vend në projektet dhe ëndrrat e mia
midis vajtimeve dhe sarkazmës
ku unë frenoj fjalën,
sepse besoj që do të vijë
koha kur nuk do të rezistoj,
do të kundërshtoj e nuk do kem frikë
e shpresoj që në çdo rrethanë
do ta mbush fytin tim me një tingull,
një pështpëritje a një belbëzim
me të cilin do të thërras:
Flisni!

(përktheu Gerta Bandilli)

Antonio SANGERVASIO

MË DASHURO

Më dashuro,
madje gjate kësaj dite plot diell,
më ngrit drejt fluturimit të paamshueshëm,
mendo në mua,
Mendimet e mia
janë lule.

I kem të mjaftueshme drithërimat
e ngrohtësisë sate,
si deborë e purpurt që nuk shkrihet kurrë.
Mendo në mua,
më ler me ndjesinë ëndrrimtare
se jam i amshueshëm në zemrën tënde,
më shiko, drejt në sy,
sot madje.

(përktheu nga italishtja: June Malushqviq)

FLI HARAP I VOGËL[2]

Fli harap i vogël, fli
Nëna yte në fushë është duke punuar,
I vogli im i zi.

Thëllënza të vogla do sjellë ajo për ty
Fruta të shijshme do sjellë ajo për ty
Mish do sjellë ajo për ty
Shumë gjëra të tjera do sjellë ajo për ty

E në se harapi i vogel nuk don të fle,
Djalli i barrdhë do vie
Dhe papritmas, çap! këmbën e vockël do e kafshojë
Yakapumba yakapumba
Apumba yakapumba
Yakapumba yakapumba

Fli harap i vogël, fli
Nëna yte në fushë është duke punuar ,
I vogli im i zi.

Të punojë punë te rënda,PO
Të punojë edhe në se nuk e paguajnë, PO
Të punojë edhe në se e sëmuar është, PO
Të punojë edhe në se mban zi, PO
Për të voglin e saj të zi,
Të punojë, PO
Ate nuk i paguajnë, PO
Të punojë edhe në se sëmuret, PO
Të punojë edhe në se mbanë zi, PO

Fli harap i vogël, fli
Nëna yte në fushë është duke punuar ,
I vogli im i zi.
(përktheu nga spanjishtja Nora Lamoja-LABREUIL)

[2] "Duerme Negrito" është një këngë-ninullë shumë e njohur në Venezuelë dhe Kolumbi. Këndohej nga popullata jo e barrdhë e robëruar që eksploatohej pamëshirshem nga padronet. Teksti i kësaj ninulle u përpunua dhe iu prezentua publikut më të gjerë botërore nga Atahualpa Yupanqu

Nick CAVE

KU RRITEN TRËNDAFILAT E EGËR

Ata më thërrasin Trëndafil i egër
Por emri im është Elisa Dej
Pse më thrrasin ashtu nuk e di
Por unë quhem Elida Dej

Që nga dita e parë kur e pashë e dija që është ajo
Se si ajo mi nguli sytë dhe mu qesh
Për buzët e saja ishte ngjyra e trëndafilit
Që rritet pranë lumit, i egër dhe plot gjak

Kur ai trokiti në derën time dhe hyri në dhomë
Drithërima ime u qetësua në përqafimin e tij të sigurt
Ai do jetë njeriu im i parë, dhe me duar të kujdesshme
Ai do më fshijë lotët që do më rrjedhin në faqe

Në ditën e dytë unë i solla asaj një lule
Ishte më e bukur se çdo femër tjetër që kisha pa
I thashë, ”A e di ku rriten trëndafilat e egër
Kaq të ëmbël, të kuq si gjaku dhe të lirë?!

Në ditën e dytë ai erdhi me një trëndafil të vetëm
Dhe tha: ”A do të më japësh humbjet dhe pikëllimet tuaja?”
Unë e mohova me kokë, sikurse kur bie në shtrat
”Po të të shfaq trëndafilat a do të më pasoje?”

Në ditën e tretë ai më çoi te lumi
Më tregoi trëndafilat dhe ne u puthëm
Dhe gjëja e fundit që dëgjova ishte një fjalë e mbytur
Ndërsa ai u gjunjëzua mbi mua me një gurë në dorë të tij.

Në ditën e fundit shkuam atje ku rriten trëndafilat e egër
Dhe ajo u shtri në breg, era shëndriti porsi hajdut
Duke e puthur për lamtumirë, i thash, ”Çdo bukuri duhet të vdes”
Dhe poshtë huazova dhe mbjella një trëndafil mes dhëmbëve të saj
(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Silvia PLATH

LIMITI

Gruaja tashmë është e përkryer
Trupi i saj
I vdekur ka buzëqeshjen e plotësisë
Iluzioni i një qytetërimi grek
derdhet bollshëm në petkat e saj
Këmbët e saj
të zhveshura duket sikur thonë:
Arritëm deri këtu. Mbaroi.
Fëmijët e vdekur janë rehatuar
secili, gjarpër i bardhë,
Ka pirë brokën e vet të qumështit, tanimë bosh.
Ajo i mblodhi
sërish në trupin e saj si petalet
e një trëndafili të mbyllur kur në kopsht
ngrinë dhe u përgjakën aromat
nga thellësia e grykave të luleve të natës.
Hëna, spektatore e eshtrave të mbuluara,
nuk ka arsye të jetë e trishtuar.
Është mësuar me këto gjëra.
Duke kërcitur errësira tërhiqet prej saj.
(përktheu Gerta Bandilli)

Marcello BARBUSCIO

MIRË U PAFSHIM E DASHURA IME

Këtë po ta përkushtoj
me zemër në shuplakë të dorës
pa asnjë pikë gjaku të ngrohtë në të;
është kjo lamtumira
E dashura ime,
njëra nga të shumtat,
ngaqë shpesh mendoj,
sikur vetëm do mund të shihja
lotët e tua të dhëmbjes

ose vuajtjen nga dashuria yte për mua,
nuk do hezitoja të vdes
është kjo një dhuratë qe nuk mund të ta bëj tani,
pasi që
po pres vigjilien e ikjes
dhe me sy plot hakmarrje
do kërkoj të ta vjedh një shikim,
të cilin, heret a vonë do ta humbasësh
duke i kërkuar bebzat e mia,
e ndoshta ai shikim nemitur dhe i humbur
do t'më bëjë që serish ti kthehem marrëzive
qe i kam parmenduar për Ty
(Përktheu nga italishtja: June Malushqviq)

Benard IGHNER

ÇDO GJË DUHET NDËRRUAR

Çdo gjë duhet ndryshuar
Asgjë nuk rri e njejtë
Çdonjëri duhet ndryshuar
Asnjëri, asnjëri nuk rri i njejtë.

I riu bëhet plak
Dhe fshehtësia shpaloset
Për këtë është mënyra e kohës
Askush dhe asgjë nuk rri pa u ndryshuar

Nuk ka shumë gjëra në jetë për të cilat duhet të jeshë i sigurt
Përveç që shiu vie nga retë
Dielli shëndrit sipër reve
Zogu fluturon

Dimëri kthehet në pranverë
Zemra e plagosur do shërohet
Oh, por kurrë shumë shpejt
Askush dhe asgjë nuk rri pa u ndryshuar
Nina Simone, „Everything Must Change”
Përktheu dhe përshtati: Gazmend Çitaku

PROZË

Bahri Brisku

VOTIMET E MONTUARA NË ZOGAJ DHE PISTULL (rrethi i Ulqinit)

Lidhja Socialiste kishte organizuar votimet dhe përsëri, për të tretin mandat për kryetar kishin propozuar që të zgjedhet Vido Vuçeviqi, të cilin shqiptarët e këtyre fshatrave nuk e donin se dyshohet që ky pas LNÇ, kishte marrë pjesë në pushkatimet e disa shqiptarëve! Vidoja me intervenimin e sigurimsave dhe të kryesisë së LSPP të Ulqinit, parashihej që të zgjedhej për të tretën herë edhe pse pjesa dërrmuese e votuesve ishin shqiptar. Në fshatin Pistull, nuk kishte anjë malazias. Hasan Bojku në fillim të tubimit zgjedhor ishte zgjedhur për vërtetues të proçesverbalit zgjedhor. Pra, këta nuk ishin zgjedhje por emërime nga UDB-ja!

Një grup votuesish së bashku me Hasanin kishin vërtetuar që votimi po falsifikohej. Bëhej përpjekje që me çdo kusht të zgjedhnin Vidon. Votuesit shqiptar që përbënin shumicën absolute, mu lutën që të shkoj me ata në kryesinë e LSPP të komunës për ta biseduar këtë çështje, e cila kishte marrë kahje të pa drejtë! Shkuarja me këtë grup të pakënaqur të votuesve si gazetar, më obligonte që të njihem me detajet e kësaj çështje delikate! Shkuam në zyren e Kryetarit të Lidhjes Socialiste të komunës. Atje na priti kryetari Dul Holloviqi, i cili në pamje të parë reflektonte një farë çudie të ftohtë! Pasi që zëmë vendet Duli na pyeti për shkakun që kishim ardhë:

- Hë shokë, pse keni ardhur? – tha Duli.

Aty me mua ishin prezent: **Shyqyri Kraja, Mahmut Metani** dhe **Hasan Bojku**. Për ardhjen tonë foli Shyqyri Kraja, i cili veç të tjerave tha:

Propozimi juaj që për kryetar të LSPP në Zogaj dhe në fshatin Pistull, është i pa drejtë për dy arsye. Një: Vidoja në këtë pozitë ka qenë dy mandate dhe ky i bie të jetë i treti. Tash për kryetar më duket se është me të drejtë që të jetë një shqiptar, ku edhe në këtë vend janë shumicë! Dhe e dyta arsye, vazhdoi Kraja, është e pa drejtë përkrahja e Vidos nga ju dhe sigurimcat! Kësaj i vjen erë diktatoriale e cila metodë antiligjore është hedhur poshtë së bashku me Rankoviqin (më 1966). Kështu që ju

më nuk mund të veproni si përpara kur për një fjalë të burgosnin... Pas diskutimit të Shyqriut, u ngrit Hasan Bojku dhe tha:

- Kësaj nuk i thonë zgjedhje nge ne por emrim nga ju!
- Nëse ju vendosni që edhe më gjatë më e përkrahur Vidon së bashku me inspektorët e UDB-së, ne do të protestojmë në instancat e tjera.
- Populli nuk dëshiron që edhe më gjatë të jetë Vido Vuçeviqi kryetar! – foli Hasani me një zë të lartë!

Holloviqi u përpoq me e arsyetuar pa të drejtë propozimin e tyre, por Hasani u ngrit përsëri dhe me një reagim të zëshëm iu përgjegj Dulit.

- Edhe pas përgjigjes tënde qartas shihet që ti e përkrah dhe e ndihmon që ai të zgjedhet në këtë forum. Nuk ju vjen turp se çka jeni duke bërë!

Pas këtij foli Mahmud Metani i cili ishte nga Gorana, por tani ishte vendosur pranë Zogajve. Ky veç të tjerave tha:

- ”Edhe pse unë jam i propozuar që të zgjedhem si sekretar i LSP për Zogaj, është e pa drejtë zgjedhja e ish kryetarit, i cili i ka mbajtur dy mandate!”

Dul Holloviqi, duke mos ditur se si t’ju përgjigjet, na u drejtua me zë të lartë:

- ”Ju lutem delni jashta zyres! Ju nuk do të na impononi neve se kë do të zgjedhim atje!”
- Ne kemi ardhë që të merremi vesh me ty për çështje të parregullta dhe nuk dalim jashta, pa na dhënë përgjigjen përse ju doni me na i montuar zgjedhjet sipas qefit tuaj. Ne nuk e dëshirojmë për kryetar Vidon dhe fund! – tha Hasan Bojku.
- More ju po delni nga këtu se menjëherë po e thrras policinë – tha Dul Holloviqi.
- More thirre policinë sa të duash se ne nuk luajmë vendit! Ia ktheu Hasan Bojku.
- Ardhja e policisë u vanua shumë dhe nuk e dimë a kishte ardhur ndopak. Ne dolëm nga zyrja pa u përshendet me Dulin!

Pas këtij takimi, Dul Holli, kishte përpluar një Informatë, të cilën ia kishte dërguar të gjitha Organizatave politike të qytetit si dhe mediave informative të Malit të Zi. Kësaj Informatës i kishte psë dhënë njgyrë politike kundër meje, për të vetmin qëllim që ky ta dëshmojë veten për patriot jugosllav (me të cilën gjë) forconte pozicionin e vet dhe hapte rrugë që të ngjitet edhe më lartë në pushtet. Gjithashtu kishte kërkuar që të më zhgarkojë ”Rilindja” nga gazetaria!

Ndoshta për këtë ose për ndonjë shërbim tjetër, pas një kohe të shkurtër, Holloviqin e emrojnë për drejtor të Ndërmarrjes Hotelerike të Ulqinit, e cila ishte ndërmarrja më e madhe dhe më e pasur.

Në këtë mënyrë, edhe pas rënies së Ministrisë së UDB-es në Jugosllavi, kundra shqiptarëve vazhdonin përndjekjet dhe burgosjet. Në pushtet përparonin vetëm ata persona që për ndonjë pashkëpunim të tyre me sigurimcat. Qe disa shembuj:

Bashkëpunëtori i dëshmuar i tyre Riza Kovaçeviqi vetëm që doli si dëshmitar i rrejshëm kundra meje në Gjykatën e Qarkut në Titograd (sot Podgoricë) më 1983 edhe pse i pa shkolluar e punësojnë në sektorin e mbledhjes së tatimeve. Në këtë vend pune është edhe sot! Kështu Enver Kurtoviqi, i cili kishte dëshmuar poashtu kundra meje, e patën liruar nga burgu për vjedhjen e telit nëntokësor dhe e punësuan edhe pse nuk ishte i shkolluar! Pastaj është interesante që Dul Holloviqin e paten ngrit edhe pse kishte vetëm shkollën normale!

Sa për ngritjen e Dulit, thuhet që këtë ia kishte bërë Fadil Taipi, i cili në një tubim lidhur me shqiptarët në Jugosllavi (përpara të gjithëve) kishte thënë:

- ”Drejt me ju thënë, unë e ndiej vehten të turpëruar kur kaloj pranë flamurit shqiptar!”

Atëherë edhe pse flamuri shqiptar ishte i lirë që të përdoret në të gjitha rajonet ku jetojnë shqiptarët në ish-Jugosllavi! Ndaj emërohej në të gjitha forumet!...

Fadil Taipi kishte mbaru fakultetin e gjeografisë. Së pari e emruan me punë në Katërkollë, pastaj (pa konkurs) e emruan drejtor të shkollës ”Boshko Strugar” në Ulqin, më vonë e vendosën për drejtor të Gjimnazit, prej aty e vejnë kryetar të Komunës së Ulqinit. Dy mandate ka qenë deputet republikan, pastaj ishte edhe deputet federativ.

Ky së bashku me Hodo Resulbegoviqin, prej shqiptarëve së bashku me Ahmet Hoxhiqin, kanë qenë më të favorizuarit nga shqiptarët në Mal të Zi. Nëpërmjet tyre edhe farefisin e kishin pozicionuar për pozita të larta!

Për vendet e punësimit dhe për eprorët e ishpushtetit totalitar – komunist i cili në thelb ishte shoven dhe antishqiptar, fomalisht i shpallte nganjëherë konkurset e punësimit dhe kushtet të cilat nevoiteshin që t’i plotësojnë kandidatët, kurse për inkuadrimet e tilla komitetet e Partisë Komuniste, ju drejtoheshin ”Sektorit të inteligjendcës – UDB-së” për pëlqimin e tyre për çdo kandidat! Pastaj ata duke analizuar qëndrimet e

tyre në jetën private: a janë me ata qpo jo, sygjeronin komitetet e PK se cili nga kandidatët i plotëson kushtet!

Për deformime e tilla, mediat nuk mund të sfidonin qëndrimet e tyre. Zbatimi i të drejtave personale në të gjitha fushat ishte e pamundur. Kundërshtimet, sfidat dhe fraksionet, konsideroheshin çmendurira armiqësore nga ish pushteti monarko-komunist!

Personat që pa dallim kualitativ dhe gradë shkollore, që skishin pasë fat me kaluar nëpër sitat dhe shoshat e përshtatshmërisë, asnjëherë nuk arrinin që të vendosen në punësim aty sipas kualifikimeve i plotësonin të gjitha kërkesat! Është e tmerrshme për nevoja të ekzistencës, disa shqiptarë ishin të shtërnguar që të zbatojnë kërkesat e sigurimcave! Personat të cilët ishin të detyruar të bashkëpunojnë me të tillët, asnjëherë nuk pretendonin të dilinin si dëshmitarë nëpër gjykata kundra atyre që i kishte vënë në shënjestër UDB-eja. Të tillët në mënyra sekrete iu referoheshin vetëm me gojë!

*(Fragment shkëputur nga libri në dorëshkrim „*Odisejada autobiografike*“, Bahri Brisku)*

Hajredin PUFJA

KANGA E DASHUNIS SË SHKURTË

Natë vere. Hana rrezon detin e gjanë; limanin e vogël e gjirin e shtron me qilimin e argjendtë.

Nji plak i ulun në kalu[3] e mban në dorë tojën[4] e lëshueme larg moles, tue shique n'ujë gjarpnushet e dritave të gjirit. Nji e dridhun e përshkuese nëpër tojë, lajmroi se asht zanë peshku. Shpejt e mbledh misinën[5], por toja e hollë - u këput.

- Uf!

Nga trotuari dëgjohen kangë gëzimi, të përcjelluna me gitare. Kudo: në rrugicë, nën pishë e palmë, çifte të gëzueshëm.

"Ajo s' luen!.. Pse nuk luen!.. Ndoshta nuk e zgjedhin... Por, pse mos me e zgjedhë? A s'e shofin djaloshat bukurinë e saj? Sytë, gojën, vetullat..." – mendonte Besimi, djali zeshkan që rrinte i vetëm pranë nji tryeze dhe shiqonte kundruell vajzën bjonde me nji plakë.

"Asht zemërmirë dhe e kulturueme" – iu kujtue biseda e shokut ma të ngushtë, Fitimit. Kjo e shtyni që t'i afrohet plakës e ta lypë vajzën për kërcim, por – dy zemra u prenë nga fjalët e plakës:

- Asht e smundë....

*

Në plazhë bahej zhurmë e madhe. Djali rremonte në sandolinë[6] dhe me sy lypte diçka anash, përpara – vajzën.

Ajo ishte shtri në breg dhe kthye kryet n' anën tjetër – kah ana.

Sa e dalloi e ktheu sandolinën në breg. Duel. Fëmijt menjiherë u kapën për sandolinë.

- Mirë dita!

Ajo u çue e marrshëm.

- Jeni vetëm?.. A të shkojmë të shëtisim? – e pyeti djali.

- S' guxoj prej tezes – u përgjigj ajo.

- E unë kam mendue se e keni nanë! Ku asht?

- Shkoi në qytet, në treg.

---

[3] Cilindër çimentoje ose hekuri ku lidhen konopët e anijes.
[4] Disa dheta metra misinë.
[5] Prej najlloni.
[6] Mjet lundrimi sportiv për dy veta.

- Vonë ka me ardhë, hajde – e luti ai.

Hypën në sandolinë. Mezi u larguen prej bregut, se fëmijt u kapshin përmbrapa.

- Kah të shkojmë?

- Nuk e dij – u përgjigj ajo.

Prej shtymjeve të fuqishme, sandolina ecte shpejt tue lanë mbrapa rrotullat e rrjedhës së shkumueme.

Iu afruan Kalas. Ndersa ajo shikonte bedenet dhe kështjellën, shiqimet e djalit përcillshin trupin e saj prej gishtave të kambëve, pulpat, shalët e mbushuna, kukat, belin, fytyrën, duert... Kostimi i saj i kaltërt, i lagun, vente në pah të gjitha vijat e trupit të saj.

- A të shkojmë n'ato shkamije? – e pyeti ajo tue tregue me nji drejtim të fytyrës shkambijt nën bedene.

- Jo! Po shkojmë n'at gur ishull që i thonë "Guri i limanit" – u përgjigj djali, e ajo, pa folë, e shikoi gurin përmbrapa.

Kur mbrrin – vajza kceu në gur, e ai e qiti sandolinën në nji rrasë dhe i muer pajollat.[7]

- Shiqo! – thirri ajo tue i tregue pranë shkambit.

- Gjuetar peshku – u përgjegj djali, mbasi kqyri.

Gjuetari e çoi kryet prej ujit, i pau.

- Besim, a po ma jep pak sandolinën të shkoj në Bashkbylyk? – iu lut gjuetari.

- Mos po vonohesh?...

- Jo!..

- Merre.

N' anën prej detit, shkambit i ishte hjekë nji rrasë e madhe prej ku s'u shifte bregu. Ishte vend i mirë pa thepa.

Besimi pajollat që i kishte në dorë i vuni n'at vend dhe u ulen. Dy palë buzë u ngjitën e, mandej, shiqimet e të dyve u drejtuen kah deti. Nji pulëbardhë po fluturonte.

- Roja jonë e detit – tha ai tue qeshë.

Ajo buzëqeshi dhe u shtri. Buzët prapë u ngjitën...

Kaloi dreka. Dreka e tyne e kësaj dite, n'ate "gur" të vetmuem, ishin të puthunat e nxehta dhe përqafimet e forta.

Simbas vaporit që udhton për vendet tjera, ish tre mbas dreke, kur gjuetari u kthye. U arsyetue se s'kishte mujtë me ardhë prej rrjedhës që kishte qenë e fuqishme.

[7] Rrypa drrasash të bamuna si çardak mos me u lagë brenda në sandolinë kur njeriu ulet.

Kur mbrrijtën në breg, ai e pyeti – a do të dalë at natë.

Përgjegjen nuk e ndjeu, se ajo u largue shpejt tue vrapue.

*

Si çdo ditë edhe tash njerëzit lahen. Besimi i veshun me pantallona ma të gjata e fanelle marinarësh, e lypte vajzën në grumbujt e njerëzve, në ranë, në trotuar, në det. Por – kot. Shkoi dhe u ul te shkallët e para, prej kah njerëzit zbresin në ranë. Kur, mbas do kohe, u ndie britma e vaporit që po u gastonte.[8] Pau nji gja të papritur. Syt iu hapën dhe brofi në kambë.

Vajza me nji çantë në dorë, me plakën dhe nji hamall që po i bante valixhen, po vijoshin ranës.

Tash e kuptoi pse ajo nuk duel mbramë...

Iu afrue vaporit dhe, tue u mbajtë për cimë, ia shtriu vajzës nji pallasturë[9]. Ajo e shtrini dorën me e kapë. Dora e saj u mbështjell dhe u shtrëngue prej dorës së nxehtë të tij.

Sirena e vaporit lajmroi nisjen. Në sipërfaqen e ujit mbeti shiriti i përziem me shkumë.

(Botuar në: *"Jeta e re"* /revistë letrare/, Prishtinë, 1/1957; *"Pasqyra e të rinjve"*, fq. 103 – 105)

[8] Po i afreohej moles.

[9] Guacë e madhe.

Vildana Dibra - ZHUBI

AS FALJE NUK T'KËRKOVA

Babatë i dojnë varzat e veta shumë.

Baba im tregonte një tregim sa e sa herë dhe çdo herë që kujtoj babën më bie ndër mend edhe ai tregim.

-Kishte pasë qenë një baba dhe kishte pasë një vajzë. I vie koha asaj të martohej por nuk i mbushej syri babës vet, dhe i dukej që askush nuk është sa duhet i mirë për t'bijen e vet. Vendos një ditë, e merr vajzën e vet, e shtjen në një thes dhe troket derë më derë gjithë qytetin, dhe aty ku është ma s'miri edhe do t'a la bijen time, mendoi ai.

Shetit gjithë qytetin por më kot. Secilës shtëpi ia gjinte nga një "behane". Merr vajzën e vet përsëri në shtëpi se vajza e t'i është aq e përsosur sa nuk ka vend të përshtatshëm pët te, mendoi i ati.

- Ishte marsi i fundit . Jo për mua.

Ishte viti 1988.

Sarajeva para luftës kishte sharmin e rrallë. Qyteti ku çdo fe dhe çdo komb mund të ndihej si në shtëpi, por edhe ndihej sikur je në shumë qytete në të njajtën kohë. Gërshetim i shumë kulturave, religjioneve, qytetërimeve të ndryshme evropiane.

Më dukej që gjithë qyteti dhe gjithë bota ishin të miat.

Ashtu më dukej sa herë që prindërit e mi më vizitonin. Mëngjezet ishin aq të bukura kur aroma e kafes me zgjonte nga gjumi. Për Drenin dhe Artin të dy prindërit e mi ishin dhurata më e bukur.

Dy fytyra të dashura, të qeshura, të qeta që as mizën nuk e trazonin. Dy qenie që na ngrohnin zemrën.

Si dielli që hyn me rrezet e veta, ashtu më dukej kur vinin nana dhe baba im në Sarajevë. Dimrin e ftohtë të Sarajevës e shëndrronin në diell dhe rreze.

Më qeshte zemra, syri, shpirti.

Por dita dhe koha është shumë e poshtër dhe e pa mëshirë.

Ditët që prisja që ata të vijnë nuk kalonin dot, por kur vinin…. eh sa shpejtë kalonin.

Nuk kishte dëshirë apo fuqi t'i ndalë.

Dhe ashtu e kalon jabanxhiu.

Gëzim i takimit, hidhërim i ndarjes dhe përsëri shpresë që ditët kalojnë shpejtë deri në takimin tjetër.

Aroma e kafes, akshyreve të nanës, bureku dhe kiflet e mëngjezit, gazi i ngrohtë i tyre, nazeve për nipat, (çamarrokat e gjyshit i thoshte), loja me letra në mbramje me ngapak hile anash dhe gjithë bukurija e jetës që të duket është vetëm e jotja. Trokitjet e musafirëve të dashur në derë që vinin të takoheshin. Gjallëria e rrugës Vase Miskina, këngët e Merita Halilit, Eli Farës dhe Parashqevi Simaku. Ushtonin këngët shqipe në mes të qytetit të Sarajevës. Mburreshim me kombin dhe këngët tona !

-Por ah që janë ndarjet, ndarjet që të zgjojnë nga ato çaste magjike të jetës.

Marsi i fundit. Si çdo ndarje me lot malli, por me shpresë që shpejtë takohemi. Sa shumë i urrejë ato ndarje. Ikën të dy atë ditë marsi. Nuk e di pse kësaj here ishte baba ai që nuk u ndante dhe me aq mallë më përqafonte. Nganjëherë edhe më dukeshin të bukura lotët e mallit. Por jo atë ditë. Ikën dhe prapë ishte babai ai që sillte kokën pas dhe nuk ndalej.

-Ishte muaj i prillit kur mora lajmin që baba gjindet në spital por nuk është gjendja e rëndë.

Mu mbushën sytë lot dhe nuk më zinte vendi edhe pse gjendjen reale e kishin msheh prej meje. Vendi nuk më zinte.

U ula poshtë në duganjë, dhe kur më pa Samiu aq të mërzitur, menjiherë tha:

”Bani teshat gati dhe nisemi.”

Më kujtohet edhe drekën e mora me vehte sa e kisha kry dhe nuk na pritej .

N’jetën time kurr nuk jam ba gati më shpejtë.

U nisëm. Çdo herë këndoja rrugës për Ulqin, por jo edhe atë ditë prilli.

Mbrritëm në Tivar natën vonë. E luta Samiun, veç të ndalemi t’a shoh babën në spital dhe vazhdojmë për Ulqin.

Jo më tha se nuk na lejojnë masi që është vonë.

Me zemër komplet të thyer vazhduam për në Ulqin. Si të kaloj e mos t’i flasë babës në spital. Nejse, vazhduam rrugën. Ishte Ramazan. Kur u ofruam xhamisë Bregut gratë me bezhbezë po shkonin të gjitha në një drejtim. Jo në xhami. Diku tjetër. Mu ngri trupi.

Drejtoheshin në oborrin e shtëpisë tonë.

A është e mundur, psherëtiva rëndë, që më paska vdek baba “?

Jo jo ma ktheu Samiu, Ramazan dhe gratë kthehen shpijave të veta.

Pesë minutat deri në oborrin e shtëpisë ishin shëndrruar në një shekull.

Ishte kohë e mirë. Oborri ishte mbushur përplot.

Një rrugë Sarajevë -Ulqin i kishte kryer të gjitha. Ndarjen nga jeta, ardhja e kufomës dhe gjithë oborri i mbushur përplot me familje dhe dashamirë.

Dhe veç unë nuk arrita, t’a shoh edhe një herë. Nuk mrrita t’i kërkoj falje babës tim që e lëndova shumë që shkova jabanxhi. Nuk priti t’a pyes kush e hedh drandofilen sonte mbi kerr që mrrita.

Sa herë që më përcillte e kishte zakon e hidhte një lule mbi kerr kur ndaheshim. Ishte mynyra më burrërore t’i mshifte lotët e ndarjes.

Nuk arrita t’a pyes asgjë. Isha ngri komplet, e pa fjalë as lotët nuk dilnin.

Si të hyja në dhomë që nuk më hynte në kry që mund t’a shihja ndryshe. Më shponin dhimbjet shumë thellë. Fytyrat e zbehta më pritnin në pragun e derës, po nuk më shkonin këmbët tutje. T’ë tradhëtojnë gjymtyrët atëherë kur edhe zemra.

Isha msu me pa fytyrën e bukur të tij të qeshur çdo herë por edhe pak të jetimit. Ishte rritë jetim dhe në varfëri. Sa herë që na tregonte më dukej që mbulon një dhimbje . Ia fali kohës kaluar të gjitha ai. Nuk i harronte ditët e fëmijërisë, por buzëqeshja e tij kurr nuk i mungonte. Zemërgjërë, fisnik, i dashur për familjen dhe shoqërinë, por më i dashur për mu. Ishte mjeshtër me fsheh dhimbjen dhe lotët baba im. Jetimit dhe të varfërit i qajnë sytë, nuk ka nevojë të derdh lotë. Thojmë ne ulqinakët ” i qanë jetimllyku në sy .”

Më la pa lot, at natë prilli. Ishin mbledh lotët aq fort në zemër që mendoja se do pëlcas.

Lotët ishin tharë

Nuk kishin forcë me dalë!

Por jo, zemra nuk pëlcet. I lëshon lotët kur s’duhet. Më dalin lot kur shikoj film të dhimbshëm, kur shoh vuajtje nëpër botë ose edhe një këngë të bukur.

Por natën e 18 prillit 1988 ishin bërë gurë. Ishte marsi i fundit që pashë fytyrën e tij me lot.

Dhe sot kur më kujtohet tregimi i tij përshpërisë ngadalë.

Më falë babë që nuk të gjeta gjallë, se ky ishte çmimi i gyrbetit që as ti e as nana nuk e donit kurrë. Nuk kishit faj, por fatit nuk i ka ik askush që t'i ikja unë.

Sa herë që shkruaj për nanën më duket që baba më shikon dhe më thotë

– Po unë jam ai babë që e mban thesin me bijat e veta…dhe ka dëshirë që gjithë jetën t'i mbaj afër, kurse ti, ti ike dhe as gjallë nuk mrrine t'më gjesh"

Përse kurrë nuk i thashë, babë edhe ty të dua shumë si nanën, ndoshta
pak ma ….por jo as falje nuk mrrina t'i kërkoj!

Dhe pastaj më thonë, lehtë e ke ti që shkruan, çfren mallin!

….. po po lehtë, lehtë e kam sepse buzëqeshja është mjeshtër i përsosur i gjurmave të zemrës. Buzëqeshja është gdhendësi më i mirë i gjurmëve që mbesin në zemër, skulptor i gjurmëve të vrazhda.

Gazmend ÇITAKU

BUKURINA

Bukurina është një peshk, i cili mesatarisht rritet vetëm 10 centimetra. Është një gjallesë shumë e bukur që jeton vetëm në ujërat e pastra të detit. Nuk është interesant për t´u peshkuar, meqë është tejet i vogël, pastaj edhe bukuria që ka bën që të çmohet e nderohet, karshi mishit të shijshëm... Në të vërtetë dikur Bukurina ishte një vajzë shumë e bukur, e cila kishte jetuar në Kalanë e Ulqinit!? Ajo çdo ditë shkonte të gjuaj peshk me Gentin që ishte një moshatar i saj. Pothuaj gjithmonë të gjithë peshqit që zënin së pari i puthnin që pastaj t´ia kthejnë sërish detit.

Ditët kalonin ndërsa këta rriteshin e rriteshin. Bukurina u bë një vajzë shumë e pame. Atë filluan ta lakmojnë shumë djemë të familjeve të pasura, por zemra e Bukurinës rrihte vetëm për Gentin. Dashuria që ndjente ndaj Gentit s´e njihte askush, askurrkush përveçse atyre të dyve.

Një ditë në Ulqin ia behën disa piratë. Befasuan popullatën me plaçkitje të paskurpullta. Vjedhën mbarë e mbrapshtë, por tronditjen më të madhe e shkaktuan atëherë kur nga shtëpitë jashtë Kalasë filluan të tubojnë vajza e gra të reja.

Për shkak të sulmit të tyre, porta e Kalasë ishte kyçur, gjersa Bukurina e Genti kishin mbetur përjashta bedeneve. Piratët i gjetën dhe rrëmbyen Bukurinën. Genti në përpjekje ta mbrojë vajzën, e cila ia kishte zaptuar zemrën, mori plagë të rënda dhe mbeti shtrirë në breg të detit. Klithmat e Bukurinës ishin të tejbotshme, dëgjoheshi larg e thellë mirëpo askush nuk u gjet t'u vinte në ndihmë.

Pasi morën plaçkën, piratët ia mbathën me anijen e tyre të madhe si dhe kishin vjedhur të gjitha anijet e mëdha ulqinake që hasën aty. Derisa anijet çanin dallgët e detit, Bukurina rezistonte edhe pse i kishte duart dhe këmbët të lidhura me zinxhirë. Ajo një çast shfrytëzoi mosvëmendjen e hajdutëve për t´u hedhur prej anijes në det. Pasi i kishte gjymtyrët e lidhura me hekura të trashë, nuk mundi të notojë për të dalë në sipërfaqe të ujit. Kështu u fundos dhe humbi në thellësi të detit...

Nga muret e Kalasë të tërë ngjarjen e kishte parë nëna e Bukurinës. Kjo me të madhe kishte vajtuar e lutur Zotin që t´ia shpëtojë vajzën e vetme. Nga vaji e lutjet e mëdha amënore, Bukurina u kthye në jetë, por vetëm si një peshk i veçantë që sot mbanë emrin BUKURINË!

Bukurina noton e lirë pranë bedeneve të Kalasë me kurreshtje gjithnjë të përqëndruar tek i dashuri i saj; mos po e sheh e të mësojë rreth fatit të tij.

Sapo mbaroi gjyshja si për çudi erdhën edhe dritat. Artin e vogël e kishte zënë gjumi. Babai i tij e mori dhe, tek ia puthi lehtë faqet e kuqe, ngadalë e shtriu në krevat.

(Tregime të çuditshme nga Ulqini – Legjenda, botoi Diti&Oli, Ulqin, 2017)

PROZË BASHKËKOHORE MALAZEZE

Zuvdija HOXHIQ

TË GJITHË TË MITË

Gjyshi im është Cuf Berisha, bektashi, i biri i dervishit Ali, nipi i shehut Ramë, të birit të Riza Kodralisë, shehut të Teqes së Vogël, baba dervishit, emrin e të cilit mbaj - Zuvdi.

Teqenë e quajnë e Vjetër ose e Vogël, sepse është edhe njëra, edhe tjetra, më e vjetër se njëzet e tri teqe bektashiane, dy rifai, dy sadi dhe sajdi dhe një teqeje hamzevi, të cilën si dervishë e kanë qarkuar në skemën malore e fushore të Dukagjinit.

Dhe është më e njohura nga të gjitha.

E vendin e ka aty ku teqeve të tjera nuk mund t'u ishte, në prehër të Bjeshkëve të Nemuna, mes manastirit ortodoks në lindje dhe katedrales katolike në perëndim, "asnjë pëllëmbë më afër njërës dhe asnjë pëllëmbë më larg tjetrës". Nuk dihet kush e ka matur dhe e ka vëne re i pari, kallogjerët apo fretërit, por në këto asnjë njeri dhe asnjëherë nuk ka dyshuar. Është ngritur në anën e populluar me banorë katolikë, kur vëllezër që kanë kaluar në islam kanë qenë sa edhe kokrra në tespihe – tridhjetë e tre.

Është ndërtuar dhe ruajtur falë fisnikëve katolikë, të cilët e kanë shikuar si një diçka të re, e cila sapo nis, reziston, forcohet, tregohet se vlen, e ngritur me fuqinë e besimit dhe të shpirtit, e respektuar nga të vetët dhe të huajt.

"Nga ata që kanë ardhur në teqe, me kohë janë shtuar dhe nga ata që kanë kaluar pranë saj" – ka shkruar Pater Gjergj Jakobi, të cilin nga burgu i Shkodrës e kanë nxjerrë bektashinjtë, dhe që të mos e vrasin turqit, e kanë fshehur në Teqenë e Vogël dhe e kanë ndihmuar të vazhdojë misionin apostolik, duke parë tek ai sivëllain në rrugën e Zotit.

Bisedat për Teqenë e Vogël, për ngjarjet e pazakonshme, shehlerët dhe dervishët e saj, janë transmetuar dhe mbajtur mend nga njerëzit e të tri feve, dhe më shumë mes paraardhësve dhe pasardhësve të saj, nga ai që i pari "fenë e të parëve e zëvendësoi me fenë e pasardhësve", deri tek gjyshi im, Cuf Alia, shehu bektashi dhe Baba Sheqi, i cili besimin në Allah e zëvendësoi me besimin te njerëzit dhe që nuk ka hyrë as në teqe e as në emrat e perëndive, as të falet në xhami, gjë që babai i tij e ka

pranuar në pajtim e në paqe, duke e konsideruar këtë si dëshirë të Zotit dhe jo si gjynah i njeriut.

Në qoftë se fati e ka ndarë nga ata, mua me ta më ka lidhur. Më ka bërë shkrimtar, i cili beson se me këtë plotëson detyrimin e vet dhe merr përsipër borxhin e të atit. Së pari para gjyshit, të cilin nuk e kam njohur (nga kjo jetë ka shkuar tre vjet para lindjes sime), por për të kam ditur më shumë nga secili që ka jetuar me të. Kam trashëguar edhe tespihet e tij dhe një libër të trashë të tij ku ka shënuar çfarë i është dukur se vlen. Shumë herë e kam shfletuar, me besimin se do të mund të zbuloj se çfarë ka shkruar gjyshi im nga e djathta, në të majtë, me një penë të dendur dhe me bojën që e kanë përgatitur vetë dervishët.

Mulla Zejnullahu ka pranuar të më ndihmojë; e ka ditur mirë alfabetin arab dhe gjuhën e tij dhe të gjyshit, gjuhën shqipe. E ka hapur fletoren kuturu, dhe nuk është befasuar aspak pse është hapur në faqen, shkrimi i së cilës më ka lidhur me gjyshin:

"Një ditë, në prag të Aligjunit (Shën Ilisë), tri vera pas kalimit në jetën e përtejme, do të më lindë nipi, të cilit do t'i vë emrin e paraardhësit, shkrimtarit të këngëve hyjnore, të këngëve të përmbledhjeve dhe traktateve të mësuara, të mençurit dhe hyjnorit Zyh Dinit, mikut të nxënësve besimtarë myslimanë, njohësit të letërsisë në tri gjuhë: arabe, persiane dhe turke, të cilit i kanë humbur shumë dorëshkrime, disa janë ruajtur, janë edhe atje ku nuk shpresojmë. Në bibliotekën e Teqesë së Gjakovës kam gjetur dhe kam kopjuar poezinë e Zyhdisë:

Për këtë botë mos kij dhimbje fare,
Shijeve të saj shkundu sa më parë,

Në të asgjë e jotja nuk është,
Qefini gjithçka do ta mbulojë.

Gjithkush përmes urës së Sirhatit
Mëkatarin e presin engjëjt pyetës
Të mirin dyert e xhenetit.

Si dhe babai i tij, as edhe Zyhdiu nuk do të lidhet me teqenë, por do të ndihet dervish. Shoh rrugën nga shkon; për hajër shkoftë dhe arriftë kudo që të niset. Është thënë: Ashtu si të përkundi djepi, ashtu të mbuloftë shati, fati është i shkruar për secilin, kurse atij i është gjykuar

të trashëgojë Zyhdinë. Nëse për ne, të thjeshtët dhe fetarët, teqeja ka qenë bota, për të bota do të jetë teqeja. E para fjalë që do të mund të shqiptojë do të jetë një nga 99 emrat e bukur të Allahut dhe fjalës së parë – *shehadet*. Gjatë kohës së ramazanit – nga syfyri deri në iftar, do të shmangë marrjen e gjirit nga nëna, lutja e saj do të jetë ninulla më e bukur, dhe kur do ta zërë gjumi, kokën do ta drejtojë drejt Kiblës”...

2.

Kam lindur në prag të Aligjunit, në shenjën e Asadit, tamam ashtu siç ka shkruar gjyshi – tri vjet pasi ka shqiptuar shehadetin dhe engjëlli i ka ardhur për shpirtin. Kam qenë më i riu në familje, në gji të nënës, por kjo nënën nuk e ka kursyer që së bashku me të tjerët nga shtëpia dhe gjinia, me bijat dhe të afërtat, të punojë në shtëpi dhe në ara “sipas një shpërblimi”, nga i cili, me drejtësinë e “kokës së shtëpisë”, kanë përfituar të gjithë. Ndodhte që dikush të kish më pak, por askujt nuk i vinte keq.

Dita e bukur e verës së vonë, që Zoti e ka dhënë për vjeljen e dhuratave dhe prodhimeve të natyrës dhe të njeriut, ka grumbulluar shumë ndihmës, të madh e të vogël, të gjithë si për vete, të gëzuar, thërrasin dhe përgjigjen, shtyjnë njeri-tjetrin të mbërthejnë qetë dhe të shpejtojnë; nuk janë aty për t’i zënë nata dhe të gdhijnë, por të kryejnë të gjitha punët deri sa digjet qiriri i Zotit.

Gëzimin e tyre e ka ndarë dhe treguar gjithçka rreth e rrotull, fluturimet e tufave të zogjve (kaçubarët) dhe fuga, zukatja dhe zhurma e bletëve dhe e mizave, rrezet e diellit në tufën e artë të misrit, fëmijët dhe kanakarët e tyre; qentë dhe këlyshët që vrapojnë pa u lodhur, ngacmojnë njeri-tjetrin dhe lehin, nuhasin me feçkë dhe shtyhen, kënaqen duke luajtur.

Nëna e ka vendosur djepin në hije, nën degët e shartuara. Është larguar për pak kohë, për të mos e parë duke më dhënë gji. Ka shkuar dhe si me krahë kthehej; shkonte drejt zogut të saj, sisorit që gugaste.

Përnjëherësh ka klithur dhe bërtitur, ka ngrirë në vend dhe i ka humbur fuqia. Vrapuan drejt saj, kanë parë atë që ka parë edhe ajo para tyre. Nga djepi është tërhequr zvarrë një gjarpër, i cili është ngjitur drejt në mollë dhe është mbështjellë rreth degës. Të gjithë janë ngrirë, pa folur. Xhaxhai Braho më është afruar, më ka marrë nga djepi, lakuriq, pelenat kanë qenë të mbështjella. I kam shtrirë duart e vogla, i qeshur, kam puqur buzët, më kanë dëgjuar se si hukas me kënaqësi.

Në duar kam pasur tespihet e bardha. Menjëherë i kanë njohur; të gjyshit, të Cuf Alisë. Kanë humbur kur e kanë lëshuar në varr. E mbajnë mend mirë, gjithmonë i ka mbajtur dhe i ka sjellë kokrrat.

Kanë shikuar të shqetësuar ato edhe mua. Kur ka ardhur në vete, nëna më puthte dhe përqafonte, herë mua e herë tespihet, që kaluan dorë më dorë. Të gjithë i kanë shikuar dhe e kanë ditur se do të jenë të mijat. Sipër, nga dega, mbi ta dhe mbi tespihet ka shikuar edhe gjarpri.

I kanë treguar për këtë imamit, Haxhi-hafiz Smajlit. U ka thënë: "Nuk ka hukatur, por ka përsëritur emrin e Allahut

– Hu...Hu... Kjo nuk është e çuditshme. Çudi nuk ka, vetëm se njohuritë tona janë të kufizuara. Pyetni dervishët, ata e dinë më mirë se të tjerët. I dërguari i Zotit ka thënë: Pyetni njerëzit e ditur në qoftë se nuk dini. Pyetni dervishët edhe nëse mendoni se dini.

Në qoftë se fëmija gjashtëvjeçar di përmendsh Kuranin, të gjitha 114 suret dhe 6236 ajetet, dhe ai në to shumë herë është bindur, bile edhe ajo me gjarprin dhe fëmijën, është me dëshirën e Allahut.

Ai gjarpër është mbrojtësi i fëmijës. Gjarpri ruan edhe shtëpinë, edhe pasurinë e fshehur nën pllaka ose diku tjetër, gjarpri do të ruajë edhe Zuvdinë.

A e keni harruar vallë se nj herë, gjatë kohës kur Cuf Alia po falej në të premte, nga muri ka ditur të dalë një gjarpër dhe ndërsa ai është ulur, i ka kaluar pranë kokës dhe nuk ka lëvizur nga vendi?

A keni harruar se mbi derën e tyrbes së Ramës, Ramës tuaj, është skalitur gjarpri që u ngjall, shkoi diku dhe pastaj u kthye ku edhe ka qenë?

Sa herë e kanë parë para pragut të tyrbes së Ramës, të cilin atëherë, ata që mbajnë ndonjë mëkat, nuk kanë guxuar ta kalojnë?"

3.

Falënderoj mulla Zejnullahun për kohën dhe mundimin që ka bërë duke nxjerrë nga fletoret e gjyshit dhe përkthyer ato që ka ditur se do të më interesojnë, në ndihmën që të gjendem me njerëzit, të cilët më kanë treguar për Fletoren e vjetër dhe për dervishët këto që po shkruaj.

E bëj këtë për të mijtë, më të afërtit, ndoshta si unë në fillim, edhe ata në fund, ato tregime dhe ngjarje do t'i bëjnë si gojëdhëna të lindura nga natyra e njeriut që të zmadhojë gjithçka që e ka të paqartë dhe që duke i përsëritur gjatë viteve, të njëjtat biseda, t'i bëjë të besueshme.

Teqeja e madhe ose e vogël është mbi rrafshin e lartë të Altarit. Dervishët tregojnë se aty, siç e tregon edhe emri, ka qenë vend i shenjtë. Edhe sot në afërsi, dikush ndesh në pllaka guri me ngjyra të ndryshme, pjesë tavolinash rrumbullake. Dervishët tregojnë edhe thellime në shkëmbinj, në të cilat në kohë të vjetra kanë mbajtur gjarprin, ruajtësin dhe mbrojtësin. Shkëmbi është i lëmuar, i thelluar lart, çudi se si dhe prej aty u shfaq gjarpri.

"E, që të rrëshqasë vetë, besa nuk mundet, as ta sjellë dikush dhe ta vendosë aty nuk mundet as kjo, do të dihej, do të gjendej këmisha e tij"...

Është traditë që në Aligjun, në Altar dalin shumë njerëz dhe sapo rrezet e diellit bëjnë me argjend majën e malit, ngrenë duart drejt qiellit, duke thënë lutjen e mësuar që në lindje.

Shumë pak e kanë të njohur ndonjë fjalë, por u duket e njohur, zoti e di se cila gjuhë është ajo, nuk e kuptojnë, por besojnë në fuqinë e saj.

Pas ceremonisë, shkojnë në rresht deri tek teqeja e vogël ku i presin dervishët me mjaltë dhe lëngje nga frutat e pyllit. Teqeja është e hapur për gjithkënd që dëshiron të futet në të.

Dhe ajo, çfarë duket menjëherë se as brenda, as jashtë, as nga madhësia, nuk i ngjan asnjë tjetre. Sa do të jetë bota, të gjithë të mësyjnë, në të ka vend për të gjithë, sikur i zgjerohen muret. Nga teqetë e tjera dallohet për këtë se ashtu si ditën, duket edhe natën "e ndriçuar me fletët e hapura të Kuranit" dhe si me llamba të ndezura, me nurin e varrit të fisnikut Rahim Dedesë dhe tyrbes pranë saj. Teqeja gjatë të gjithë vitit është e hapur, edhe ditën, edhe natën. Dhe kur furtuna fshikullon, dhe drurët e ngrirë pëlcasin, thyhen dhe bien, në të është ngrohtë. Zjarri nuk është ndezur kurrë, dervishët rreth saj shkojnë zbathur ose me nallane, me këmishë të zbërthyer.

Kush do të nisej drejt saj me zemër të pastër, do të arrinte aty lehtë; në të do të gjente më shumë nga çka kërkuar. Ka pasur edhe të tillë me qëllime të këqija, të cilët do ta futnin veten në nevoja dhe rreziqe. Do të endeshin, do të humbnin, do silleshin qark. Do t'i hante nata ose do t'i shqyenin egërsirat nga ulërimat e të cilave janë tmerruar, sikur të mos i ndihmonin dervishët, duke i mbuluar me mbulesën e dervishit, duke i futur në teqe dhe duke i larë me ujë të ftohtë akull. Kush hynte në të, nuk do të ishte i njëjtë sikur dilte. Në të do të gjente atë që kish humbur, i mësuar se ajo që i mungon, është më pak nga ajo që ka pasur.

Patër Gjergj Jakobi ka shkruar se "Teqeja e Vjetër ose e Vogël, siç e quan dikush, është në vendin ku kryqëzohen rrugët dhe ndahen erërat,

dhe mbi të, nga shkëmbi shpërthejnë dy burime të forta. Ai nga ana e lindjes rrjedh drejt perëndimit; ai nga perëndimi drejt lindjes dhe bashkimin e kanë poshtë teqesë. Aty qetësohen dhe shtrëngohen, zhurma pothuaj nuk u dëgjohet, uji është i pastër dhe ,,në derdhjet, ndërron ngjyrë, si edhe troftat, luspat e të cilave shkëlqejnë si kokrra qelibari. Përroi është plot me to, askush nuk i zë, dervishët i ushqejnë, si edhe shqiponjat, të cilat janë aq mbi teqe sa edhe ka në të dervishë. Kur ndonjë dervish kalon në ahiret, një shqiponjë zhduket. Shqipet nuk i sulmojnë zogjtë e tjerë, as edhe krijesat më të vogla, as edhe gjarpërinjtë që janë kudo, por nuk u trembet askush. Disa çmbështillen dhe lëkunden, disa lëvizin e hukasin, rrotullohen në gurin me diell, mbështillen rreth degëve, rrëshqasin deri tek pragu i teqesë dhe kthehen. Nuk mbahet mend se kanë kafshuar kënd. Sapo zgjohen nga gjumi letargjik dhe heqin këmishën, fërkojnë sytë me barin onis, për të kthyer shikimin e dobësuar. Farën e onisit e përdorin dhe dervishët, sepse kjo u përmirëson më mirë shikimin për leximin e Kuranit, ndaj mund ta lexojnë dhe në errësirë. Në kopsht kultivojnë bimë të ndryshme, i thajnë dhe i ruajnë, dinë t'i përdorin më mirë se mjekët tanë.

Kanë edhe një koshere të madhe. Mbajnë bletë, për të cilat thuhet se janë krijesat më të mira të Allahut. Bletët janë të mëdha si edhe grethat, kanë një thumb të gjatë me të cilin depërtojnë deri në fund të lules dhe thithin nektarin dhe lëngun. Nuk ka mjaltë më të shijshme dhe më të shëndetshme se mjalti i tyre.

Pas teqesë, gati ngjitur me murin, është tisa me një trung të pazakonshëm dhe lartësi të madhe. Thonë se është një mijë vjetësh, përmendet në krisobullën e Deçanit dhe besojnë se është në gjysmën e jetës. Rrufetë bien në pishat dhe molikat, i ndajnë, i djegin, i bëjnë ura zjarri dhe kërcej të thatë, i shtypin deri në rrënjë, kurse asaj që është deri në gjysmë më e lartë "kurrë nuk i kërcënohen..." Nga farat e kokrrave të tyre dervishët bëjnë lëngje të shijshme si dhe shurupe mjekësore të dendura. Ata, me anë të bimëve, dinë si do të jetë koha dhe ç'kohë e ditës është. Lulet e minjve hapen dhe drejtohen nga ora nëntë deri në mesditë; lulja qumështore hapet në ora shtatë deri në pesë pasdreke; lulja shpatë mbyllet para se të bjerë shi; tërfili me mbledhjen e gjetheve paralajmëron shi dhe gjëmime.

Rreth teqesë rriten lulet "shehlere" të cilat nuk mund t'i mbjellë askush. Populli i quan "fyelli i dervishëve", sepse kur fryn era, ato pushojnë të kenë aromë, lëshojnë tinguj të ngjashëm me fyellin. Lulet ngjajnë me kapën e bektashinjve – të bardha, me katër rrudha,

ngjethen, duken ato sikur sillen dervishët. Thonë se edhe era e tyre kuron, ashtu sikur ato më të mirat se rehani i ëmbël forcojnë zemrën, shmangin dhimbjen e kokës dhe gjumin e bëjnë më të mirë dhe më të këndshëm.

Në kopsht kanë bimë të ndryshme erëzash dhe zagna qepësh, qepë me kokë të errëta dhe me gjeth, të drejtuara sikur të ishin hunj. Hanë pak, as gjysmë kokë qepe, një kafshatë bukë të pjekur në kaki, ku ka për një, ka për tre, pinë ujë të vakët, thonë se më shumë varre ka hapur luga se shati. Një herë në vit, në prag të ditës së shenjtë të Nevruzit, hanë nga një ose dy hurma, të cilat Profeti i ka dashur më shumë...

Më ka treguar Dervish Agani se kur një tërmet e ka shpërthyer bjeshkën dhe ka shkatërruar bredhat dhe pishat shekullore, shembur kullat, shpërthyer kështjellën, Teqeja e vjetër ka mbetur si ishte më parë. Me dëshirë të Zotit, tridhjetë e tri herë është rrotulluar dhe kthyer dhe asgjë në të nuk ka luajtur dhe lëvizur. Vetëm kudumet, hallkat bin-bir, sazet e fyelli janë dëgjuar. Sheh Hajredinin e kanë gjetur mbi Kuranin e hapur. As ka dëgjuar, as ka parë e as ka ndjerë gjë. Kur i kanë thënë se sa është tundur dhe shkundur, i ka shikuar dhe si me çudi; si ka mundur të dijë kur ka qenë duke mësuar Kuranin?! Dhe ka vazhduar të lexojë".

Dhe fra Lorenco Santori, napolitani i zgjuar, i cili qytetin rrëzë Vezuvit, mirësinë e Mesdheut dhe diellin e jugut e ka zëvendësuar me flakën e qiriut, duke rrezikuar që nizamët ose fanatikët fetarë të mos e vrasin, ta hedhin në humnerë, mbrojtjen e parë dhe më të rëndësishme e ka gjetur tek dervishët e Teqesë së vogël. Besimtarin e thjeshtë e kanë dashur dhe pranuar si njërin nga vëllezërit. Po të mos mbante qyrk, do të ishte si ne; po të mos mbanim qyrk, do të ishim si ai" - ka thënë Mul Sokoli, i cili njëherë, për të mashtruar nizamët, i ka ndërruar rrobat me të, megjithëse ishin gati të njëjta. Santori ka mbajtur një veshje të vjetër katolike, ka shkuar me nallane ose sandale. Pamjen dhe ndikimin e tij mes katolikëve të varfër e kanë përjetuar si ndihmë dhe shërbim ndaj tyre. Ka mësuar gjuhën shqipe, prej dervishit ka mësuar turqisht, kurse ata i ka mësuar italisht. Kur e kanë thirrur të ndryshojë vendin e shërbimit dhe i kanë ofruar një vend më të mirë, që të zgjedhë se ku do, u është lutur që ta lënë aty ku "ka njeh dhe është mësuar".

"Këtu më ka dërguar Zoti", – ka thënë.

Nga kisha e Zhupës deri tek Teqeja e vogël kanë qenë rreth nëntë mijë hapa; nga zemra e tij deri tek zemra e tyre asnjë hap. Kanë vizituar shpesh njeri-tjetrin. Të entuziazmuar me biseda shpesh janë gdhirë, duke mos dremitur asnjë lëvizje syri. Ka ndodhur që gjithë natën ta gdhijnë

dhe të mos flasin asnjë fjalë. Mirë është thënë: Heshtja e nxënësit është më me vlerë se lutja.

Njëherë, kur ka përmendur Patër Gjergj Jakobin dhe bisedën e tij për tërmetin e Teqenë e vogël, Sartini i ka pyetur për kryengritjen e jeniçerëve në Kostandinopojë, të cilën e kanë filluar bektashinjtë dhe për këtë shkak kanë pësuar. Jeniçerët kanë rrëzuar kazanët dhe kanë goditur mbi to, kanë prerë disa kujdestarë dhe Jonuz Pashën me ta, çfarë e ka shfrytëzuar Mahmud Pasha që të ndahet me jeniçerët dhe aq më shumë me bektashinjtë shqiptarë, gjithnjë e më rrebelues, të mbledhur në shoqëri të fshehta, duke dobësuar perandorinë, të cilës i kanë ndihmuar më shumë se të tjerët që të jetë e fuqishme. Teqetë janë djegur, kokat janë prerë dhe rrokullisur, duke goditur njëra-tjetrën duke vringëlluar, Bosfori ka qenë i mbushur me trupat e dervishëve.

Teqeja e vogël ka mbetur e paprekur. As pasha i Shkodrës e as ai i Pejës nuk kanë guxuar ta sulmojnë, duke u frikuar nga bashkimi i Berishës, Mirditës, Kelmendit, Kastratit dhe fiseve të tjera që do t'i binin vuajtje perandorisë.

Aq sa janë dobësuar në Turqi, po aq janë forcuar në Shqipëri. Është përfolur se çdo bektashi nuk është shqiptar, por çdo shqiptar është bektashi. Në Shqipëri kanë mësyrë
mbështetës nga Maqedonia, Greqia, Rumania, nga jugu i Italisë. Për një kohë të shkurtër janë rindërtuar teqetë e vjetra dhe janë ndërtuar të rejat, por edhe kishat dhe Katedralja e Shkodrës, më e madhja në Ballkan. Shehlerët janë takuar në teqenë e vogël dhe kanë vendosur të thërrasin edhe përfaqësuesit shpirtërorë katolikë dhe ortodoksë në Manastir ose Tiranë, që të zgjedhin udhëheqësit dhe "të realizojnë ëndrrën shekullore të popullit më të vjetër në Ballkan".

"Ne nuk jemi turq, ne jemi shqiptarë" – është dëgjuar gjithnjë e më shumë nëpër teqetë, në xhamitë dhe kishat, në bashkimet në fshatra dhe në qytete. Pashallarët, fretërit, shkrimtarët, bejlerët, kanë përgatitur popullin për atë që do të ndodhte më vonë.

E lënduar, duke u ndjerë e tradhtuar dhe e rrezikuar, Turqia ka filluar një luftë të rreptë, duke ua bërë rezistencën dhe lëvizjen më të fortë.

Ata, tek të cilët ka pasur më shumë shpresë, janë ngritur kundër saj.

"Kemi rritur gjarprin në gji" – ka thënë Sulltani.

"Gjarprin që ha bishtin e vet", – ka përsëritur Topall Pasha, duke mos ditur se çfarë ka dashur të thotë me këtë.

Përktheu Dimitrov Popoviq, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe
Redaktor në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore, Podgoricë

Senad KARAGJUZOVIQ (Tivar, Mali i Zi)

DHOMA PREJ GURIT TË KALTËR

Në shtëpinë time të vjetër, më shumë se njëqind e pesëdhjetë vjet (rrënimin e të cilës e filloi kur ra tërmeti i 68-tës kurse e mbaroi ai pasuesi i vitit 1979), në kat ka qenë një dhomë gjumi, në të cilën për të fjetë së pari shkonim unë, vëllau, motra e pas nesh me avashllëk[10] edhe nëna jonë e cila gjithsesi së pari na mbyllte gojën, ndezte llambën dhe fikte dritën kryesore.

Pastaj, lart deri në dhomën e fjetjes, shkallëve të palatuara të drurit, do vinte babai me hapa të lodhur mullisi, do hapte kapakun e orës së vjetër të murit dhe kurdiste zymrekun[11] e saj, pastaj kthente çelësin e kurdisjes në vendin e vet brenda orës, mbyllte kapakun dhe pabëzërë shtrihej në anën e vet të krevatit. Kurrë nuk ka fjetë me pizhame, flinte në brekë. Ishte kjo koha kur *boksericat*[12] e sodit quheshin *brekë meshkujsh* (dhe ato i kishte dy nuancash, të hirta ose bojëqielli e çilët), gjithsesi të hekurosura dhe nxjerrë vijën porsi pantallonave. Në të vërtetë ishte kjo koha – siç thoshte babai im – kur *shkronja* dhe *detyrimisht* shkruhej me pikë të përdredhur çuditëse... Sot gazetarët dhe ata të cilët shkruajnë shpejtë e shkapërcejnë këtë shenjë pikësimi, gjë që ja edhe unë jam duke e bërë që nga koha kur iku socializmi.

Pra, siç thashë, do hiqte unazën me gurë të zi oniksi (kara tash), kurdiste pak përmbi gjysmë *Darwill-in* e tij të kahershëm dhe lehtë e më zë të vrazhdë do pështpëriste ”fike”, dhe nëna do fike lambën e vajgurit. Dhoma ishte shumë e madhe apo ndoshta unë isha shumë i vogël, kush e di (fëmijët të gjitha i shohin nga perspektiva e bretkosës), dhe gjithmonë ishte e lyer në bojë qielli të çiltë.

Dritaret e mëdha, një nga veriu dhe dy nga ana perëndimore e shtëpisë, ishin punë dore të marangozit – *dogramaçi*[13] (sikurse edhe e gjithë mobileria e paraluftës) dhe të lyera në jeshile[14], gjithashtu edhe tavani nga i cili kacavarej llusteri i porculanit me vizatime bojëqielli (i cili ishte i prodhuar viteve të shtatëdhjeta në mënyrë që populllësia e

[10] AVASH ndajf. bised. Pa u nxituar, ngadalë, jo shpejt.
[11] Zymrek turcizëm, mekanizmi kryesor i orës i cili kurdiset, zemra e orës
[12] Veshje e brendshme e hollë, që mbahet në trup nga mesi e poshtë; të mbathura, mbathje. Kanë marrë emrin si mbathje që veshin bokserët.
[13] Dogramaçi (turc.) - Marangoz që çdo gjë punon me dorë, pa ndihmën e makinave
[14] Jeshil (turc.) ngjyrë e gjelbërt

varfër socialiste e cila jetonte në territorin e RSFJ-së të kujtojë madhështinë e Mao Ce Dunit dhe Kinës vëllazërore)!

Po perdet nga tiftiku[15] i tejdukshëm që vareshin nga tavani e deri në dysheme!? Ato duhej të na kujtonin (neve *shokëve*) perdet nga Bosfori dhe vilën–pronën, dhuratën e Kemal Ataturkut për Josip Brozin! (Edhe diçka para se të harroj: të gjitha ato shtëpi të vjetra që nga koha e *Portës* ishin prej guri dhe përplot me akrepa[16], të cilët ditë-natë *i përbinim* me nallane por pa sukses. Fakt është se këto insekte të mrekullueshme me pamje tmerruese askend asnjëherë nuk e kanë pickuar.

Verës i linim dritaret hapur, e në ramat e tyre ishin rrjetat për mushkaja që ishin të ndryshkura pasi që askush nuk i hiqte dimër-verë... Gjatë mbrëmjeve me hënë të plotë të gjitha këto i jepnin një tonalitet fëmijërisë sime, kujtesës sime të pashlyer, të cilën një ditë do ta marr me vete në dhé. NËNKALAJA e bukur dhe e vjetër definitivisht u fshi nga tërmeti i nëntë e ca shkallë merkali (nëse mund t'u besojmë seizmografëve), kurse sot sikur nuk ekziston fare!

Aty jetojnë disa të huaj, sepse vendasit i shitën pronat e veta pothuaj falë, kurse ata që mbeten ndërtuan shtëpi të stilit soc-realist dhe me këmbngulje distancohen nga ardhacakët, sikur ata të ishin lebroz e jo njerëz të mishit dhe gjakut.

... Mbrëmjeve me hënë të plotë, rrija deri vonë zgjuar dhe dëgjoja gërhitjet e të ngujuarve të dhomës. Era e lehtë që fryente mbrëmjeve i nginte deri lart në tavan perdet e tiftikut, ndërsa aroma e lule-topçës dhe zambakut të bardhë përhapej nëpër tërë dhomën që nga kopshti.

Ora e murit prej mesingu, i cili rrinte varur në murin e shtuar mbi bibliotekën e babait (bibliotekë e cila kryesisht ishte me literaturë marksiste), shëndrinte në dritën e hënës. Pra, kur ora ta ketë numruar njëherë kohën e vet e pastaj timen, gjumashët e fjetur njëherë do rrotulloheshin dhe do vazhdonin të kërhitnin. A ëndërrova, apo ishte kjo dhoma e fëmijërisë sime së hershme? A ishte e gjitha magji? Gënjshtër? Fantazi? Krevati i madh dopio në të cilin flinin nëna dhe babai, pastaj shilteja në të cilin flinim unë, vëllau dhe motra, dollapi i drurit si dhe ormani trekrahesh në të cilin fshihesha duke pritur që motra të vinte para pasqyrës dhe ta shihte vehten e saj gjatë ndezjes së cigares e cila

[15] Lesh angora, lesh i shprishur

[16] AKREP I m. sh. zool. Kafshë e vogël helmuese me ngjyrë të zezë, me këmbë nyja-nyja, me dy gëthapë përpara dhe me një thumb të përkulshëm nga pas; sfurkth, përçollak.

gjithmonë i shpëtonte nga goja kur unë furishëm dilja nga ormari dhe i kërkoja një tym, kurse ajo me fytyrë të zbehtë do të ngrinte cigaren nga toka duke u mbajtur për zemre...

A është kjo ëndërr?

Jooo, s'ka mundësi!!

Sot jam mëse i sigurt, që dhomën të cilën pjesërisht e shpjegova dhe në të cilën herën e fundit kam fjet më 15 prill të vitit 1979 deri në orën gjashtë të mëngjesit, ishte e diele dhe do duhej të shkoja e të blej një kilogram mish të grimë, dy pako *Filter 57* dhe një supë gjeli *Podravkë* të njohur përnga gjeli legjendar në ambalazh, nuk ishte ëndërr, nuk ishte iluzion. Sot, pas gjithë atyre viteve e di se ajo dhomë ende ekziston në kokën e motrës sime, të vëllait dhe rradaken time (nëse këtë timen mund ta quaj kokë)!

E materializojmë sipas nevojës së qendrës emotive të trurit tonë...

Ja pra, ky ishte një homazh për dhomën prej gurit bojëqielli nga koha e *Portës*, kurse për këto shtëpitë e reja të cilat unë, motra dhe vëllau panumërsisht i kemi ndërru deri më sot, vallë, nuk kemi çfarë të themi, përveç se i takojnë një fëmijërie të huaj.

Për ato le të kujdesen këta kalamjt e sodit, të cilët s'kanë asgjë tjetër përveç kompujerëve, orendive të shtrenjta dhe O Zot shtëpi që të kujtojnë tansporterë ndërgalaktik.

Botuar në Antologjinë e popujve pakicë në Mal të Zi, Na putu putnici, 2015
(*përktheu Gazmend Çitaku)*

PROZË BOTËRORE

Paolo COELHO

SEKRETI I LUMTURISE....

Njëherë e një kohë, një tregtar, dërgoi të birin e tij që të mësonte sekretin e lumturisë tek më i mençuri dhe i urti i të gjithë njerëzve.
Djali udhëtoi i rraskapitur për dyzet ditë në shkretërirë, derisa arriti në një kështjellë të mrekullueshme në majën e një mali. Atje jetonte "I Urti" që kërkonte djali.
Në vend që të gjente një njeri të shenjtë... heroi yne hyri në një sallë ku mbretëronte një lëvizje e pareshtur, një zhurmë e madhe, një gjendje e çmendur: tregtarë që hynin e dilnin, gjithandej grupe të vegjël që flisnin me zë të lartë, një orkestër që luante melodi të ëmbla. Diku aty ishte edhe një tavolinë e mbushur plot e përplotë me të gjitha llojet e gjellëve më të shijshme dhe më të famshme të asaj krahine.
"I Urti" fliste me të gjithë, ndaj djalit i duhej të priste dy orë që t'i vinte radha për tu pritur nga ai.
"I Urti" e dëgjoi me vëmendje arsyen e vizitës së djalit, por i tha djalit që në atë moment nuk kishte kohë të mjaftueshme që t'i shpjegonte atij sekretin e lumturisë. Edhe i sugjeroi që të bënte një shetitje nëpër pallat e të kthehej pas dy orësh.
Ndërkohë dua të të kërkoj një nder, i tha plaku, duke i dhënë në dorë një lugë të vogël çaji, në të cilin hodhi dy pika vaj.
"Kur të ecësh, mbaje këtë lugë në dorë edhe ki kujdes mos të rrëzosh në tokë pikat e vajit".
Djali filloi të ngjiste e zbriste shkallët e gjata të pallatit, duke mos i shkëputur sytë për asnjë moment nga pikat e vajit në lugën që mbante në dorë. Në krye të dy oreve, djali rikthehet tek "I Urti".
Atëherë më thuaj i thotë "I Urti", a i pe qilimat e mrekullueshem persian që kam në dhomën e ngrënies? Po kopshtet e mrekullueshme që rrethojnë kështjellën, a e di iu deshen plot 10 vjet, mjeshtrit të kopshtarëve për t'i krijuar? Po pergamenat e bukura që ndodhen në bibliotekën time, a i vure re?
Djaloshi i turpëruar, i rrëfeu që nuk kishte parë asnjë gjë. Shqetesimi i tij i vetëm ishte që të mos rrëzonte në tokë pikat e vajit që "I Urti" i kishte besuar, për t'i mbajtur me shumë kujdes.

Epo mirë, nuk ka gjë, i kthehet "I Urti", ktheu pas dhe shiko një nga një mrekullitë e botës sime. Nuk mund të kesh kurrë besim tek një njeri, nëse nuk i njeh mirë shtëpine e tij.
I qetësuar, djaloshi me lugën në dorë, rifilloi të shetiste pallatin, por kësaj here, duke vërejtur me kujdesin më të madh të gjitha veprat e artit të varura në tavan dhe mure.
Vështroi kopshtet, malet rrethues, brishtësine e luleve, thjeshtësinë dhe shijen me të cilën çdo vepër arti ishte vendosur në vendin e duhur, në harmoni të plotë me gjithçka që e rrethonte.
Në kthim, kur ritakoi "Të urtin", rrëfeu dhe përshkroi me zellin më të madh gjithçka që kishte parë në pallat, në çdo detaj.
Po pikat e vajit, që të lashë nën kujdesje, ku i ke? - pyeti " I Urti".
Duke parë lugen, djali vuri re që i kishte rrëzuar pikat e vajit.
"Ja pra, i tha "I Urti" – Sekreti i Lumturisë është të arrish të shikosh të gjitha mrekullitë e botës në çdo detaj, pa harruar për asnjë moment dy pikat e vajit që mban me vete në lugë."....

(Pjesë e shkeputur nga romani "Alkimisti" i Paolo Coelho)

Dino BUZZATI

DËSHIRA TË GABUARA

Shpesh njerëzit përpiqen të arrijnë atë lumturi që me pak maturi do ta nuhasnin që në fillim se është e paarritshme. Ja tre shembuj.

Trusi

Në atë vend trusi s'mund të them se ishte përjashtuar fare, sepse kjo s'do të kishte kuptim, meqenëse trusi është një nevojë jetësore, por mbahej i kontrolluar e i rezervuar si të ishte një rrezik për shoqërinë. Për të trusuar duhej të plotësoje disa kushte të caktuara: të kishe një moshë të përcaktuar, të nxierrje lejen qeveritare, etj., ndërsa disa lloje trusesh ishin rreptësisht të ndaluara, si krime. Për këtë trusi dëshirohej si gjëja më e çmuar në botë. Të lodhur nga mohimi prej shekujsh i trusit, një ditë të bukur të rinjtë filluan të protestonin dhe vrulli i tyre është kaq i madh saqë rrëzoi çdo pengesë. Qeveria u zbath, nismëtarët morën pushtetin, zgjodhën një president dhe aprovuan një ligj që shfuqizonte ato të mëparshmet, kështu trusin mund ta gëzonte çdo qytetar, qoftë mashkull a femër dhe të gjithë mund të trusonin sipas qejfit.

Fitorja u festua nëpër sheshe e rrugë ku shpërndahej trus pa kufi: Ishte lumturia që kishin ëndërruar prej shekujsh. Të gjithë u zhytën si të babëzitur. Miliona burra e gra trusonin të çliruar në sy të njëri-tjetrit.

Por nuk zgjati as gjysëm ore dhe u ndjenë të ngopur e të zhgënjyer. U dëgjuan zëra që protestonin: "Ky është mashtrim. Nuk është si trusi i dikurshëm. Na e kanë hedhur." U shfaqën pankartat. Vargu i protestuesve. Një turmë e xhindosur përpara pallatit të qeverisë së re. Në ballkon u shfaq presidenti. Ra heshtje. Ai tha: "Ç'është gjithë ky zemërim? Trusi që u kemi dhënë nuk ndryshon asnjë fije nga trusi që u është ndaluar. Por i kemi bërë llogaritë gabim, duke filluar që nga unë vetë. Ajo që na dukej si ëndrra e paarritshme kur na ndalohej, sot që mund ta kemi sa të na dojë qejfi, e ka humbur bukurinë. Faji s'është i imi. Jap dorëheqjen. S'ma kishte marrë mendja se në këtë botë, për fat të keq, çdo gjë paguhet deri në monedhën e fundit."

Il genio ante litteram

Fabio Terraci, një piktor i ri që kishte mbaruar një shkollë me emër por që i mungonin idetë bëri një udhëtim të gjatë deri në Finlandën e largët, ku ishte vënë në punë truri më i fuqishëm elektronik mbi dhé, i specializuar në çështjet kulturore: "Unë kam pak fantazi" mendonte ai "por më ka lindur një ide e jashtëzakonshme: ta pyes kompjuterin e

fuqishëm sesi do të jetë arti pas një shekulli. Ai do të më përgjigjet patjetër dhe duke ndjekur mësimet e tij unë do të shkoj njëqind vjet përpara kolegëve të mi dhe do të më shpallin kështu gjeni e do të bëhem i pasur dhe i famshëm.
Me të mbërritur në Finlandë pagoi tarifën prej 400 dollarësh dhe i dorëzoi fletushkën me pyetjen e tij teknikut të caktuar për këtë punë. Kërkesa e përkthyer në terma kibernetike u fut në barkun e përbindëshit, i cili pas nja dy orësh pune zhurmuese, nxori një karton të vogël mbi të cilin ishte riprodhuar një pikturë. Terraci i nguli sytë krejt i befasuar. Ishte një grua nudo, e re, provokuese, shumë e bukur, e shtrirë mbi divan; ishte pikturuar me kaq saktësi e dashuri në hollësira sa dhe Ingresi do ta kishte zili.
Djaloshi u zu ngushtë. Megjithatë, duke pasur besim tek roboti, u kthye fluturimthi në vendin e tij dhe filloi ta riprodhojë me përmasa të mëdha pikturën e së ardhmes. Bëri rreth tridhjetë piktura me po të njëjtin stil dhe sa më shumë zhytej në pikturë aq më tepër bindej se ai stil është një çlirim ngushëllues.
Hapi një dispozitë me shumë piktura të tilla, pastaj hapi të dytën, të tretën, të dhjetën në qytetet më në zë. Po të gjithë u tallën me të. “Kjo është pikturë e kohës së qepës” thonin. “Dhe ta sjellësh në ditët e sotme është turp”.
Kur dëgjoi këto fjalë Ternaci i nxehur në kulm, i hypi avionit dhe drejt e në Finlandë për t’u zënë me kompjuterin: “Të pyeta se si do të pikturohet pas njëqind vjetësh dhe ti më nxore një femër nudo. Unë e kopjova pikë për pikë, por të gjithë më quajtën një vjetërsirë qesharake. Siç duket ti ke gabuar prandaj të lutem m’i kthe 400 dollarët që të dhashë”. Truri u përgjigj: “Je gabuar ti, djalosh. Është gjë e madhe sikur artistëve të mëdhenj t’ju njihen vlerat njëzet vjet pas vdekjes. E si mund të pretendosh atëherë që bota të pranojë një pikturë që do vijë pas 100 vjetësh?”
Poezia
Xhorxho Kamit, pronarit të minierave një herë, tek ndodhej në bordin e jahtit të tij, iu dha rasti të shpëtonte një djalosh, i cili po përpëlitej mes dallgëve. Ishte një djalosh me një bukuri të jashtëzakonshme dhe siç u mor vesh më pas na ishte biri i Zotit. Ky i fundit duke e ndjerë veten në borxh, çoi njerëz ta thërrisnin Kamin dhe e pyeti se çfarë shpërblimi kërkonte.

(fragment nga “Mistere të padukshme” përkthyer nga Mimoza Hysa)

ESE

Jovan NIKOLAIDIS

SHQIPTARËT DHE UNË

Kur u bâ Shqypnija,... nji shumicë e shqyptarëve e gëzue. Robnija e errsija e pêsëqindvjetëve na ndrroi êmnat, por nuk muejti me na ndrrue zêmbrat... (nga Hylli i Drites, 1939)

T'a dijë Shqypnija/Prá, e sheklli mbarë,
Se mâ mbas sodit/U s'jam Shqyptár,
A ndiet, Zotni,/që rrini m'shkam?
Un mâ me sodjet/Shqyptár nuk jam.…
Përsè veç shqypja/Do folë n'Shqypní,
(Si duen me thânun/Nji palë zotní),
Kur me 'i gut'n Morgen!/A i kalimera!
Me'i dobra večer!/A buona sera! Gj. Fishta, Metamorfoza

***Të tyrët** pas atyre, **tanët** pas nesh, kjo njëkohësisht të gëzon dhe frikëson, mbahen jaranat, mbahen bashkëatdhetarët, prapë janë në modë **shenjat personale**. Po kush rri pas meje, dhe kush të tillët do i ndihmojë? Kur kthehem pas – askush, përveç hijes së zgjatur në rrugë pas mesnate.* A. Dediq: Kush rri pas meje

Dhe lexova e dëgjova shumë tregime për ta, por prapë mbeta në besimin se ata, të cilët kishin shkruar për ta, nuk i njihnin aq sa duhet. Branisllav Nushiq: Nga Kosova në detin blu

Dëshira që të shkruaj një libër për Shqipërinë dhe shqiptarët në mua grishte një qëllim të kahershëm. Si një lajtmotiv mistik e ruaja këtë dëshirë përbrenda meje, të pambaruar, deri në momentin kur pata rastin të qëndroj në Kosovë dhe Shqipëri si shkrimtar-musafir te miqt

shkrimtar. Qëndrim ky i cili ma përforcoi dhe vërtetoi përuljen time të kahershme ndaj këtij populli. Motit në këto anë, prej trojeve të tyre malore, mbërriti babai im, kaherë, i shtyrë kush e di nga çfarë. Dhimbje e vjetër e shpërnguljes me dhunë. Në jetën e tij përplot gjemba shpesh mbështetej tek shqiptarët, duke i konsideruar si kusherinj dhe miq të vet. Dy gjysmë-motrat e mia kaherë ishin të martuara në Shkodër. Atje vdiqën dhe u varrosën. Kurse nga Shqipëria në shtëpitë tona erdhen dy nuse – këtu ato gjeten prehjen e përjetshme.

Gjatë gjithë kohës mes të njohurve, e veçanërisht mes ndjellakeqëve edhe më shumë, më përcillnin pretendimet se në të vërtetë unë jam shqiptar. Jam dhe s'jam shqiptar, i them atyre që kombi për ta është shumë i rëndësishëm. Atë çka do thoja rreth perjardhjes time, kur në to më shipen bisedat, për ta nuk është edhe shumë e pranueshme. Sot në Ballkan të lidhesh për kolektivitetin, nacionalitetin ose fenë është shëndrruar në një disiplinë atletike vrasëse: gara për rrënjët. Pak kush do të kuptonte mendimet e mia, qëndrimet për atë temë të shpifur: kush je dhe çka je. Nuk pranoj që përballë kaq shumë temash dhe dilemash që jeta na i ngarkoi mbi supe, të lavdërohem me atë se jam i ndokujt dhe se dikujt duhet t'i përkas. Më së shumti i përkas vetes time dhe atyre që i çmoj. E kush jam unë me perjardhje – kjo në mua është mshehur si diamanti në thesar. Sulmuesit ndaj etnosit, prejardhjes, fesë apo rasës, të tillët nuk banojnë në bindjet e mia. Në atë grumbull të paharmonizuar dhe të pahijshëm, mua nuk më keni.

Gjatë qëndrimit në Kosovë dhe Shqipëri lindën disa tekste të cilat lexuesi do t'i hasë në këtë libër. Ese nostalgjike, këngë lirike, gjykime të athëta dhe përshtypjet rreth lojrave ballkanike me gjak dhe shpresë; dëshira të përbashkëta të cilat vajtojnë për pejzazhet europiane. Besoj se Ballkani perëndimor kaherë ka merituar vend më të mirë në hartën botërore. Veçanërisht – Mali i Zi dhe Shqipëria. Pjesë nga letërkëmbimit që zhvillova me miqët, dhe kanë të bëjnë, mes tjerash, me tema nevralgjike për shqiptarët dhe ata përreth tyre, pastaj edhe disa variacione poetike të cilat ua dërgova mediumeve gjatë qëndrimit tim atje. Fabula rreth një miqësie. Lexuesi do të hasë edhe në gjurmë të bisedave të cilat i zhvillova me njerëz të ngritur gjatë shetitjeve të mia të gjata në Tiranë. Biseda rreth sfidave të kohës ku jeta çdo ditë e ka më ngushtë. Besoj se këto shkrime, nëse jo më shumë, të jenë një kontribut i vogël në heqjen e paragjykimeve të cilat ekzistojnë për shqiptarët. Ato janë të mëdha, shpeshherë ndjellakeqe, dhe nuk i shërbejnë përmirësimit

të raporteve me popujve të Ballkanit, gjeohapsirën ku shqiptarët më së shpeshti ishin të viktimizuar. Rrallëherë edhe gjaksorë.

Një shetitje e shkurtër nëpër të kaluarën

Shqiptarët janë grupi etnik më i vjetër i Europës juglindore. Trung etnik parahelen, të cilët së pari helenët e pastaj edhe sllavët, i shtyen në pjesët malore të Ballkanit jugperëndimor. Gjuha e tyre dallon si nga greqishtja ashtu edhe nga gjuhët sllave në fqinjësi. Por, organizimi fisnor, mënyra e jetesës, punës dhe luftës, e pjesërisht edhe veset, janë të njejta me popujt që i patën fqinjë. Popull fatkeq, sakrificash të mëdha, i sfiduar deri në çmenduri, i ndershëm në veprim dhe i qëndrueshëm në mëri. Të gjitha këto deri sa nuk mbërritën turqit.

Kryepleqët fisnor shqiptar, paria fisnore, u mblodhën dhe pastaj u rreshtuan rreth një prijësi. Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Luftëtarit të madh malësor nga shpatijet malore të Krujës, kryeqendrës së tyre. Trembëdhjetë dyndje turke u thyen nga vullneti i hekurt dhe guximi i pashembullt i birit më të madh të popullit të shqiponjave. Të cilit Europa e krishterë i mahnitej, jo pa mendjemadhësi romantike. Që nga ajo kohë Ai shenohet si i shenjti i të gjithë shqiptarëve. Pavdekësia e tij epike është një tregim i bukur për tërë Ballkanin në përgjithësi, mjalti dhe gjaku i kësaj pjese të botës. Pas vdekjes së Skënderbeut, turqit vendosin pushtetin dhe në këto hapsira mbesin gjatë, shumë gjatë. Ishte kjo koha e skamjes dhe e vendosjes së ndryshimeve të cilat as e ardhmja nuk do mund ta mohojë.

Turqit asnjëherë nuk e sunduan fortë Shqipërinë, në atë mënyrë siç kishin sunduar dikur Roma e pastaj Bizanti. Megjithatë, edhe pse në pamje të parë sipërfaqësore, ai ishte një pushtet i shpërndarë mirë, i cili me kohë solli ndryshime thelbësore. U bënë zhvendosje prej të cilave dy shpërngulje ishin më drastiket: ajo drejt Greqisë, madje deri te ishujt, e cila ashpërsohej sa më i madh ishte islamizimi i popullsisë shqiptare, dhe ajo përtej detit, në jug të Italisë dhe në Sicili. Të dyja këto grupime të zhvendosurish më vonë do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në luftën për pavarësinë e Greqisë, gjithashtu edhe ikanikët në Itali, që më vonë u quajtën Arbëresh, do të shquhen në kontributin e dhënë në themelimin e Italisë së unjësuar. Kontrubut të veçantë japin edhe në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe fillim të shekullit njëzet në mëvetësinë e Shqipërisë.

Truqit i thellojnë ndasitë e pranishme fetare e shoqërore. Tradicionalisht shqiptarët ndahen në Gegë dhe Toskë. Gegët janë nga veriu, kurse

Toskët nga jugu. Ata në një pjesë të madhe i ndanë edhe lumi Shkumbin. Gegët janë malësorë, të vrazhdë, luftarak dhe më shtatlartë se Toskët, të cilët janë më të shtatshkurtër, shpirtë të brishtë dhe me kulturë bizante. Fillimisht, fiset shqiptare i përkisnin kishës ortodokse lindore, megjithë që edhe katolicizmi u fut shumë shpejt mes këtij populli, veçanërisht si kundër-reagim i trysnive të serbëve ortodoks, të cilët vërshonin nga veriu. Para se të vinin turqit, shqiptarët ishin të krishterë, ortodoks dhe katolik. Duke përqafuar islamin ata u bënë aleatë të Turqisë, shpeshherë të barabartë me ta. Kurse në jug dhe lindje, ku pushteti turk ishte më i ashpër, Shqiptarët e pasur ortodoks përqafuan islamin në mënyrë që të mbajnë pasurinë dhe kontrollojnë tregëtinë. Atyre iu bashkuan edhe shtresa më e varfër e popullsisë, qiramarrësit dhe punëtorët e krahut, gjithashtu të mashtruar me lehtësira të imëta edhe ashtu në atë jetë të përvuajtur. Në atë kohë, ende me rregullim të fortë feudal, bashkëpunimi me Otomanët ishte çështje e pragmatizmit. Feudalët shqiptar përmes islamit ruajtën pasurinë dhe kishin qasje, madje edhe kontrollë ndaj pushtetit administrativoligjor. Në territorin e vet, shpesh edhe në sistemin ushtarak mbanin frejt.

”... Në çdo kohë viti mbi kalë kam vizituar brendësinë e vendit, i përcjellë nga dy mësues, me bashkëmoshatarë dhe përcjellje të madhe. Në fshatra isha musafir i fisnikëve të shquar, i gostitur me festa të ndryshme përcjell me valle popullore, e që ishte edhe pjesë e arsimimit të të rinjëve... Në gjah kalëroja nën përcjelljen e langojve; atëbotë çdo i pasur kishte një tufë zagarësh. Gjuanim lepuj, e kjo konsiderohej si vendim i mirë për shkak të zhvillimit të aftësisë së kalërimit. Kurse argëtimi më i madh me pushkë ishte gjuajtja e shepkave dhe rosave të egra. Në muajin maj argëtoheshim nëpër male duke gjuajtur me rrjetë shkurta... Më përcillnin të rinjtë e shërbëtorëve shtëpiakë si dhe gjahtarë të rryem. Të rinjë nga familje fisnike shërbenin nëpër shtëpitë kryesore të vendit si shenjë respekti, dhe njëkohësisht të rinjtë mësonin bukursjelljen. Duke marrë pjesë në ngjarjet ditore njoftoheshin me punët publike dhe përfitonin edukim... Të gjithë ishin të veshur në veshje kombëtare me qëndisje të pasur. Të aramatosur me armë zjarri dhe jataganë të larë në argjend futur në rripa lëkure të zbukuruar. Shumica kishin kuajt e vet, ndërsa beglerët, kur vinin festat apo raste të ndryshme solemne u dhuronin armë dhe gjësende të çumueshme.” *(The memoirs of Ismail Kemal Bey,* ed. by Somerville Story, London, 1920.*)*

”Me frika rri fshatari i cili, bukën e thjeshtë të misrit, të përzier me miell gruri e thekre, nuk do t’i presë të korrat e ardhëshme. Elbi ruhej për kuaj

dhe mushka. Në kohëra të mira në pijata mund të gjendeshin edhe perime të gjelbërta, fasule apo oriz. Të krishterët hanin edhe mish e peshk, por, vetëm për festa. Gjalpi dhe djathi ruhej për ditë të ftohta, kurse qumështi ishte luks. Kequshqyerja dhe papastërtia shkaktonin vdekshmëri të madhe. Terboheshin malarija, tuberkulozi dhe sëmundjet e eshtrave. Në një hapsirë jetonin disa familje. Zakonisht shtëpitë përdhese nga thuprat dhe balta por edhe ato në kat, ndërtoheshin nga guri i palatuar, me dhoma për çiftet dhe musafirë, kurse kuzhina dhe dhoma e ndenjes për beqarët e shtëpisë. Votra, burimi i vetëm i nxehtësisë, prej të cilës edhe ngroheshin por edhe zienin, duke u mbrojtur nga shumëkëmbëshi e cila depërtonte nga dyshemeja. Dritaret pa xhama të mbylleshin me lecka të vjetra, kashtë ose dërrasa në mënyr që të mbrohen nga stuhitë e erës. Nuk dihej për kanalizim. Disa shtëpi kishin puse, fshatarët ujin e bartin me teste nga prroni, ose e mblidhnin nëpër fuçi nga shiu. Ngandonjë teste ose enë bakri, disa lugë dhe pjata bakri. Baulja pranë murit tregonte se e zonja e shtëpisë ruante diçka nga paja dhe bizhuteritë e kohës së martesës. Shtrat nuk kishte askush. Flihej nëpër shtroje leshi ose kashte. Gjatë ditës ato lagroheshin në një grumbull në këndin e dhomës. Ishin përplot me morra dhe para se të shkohej me fjetë secili të vetat i shkundet mirë e mirë mbi votër duke u mundu që të shkundin parazitët nga pëlhurat. Muslimanët, më të vobektë se të krishterët, ishin më pak të pastër, dhe pre më e madhe e morrave dhe bubeve. Pranë shtëpive të kamura ishin ahuret kurse tek ato më të varfura ahurin nga kthinat e shtëpisë i ndante vetëm një murë i hollë. *(The Albanian Struggle in the Old World and New*. Kompiled and Written by Members of the Federal Writer's Project of the Works Progress Administration of Massachusetts, Boston, 1939*)*...

Fisi gjithmonë rrinte i fortë. Me te drejtonte kryeplaku i ndihmuar nga pleqësia, e nganjëherë formohej edhe kryesia, e përbërë nga përfaqësuesit e familjeve më të mëdha përbrenda fisit. Në veri pushteti më shumë lidhej përmes fiseve luftarake, kurse në jug përmes zotëruesve të tokave. Si njëra ashtu edhe pala tjetër përmes bashkëpunimit i kanë mbajtur pozitat e caktuara në shërbim të turqëve, duke mbërritë shpesh edhe deri në Stamboll. Gjatë tërë sundimit të turqëve pushtetin e vërtetë në territoret ku shqiptarët ishin në shumicë e mbanin disa familje feudale. Prej tyre zgjedheshin udhëheqësit, njerëz të cilët kontrubuonin vendit dhe popullit të vet. Shqiptarët edhe pse muslimanë, katolikë dhe ortodoksë, nyjen etnike rrallëherë ka mundur t’ua shkëpusë ndokush.

Zakonisht shqiptarët nuk janë fanatik fetarë. Një pjesë e muslimanëve shqiptarë i takonin rendit bektashian, i cili ishte i butë tolerant dhe joortodoks. Bektashinjtë me predikimet e veta përhapnin bindje panetike dhe univerzale. Ata ishin pasues të mistikut anadollak Haxhi Bektash Veliut.

Rol të rëndësishëm në islamizimin e popullsisë së krishterë shqiptare luajtën bektashinjtë. Islami u përqafua shumë lehtë sepse bektashinjtë pranonin barazinë e të gjitha religjioneve. Ata duke i dhënë më shumë rëndësi vlerave të fshehta shpirtërore se sa atyre të jashtme, nuk insistonin në domosdoshërinë e zbatimit të ritualit të faljes së namazit pesë herë në ditë, dhe atë të agjërimit. Pinin venë dhe u lejonin femrave të dalin të pambuluara, pa ferexhe, pastaj të rrijnë me meshkuj dhe të ndajnë aktivitetet ditore së bashku. Kjo ishte shumë e afërt me mentalitetin e fshatarit shqiptar. Bektashinjtë shqiptarë përveç tolerancës dhe hedonizmit modest, shpesh ishin edhe bartës të përpjekjeve dhe aspiratave kombëtare, dhe kështu nuk ishin shumë për qejfin e pushtetit turk.
Shqiptarët muhamedan dhe të krishterë gjatë gjithë kohës jetojnë pranë njëri tjetrit, duke u mvarë nga shoqi-shoqi në jetën e rëndë dhe të rrezikshme. Grindjet mes fiseve nuk janë të rralla, por kurrë nuk ishin të karakterit fetar. Pjestarët e një familje praktikonin fe të ndryshme, të parët i pagëzonin, tjerët i bënin synet, si dhe emrat disa prej tyre i kshin të dyfishtë – Leka ishte edhe Arsllan dhe mvarej prej vendit dhe kushteve që mbretëronin. Me përhapjen e arsimimit dhe të kulturës në përgjithësi të popullsisë shqiptare, si dhe me kontaktin dhe pjesëmarrjen e tyre në pushtet, pjesërisht këto lidhije ishin të ndera, por asnjëherë aq të ndera sa të prodhojnë ndonjë mosmarrëveshje të përmasave të gjera. Disa nga prijësit ishin të vetëdijshëm për këso rreziqesh separatiste. Historia kujton Pashko Vasën i cili thirrte popullin e vet që të zgjohej: ”Mos shikoni kisha as xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria”. Gjë që ke sllavët dhe grekët feja ishte shpesh motiv i përçarjes.

(Fragment nga libri ALBANCI I JA, Plima, 2017)

Nga gjuha malazeze përktheu dhe përshtati Gazmend Çitaku

EX-LIBRIS

Dr Gëzim PUKA
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

DISA ARSYE TË MIRA PSE DUHET LEXUAR “FEJESA N’DJEP A SE ULQINI I MARRUN”

Së pari, ju falënderoj që keni ardhur dhe keni gjetur kohën për të marrë pjesë në këtë promovim. Më ka bërë shumë përshtypje dhe më ka dhënë një kënaqësi të veçantë edhe në veprimtari të tjera të organizuara nga kjo qendër e promovimit të artit dhe kulturës, interesi dhe vëmendja juaj për argumentet në fjalë.

Duke e personalizuar pak diskursin, mund të them se me Gazmend Çitakun kemi instalur një miqësi dhe një bashkëpunim të veçantë në funksion të sistemit letrar. Kur më tha se studimin tënd mund ta botoj, të them të drejtën nuk pata shumë besim se do t’ia arrinte, ndërsa ajo që më çuditi edhe më shumë, ishte interesimi i tij për të botuar në Ulqin romanin e Ndoc Nikajt që kemi sot në dorë “Fejesa n’djep a se Ulqini i marrun”. Nuk e di nëse atë e tërhoqi fakti se aty ishte si personazh një qytet. Ulqini juaj dhe Ulqini ynë! Kjo qendër e lashtë shqiptare që u bë pjesë e një ndër romaneve më të para të letërsisë shqiptare.

Romani shqiptar, që lindi njëherazi me Shqipërinë e pavarur, nuk i la në harresë disa ngjarje historike që shkaktuan plagë ende të pashërueshme për kombin tonë.

Për llojin e romanit “Historia e letërsisë shqipe” njeh si nismëtar Ndoc Nikajn. I cilësuar si “babai i prozës gege të shekullit XX”, Dom Ndoc Nikaj ishte një ndër shkrimtarët më prodhimtarë të letrave shqipe të fundit shekullit XIX dhe dekadave të para shekullit XX. Përgjatë kësaj veprimtarie thuajse 30-vjeçare ka qenë autor, por edhe përkthyes i më shumë se tridhjetë veprave të botuara. Një shkrimtar plot dinamizëm dhe personalitet, që dëshironte të ishte gjithnjë një hap para të tjerëve. Ai ishte një ndër bashkëpunëtorët kryesorë të revistës “Albania” (1891) botuar në Bruksel dhe Londër nga Faik Konica. Në vitin 1910 themeloi të përjavshmen “Koha”, më pas periodikët: “Bashkimi”,“Besa Shqyptare”, “Zani i Shkodrës” . Ndoc Nikaj cilësohet edhe si nismëtar i shtypshkrimit shqip. Në vitin 1909 krijoi shtypshkronjën “Nikaj”, në të cilën u shtypën botimet e tij dhe të shumë autorëve shqiptarë nga mbarë

vendi. Romancieri i parë në gjuhën shqipe, bariu i shpirtrave, veprimtari, patrioti, publicisti dhe botuesi, ndoshta nuk kërkonte nderime të veçanta nga regjimi komunist që u vendos në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, por as dënimin s'kishte pse ta priste. Vdiq në burgun komunist në moshën 87 vjeçare.

Romani *"Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun"* u botua për herë të parë në vitin 1913. Me këtë lloj titulli të dyzuar, emërtues dhe sqarues, autori na rrëfen një ngjarje dashurie, që shkon kundër zakonit të fejesave në moshë të mitur, mjaft të përhapura në atë kohë në malësitë shqiptare. E gjithë kjo dramë ndodh në skenën e një ngjarjeje historike, siç ishte lufta për mbrojtjen e Ulqinit, pas Kongresit të Berlinit (1878). Shkëputja e Ulqinit nga trupi i Shqipërisë (1880) ishte një gjymtim historik, që nuk mund të mos kontekstualizohej në romanin e këtij shkrimtari dhe patrioti shkodran.

Në veprën e tij *"Ndoc Nikaj dhe burimet e romantik shqip"*, studiuesi Gjovalin Kola me të drejtë vëren se: *"Tiparet zotëruese në karakterin e Nikajt si krijues: dashuria e madhe për atdheun e lirë e të bashkuar, besimi në Zotin, ekzaltimi i dashurisë si themel i jetës, familjes dhe mospajtimi me zakonet që dhunonin dinjitetin moral të femrës shqiptare, ishin ato që përcaktuan fizionominë e veprave dhe psikologjinë e personazheve të tij. Ndjeshmëria e lartë e personazheve është karakteristikë në veprën e Nikajt. […] Ndjenja përdoret nga Nikaj për t'iu imponuar lexuesve për efekte morale. Ajo luan rolin parësor në përpunimin e lëndës letrare".*[17]

Në faqet e këtij teksti historia del vetëm si sfond i rrëfimit dhe shfaqet përmes ngjyresave mistike, aventurave të herojve, apo përmes ndjenjës së dhimbjes dhe mëshirës për humbjen e luftës. Duket se aventurizmi si frymë e përgjithshme e kësaj lloj proze plotëson kërshërinë e lexuesit të kohës për të njohur botën, gjeografinë dhe etnografinë e saj, si dhe dëshirën për ekzotikë.

Po të shihet kompozimi, fryma që sjell ky roman, ambienti, struktura e intrigës, hetohet e përbashkëta që ka me romanet tipike romantike evropiane. Rrugëtimi gjenerativ i narracionit është i tipit: Subjekti A-ja dhe ndihmësi këtij subjekti (Shpendi dhe Sokoli, vëllai i Bardhës) do martesën me subjektin B (Bardhia) dhe B-ja (Bardhia) e do A-në (Shpendin). Por B-në (Bardhën) e do për grua edhe C-ja (dhëndrri nga Gruda të cilit i është premtuar gruaja që në djep), por B-ja (Bardhia) nuk i do C-në (dhëndrrin nga Gruda), prandaj A-ja dhe ndihmësi i tij (Shpendi dhe vëllai i Bardhës, Sokoli) urren C-në (dhëndrrin nga Gruda)

[17] Kola, Gjovalin: Ndoc Nikaj dhe burimet e romani shqip. "Apollonia", 1997, f. 135.

Autori preferon një strukturë letrare që përmban elemente të formacioneve të ndryshme stilistike, si të: romantizmit, të sentimentalizmit dhe të realizmit. Në leximin tonë shkrimtari është i vetëdijshëm për ndërligjësinë e këtij raporti dhe kujdeset që lexuesit t'i japë vepër letrare e jo historike. Në veprën e Ndoc Nikajt është i dukshëm përshkrimi i peizazheve, por nuk mungojnë edhe elementet e traditës, të folklorit etj. Autori përshkruan vende dhe ngjarje, të cilat i ka vizituar ose i njeh mirë nga leximet.Vepra i përket vitit 1913, sot jemi në 2017, por jam i bindur se ky interval kohor më shumë se njëshekullor është mbushur dhe vazhdon të mbushet me kënaqësi leximi, kuptimi dhe interpretimi të ri.

Për shumë prej jush një prej leximeve të mundshme mund të ishte ai që thashë pak më lart. "Ulqini personazh!". Mbase Ndoc Nikaj në qëllimshmërinë e tij kërkoi ta fotografojë përmes artit të fjalës atë luftë të madhe që u bë për ta mbrojtur atë. Shumë kohë më vonë kur lloji i romanit do t'i forconte pozitat e tij në letërsinë shqiptare, qytetin personazh do ta bënin edhe të tjerë autorë, një nga të cilët deri në perfeksion, siç është Kadare, i cili e përjetësoi Gjirokastrën në romanin "Kronikë në gur". Nga 15 kapitujt që ka romani *"Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun"*, 2 kapituj i kushtohen luftës për mbrojtjen e Ulqinit.

Duke rindërtuar kuptimin përgjatë faqeve të këtij romani nuk ka se si të mos rindizet një lloj ndjenje që e quajmë krenari kombëtare. Ajo që ndodh në roman në të dyja linjat e veprimit të tij në pak fjalë është se fitohet një zemër vajze nga heroi i romanit, por humbet një qytet. Bardhia dhe Shpendi përvijojnë ciklin e mbijetesës së shqiptarisë. Një qytet ka rënë, por finalja e librit është e lumtur dhe e hapur:

"Bardhia e Shpêndi u plakne n' dashtnii t' shoqishoit, rritne fmiit n' hiir n' Tenzot e n' dashtnië t' komsiis e dielmt e tyne mâ t' parët filluene me ndîi n' zêmer e me cfaqë nder kuvênde t' burrave e t' dielmniës si i Shkreli nuk do t'desin vetem per Shkrel as per Male t' Mdhaa por per Shqypnië marë pse: Rrethi i Shqyptarve âsht Gjith Shqyptarija."

104 vjet më vonë nga dalja e librit, "Ulqini i marrun" personazhi referencial i romanit të Ndoc Nikajt, e vijon jetën e tij i përqendruar tek çështjet e shqiptarisë, pjesë e rëndësishme e së cilës është edhe kultura. Çdo epokë e kupton një tekst të transmetuar në mënyrën e vet. Teksti që u ribotua sot, romani "Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun", është pjesë e traditës, për të cilën mendoj se epoka jonë ka interes objektiv edhe për të kuptuar vetveten. Kjo epoka jonë shqiptare e hallakatur në përditshmërinë e një bote në dukje gjithnjë e më të vogël, të shtirë dhe sipërfaqësore, nuk më ngjan se e ka luksin të anashkalojë dhe të mos përtypë pak nga idealizmi i pastër, nga ndjenjat e thjeshta të dashurisë

për këtë hapësirë shqiptare që me aq përpjekje e sakrifica e kemi trashëguar.
Mbase kjo në aspektin stilistik nuk është një kryevepër dhe për ironi këtë e parashikon edhe autori. Tek libri *"Kujtimet të nji jete së kalueme: trazime jete"* ai trajton vlerën e shkrimit dhe të leximit të veprave letrare, duke vënë në qendër të vëmendjes kënaqësinë dhe dobinë e tyre. *"Lypet qi ta terhjekin lexuesin per vazhdimin aq sa kuer t'afrohet perfundimi t'i lanë gadi nji si keqardhje për marrimin e librit. Për me ja mbërrij asaj lypet qi shkruesi të ketë nji zotsi të veçantë për me i rreshtue ambel e të lidhun arrsyetimet e çfaquna në gjith diftesat e tija, por duhet qi edhe diftesat e çfaquna të kenë nji dishka ngrehse në veti, për qi me mbajtë të gjallë kurreshtjen për me mberrij me dijt përfundimin. Kjo gja âsht nder romanxa qi të majnë pezull që në fillesë e deri në fund menden e andjen për me dijt marimin e një dashtunije o në sjellje të mirë ose të keqe.[...] Nji punë qi e ngrehë lexuesin dhe e ngucë për me vazhdue në këndimin asht ajo qi nder faktet mund të shofi kjartas shka ndoshta ka mujtë me ndigjue prej tjerve nder bisedime të shkurta por qi në menden e tij nuk asht perbâ nji gja e kjarët e per mbi të gjitha tjerat ka me gjetë në këto shkrime, në vend të nji romanxi dashtunuer për femna sikur janë të gjith romanxat, ka me gjetë dashtunin ma shejten e mâ të çmueshmen qi kje e asht dhe ka me kenë për nierin e ndershem dashtunin e atëdheut, burrnitë, kreshnikitë, flijimet qi e ushqejnë dhe e ngijn shpirtnisht e mendsisht nierin e urtë."* [18]
Ky roman që marrim sot në dorë është pjesë e veprave të traditës së letërsisë shqipe, por për kulturën dhe për universalitetin e ideve të tij, i përket edhe kohës sonë.
Sa herë që kam ardhur në Ulqin duke filluar që nga viti 1996, më është krijuar ideja e një lloj viktimizimi të njerëzve në krahasim me një të shkuar më të mirë. Më është krijuar ideja e një të vetëndjeri pak të çuditshëm tuajin në rrethinat e jetës shqiptare. Kjo më ngjan më shumë me një simptomë imagjinare, të shpikur nga ju vendasit, sepse nga jashtë unë shoh një energji të madhe edhe në ndihmesën tuaj për kulturën, siç po e dëshmon edhe kjo veprimtari, që e bën Ulqinin një ndër qendrat dhe aspak periferi të kulturës sonë. Kjo domethënia ime subjektive i përngjitet edhe kuptimit të romanit që do të rilexojmë, i cili që në titull e ka përjetësuar Ulqinin në pjesën ikonike të letërsisë shqiptare.

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit "Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun" të autorit dom Ndoc Nikaj. Botoi Diti&Oli, Libraria ARTI, Ulqin, 2017)

[18] Nikaj, Ndoc: Kujtimet të nji jete së kalueme: trazime jete, përg. Arben Ndreca, Shtëpia botuese "Onufri", Tiranë 2016, f. 12

Dr Rrustem BERISHA, Prishtinë

ZËRI KËNDIMTAR I SHESTANIT

Prof. Dr Simë Gjon Dobreci: KRIJIME POPULLORE SHESTANASE

Pagëzimi i veprës kështu tregon se dimensioni i saj kryesor është artistik. Këtu ka material të prodhimit letrar të popullit të llojeve të ndryshme dhe, natyrisht se është me vlerë solide.

Kryesisht, në vepër janë publikuar këngë të popullit që në pikën e sasisë zotëron lirika. Lirika jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi arti, është më tepër e përkryer. Disa nga këngët lirike këtu, të themi së është bërë zakon të konstatohet, kanë vlera të gjenden në faqet e antologjive të llojeve përkatëse.

Duhet thënë drejt se libri sjell edhe një sasi të materialit gjuhësor, disa të dhëna historike të mbështetura në arritjet e shkencave dhe portrete njerëzish shestanas, të cilët si krijues e veprimtarë merituesheëm kanë zënë vend në kujtesën e shestanasve, madje edhe në hierarkinë e krijuesve të çmueshëm. Ata janë bërë pjesë me vlerë e historisë së Shestanit, prandaj prof. Dr Simë Gjon Dobreci, duke i radhitur këtu e ka formuar kujtesën tonë dhe nderimin për ta.

Qëndrimi personal, karakteri i tyre i fortë, dashuria për Shestanin dhe shqiptarët, që ata thanë me shkrimet e tyre në kohët e duhura e të vështira i shpie ato figura në radhën e personaliteteve të kombit tonë.

Si po them, libri ka një material edhe pak më të ndryshëm se ç'është pagëzuar, por me te i shtohet vlefta edhe më tepër. Pretendimet e prof. Dr Simë Gjon Dobrecit nuk janë edhe aq modeste kur në to e shohim njeriun vullnetfortë, të pathyeshëm në qëllimet e tij për t'i shtruar e shkruar drejt të vërtetën. Kjo e bën, po them kështu, autorin dhe veprën e tij me sukses.

Një shikim të thjeshtësuar do e bëjmë sipas kapitujve të librit që është vetëm pamje e një pjese të vlerave, të cilat hapen e mbyllen brenda 257 faqeve.

Në fillim të kësaj përmbledhje këngësh është publikuar poezia e Gjergj Fishtës "Gjuha shqype" që është tingëllim kushtrimi për ta ruajtur dhe folur gjuhën amtare. Këtë ide e këtë qëllim e thekson shumë shpesh prof. Dr Simë Gjon Dobreci, të thuash në çdo shënim të shkurtër apo në çdo shkrim më serioz.

Këngët që autori i librit sjell këtu do të ligjërojnë edhe vite e vite, ato nuk duan t'ia dinë se apo mbetet Shestani pa banorët e vet, pa ata që i krijuan apo i kënduan. Ato do ta përcjellin jehonën e dashurisë, të dasmës, të vajtimeve, të trimërive përgjithmonë të fiksuara në libër dhe të ruajtura në kapitalin e folklorit tonë. Ato si kanë tingëlluar me vite e shekuj ngrohtë, do ta mbajnë të ngrohtë edhe më tutje këtë krahinë dhe tërë prehnin e krahinorin e Krajës.

Dobreci këtë prodhime letrare i solli në libër pas disa viteve me radhë që i publikoi në revistën "Buzuku"

Në këngët e dashurisë poetizohet nga rapsodët mosha më e lumtur e jetës. Ajo nuk është jetë pa pengesa e pa brenga, por të gjitha kalohen gëzueshëm, sepse është vetë moshë e fitoreve që i gjen rrugët e dëshiruara dhe të mundshme.

Në dashuri edhe sakrifica është fitore. Në këngë reflektohet sinqeritet i plotë midis të rinjve. Dy epitetet që i jepen vajzës *mollë e kuqe top sheqere* përcillen me mangësinë se ka mbetur e vogël. Vogëlsia ka arsyen se ajo një përkrahje e nuk e gjen të prindit pleq, por e shpreson te e motra.

Kënga e bën të padurueshme vogëlsinë, sepse vajzës i janë bërë përshkrime që zgjojnë ndjeshmërinë me krahasimin më gjerat e bukura dhe me shije të mirë.

Në lirikën e dashurisë trajtohet maturi i rrëmbimit të femrës. Një temë e tillë trajtohet në këngën Larg ma lulldonjin nji vashë, në të cilën ka përshkrime mjetesh veshjesh, veprimesh, mallrash të tregtisë.

Përsosmërinë e rrëfimit e shpreh ligjërimi i rregullt që krijon një taktizim kur të dukën tri femra e djali duhet ta dallojë atë që kërkon. Pra, është këngë me stil të veçantë që vazhdon kah qartësimi dhe lehtësimi i veprimit për të rrëmbyer vajzën.

Dashuria shprehet në trajta të ndryshme dhe ngjyrime të plota të shijeve. Në këngën 'Dal n'abarr me mjelun dhentë' Pas bisedës të shkurtër të vajzës me djalin bëhet një kontakt me shijet që ndjehen me femrat të trevave të ndryshme, bëhen muhabete për monotoninë që tregohet në muhabetin e tillë në mosha të shtyra. Duket sarkastike të krijohet atmosferë dashurie midis pleqve e plakave.

Kemi në përfytyrim për jetimin e Mrika Lenës që i ka frikën e ruhet prej një djali për arsye të hasmërisë, siç jepet një shënim, por ajo prapë bashkohet me te, ndërsa e ëma gëzohet e uron, që pikërisht e merr vajzën ai që e don.

Është kjo një këngë me shumë vargje, me rrëfim të logjikshëm dhe po mungoj diçka në njërën variant si pyetje apo përgjigje do e mos e gjen me mund se si është rrjedha e drejtë dhe vërtetë. Këto përsëritje të pyetjeve dhe përgjigjeve kanë një ngjashmëri me refrenin dhe i japin bukuri e kuptim këngës.
Në këngën 'Nën nji mollë e nën nji dardhë' na jepet përfytyrimi qesharak i takimit të vajzës dhe të plakut, madje takimi i fatshëm i vajzës me djalin e ri. Pamje këto që i ka pasur edhe realiteti jetësor.
Dasma, festa më e gëzueshme e familjes shqiptare është paraqitur këtu me valle, këngë, ngritje dollish. Si gjithmonë, vajza nguron të ndahet nga familja, tek djali e ftojnë me gëzim se edhe atje dot bashkohet me njerëz që do ta duan e afrojnë si njerëzit e gjakut.
"Po këndon zogeja m'llinjë" është një porosi që u drejtohet të rinjve që të marrin vajzat mira, sojnike, sepse pasojat më të këndshme. Nusekeqi ka mort gjithmonë në shtëpi, e kjo do të thotë ka jetë të hidhur. Nuse miri ka gjithmonë dasmë e gëzim, prandaj mos të ftohet fare në dasmë. Është kjo një porosi e traditës që me martesë të mbarë të krijohet lumturia familjare.
Përfytyrimin për barinjtë dhe rolin e tyre e jep kënga e njohur "Blegeron delja në mal". Ajo s'jep me siguri vlerën e kujdesin e bariut që dëshmon si ky e foconte një veprimtari me të cilën populli ka siguruar ekzistencën.
Kurbeti është një tragjedi, siç dihet historikisht, që e përcjell popullin tonë kaherë, me sheku. Mërgimi ka tharë, si thuhet, shumë zemra prindësh, grashë, fëmijësh, ka fikur shtëpi. Si dhimbje e rëndë mërzimi ka frymëzuar një lloj kënge të veçantë, e cila shpesh brengë, mallëngjim dhe pikëllim. Ë gjitha këto ndjenja përjetohen mundimshëm.
Vepra "Krijime popullore shestanase" e nis këtë cikël këngës me "More Kraja nën Rumi". Pikëllimi këtu bie mbi krahun e gjerë të një krahine me të shprehurit e frikës se ata do të çkombëtarizohen, do të tresin me gjuhë e besim në valën e kombit tjetër. Dhembja lëshon klithma për të mbeturit e paktë e të vetmuar, të cilëve s'ua hap kush derën as për festë.
Këtu kemi vajtime që bëhen për individët dhe një tjetër për shestanasit, pra për të gjallët që po e shkretojnë vendin, duke e boshatisur. Vaji i thellë rrjedhë nga zemra. Me anë të shprehjes së gradacionit rritet e forcohet pikëllimi që është frikë me dozë të madhe pasigurie se në këto cepa fshatrash shqiptare *nesër* nuk do të ketë *nesër*.
Në pak këngë humoristike këndohen disa aspekte të jetës reale. Lena ka marrë një burrë të paaftë dhe ai vetiu bie në skena qesharake, në të cilat

Lena ia jep krahasimet natyrisht banale, por për tipin e tillë të meritueshme.
Tjetra është një rrëfim që ngjet me fantastikën. Gjuetari "mrekulli" pa armë të gjuetisë dhe prej atyre "mrekullive" të lavdishme s'del kurrgjë.
"Shtatë katune me nji mulli" në mënyrë përçmuese tregohet varfëria e këtyre fshatrave. Në secilën veprimtari të tyre mospasja (ngushllaku), si i thuhet, ua afron pamjet e çoroditura të aktiviteteve prej punëve të thjeshta deri te trimëritë.
Këngër e reja, si thuhet në një cikël këtu janë vërtetë në frymën e këngëve të vjetra, por përsosmëria e tyre artistike nuk është arritur, sepse ato duhet të interpretohen nga breza të tërë dhe nga talente të shumtë për t'u ndërtuar mirë artistikisht si krijime të mëvetësishme.
Me rëndësi është në to, me gjithate, dukën e sotmja është fakt se disa krijues kanë shkruar aq popullorçe sa poezitë e tyre janë kënduat nga rapsodet popullorë.
Të kujtoj me poezitë e Hil Mosit, të Gjergj Fishtës, të Naimit, Çajupit etj. Kjo shkrirje talentesh, të themi popullorçe, kah do që t'i sjellësh e ta marrish, na qet te buka jonë. Unë e çmoj një ndihmesë të tillë.
Tani po e zëmë me pak fjalë këtu këngët historike. "Kanga e Caf Metos" një trim që vret tre e plagos dy vetë, flet për amanetin që i lë nënës ta sjell djalin në Shkodër, t'i tregojë ku e si ka luftuar i ati me bindje se trimërinë po e le trashëgim, dhe është porosi që vjen nga breznitë.
Këngët historike këtu japin shembuj krenarie në luftat me armiqtë e vendit. Të tillë trima janë Luc Pjetri, Çun Mula. Këndohet për Luftën e Parë Botërore dhe të Dytën, kur fqinjët turren të tërbuar mbi shqiptarët me qëllimet e tyre hegjemoniste, okupuese dhe kriminale. Por, si thuhet për këngë, nuk e marrin atë që presin, sepse:
Met serbjani e cërnagori,
Dhetë për nji u pague Malsori.

Lufta e Taraboshit e tregon qëndresën e shqiptarëve kundër serbëve e malazezve. Por, ngulet vullneti për t'u mbrojtur Shkodra.
Tematikë mbrojtëse na thotë edhe kënga "Nji t'mërkure n'iqini" ku mbrohet Ulqini. Këtu janë emrat e luftëtarëve të njohur të kohës së Lidhjes shqiptare të Prizrenit, si Veli Mani, Halil Qatja e Huso Shestani.
Në ciklin "Kanga balada elegji" prinë "Ag' Ymeri na u martuo". Kjo është këngë e vjetër që lidhet me trevën e Ulqinit dhe është si art një lloj xhevahiri. Moti i kthimit të burrit është motiv antik i trajtuar nga Homeri. Pas një numër faktesh motivit tonë ia shton origjinalitetin

dashuria e respekti i kryepersonazhit, Aga Ymerit, babë, nënë, shtëpi e madje për grua. Shenjat e njohjes dhe koha e gjatë e mostakimit janë elemente të letërsisë popullore si kode të vjetra për t'u riofruar të dashurit.
Ndër këngët legjendare që shquajnë në trupin e tyre rrëfime bindëse e bukuri arti janë "Kanka e Kalasë së Shkodres", "Kënon blega", "Nantë vllazni kishin nji motër" "O i mjeri, more nanë" "Oj Rumia bjeshkë e naltë" etj.
Në balada e legjenda shquhen konfliktet dhe vetëflijimet që paraqesin inertes të zbërthehet arsyeja e tragjikës dhe shkatarët. Këta faktorë thelbësorë të këtyre krijimeve janë përbërës esencial dhe shkaktojnë plot dhembje e pikëllime me jehonë të fortë.
Këngë kreshnike është vetëm një dhe ajo ka, mendoj, rëndësi shumë për t'u qartësua disa gjykime që janë dhënë për prozën tonë.
Kjo këngë "Në Fushë t'Udbinës" me personazhe krishtere, katolike mund të na jep një fakt për fillime më të hershme të eposit tonë, sepse është supozuar që në këto këngë ka ushtruar ndikim pushtuesi turk.
Në fushën e gjuhës ai sjell fjalë të urta thënie të ndryshme nga aktivitetet e njerëzve dhe sjelljeve të mira e të liga, të cilat janë ligjërime të dendura me domethënie kuptimore të thella. Nga respekti e dashuria ai i ka pagëzuar "fjalë flori të shestanasve", "Disa përshëndetje e urime të shestanasve", "Disa mallkime, troma shestanasve", madje vijnë emrat e familjeve, të meshkujve dhe të femrave, ku herë herë autori kërkon domethënien e tyre në shqipe.
Përvoja e provuar jetësore e konkluduar në shprehjet e tilla është konsideruar si mendim i lart filozofik, si udhërrëfyes në jetë. Shumicë nga këto thënie edhe sot i përdorë masovikisht populli shqiptar.
Në shkrimet që janë bërë për individët, duke filluar nga figura e Buzukut e deri te Pjetër Perkoliqi, japin shkurtas portretet e njerëzve që me veprën e tyre u bënë shenjë krenarie e shestasve, madje edhe emblema në kulturën kombëtare. Ata pas formimit të tyre intelektuale të lartë dispononin atdhedashuri dhe guxim dhe jetuan e vdiqën, por mbeten individë të ndritshëm.
Këta emra nuk janë shumë. Por janë për t'u kujtuar gjatë, Lekë Perkolonj, Dom Pjetër Perkoliqi, Patër Vinçens Malaj, Patër Zef Jankaj, Patër Zef Tagaj.
Nëpër faqet e librit ka një numër të konsiderueshëm fotografish, ku secila me gjuhën e emrin e vet paraqet dokument për besimin, për

bujqësinë, festat familjare e popullore, për blegtorinë, veshjet kombëtare, lojërat e vallet.
Ato janë dokument i jetës së gjallë të Shestanit, pjesë e lumturisë që e përjetuan dikur shestanasit, por janë edhe pjesë deshpruese sot me pamjen që dëftojnë rrënojat e shtëpive lënë shkret.
Kjo vepër e Prof. Dr Simë Gjon Dobrecit është nisur në udhëtim. Ajo do të arrij tek individet, tek nxënësit, tek studentët, tek studiuesit dhe do të vendoset nëpër biblioteka që janë tempulli art do të na i kujtojë blerimit, shkembinjtë, prrojet e thepat, Ruminë e lart, zilet e tufave, rreshtin e dasmorëve gjithmonë deri sa të shkruhet shqipja. Kam frikë, ashtu si na njofton libri, për katastrofën e zbrazjes së Shestanit, se mos vepra është zëri i fundit i artit që dëgjohet e shënohet prej andej.
Nuk shpërblehet autori me fjalë. Prof. Dobreci dhe arti shestanas do të jenë vet ngrehina që na pasuron me kujtime për një skaj shqiptar mundimtar dhe krenar, ku Sima dhe libri i tij do të qëndrojnë ashtu me ballin e shkëmbit të patundur. Dine se libri brenda ka më shumë bukuri e rëndësi, sesa i përmenda ketë herë.

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit ”Krijime popullore shestanase” të dr Simë Gjon Dobreci. Botoi Diti&Oli, Libraria ARTI, Ulqin, 2017)

Gjekë GJONAJ

COPËZA TË BUKURA TË JETËS SË ULQINIT, TË SHKRUARA ME NDJENJË TË THELLË SHPIRTËRORE

Në çdo rrugëtim nëpër kohë dhe hapësirë çdo qytet, çdo tërësi urbane ka rrëfimet, anekdotat dhe legjendat e veta, sikurse edhe Ulqini. Një pjesë të tregimeve të këtij qyteti i ka përmbledhur prim. dr. Gani Karamanaga në librin e tij "Në derë të oborrit".

Kur fillova ta lexoj dorëshkrimin e këtij libri, nuk i besoja vetes se do të më tërhiqnin ato rrëfime artistike t'i lexoja deri në fund, të cilat "prekin" ngjarje të ndryshme në Kalanë e Ulqinit. Gati secilin tregim, legjendë apo anekdotë e lexova si ngjarje dite, kohe, momenti apo ngjarje rastësie, sepse në mes meje e veprës u krijua një "magnet" që më tërhiqte fort - ato rrëfime, që janë copëza të bukura të jetës së Ulqinit. Pata kënaqësinë që gjatë leximit të këtij dorëshkrimi të përjetoja çaste të këndshme dhe të mësoja se fjala është për një autor që qytetin e tij të lindjes e ka në zemër.

Brenda tregimeve të këtij vëllimi Karamanaga trajton tema e motive, ngjarje e personazhe, sa aktuale aq edhe të rëndësishme dhe interesante nga jeta e Kalasë së Ulqinit, e cila vlerësohet ndër monumentet më të bukura të trashëgimisë kulturore jo vetëm në rajon por edhe në Adriatik, ku pjesët më të vjetra të mbetura nga bedenat e saj datojnë që nga koha ilire.

Duke shkruar për vlerat e gjithëmbarshme të tregimeve të përfshira në këtë libër, shpreh bindjen se autori i tyre ka arritur të dëshmojë pjekurinë e veçantë, si në aspektin e përmbajtjes ashtu edhe të origjinalitetit krijues, që u bën temave e ngjarjeve, të cilat i ka bërë objekt të trajtimit.

Tregimet e Gani Karamanagës të marra nga realiteti jetësor, shoqëror e historik, në vendlindjen e tij, të cilat na mësojnë shumë, janë të shkruara me frymëzim, emocion e ndjenjë të thellë shpirtërore. Ato ngërthejnë ngjarje interesante, të cilat autori i trajton me mjeshtëri e me të dhëna të vërteta, që tregimeve u japin vlerë të veçantë, edhe ideore edhe artistike. Këto visare të çmuara, që burojnë nga e përditshmja individuale dhe kolektive, ai ka ditur t'i sistemojë dhe t'i nxjerrë në sofrën publike për t'i shijuar të gjithë ata që e duan këtë ushqim të shpirtit.

Çdo kapitull e çdo pjesë e këtij libri, qoftë ngjarje, personazh, tregim apo anekdotë, është shkruar natyrshëm, me ndjenjë, larg lakmisë për të folur apo shkruar me superlativa, por ashtu thjesht e rrjedhshëm, gjë e cila të bën për vete, të josh dhe të imponon respektin.
Ky libër evidenton dukshëm lidhjet e autorit me vendlindjen, bashkëqytetarët, njerëzit e afërt apo shokët e udhëve të jetës. Në njëfarë mënyre, kjo vepër është një "pasaportë" tjetër për vendlindjen e autorit, për Ulqinin.

Me këtë botim, duke përshkruar ngjarjet mirë e qartë përmes kujtimeve e fotografive autentike, autori e plotëson një mozaik dhe një zbrazëti të theksuar për pasqyrimin e ngjarjeve nga e kaluara historike e këtij qyteti të lashtë.

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit "Në derë të oborrit" të dr Gani Karamanaga. Botoi Bashkimi i krijuesve shqiptarë në Mal të Zi, Ulqin, 2017)

Dimitrov POPOVIQI, Podgoricë

DISA FJALË RRETH ROMANIT "TË GJITHË TË MITË" TË SHKRIMTARIT DHE AKADEMIKUT ZUVDIJA HOXHIQ (BERISHA)

Në Ballkanin e trazuar ku aspirohet shumë për të ecur përpara, por ku ende ndjehet e pa tharë vula e tragjizmit të luftërave të kaluara mes njerëzve, vazhdon të shfaqet si një hije e mjegullt urrejtja mes shtresave dhe grupeve të njerëzve. Sistemi politiko-shoqëror i ka ngritur të gjithë kundër të gjithëve, po shahen deri në "shtatë brez", si thotë një fjalë e urtë...saqë njerëzve u është shtuar malli e dëshira për të dëgjuar diçka më të ëmbël, më të butë dhe më njerëzore. Dikush të shurdhon me zhurmën e lëvdatave personale përmes retorikës gojore e fjalimeve, dikush të shurdhon përsëri me trokitjet e dekoratave, që këtij nënqielli nuk u mungojnë...kurse të tjerëve, ndoshta neve që merremi me botën e librit na mbetet t'i nënvizojmë e kujtojmë shpesh fjalët e Azem Shkrelit me vargjet e një domethënie të veçantë

"Se edhe ata që flasin rrallë s'i duan më pak
se të tjerët fjalët e veta..." (nga poezia "Letër një miku", strofa e fundit).

Ndoshta edhe kjo ka qenë njëra nga arsyet që më ka shtyrë ta përkthej këtë roman të mikut tim Zuvdija Hoxhiq, duke i shtuar edhe atë kryesoren se në të kam gjetur shumëçka nga e kaluara ime, kur kam jetuar afër vendlindjes së tij disa vite si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në zemër të Bjeshkëve të Nemuna, në Dragobi –Valbonë. Si vath në vesh më kanë mbetur fjalët e urta të plakut Dul Alia: "Kur lëviz natën, këndo, fol me vete, recito" që të të ndihet zëri, se vendi ka shumë kafshë të egra, sidomos arinj. Egërsira kur dëgjon zërin e njeriut ndalet, dhe njeriu kur e sheh, ndalet. I lëshojnë rrugë njeri-tjetrit. Gjithnjë më ka ndjekur ky shqetësim: njerëzit kanë gjetur një kod marrëveshjeje me egërsirën (ariun), kurse e kanë të vështirë ta gjejnë mes vete, pra mes njerëzve...

Librin e kam pasur në dorëshkrim në gjuhën malazeze, kur më është dhënë për ta lexuar dhe për t'i dhënë mendimin tim, të konkurronte apo jo për shpërblimin "Ungjilli i Mirosllavit", një çmim prestigjioz në Malin e Zi. Detyrimisht! – i jam përgjigjur, - dhe duhet të ndodhë diçka

e madhe që të mos e marrësh ti këtë shpërblim për romanin në fjalë. Ka qeshur, siç qesh gjithmonë dhe kur ma ka sjellë të botuar, unë ia kam dhënë të përkthyer. I ka ardhur mirë dhe e kemi botuar në shqip...(unë si malazez e kam përkthyer në shqip një shqiptar, ashtu si mua malazezit m'i ka përkthyer poezitë në gjuhë malazeze profesori Pjetër Dreshaj, besoj një emër i nderuar i arsimit në gjuhën shqipe).
Kam përkthyer jo pak libra në gjuhën shqipe dhe të them drejt asnjëherë nuk u gjeta ngushtë, sepse të përkthesh në shqip është njësoj sikur të ulesh në një sofër të begatë dhe të gjerë, ku nuk ke nevojë të shtysh bërrylat për të zënë vend, sepse ajo është shumë e pasur dhe e pranueshme në rregullat e drejtshkrimit të saj si dhe ka një bagazh historik e leksikor shumë të fuqishëm.
Jam gëzuar shumë, që Qendra për kulturë me fondet për pakicat e ka botuar menjëherë. Libri është shpërndarë gjithandej: këtu tek ju, në Tiranë në Kryegjyshatë, në Shkodër mes inteligjencies shkodrane, në Ulqin ku i është bërë një promovim i shkëlqyer etj. Ndërkohë përgatitet që t'i bëhet promovimi së shpejti edhe në Shkodër. Këto ditë libri do të botohet edhe në Tiranë, nga shtëpia botuese "Onufri" dhe brenda muajit gusht do të jetë në përdorim.
Çfarë e bën librin e Zyhdisë që ta duam:
Së pari: Dëshira për të nënvizuar se në këtë jetë të trazuar nuk ka vetëm gjëra të këqija, ka edhe shumë gjëra të bukura, për të cilat krenohesh se ekzistojnë, janë të pranishme, i përjetojmë, por në vend që të përgjithësojmë këto mbajmë mend një të keqe të cilës i japim krahë.
Së dyti: njohjes sonë si lexues, kemi shumë çfarë t'i shtojmë në kuptimin si është Malësia dhe malësorët. Mrekullohesh, nëse i njeh për herë të parë, ose rikujton njohjen që ke për malësorët, për mënyrën e jetesës, për punën dhe begatinë shpirtërore, për kalimin e vështirësive dhe krenarinë e bukur, them të bukur se diku krenaria na luan me kryet, etj.
Së treti si bijë të natyrës na bën ta shtojmë respektin ndaj saj, në njohjen dhe zbatimin e ligjeve të saj, që janë objektive, që nuk varen e "varen" prej nesh, prej nga rrjedhin deduksione me vlerë; e duam malin, e duam thneglën, e duam rrëqebullin, e duam viçin që po mbytet dhe sakrifikojmë për të, por nuk duam njeriun!?
Së katërti përmes fisit të tij, shkrimtari na jep tipin e familjes malësore shembullore ku gjithkush gjen nder te dera e saj. "Shtëpia e Zotit dhe e miqve" – kjo sintagmë e fuqishme në të folurit e këtyre anëve, këtu realizohet në formën më të përkryer, duke krijuar një lidhje shpirtërore, " pa të cilën, - siç shprehet Rexhep Qosja , - nuk ka përbashkësi të

vërtetë". Në familjen e tij rritet edhe një hallë që nuk është e gjakut dhe e besimit, që një dorë e panjohur u a ka lënë pas dere një natë që ta rrisin...apo qëndrimi i vendasve ndaj batalionit të Bokës që është i paharruar, etj. etj.

Së pesti, ajo që na mundon më shumë në këto treva, prezenca e atij "tjetrit", me kombësi, fe e gjendje materiale ndrysh, ndoshta diku tjetër shfaqet e frikshme, e papranuar, por këtu është shembullore. Ajo Teqeja e vogël, po aq larg nga Kisha ortodokse dhe nga ajo katolike, nuk ngjason me objektin majë Rumisë, se kishat i ndërton populli, shpirti, besimi e jo forca, qoftë kjo edhe ushtarake.

Së gjashti, romani kap të gjitha shtresat e shoqërisë dhe u jep vendin e merituar si një mjeshtër i aftë e i gjithëdijshëm.

Së fundi, romani në formën artistike është shumë modern, ai ngërthen shumë bukur realen me imagjinaren, krijon një fantazi që të lë pa mend, sidomos kur jep shpjegime me vizitën në Hënë, për fjalët e kozmonautit, për objektet që duken prej atje, pa i mbajtur anën askujt, as për besimin islam, ashtu edhe atë të krishterë. Ekzistencializmi është i pranishëm kudo. Shkrimtari është mjeshtër i përshkrimit të natyrës, por nuk bie në natyralizëm, ai përgjithëson me një fuqi të veçantë. Takimet me rrëqebullin (risin) mbeten të pashlyera. Paralelizmin figurativ artistik dhe jetësor e ndeshim kudo. Varrimi i të atit, kalimi me kufomën e tij në Çakorin e mbuluar nga bora e ngrirë, rrëshqitja e arkivolit në akull, rendja për ta kapur të krijon një skenë a thue se je në filmat "horror"-rendja pas të vdekurit... dhe nëna i thotë ...mua më varrosni aty ku e keni më lehtë, ku të doni ju. Po ashtu historia e nënës me valixhen me eshtrat e të birit në tren ...etj. që do t'i lexoni dhe do t'i kujtoni shpesh.

Romani na sjell edhe shumë figura të artit me të cilët e ka lidhur jeta Zyhdiun. Shumë interesante janë bisedat me Mekulin, Zogoviqin, Kostiqin e të tjerë. Shumë të këndshme janë takimet jashtë shteti. Shumë tërheqëse faqet që tregojnë edhe për sakrificat e tij. Pra çfarë nuk gjen në këtë libër?

Të mos harrojmë Zyhdiu është bektashi. Bektashizmi ka një traditë shekullore e shembullore në Shqipëri. Jo pak figura të shehlerëve shqiptarë përmenden aty. Dhe me meritë. Aty përmendet me pietet njëra nga familjet më patriote e më me vlerë të trevave shqiptare, ajo e vëllezërve Frashëri: njëri, i madhi, Abdyli, strateg, i dyti Samiu, filozof i madh, kurse i treti Naimi –bilbili i kombit dhe i gjuhës shqipe. Tek ata ka sunduar panteizmi – Zoti kudo, në çdo gjë. "Me qiejt mos u mbani, se nuk mbahen asgjëkundi" – porosiste Naimi në një nga krijimet e tij. Por

aty ka edhe të tjerë e të besimeve të tjera, myslimanë e të krishterë që i ngre lart, ashtu edhe si e meritojnë.
Romani ka vlerë dhe në vazhdën e shkrimeve të mëparshme i jep vlerë reciprokisht edhe vetë shkrimtarit, që në moshën 75 vjeçare vazhdon të shkruajë dhe të ndjehet i vyeshëm për brezat e kohës së tij, por edhe ata që vinë pas. Ta njohësh të kaluarën tënde është një obligim i madh. Ai nuk e ka njohur gjyshin, por rruga për ta njohur na pëlqen edhe ne, e ndjekim me kujdes në të gjitha veprimet, dhe del fitimtar.
Në takimin me Shoqatën e krijuesve shqiptarë në Ulqin, kur u bë promovimi i këtij romani, mori pjesë dhe diskutoi edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Malin e Zi, Zoti Skënder Durmishi, i cili theksoi mes tjerash, rëndësinë e librit dhe veprimtarive kulturore në rritjen e klimës së mirëkuptimit mes popujve. Ndërsa njëri nga shkrimtarët që diskutoi, një emër i nderuar për letërsinë për fëmijë, Hajro Ulqinaku, pasi e vlerësoi si duhet, shprehu mendimin se romani do të ish më mirë të quhej: ”Fisi im”. Kam mendimin, se Zuvdija i tejkalon kufijtë e fisit të vet, se këtu, të tijtë - janë të gjithë: edhe shqiptari, edhe malazezi, edhe boshnjaku, çdo njeri me zemër e vepra të mëdha, asish që Malësia ka me shumicë. Për Zuvdinë ata janë engjëjt e tij dhe për t’i quajtur të tillë ai u ka gjetur edhe parajsën e duhur, vendlindjen, ku është lindur e rritur. Le ta mbyll diskutimin tim me fjalët që kam shkruar në fejsbukun tim, kur e kam lexuar librin e Zuvdiut, fjalë të cilat si përkthyes dhe redaktor i tij në gjuhën shqipe i kam lënë në kapakun e fundit të librit dhe që janë mirëpritur e miratuar nga miqtë e mi, por edhe të shkrimtarit, anë e kënd Shqipërisë dhe në Kosovë:
“Zuvdija Hoxhiq (Berisha), një ndër shkrimtarët më të mëdhenj e më në zë në Malin e Zi, por edhe një njeri i mrekullueshëm në kuptimin më të plotë të kësaj fjale, ka trajtuar në këtë roman biografik marrëdhënie të shkëlqyera e shembullore mes kombësive, feve dhe brezave. Kur ta lexoni, do t'i ndjeni edhe më shumë vlerat dhe traditat e malësorëve, por edhe bashkëvendësve të tjerë, pa pasur nevojë të zbukurohen, sepse ato janë me të vërtetë të qenësishme, të bukura e të patjetërsueshme, dhe sidomos kur jepen artistikisht, siç i ka dhënë pena e këtij mjeshtri të madh, ato ngrihen edhe më lart dhe qëndrojnë në kohë si bjeshkët që i mbajnë.”

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit “Të gjithë të mitë” të Zuvdi Hoxhiqit. Botoi Enti i Teksteve dhe mjeteve mësimore, Podgoricë, 2017)

Gerta BANDILLI, Korçë

“TË PREKËSH ULQININ NË VARGJE POETIKE

“Të marrësh pjesë në takime poetike, ku Zot i sofrës është poezia dhe për më tepër poezia e mirë dhe e zgjedhur, është nder. Kënaqësi që u bëra pjesë e Netëve Poetike të Ulqinit”

Gjithnjë është folur për rëndësinë e poezisë, gjithmonë janë zhvilluar takime poetike, konkurse, interpretime të saj, etj.poezia, e përkufizar nga shumë studiues, e interpretuar nga artistë, e vëzhguar nga afër prej kritikëve, më së shumti ju përket poetëve, që sipas Aristotelit janë filozofët më të mëdhenj të kohërave. Pa dyshim që kjo është thënie shumë e madhe për morinë e botimeve të poezisë, faqeve sociale që merren me të, por ngelet nga përkufizimet më të sakta, sepse poezia është ndjesia që lëviz në shpirt, farkëtohet në frymë, konkretizohet në mendim, për t’u shkruar më pas në letër. Kur kjo bëhet në mënyrën e duhur, me pasion dhe profesionalizëm përkufizohet me fjalët: “Është shkruar për mua”. Duke u ndalur tek takimet poetike, Ulqini mbledh poetë nga caqe të ndryshme, i vë në start para një teme të caktuar dhe në fund kurorëzon fituesit që “Libraria Arti” i përfshin në antologjinë që boton për këtë aktivitet. Antologjitë në përfytyrimet e mia sjellin Ulqinin, ashtu siç është i kaltër, i ngritur mbi dëshira njerëzore, tradita kulturore dhe lashtësi historike. Ndërsa poetët shkruajnë për Ulqinin unë eci midis vargjeve si përmes rrugëve të tij, takoj metaforat, njësoj sikur takoj njerëzit e tij dhe përjetoj emocione të forta tundimesh për të vrapuar drejt tij. Por është e pamundur që një frymë magjie të më sjellë në këtë qytet sa hap e mbyll sytë, prandaj njëlloj si poetja unë i drejtohem dallëndyshes të fluturojë e në sqepin e mbushur me lulevjollca të sjellë pak aromë. Lashtësia e këtij qyteti duket që në vargun “ a keni dëgjuar për Adamin e dytë?” , për të na treguar se Ulqini ka njëzet shekuj që hijeshon mbi valët e detit, që tregon historinë e kalasë, rojë e fatit të trazuar të ulqinakëve, fis taulantësh e bij kastriotësh. Ulqini duket se ka dalë nga magji përrallash treguar nga një Peshk i Artë, atje tek Kacemja nën kala, sepse ky qytet që ditën është i kaltër, natën shndërrohet në qytet të bardhë, a thua se pulëbardhat që fluturojnë në rrathë koncentrikë e me forma të përcaktuara shkundin bardhësi nga krahët e tyre. Ulqini është i bukur edhe në vjeshtë, thotë poeti, sepse përkundet ende në ëndrra misterioze, sepse dita me diell nuk i thotë dot

lamtumirë qytetit, sepse deti i tij është liria e munguar, sepse buzë tij sërish bëhet dashuri, të cilën kamerat nuk e kapin dot.
Dashuria për qytetin është dashuri e thjeshtë, por e përjetshme. Koha që mplak njeriun, mplak edhe qytetin, edhe valët lozonjare, edhe ledhet e hënës. Dashuria e qytetit dhe e banorit të thjeshtë të tij, është një simbiozë mbijetese, qyteti i jep njeriut vlerën dhe njeriu i jep atij mbijetën.
Nga qytete të tilla ku lashtësia projektohet në të tashmen është vështirë të largohesh, mirëpo kur dera mbyllet përvajshëm pas nesh, fati i ecejake na pret. Na çojnë këto ecejake gjithkund, ndërtojmë jetën tonë larg vendlindjes, humbasin në çudi që na mpijnë e na shndërrojnë në zogj vjeshtakë. Askujt, asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk pëlqen të largohet nga vendlindja, por vrulli i jetës së sotme, kushtet historiko-ekonomike e deri tek dëshira për udhëtime na bëjnë të mërgojmë larg, mërgim ky që shoqërohet me përjetime ndjenjash të forta, me dhimbje shpirti, psherëtima zemre dhe lot në sy. Motivi i mërgimit është sa i lashtë aq edhe koherent. Modele të shkëlqyera të përjetimeve të mërgimit na vijnë, që nga epizmi i Itakës e deri në vargjet modeste të ndjenjave që përcjellin pasione poetësh. Mërgimi brenda vetes mbart edhe dramat e veta si stepja ndaj të panjohurës, pritja për t'u kthyer, kthimi në vendlindje si një i huaj ku askush nuk të ndjek, pa përmendur kostot ekonomike. Mirëpo koston e vërtetë të mërgimit e paguan shpirti i emigrantit, i cili jeton gjëmën e ikjes. Askush nuk e gjen dot përse ikën edhe po të pyesë shkëmbin, lumin, detin apo qiellin. Mërgimtari ndihet i huaj, në dilemën se ku do të kthehet, pasi pas shumë vitesh mërguar, në vendlindjen e tij nuk e njeh më njeri. Historia që do të shkruante në vendlindje tani është zëvendësuar nga malli për rrugën ku kishte ecur dikur, për hijet e vështrimeve mbi kthesat e njohura, për jehonën e zërit të nënës. Për mërgimin kanë shkruar shumë autorë dhe do të vazhdojnë të shkruajnë akoma, sepse gjithmonë njeriut i duhet të nxitojë për t'u larguar diku. Kohët moderne kanë tjetërsuar emigrimin, por jo mallin dhe përjetimet e të mërguarve. Poetët janë ata që me forcën e shpirtit dhe mendimin abstrakt i kthejnë njerëzit në shpezë shtegtarë, i nisin në vise të panjohura si vjeshta me shi duke ndjekur diellin, për t'i kthyer në pranverë, kur gazmendi i saj përfshin gjithë natyrën.
Në këto rreshta nuk hodha veçse emocionet e përjetuara gjatë leximit të antologjive të "Librarisë Arti", duke u përpjekur të përfytyroj mistere frymëzimesh, agime që përthyhen në pika vese e shndërrohen në ylberë, ditë që largohen thellësive të detit, netë që pikojnë të kristalta nga yje të kaltër dhe eca rrugëve të vjetra të Ulqinit për të krijuar rrugë të reja në bashkëpunime poetike.

Asllan BISHA

ZËRI I DETIT, ZËRI I HAJRO ULQINAKUT

"Zëri i detit", është libri i ri, i Hajro Ulqinakut. U lind në Ranë të Ulqinit më 1938. Hajrudin Pufja mësimet e para i kreu në vendlindje buzë detit. U dashurua me detin qe kur ishte nxënës i fillores. Që kur ishte normalist i linden dëshirat për të afirmuar vlerat kulturore të vendlindjes dhe kombit. Mbaroi normalen, e emruan mësues në Ostros të Krajës. U mësoi shkronjat fëmijëve me dashuri. Ai kishte etje për të mësuar dhe vazhdon studimet në Beograd. Sa më larg vendlindjes dhe detit aq më shumë i shtohej dëshria për vendlindje. Dhe këtu nisën shkrimet e para nga letërisia, folklori, gjuhësia. Kreu fakultetin e albanologjisë në Beodrad. Ai u punësua në Ferizaj, ku fillon punën në arsimimin e brezave të rinj. Themelon seksionin letrar De Rada dhe nxit aktivitetin letrar. Ishte gazetar i Radio Prishtinës dhe nga viti 1974 punon gazetar, redaktor i Programit për Fëmijë deri në vitin 1990 kur përjashtohet nga puna nga dhuna policore serbe. U kthye në vendlindje, por për autorin e shumë veprave letrare, autorin e librit "Fëmijët e detit" të botuar më 1967 në Prishtinë, "Margaritarët e zez" 1969 dhe 15 librave për fëmijë nuk u gjet një vend pune.

Tregimet e para për të rritur janë sprovë, por Hajro Ulqinaku i përkushtohet tregimit të shkurtër ku del në pah talenti i tij. Motivet e detit dhe për detin, tregimet janë përjetime të fëmijërisë e cila është frymëzuese me interes. Ulqinaku me tregimet e tij iu afron detin fëmijëve të Kosovës. Ata mësojnë, hetojnë rrëfimet e sinqerta nga deti, por edhe pasurojnë flalorin me shprehje detare. Interes të veçantë paraqesin legjenda për kusarët e Ulqinit, personazhi i Lika Cenit i cili e mund kryepiratin Karallampon. Melodrama është inspirim nga e kaluara e Ulqinit, po ashtu libreti "Dasma e Ulqinit" me lëngë dhe valle ulqinake. Tragjedia e Tivarit bazuar në rrëfimin e Azem Hajdinit, përshkruhet tragjedia e Tivarit, për të cilën vitin e kaluar Hajro Ulqinaku përpiloi hartoi librin "Tivar varri" ,Përmblodhi poezitë e të gjithë krijuesve tanë për ngjarjen makabër të Tivar, për fatkeqsinë e Tivarit, për të cilën u hesht shumë.

Me vlerë është edhe fejtoni ,,Gjurmëve të poetit,, për poetin Migjeni. Të afërmit e tij flasin dhe ndriçojnë ketë figurë me interes të kombit tanë, për poetin që tëtjerët deshën ta përvetësojnë. Fejtoni është shkruari drejtë dhe sqaron jetën dhe veprën e Migjenit, i cili u detyrua të bëhet prif

ngase nuk kishte mundësi të shkollohej, familja e tij s'kishte mundësi ekonomike. Dhe Migjeni s'pranoi të punojë si prift, ngase gjithmonë kishte dëshiruar të bëhet mësues. Punoi mësues në Vrakë dhe në Pukë. Ishte i nderuar dhe i dashur nga nxënësit dhe prindërit. Fejtoni sqaroi se Migjeni ishte shqiptar shkodran. Një kapitull i veçantë i këtij libri është edhe ikja e Arbreshëve matanë detit dhe fati i tyre. Ikje arratisje dhe mërgim. Shkrimtari në kapitullin e parafundit flet se Simon Simeonis në vitin 1322, i cili erdh me shokun e tij nga Raguza, Dubrovniku në Ulqin vazhduan udhën për Durrës për Tokën e Shenjtë-Jeruzalem-Palestinë. Këta dy pelegrinë anglo-irlandez Brigjet shqiptare i quanin Albania ndërsa arbreshët i qujajtën albanez.

Veprimtaria e Hajrudin Pufjes e Ulqinakut të Madh është një begati perlë që ka vlerë dhe, jo vetëm për kulturën e Ulqinit, por për atë mbarëkombëtare. Ky krijues me dashuri punoi për të mirën e vendlindje duke ndriçuar shumë personalitete të kësaj treve. Libri "Zëri i detit" është zëri i Hajro Pufjes i Ulqinakut të Madh, i cili punoi për të mirën e vendlindjes. Ai u kthye Itakës, dhe mbet biri i saj besnik me vepra që janë xhevahir.

Asllan Bisha, shkrimtar, redaktor

Murat GECAJ, Tiranë

ME DASHURINË PËR NJERËZIT DHE KUJDESIN NDAJ SHËNDETIT TË TYRE…

(Përurohet libri i Prof.Emeritus Dr.Hektor Çoçoli, "Nostalgji-Intervista e jetës sime")

Sot paradite, në sallën "Unesco" të Muzeut Historik Kombëtar, në kryeqytet, u organizua përurimi i librit të ri, me autor Prof.Emeritus Dr.Hektor Çoçoli, "Nostalgji-Intervista e jetës sime"(Nga SHB "Albas", redaktore Nirvana Lazi e recensent Nasho Jorgaqi dhe me hyrje nga vetë autori e bashkëshortja, Lirika) . Ishin të pranishëm: familjarë të autorit, bashkëkrahinas nga vendlindja e tij, Gjirokastra dhe rrethe tjerë të vendit, pedagogë e studentë, personalitete të jetës asrimore, kulturore e shkencore të kryeqytetit, nga media e shkruar dhe ajo elektronike etjerë.

Moderator i kësaj veprimtarie ishte i mirënjohuri Bujar Kapexhiu. Pasi uroi mirëseardhjen në këtë ngjarje të shënuar, si për autorin dhe tërë të ftuarit, të parit ia dha fjalën Laurant Bicajt. Ai u ndal, shkrutimisht, në përmbajtjen e kësaj vepre, (me gjithësaj 517 faqe e me dhjetëra fotografi), duke nënvizuar trajtimin bukur me fryëzim e nostalgji të etapave të ndryshme të jetës, që nga lindja dhe deri sot. Në të gjitha faqet e këtij libri të ri, ai na del njeri i mirë e familjar shembullor, koleg e mik i dashur, mjek specialist-radiolog i aftë, pedagog dhe veprimtar i shquar e i palodhur, i cili ka lënë gjurmë të pashlyera, kudo që ka jetuar e shërbyer.

Vërtet moderatori i këtij përurimi kishte parashikuar emrat e disa vetave për të folur, por nga ajo sallë e tejmbushur secili kishte për të thënë shumë për Hektor Çoçolin. Në libër ai ka folur në veten e parë, ndërsa ngjajet, që përshkruan, nuk tregojnë për meritat e veta, por kryesisht të qindra njerëzve, me të cilët ka jetuar e punuar, si në kryeqytet dhe në rrethe të ndryshme të Atdheut.

Në një priudhë të gjatë të jetës së tij, prof.Hektor Çoçoli ishte ndërmjet pedagogëve e studentëve të Fakultetit të Mjekësisië, në Universitetin e Tiranës. Prandaj, për ndihmesën e çmuar të tij në fushën e arsimit dhe të pedagogjisë, foli prof.Musa Kraja. Ai theksoi jo vetëm aftësitë profesionale, me të cilat u dallua në leksionet e praktikat e tij në spital, pranë të sëmurëve, pra pedagog e mjek, por dhe për taktin pedagogjik e

dashamirës të komunikimit dhe dashhurinë, që ka shfaqur përherë me njerëzit. Për këto merita të veçanta e cilësi dalluese të tij, u shprehën edhe folësit e tjerë, mjekët e pedagogët e njohur, në fushën e mjeksisë sonë: Pandeli Çina, Elez Selimaj e Flamur Tartari.

Por, gjatë jetës së tij, ashtu siç del qartë nëpër faqet e këtij libri voluminoz, prof.H.Çoçoli ishte dhe është njeri me interesa të gjëra. Prandaj, "Mjeshtëri i Madh" Zhani Ciko tregoi, se sa me dëshirë i ka ndjekur ai shfqajet e ndryshme artistike në kryeqytet. Në shenjë respekti, i dhuroi atij një "sidi", me krjimtari të kompozitorit të shquar, Nikolla Zoraqi. Më tej, për dashamirësinë e këtij mjeku ndaj sportit, foli komentatori ynë i mirënjohur, Ismet Bellova dhe për aftësitë aktoreske të Hektorit tregoi bukur, Bujar Kapexhiu.

Të paharruara për mjekun radiolog Hektor Çoçoli kanë qenë pesë vitet e shërbimit të tij, në Malësinë e Gjakovës (Tropojë). Atje u dashurua jo vetëm me bukuritë natyrore alpine, por dhe njohu nga afër traditat e mrekullueshme të asaj krahine, atdhetare e liridashëse, përjetoi bujarinë dhe mikpritjen e malësorëve etj. Prandaj, për atë kohë "të artë" jetës së tij, ai ka folur me aq pasion nëpr faqet e këtij libri. Po, për këto dëshmuan edhe përfaqësues të atyre anëve, si: publicisti Mujë Buçpapaj, punonjësi i sektorit të shëndetësisë e humoristi, Ali Mula-"Mjeshtër i Madh" dhe kuadri drejtues i këtij sektori jetik e radiologu, Vogël Ademi. Ndërsa kusheri i tij dhe publicisti Fatos Çoçoli nënvizoi se, në çdo faqe të këtij libri, lexuesi do të gjejë jetën e vërtetë, jo për autorin, po për të tjerët, që njohu dhe që e duan përherë njeri-tjetrin. Për shpirtin poetik dhe ndjenjat e pastra njerëzore, të cilat i ka derdhur autori në këtë libër, foli botuesja e tij, e cila e vlerësoi këtë vepër, si "enciklopedi njerëzore".

Të pranishmeit në këtë përurim ndoqën me interes edhe përshëndetjen e përzemërt, të mjekut nga Ulqini, Dr. Gani Karamanaga. Ai i dhuroi autorit të librit, që u përurua sot, një botim të tij dhe revistën, e cila del atje, "Dija". Po kështu, e ftoi atë, me bashkëshorte Lirikën, në përurimin e botimeve të tij.

Në mbyllje të kësaj veprimtarie përuruese, të bukur e mjaft mbrelënëse, foli shumë shkurt, prof.Emeritus Dr.Hektor Çoçoli. Ai i falënderoi, me zemërbardhësi, të gjithë folësit e pjesëmarrësit dhe tha se ndjehet i lumtur që, kurdoherë e kudo, është rrethuar nga njerëz të mirë, mirënjohës e vlerësues, të cilëve u ka shërbyer përherë dhe pa u kursyer, me të gjitha aftësitë mendore e fizike. Janë mjaft domethënëse fjalët, që ai ka shënuar në ballinën e fundit, të librit të tij: *"Nostalgjinë time për të kaluarën e ruajta të fshehur, si një thesar të çmuar, brenda shpiritit tim,*

deri sa një ditë atë e trazoi dikush, ky dikush kaq shumë i rëndësishëm për mua…Një ditë mora guximin dhe fillova të shkruaja. Hodha në letër fjalët e para, më tej fjalët u bën fjali, rreshtat u bënë faqe të tëra. Dhe, kështu, u krijua ky libër, të cilin mendova ta titulloj "Noslagji"…".
Ishte kënaqësi, kur edhe unë, bashkë me shumë kolegë e miq të prof.H.Çoçolit, e morëm në duar këtë libër, me nënshkrimin e bukur e dashamirës të tij. Pastaj, bisedat i vazhduam në koktejin e shtruar nga familja, me këtë rast dhe bëmë shumë fotografi të përbashkëta. Si ato dhe tërë kjo veprimtari përuruese, do të mbeten, për ne pjesëmarrësit, një kujtim i çmuar nga jeta dhe do të bëhen pjesë e nostalgjisë, me të cilën prof.Emeritus Hektor Çoçoli, shkroi e ua dhuroi librin e tij, lexuesve të sotëm dhe atyre, që do të vijnë pas nesh. Sepse, nga përvoja e gjatë jetësore e tij, ata do të mësojnë, se ai nuk kurseu asgjë për shëndetin e gëzimin e tyre dhe kurdoherë e kudo fali, vetëm dashuri njerëzore.

Tiranë, 4 mars 2017

Jaho KOLLARI

EDHE NJË BOJË NJERIU

Çfarë e bën gjësendin (apo individin) të madh? Vepra, pamja, jetëgjatësia, apo... Ndodh që të gjitha këto të ngërthehen në një trup të vetëm që bëjnë që madhështia të mos ketë si njësi matëse përmasat, proporcionet, vetitë, apo edhe ndonjë natyrë tjetër. Njeriu, edhe po të mos ketë bërë shumë në jetë, vetëm arritja e moshës së thellë e bëjnë atë të veçantë. Vendin poashtu, meqë resursi më i madh i një vendi është dhe mbetej subjekti, pra, mbindërtimi i natyrës rreth së cilës ajo (natyra) njerëzore jep e merr me të, dhuron kreativitet për të marrë inspirim, që s´është veçse fuqia me të cilën qenia njerëzore ngrihej në piramidën e zinxhirit të të ushqyerit. Pikërisht kjo fiziologji, si marrja e ushqimit dhe çiftëzimi janë dhe mbeten kyçi i mbijetesës. Vendosja e Homo Sapiensit në pirgun e zinxhirit të të ushqyerit e bën atë Zot të planetit, njëkohësisht që atij i vihej detyra që, duke mbrojtur mjedisin, mbron edhe ekzistencën e vetvetes.

Mbase me të drejtë parashtrohet pyetja: ç´kuptim ka jeta, kur jemi e vetmja qenie që është e vetëdijshme se një ditë do të vdesë?! Jeta, në vete, nuk do të ketë aq vlerë po të mos ekzistojë mekanizmi më i përkryer natyror, i cili është fort i ankoruar në gjenet tona, e ai është çiftëzimi. Vetë përcjellja e vetive tona prej brezit në brez e bën jetën e individit, ndonëse të shkurtër, të ketë kuptim.

Një veti tjetër që jetës së njeiut i jep kuptim është kreativiteti. Jorrallë njeriu identifikohej përmes aftësisë, apo aftësive që ka, përmes dhuntisë apo veprës së vet, si p. sh., përmes një vendi (të cilin e ka ndërtuar), fshat apo qytet qoftë. Për t´u hidhur me këtë të fundit mund të thuhej se jeta merr kuptim edhe atëbotë kur individi e ndjenë veten si pjesë e një komuniteti. Sa më i moçëm të jetë ai komunitet aq më i rryer bëhej. Nga kjo mund të shkulej se secili individ e rrit shtatin e vendit ku jeton edhe për madhësinë e vetvetes. Duke u nisur nga fakti që madhësia e një qyteti, ta zëmë, matet me numrin e banorëve, ndërlidhej me atë se numri i banorëve ka rëndësi për madhësi fizike, mirëpo për madhësi dhe rëndësi të një vendbanimi nuk çon peshë vetëm numri i banorëve, në mos më tepër ngjarjet e, sidomos, vjetërsia e tij.

Pikërisht këtu qëndron i strukur strumbullari i kësaj vepre letrare të Gazmend Çitakut: madhështia e Ulqinit nuk matet me numrin e popullatës apo hapësirës, por me ymrin e gjatë të tij. Është plotësisht e

pamundur të jetohej gjatë e të mos përjetohej gjë, çka Ulqini bëri me bollëk në këta 25 shekuj.
Duke filluar nga Mbretëresha Teutë, Odiseu, Sabataj Cevi, Likaceni, Servantesi... e mbaruar me Bego Babotit, legjenda këto që në trajtë letrare Çitaku me mjeshtri na i sjell këtu, çfarë edhe është madhështia e kësaj vepre. Veç përmasës së thellësisë që ka vepra, me të cilën i depërtohej mjaft thellë nocionit hapësirë-kohë, ajo ka edhe gjerësi dhe gjatësi, pra, horizontalitet dhe vertikalitet dhe kjo e fundit ka tejet shumë rëndësi, meqë vlera veprës i rritej me rritjen e numrit të lexuesve. Pikërisht ky fakt mund ta bëjë atë të madhe, pra, mosha dhe hapësira mbarëshqiptare e lexuesit.
Çitaku si letrar, për habi, nuk vjen me një vëllim poetik (si ndodh shpesh), por me një vistër tregimesh, syzheun e të cilëve pothuaj çdo vendari e ka dëgjuar. Mirëpo tani ky ka edhe këtë mundësi: t´i ndjejë, dëgjojë dhe shijojë edhe në petkun artistik.

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit "Tregime të çuditshme nga Ulqini"- Legjenda, të Gazmend Çitakut. Botoi Diti&Oli, Libraria ARTI, Ulqin, 2017)

LIBRI

Gjovalin ÇUNI, Shkodër

NJË VËSHTRIM BIBLIOGRAFIK MBI VEPRËN E FRANG BARDHIT

Në çdo kulturë flitet denduar për "ngjarje" në rastin e botimit të librave, pa qenë të sigurtë se sa jetegjatë do të jenë ata, nga njëra anë, si dhe sa të mirëpritur mund të kenë qenë ata, nga tjetra, shkruan Plasari, [19]

Në rastin konkret meqë librat janë të njërit nga pesë autorët më të vjetër të gjuhës por edhe letërsisë shqipe,dhe meqënëse se ata lindën në rrethana të vështira të shekullit XVII, por edhe në një ambient të brëndshëm, të pakulturuar, duhet thënë se jetëgjatësia e tyre, por edhe mirëpritja janë të lidhura me bibliotekat, vendet e ruajtjes të trashigimisë së vyer kulturore të vendeve të ndryshme, përgjatë shekujve.

Para se librat të përdoren dhe /ose të studiohen, duhet të dihet që ata ekzistojnë: ky është parimi lëvizës që shërben si shtysë në vlerësimin e çdo biblioteke[20].

"Librat për libra – vijon A. Plasari- janë të kushtueshëm nga pikpamja e investimit intelektual, shkencor dhe kohor, përkatësisht financiar, duke qenë njëherësh ky investim që i bën ata bartës vlerash të pamohueshme[21].

I tillë ishte edhe kalvari i botimit të librave të Frang Bardhit, i pasqyruar saktë nga njohësit e jetës së tij, si M.Roques, S. Riza, J. Rrota, I. Zamputi, E.Çabej. F. Fishta, W. Kamsi, B.Demiraj etj. Kalvari ndahej mes jetës mesharake dhe njeriut diturak, që duhej të kapërcente pengesat të panumërta të të tijve, pushtuesit turk, por edhe të hierarkisë kishtare. Të mos harrojmë se **"**Fjalori latinisht-shqip" para se të botohej mori aprovimin e Mark Skurës "Episcopos Stephanenesis"[22] (Ipeshkëv i Arbërit) dhe më vonë atë të Kardinalëve të Kongregacionit Propaganda Fide.[23]

---

[19] Plasari, Aurel. Parathanie e botimit Libri shqip 1555-1912. Tiranë: Biblioteka Kombëtare, 2010, f. 11.

[20] Po ai: Po aty.

[21] Po ai"Po aty.

[22] Roques, Mario. Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera. Shkodër:Botime Françeskane, 2011. f..91

[23] Po ai : Po aty f.92.

Librat e Frang Bardhit:
Shqipërimet e dorëshkruar të kredos dhe të ritualit.
Relacionet italisht (1637, 1638, 1641), të përkthyera nga Injac Zamputi.
Apologjia latinisht mbi origjinën e Skënderbeut, kundër tezës së Jan Tomkut, mbi orgjinën boshnjake të Skënderbeut. (Romë, 1632), me titullin e saktë:
"Gjergj Kastrioti Epirotasi, popullorçe Skënderbeu, trimi me fletë dhe i pathyeshme, prind i epirotasve-ridhënë të vetvet dhe atdheut",
"Dictionarium Latino-Epiroticum una cum nonnullis usitatioribus loquendi formulis" (Fjalor latinisht-epirotisht…..) bashkë me disa mënyra shprehjesh që përdoren shpesh, hartuar nga Frang Bardhi epirot, … Romë 1635) [24]
"Fjalori latinisht-shqip", cilësohet si vepra më e rëndësishmja e Frang Bardhi, pasi është leksiku i parë i gjuhës shqipe, i hartuar nga një shqiptar, që sipas. Kolë Ashtës nga 2544 fjalë shqipe të fjalorit , afro 1300 janë të brumit vëndas. [25]
Mario Roques, zbuluesi dhe njohësi më i mirë të veprës së F. Bardhi na sqaron se ajo lindi "… në trysninë e italishtes dhe të turqishtes, ndoshta për njerëzit e dijtun, dhe nën ndikimin e latinishtes, pasi leksiku i shqipes (së Veriut) po humbte pastërtinë e vet… , dhe do të shërbente me shkrue shqip, vepra të dobishme për përhapjen e fesë. Po duhet sidomos të mënjanojë gabimet dhe shpërdorimet ndaj të cilat, madje, asht shumë rrezik kleri shqiptar, për arsye të padijes së gjuhës latine[26] . 113 fjalë të urta, të mbledhuara nga Frang Bardhi dhe të vendosuara në fund të librit, e bëjnë atë edhe nismëtar të folkloristikës sonë.[27]
Për kah rëndësia në krijimtarinë e F. Bardhit nuk mund të lihen pas dore edhe trajtesat e tjera, historike, fetare dhe folklorike të pasqyruara në relacionet, e tri vizitave baritore,[28] të krahinave të Pukës, të përfshira në Dioqezat e Sapë-Zadrimës dhe Pultit.
Nëse thellohemi në studimet, e bëra mbi veprat e F.Bardhit nga autorë të fushës, mund të arrihet në konkluzion, se këto vepra janë pjesë e

[24] Pepa, Simon. Kontributi i klerit katolik në leksikografine shqiptare. Në seminarin: "Krishtërimi ndër shekuj:, Tiranë, 2000, f. 447.
[25] Po ai: Poaty.
[26] Roques, Mario. Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera. Shkodër: Botime Françeskane, 2011. f. 92
[27] Pepa, Simon. Kontributi i klerit katolik në leksikografine shqiptare. Në seminarin:"Krishtërimi ndër shekuj:, Tiranë, 2000, f. 448.
[28] Shënim. Relacioni i parë 1637, "Puka dhe pukjanët, Relacioni i dytë (1638) Pulti dhe malësorët, Relacioni i tretë (1641) "Zadrima dhe zadrimorët".

trashëgimisë më të vyer të dokumentave shqipe, por fatkeqësisht, bazuar në kohën kur lindën shek. XVI-XVII, nuk na rezultojnë se do të kenë patur ndonjë ndikim të madh kulturor në vend. Kjo lidhet me injorancën kulturore të popullsisë vëndase, që rridhte edhe nga pamundësia zhvillimit të kulturës (sidomos e gjuhës) gjatë rregjimit turk, e aq më tepër që autorët e këtyre veprave ishin prelatë katolikë të Veriut.
Këtë e vërteton edhe fakti së në rrjedhë të shekujve as që dihej ekzistenca e tyre. Ndër vite hulumtues të ndryshëm, por edhe bibliografë kanë ndjekë, siç shkruante A. Plasari, odisenë e botimeve,[29] humbjes, gjetjes, rihumbjes, rigjetjes e kështu me radhë.
Fatmirësisht, siç ndodh rëndom edhe në ditët e sotme në Shqipëri, do të ishin të huaj që do të inicionin një proces kërkimi të dokumentave të shqipes, të shpërndarë në biblioteka të ndryshme europiane, nisur më tepër nga kërshia për këtë vend, por dhe nga interesat shkencore në kuadër të përpjekjeve për të zbuluar identitetin kombëtar të popullit tonë. Në kohët moderne pati një interes të shtuar edhe nga studiuesit shqiptarë ku mund të veçojmë Faik Konicën, Mehdi Frashërin etj. Një ndihmesë të veçantë në studimin e veprës së F.Bardhit ka dhënë studiuesi frëng Mario Roques, që i përkrahur edhe J. Rrota " … bante nji përpjekje organike [30] për të paraqitë kjartë e sa ma të plotë si në pikpamje kronologjike dhe bibliografike, krejt nji plejadë autorësh të vjetër"[31] .
Mario Roques zbuloi dhe ribotoi "Fjalorin…." shqip të F.Bardhit, në shtesat introductive pranë fjalorthit të Arnold Von Harff dhe e paijisi me një hyrje prej 48 faqesh.[32] Krahas fjalorit , M.Roques, ishte autor i studimeve shqiptare të përmbledhura në vëllimin "Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe"[33], që Filip Fishta , e cilësonte si fillesë të një "Corpusi të dukumentave të hërshëm të shqipes", të zbuluara në biblioteka dhe arkiva të Italisë, pas konsultimeve të bëra me specialist të fushave, bibliotekare por edhe paleografë. M.Roques i njihet merita e zbulimit të

[29] Plasari, Aurel. Parathanie e botimit: Libri shqip 1555-1912. Tiranë: Biblioteka Kombëtare, 2010, f. 11.
[30] (Vepra: Recherches sur les anciens texts albanais, dhe Le dictionnaire albanais de 1635 edite avec introduction et index complete par Mario Roques).
[31] Roques, Mario. Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera.Shkodër:Botime Françeskane, 2011. f.5
[32] Fishta, Filip në : Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera.Shkodër:Botime Françeskane, 2011. f. 12.
[33] Fishta, Filip. në :Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera.Shkodër:Botime Françeskane, 2011. f 11.

dokumentave gjuhësorë, si bie fjala: Dokumenti i Ambrosiana-s së Milanit në kërkim të të dhënave të reja historike dhe letrare mbi L. Matrangën (1592); në bibliotekën Vatikanit zbuloi veprën e P. Budit dhe lajmëroi, i pari, botimin e parë tri veprat të Budit, "Doktrina e Krishterë" (1618), "Rituali romak" (Rituale Romanum), (1621) dhe Shpjegimin e Meshës Shejte të po atij viti. I njëjti autor zbuloi në arkivat e Propagandës dhe të Vatikanit edhe "Fjalorthin italisht- shqip " të vitit 1633 të Pjetër Mazrrekut.[34]

Diku më lart u përmend odiseja e librave, ndërsa në fillimimet shekullit XX, ata do të publikoheshin pjesë –pjesë apo edhe do të studioheshin në tërësi, apo edhe pjesë të veçanta në fletoret: "Albania", "Përparimi", "Hylli i Dritës", dhe "Leka" nga personalitete të shkencave filologjike të kohës, mes të cilëve Dom Ndre Mjeda dhe Justin Rrota o.fm..

Më tej asgjë. Fatkeqësisht për një periudhë të gjatë 50–vjeçare të diktaturës komuniste, ashtu siç thonin edhe vetë shkrimtarët e vjetër, librat "hupën si kripa në ujë", për publikun e gjërë të studiuesve duke u bërë vetëm prona të instituteve shkencore. Për studiuesit e interesuar ata ishin përsëri të humbura. Më të drejtë, A. Plasari, këtë moment e cilësonte si histori më vete, vështirësi të pakuptueshme të kohës, të rregjimeve tanimë të lëna mbrapa, të kushteve në përgjithësi, përfshirë pengime, shtërngime etj.[35]

Kultura shqiptare duhet t'i dedikojë mirënjohjen më të thellë bibliotekave dhe veçanarisht bibliotekave të Shkodrës, së pari atyre të enteve fetare, muslimane dhe katolike (françeskanë dhe jezuitë), por edhe pasionit të shumë individëve të kulturuar, që arritën të hulumtonin, grumbullonin, por edhe ruanin këto vlera të rralla dhe të pazevendësueshme të kulturës sonë kombëtare.

Njihej pasioni i Atë Gjergj Fishtës, në blerjen e librave të rrallë për Shqipërinë, që mund t'i ndeshte në vizitat që bënte jashtë vendit .

"… sa herë ju paraqitte mundësia ekonomike shetitte libraritë e antikuariatit , kudo që gjëndej nëpër botë, për më ble libra të rallë e të çmueshëm, nga përmbajtja po ashtu edhe nga vjetërsia, si dhe në pikpamje artistike e të gjitha për pasunimin e krijesës së vet , Bibliotekës

[34] Fishta, Filip në : Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera.Shkodër:Botime Françeskane, 2011. f. 12.

[35] Plasari, Aurel. Parathanie e botimit Libri shqip 1555-1912. Tiranë: Biblioteka Kombetare, 2010, ff 11-12..

Francëskane. Blete libra, riproduksione arkitekturet e pikturet auktorësh të vjetër me famë se dikuj kanë me vjeftë ndinji here si aspiracion”.” [36]
Frymëzimi kulturor i shtyu edhe klerikë të tjerë të formonin rrjetin e bibliotekave të tyre të famshme, por edhe drejt hulumtimeve të dokumentave të shqipes. Mjafton të kujtojmë Atë Justin Rrotën që solli së pari të fotografuar më 1929, “Mesharin”, apo edhe jezuitët Fluv Kordinjano e Atë Zef Valentinin. Ky i fundit gjurmoi shumë vite në arkiva dhe biblioteka të Europës, çdo të dhënë që lidhej me Shqipërinë, duke na lënë pas vepra madhore, thuajse në çdo fushë të shkencave filologjike, përfshirë kryeveprën 30 vëllimshe “Akte shqiptaro–venete të shekullit XIV-XV”[37], e sa vepra të tjera të karakterik të së drejtës juridike, kanunore, historisë, etnologjisë dhe etnografisë etj.
Rrugë e gjatë dhe vështirë ishte mbrojtja e trashëgimisë kulturore e koleksionuar në bibliotekat e famshme te Shkodrës. Shumë dëshmi janë dhënë për valën shkatërrimtare që përfshiu të gjitha bibliotekat, veçanërisht ato të enteve fetare, por edhe për përpjekjet e njerëzve “diturakë”, për të shpëtuar ndonjë gjë. Duhet të lexosh Atë Zef Pëllumbin, për të kuptuar kalvarin që pësuan bibliotekat. “Në fillim të viteve 1945,-shkruan ai- nga një ekip njerëzish të ardhur nga Tirana u muar një listë librash të autorëve të vjetër të traditës, ndërsa me fillimin e viteve 1946 u thyen dyer dhe u plaçkitën pa farë kriteri.[38]
Gjithsesi shikimi me vëmendje i asaj që ka ngjarë, të lë të kuptosh që edhe në rradhët e çlirimtarëve ka patur njerëz, të mënçur që ditën të ruanin pjesën më të madhe të trashëgimisë.
Në ditët e sotme në bibliotekën e Shkodrës, por edhe në atë Kombëtare ndodhen këto libra, që qartazi mbajnë vulën e institucioneve fetare nga kanë ardhur. Në bibliotekën “Marin Barleti” të Shkodrës janë një sërë librash, pjesë të bibliotekave personale të Fishtës dhe Gjeçovit, por edhe të klerikëve të tjerë. Në fondet e kësaj biblioteke janë ruajtur edhe libra të institucioneve fetare islame, që i janë kthyer Myftinisë së Shkodrës.
Sa i takon Frang Bardhit, duhet theksuar se veprat origjinale nuk ndodhen në Shkodër.
E vetmja kopje e “Fjalorit …… “ gjëndet në Tiranë, në B.Kombëtare. Ajo ka shënime të shkruara me dorën pothuajse në të gjitha faqet dhe mban vulën e “Collegium S. Francisci Xavri Scodra”, . Besoj se nuk ka

[36] Kamsi, Willy. At Gjergj Fishta për kulturën shqiptare. Hylli i Dritës. Numër i posaçëm.
[37] A.v. At Giuseppe (Zef) Valentini. Vepra I. 2005.[f.13]
[38] Pllumi , Zef. Histori kurr e tregueme. Tiranë, 2006.f.43.

nevojë për koment, pasi vjen nga Shkodra, dhe i takon bibliotekës së jezuitëve, përduruesve të parë të një alfabeti me shkonja shqipe.[39]
Siç del nga hulumtuesit dhe bibliografët, ndonëse me këtë vepër nis botimi i 35 titujve të librave të shtypura dhe botuara nga shtypshkonja e "Propaganda Fides", numri i kopjeve të këtij libri është shumë i kufizuar, pasi për shkaqe të ndryshme, ai asnjëherë nuk pau më dritën e ribotimeve, ndonëse libra të tjerë të autorëve të vjetër shqiptarë u ribotuan disa herë nga kjo shtypshkronjë. Sot ky libër gjëndet në biblioteka të ndryshme, përfshirë, Bibliotekën Nacionale të Parisit, nw ato të Gjenevës dhe të Londrës.
Të fotokopjuara librat e Frang Bardhit, "Apologjia e Skënderbeut" dhe "Fjalori… " ndodhen në bibliotekën e etërve françeskanë "Àt Gjergj Fishta" në Shkodër.
Në ditët tona "Fjalori……. " është ribotuar nga W.Kamsi. Ai është i përfshirë në librin: "Gjurmime mbi tekstet e vjetra ", por edhe nga Bardhyl Demiraj, ne vitin 2008, me titullin original.
Ishte një homazh i merituar, për një njeri, për një klerik, që jetoi pak e punoi shumë, humbi shpejt, por la gjurmë.

[39] Vozga, Ramaza. Libri shqip 1555-1912. Tiranë:Biblioteka Kombetare, 2010, f. 76.

Adriana HOXHA, Ulqin

A ËSHTË MJEDA PËRKTHYESI MË I MIRË I "MBRETIT TË TULËS"?

Mbreti i Tulës	**Der König in Thule- Goethe**
Deri n'dekë besnik ke s'thohet	Es war ein König in Thule,
Ishte n'Tule 'j padisha,	gar treu bis an das Grab,
Diq e dashtna mbas do kohet	dem sterbend seine Buhle
E 'j got' arit shej i la.	einen goldnen Becher gab.
Sa at gotë arit gja nuk dote	Es ging ihm nichts darüber,
E gjithmonë me tene piu;	er leert' ihn jeden Schmaus;
Por ka 'j lot për faqe i shkote	die Augen gingen ihm über,
Gjithsaherë pite fatziu.	so oft er trank daraus.
Kur pau vedin tuj mbarue	Und als er kam zu sterben,
Njeh qytetet, e gjithçka	zählt' er seine Städt' im Reich,
Trashëgimtarit ia la shkrue,	Gönnt' alles seinen Erben,
Por putirin nuk ia la.	den Becher nicht zugleich.
N'ndeje t'parve, n'buzë të dedit	Er saß beim Königsmahle,
Gjith' parsin n'nji gost' i thrret;	die Ritter um ihn her,
Ulet n'gost e ka rreth vedit	auf hohem Vätersaale,
Mbledhun bashkë parsin' e vet.	dort auf dem Schloß am Meer.
E t'ksaj t'kandshmes jetë dëshirin	Dort stand der alte Zecher,
Piu ma t'mbramin e lumnoi	trank letzte Lebensglut,
Pijsi plak, mandej putirin	und warf den heiligen Becher
Ndër val' t'detit e flakroj.	hinunter in die Flut.
Tuj e zhyt' e pa n'fund t'zallit,	Er sah ihn stürzen, trinken
Tuj këcye nalt, tuj hupë me turr;	und sinken tief ins Meer,
E n'at' ças i ranë prej ballit	die Augen täten ihm sinken,
Fikun syt' e s'piu ma kurr![40]	Trank nie einen Tropfen mehr.[41]

(përkthim i Ndre Mjedës)

[40] Johan Wolfgang von Goethe, Vepra 2 - Poezia, Naim Frashëri, Tiranë, 1988, f. 154-155

[41] Arshi Pipa,Vepra 4 – Lyrika Evropiane Moderne, Phoenix, Tiranë, 2000, f. 78,80

Ekoja thotë se të përkthesh do të thotë "*të thuash të njëjtën gjë në një gjuhë tjetër*"[42], që nuk është shumë e saktë, sepse kurrë nuk mund të thuhet krejtësisht e njëjta gjë nga një gjuhë në tjetrën. Për këtë, ai shton se "*duke përkthyer thuhet thuajse e njëjta gjë*"[43] dhe kështu e saktëson dhe përmirëson mendimin e vet.

Gjatë përkthimit, sidomos të poezisë, hasim në probleme si në humbjen e ritmit të poezisë apo në humbjen e rimës në fund të vargjeve, transformimin e figurave stilistike nga njëra në tjetrën, mbi të gjitha mund të tjetërsohet stili i autorit krijues. Sipas Pushkinit "*çdo gjuhë ka konstantet e veta, figurat e veta retorike konvencionale, shprehjet e veta të zakonshme që nuk mund të përkthehen në një gjuhë tjetër me fjalët përkatëse*"[44], ndërsa Ekoja thekson se "*tashmë është pranuar që përkthimi nuk është thjeshtë një kalim nga një gjuhë në tjetrën, por edhe një kalim nga një kulturë në tjetrën, nga një enciklopedi në tjetrën. Një përkthyesi lipset të mos i trembet syri jo vetëm nga rregullat rreptësisht gjuhësore, por edhe nga elementet kulturore në kuptimin më të gjerë të fjalës*."[45]

Në thelb përkthimi nuk është gjë tjetër veçse "*një tekst, i cili varet prej një teksti tjetër*"[46] Pra, përkthimi është një rikrijim i asaj që është krijuar tashmë një herë. Secili përkthyes sjell një variant të ri përkthimi, të ndryshëm nga origjinali dhe kështu, korpusi i përkthimeve është mbase një grumbull dështimesh në përpjekjen për të imituar origjinalin. Nëse këtë që thamë e ilustrojmë me simbole matematikore, na del se:

nga teksti burimor *X*, përkthyesit e ndryshëm gjatë përkthimit rikrijojnë tekste të tjera $X_1, X_2, X_3 ... X_n$ (X_i ku i=1,2,3...n), por asnjëherë nuk mund të rrjedhojë barazimi:

(teksti origjinal) $\boldsymbol{X = X_i}$ *(teksi i përkthyer),* gjithmonë kemi $\boldsymbol{X \approx X_i}$.

Me këtë që sapo konstatuam, nuk jemi duke thënë se nuk ekziston përkthimi i mirë, apo se nuk duhet të përkthejmë, por thjeshtë jemi duke

[42] Umberto Eco, Të thuash gati të njëjtën gjë – Përvoja përkthimi, Dituria, Tiranë, 2006, f. 9
[43] Po aty, f. 296
[44] Eshref Ymeri, Përkthimi, një histori pasioni, OMSCA-1, Tiranë, 2015, f.75
[45] Umberto Eco, Të thuash gati të njëjtën gjë – Përvoja përkthimi, Dituria, Tiranë, 2006, f. 171
[46] Chevrel, Yves, Letërsia e krahasuar, Albin, Tiranë, 2002, f. 67

sqaruar se në këtë fushë nuk mund të ekzistojnë dy gjëra krejtësisht njësoj.
Edhe pse ne nuk i besojmë shumë përkthimit, ai është i nevojshëm për qytetërimin. Asnjë kulturë nuk mund të mjaftohet vetëm me traditën e vet letrare. Të njohësh veten më mirë, mundesh përmes njohjes së tjetrit, të huajit. Kështu lind nevoja për përkthime. Secila kulturë do ishte shumë e varfër nëse do privonte veten nga njohja e tjetrit. Të lexosh vetëm letërsi shqipe dhe të mos dish se ku ka arritur qarku tokësor në fushën e letrave, do ishte një mungesë e madhe e njohurive, mungesë e kulturës, qytetërimit, mungesë informacioni, me këtë do rrjedhojë edhe aftësia më e kufizuar e përdorimit mjeshtëror të fjalës. Ndaj, fati i njerëzimit qëndron në duar të përkthimit, qoftë ai i konsideruar si i realizueshëm apo jo.
Në gjuhën shqipe njihen *shtatëmbëdhjetë*[47] a më shumë përkthime të baladës "Mbreti i Tulës" me autor Gëten. Midis të tjerësh, atë e kanë përkthyer Ndre Mjeda, Lame Kodra (Sejfulla Maleshova), Vehbi Bala, Jorgo Bllaci, Arshi Pipa, Skënder Luarasi, Përtef Kruja, Shpëtim Çuçka, Pashko Gjeçi, Lisandri Kola...
Po të përqëndrohemi te përkthimi i Mjedes, do shohim që Mjeda ka një mënyrë interesante përkthimi sepse poezinë e laton me stilin e vet, gati deri në atë masë sa humbasin gjurmët e Gëtes. Meqë Mjeda bën shumë ndryshime në përkthim, shpesh të le të dyshosh se Mjeda nuk ka përkthyer nga origjinali gjerman, por nga një përkthim i dytë. Dyshojmë të ketë pasur në duar një përkthim italian të vitit *1906* të *Giosuè Carducci*, i cili poezinë e Gëtes e ka në përmbledhjen *Rime nuove*. Po t'i analizojmë me vëmendje këto dy pëtkthime, do shohim që ngjasojnë shumë.
Studiuesi i Gëtes dhe poeti gjerman Johann Peter Eckermann thoshte që *të përkthesh nga një gjuhë e dytë është njësoj sikur të lash rrobat atje ku më parë kanë larë të tjerët.*
Me atë se si ne e kuptojmë përkthimin, mendojmë se Mjeda "nuk ka bërë përkthimin më të mirë" sepse i ka dhënë liri vetes për të ndrërhyrë shumë në poezi. Ashtu siç cilësohet i dobët një përkthim që e ul vlerën e origjinalit, që sjell një poezi të degjeneruar dhe të ndryshuar në sensin negativ, ashtu duhet parë jo i mirë edhe përkthimi që e tejkalon stilin e

[47] Sipas studiuesit Agron Tufa , artikull i Violeta Muratit – "Në Kishën e Mjedës, në Kukël" në revistën "Kumbona e së Diellës", nr.11/12, Kryedioqeza Metropolitane Shkodër – Pult, Shkodër, Nëntor-Dhjetor 2015, f.27
http://www.kishakatolikeshkoder.com/media/1258/nentor-dhjetor-2015.pdf

origjinalit, e rrit në piedestal, e sjell në një version shumë herë më të mirë. Mjeda është një mjeshtër i madh i fjalës. Ai ka një stil të lartë shprehës. Të lartë po aq sa Gëtja? Më shumë se Gëtja? Duhet ta peshojmë mirë.

Stili i lartë duhet të ketë varg të përsosur, të tingëllojë bukur, të jenë të krijuara për t'u mbajtur në mend. Mbi të gjitha, sipas Horacit ka rëndësi emocioni, mallëngjimi, përcjellja e ndjenjave drejtë lexuesit, sepse nëse vetë autori nuk emocionohet, nuk e emocionon dot as absorbuesin e veprës së tij.[48] Pseudo Longini bën një sqarim akoma më detajues të stilit të lartë kur flet për të madhërishmen. Sipas tij, diçka që përsëritet shpesh, diçka që e përshkon veshin tonë shumë herë, pushon së qeni e madhërishme. *"E madhërishmja e vërtetë dhe e bukur, është ajo që mbetet përgjithmonë në shijen e të gjithëve."*[49] Sipas teorisë së tij për të madhërishmen, që të arrihet një vepër e tillë, madhore, duhet gjuha të jetë e tillë, e madhërishme.

E madhërishmja, pasioni dhe tropet janë elementet kryesore të ligjërimit që një vepër duhet të ketë për të qenë e një stili të lartë. Sipas Longinit, pikërisht *shkujdesja e gjuhës është poshtërimi më i madh i madhështisë. Fjalët e ngjashme që përdoren në mënyrë të papërshtatshme janë njolla e stilit.*[50]

Me kaq sa shpjeguam, kuptojmë që një poet për të pasur stil të lartë duhet të jetë aq i talentuar e i zgjuar sa të latojë mirë gjuhën, t'i japë asaj gjallëri, shije, bukuri, ndjenjë,... Të gjitha elementet që u përmendën në sqarimin që i bëmë stilit, i posedon edhe stili i Gëtes edhe ai i Mjedes.

Po të fillojmë të peshojmë se cili ka më shumë madhështi se tjetri, mund të themi Mjeda. E njohim Gëten, por poezia që kemi trajtuar është nga ato poezi që është shkruar gjatë lëvizjes "Stuhi dhe Vrull" që ka pasur qëllim të krijojë sa më shumë art të kuptueshëm për popullin. Ndaj, duke u mbështetur në parime të tilla, Gëtja këtë poezi e ka thurur duke u munduar të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe njëkohësisht i ëmbël. Poezia në fjalë në origjinal na kujton poezitë popullore. Vetë vargu i parë ngjason me fjalinë klishe të përrallava : *Na ishte një herë....* Në krahasim me këtë, teksa lexon Mjeden nuk kujton poezinë popullore, aq më shumë ai nuk fillon me fjalinë hyrëse të përrallës, por e modifikon atë shumë duke e bërë shumë origjinale. Përveç kësaj, në origjinal Gëtja tërë kohës kur përmend kupën, e thotë në të njëjtën formë, ***Becher***, ndërsa Mjeda përsëritet më pak, herë thotë ***putir***, herë ***gotë.*** Mjeda tenton të bëjë përzgjedhje të fjalëve, gjenë mënyra më të bukura për të treguar një

[48] Po aty, f. 39, 55

[49] Pseudo – Longini, E madhërishmja, Enti Botues "Gjergj Fishta", 2009, f. 37

[50] Po aty, f. 97-99

veprim. Nuk thotë ***i erdhi vdekja***, por ***pa vedin tuj mbarue***, apo nuk thotë ***ia la të gjitha trashëgimtarit***, por thotë ***trashëgimtarit ia la shrue.*** Edhe kur flasim për shkurtësinë e veprimit, situatës, këto dy poetë ndryshojnë. Gëtja i thotë gjërat më shkurt, ndërsa Mjeda i komplikon. Për shembull Gëtja thotë: ***Trank letzte Lebensglut*** (Piu të fundit afsh jete), ndërsa Mjeda me këtë varg zgjatet dhe këtë e thotë në dy vargje: ***E t'ksaj t'kandshmes jetë dëshirin/ Piu ma t'mbramin e lumnoi...*** Zgjatja e veprimit në harkun kohor nuk është gjithmonë pozitive, por në këtë rast më bukur duket varianti i komplikuar i Mjedes sesa i thjeshti i Gëtes.

Edhe te përdorimi i figurave stilistike, Mjeda është më sasior. Gëtja formon më pak figura sesa Mjeda.

Gabriel Garcia Marquez thoshte se kishte hasur pjesë të veprave të tij të përkthyera që i tingëllonin më bukur në përkthim sesa në spanjishten e tij. Ndërsa Kadareja pohon se "*përgjithësisht legjenda e "përkthimeve që janë më të mirë se origjinali" nuk është veçse një legjendë. Megjithatë, nuk përjashtohen raste tepër të rralla kur mrekullia ndodh. Por, këto raste lidhen me emra poetësh ose shkrimtarësh të mëdhenj që kthejnë në gjuhën e tyre vepra të kolegëve të tyre."*[51] Na duhet të kundërshtojmë Kadarenë në këtë pikë dhe të themi se përkthimet më të mira se origjinali nuk janë një legjendë, por janë një mrekulli që në shqip quhet Mjede.

Si përfundim, *Mbreti i Tulës* sipas Mjedes është një rikrijim, një poezi e re. Nëse një lexues njihet për herë të parë me Gëten përmes këtij përkthimi, ai ka për ta dashur Gëten gjatë gjithë jetës. Ky përkthim përbën një mrekulli sepse është Mjede dhe Gëte bashkë. Shprehim keqardhjen tonë që kemi një gjuhë të vogël në aspektin e njohjes së saj nga kulturat e tjera, shumë pak të huaj mund të lexojnë shqip, ndaj shumë me vështirësi mendimet e zbulimet shqiptare mund të jehojnë në botë. Kështu edhe në këtë rast mendojmë se, po të ishte i njohur në botë varianti shqip i Mjedes i *Mbretit të Tulës*, me siguri do lexohej e do i rezistonte kohës po aq sa origjinali.

Për ta përmbyllur do themi atë që thoshte Gëtja:

"Mund të themi çfarë të duam për të metat e përkthimit, por kjo punë është dhe do të ngelet gjithmonë ndër ndërmarrjet më të vështira dhe më të vlefshme të shqetësimeve të përgjithshme të botës. "

[51] Eshref Ymeri, Përkthimi, një histori pasioni, OMSCA-1, Tiranë, 2015, f.163 (shkëputur nga Ismail Kadare, Përkthimi është diçka universale, "Mehr Licht!", Nr.3, 1997, f. 238

Dr. Gëzim PUKA,
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Letërsisë
Ylber DYLI, *Shkolla Jopublike"Haxhi Sheh Shamia"*

ARSIMI NË GJUHËN SHQIPE NË ANËN E MALIT (REPUBLIKA E MALIT TË ZI), MES VËSHTIRËSIVE DHE SFIDAVE

Rreth arsimimit në gjuhën shqipe të zonës së Anës së Malit.

Popullsia e Anës së Malit dallohet për vlera arsimdashëse. Pozita e saj, si vend kalimtar në tregtinë ndërmjet skelës së Obotit dhe qytetit të Shkodrës, si dhe ndërlidhëse mes qyteteve të Ulqinit dhe Shkodrës ishte faktor përcaktues në domosdoshmërinë e zhvillimit të arsimit. Këtu gjejmë edhe gjurmët e para të shtypshkronjës "në Obot, një shtypshkronjë e vogël e K. Xanetit dhe e Shtjefen Shkodranit e ngritur 1563"[52], e cila tregon qartë për interesin ndaj diturisë.

Copëtimi i tokave shqiptare dhe aneksimi i tyre në Mbretërinë e Malit të Zi, e bëri të pamundur procesin e hapjes së shkollave shqipe. Asimilimi gjuhësor, nëpërmjet imponimit të gjuhës serbe, ishte pjesë e politikës shtetërore malazeze. Ulqini dhe rrethinat e tij në nëntor 1880, nën presionin e Fuqive të Mëdha, i kalojnë Malit të Zi. Qeveria malazeze, ndërkohë urdhëron hapjen e shkollave serbe, për vitin shkollor 1882-1883.[53] Rezistenca e popullsisë shqiptare ndaj shkollës serbe, bënte që frekuentimi në këto shkolla të mos ishte i rregullt. Detyrimi dhe dërgimi me dhunë në shkolla, nuk i dha efektet e dëshiruara.

Princi Nikolla dëshmonte se *"gjuha serbe në këtë anë të Mozhurit nuk është ndier,"*[54]duke treguar qartë për dështimin e procesit të shkollimit të shqiptarëve në gjuhën serbe. Edhe në vitet pasuese, mësimi i gjuhës amtare nga popullsia shqiptare nuk u bë i mundur, madje u ndalua me ligj. Ligji malazez mbi arsimimin sanksiononte qartë se të gjithë fëmijët shqiptarë që jetonin në Mal të Zi, "*janë të detyruar të ndjekin shkollën shtetërore ose private serbe. Ata nuk mund të ndjekin*

[52] Ziu , *T.," Oborret e Shkodrës*", Shkodër, 2002, f. 43.
[53] Berisha, P., "*Shkollat dhe arsimi i shqiptarëve në territorin e sotëm të Ulqinit gjatë motmoteve*", Ulqini në rrjedhat e kohës, Ulqin, 2000.
[54] Draga,N., "Shpallime gjeografike" , Art club, Ulqin, 2001, f.18.

një gjuhë tjetër mësimore, pa kryer shkollën fillore serbe."[55] Marrëdhëniet në mes Mbretërisë së Malit të Zi dhe popullsisë shqiptare në fushën e arsimit dhe kulturës nuk mund të ndikonin në lëvrimin e gjuhës shqipe.

Pavarësisht nga copëtimi i territoreve shqiptare në vitin 1913, shohim edhe tentativën e zhvillimit të arsimit në Anën e Malit në hapësirën e Malit të Zi.



Dëftesë e vitit 1939, Sh. F. Sukobinë Dëftesë e vitit 2016, shk. 9-vj. Katërkollë

Ndryshimi i situatës politike gjatë Luftës së Parë Botërore, me pushtimin e Malit të Zi nga perandoria Austro-Hungareze, dhe përfshirja në këtë perandori edhe e Shqipërisë Veriore, mundësoi hapjen e shkollave shqipe. Ligji arsimor austriak[56] theksonte se "*… në shkollat fillore fëmijët duhet të mësohen në gjuhën e tyre amtare*." E drejta e ruajtjes dhe e kultivimit të identitetit kombëtar, nëpërmjet gjuhës dhe kulturës, që u lejua nga pushteti austro-hungarez, solli hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Shkolla fillore në gjuhën shqipe u hap në Ulqin, me 1

[55] Hoti, *V., "Aspekte të zhvillimit të arsimit shqip në Ulqin dhe në trevat e tjera në Mal të Zi në periudhën e Luftës së Parë Botërore"*, Ulqini në rrjedhën e kohës,Ulqin, 2000, f. 149-158.

[56] Hoti,V., "*Aspekte te.… …", Vepër e cituar,* f.153.

shtator 1916 dhe kishte katër klasa. Hapja e shkollave shqipe u realizua në të gjithë vendbanimet shqiptare të aneksuara nga Mali i Zi, duke bërë që, deri në qershor 1917,të funksiononin 23 shkolla në gjuhën shqipe.[57]

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore dhe konsolidimin e shtetit malazez në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, dhe më vonë të Mbretërisë Jugosllave, rifilloi procesi i hapjes së shkollave në gjuhën serbo-kroate. Në territoret e banuara me shqiptarë, në komunën e Ulqinit dhe vendbanimet e Anës së Malit, u hapen shkollat në Selitë, Sukubinë dhe Krythë në gjuhën serbo-kroate-sllovene, në vitin 1929.

Shkolla e parë në gjuhën shqipe do të hapet në Krythë po në të njëjtin vit[58]. Këto shkolla funksionuan deri në vitin 1941. Kushtet e zhvillimit të mësimit nuk kanë qenë të mira. Mungesa e teksteve, mjeteve didaktike dhe sallave të leximit, nuk mund të garantonin cilësi për mësimdhënie. Veçori e përpjekjeve për arsimim ishte çelja e institucioneve parashkollore, në Ulqin, të cilat u frekuentuan nga një numër i madh fëmijësh shqiptarë[59]. Zhvillimet politiko-ushtarake, si rezultat i Luftës së Dytë Botërore, mundësuan që kufiri shqiptaro-malazez të mos ishte funksional. Në një situatë të tillë, Ministria e Arsimit të Shqipërisë,[60]për vitin shkollor 1941-1942 vendosi të dërgojë mësues në të gjitha trevat shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë. Si rezultat i kësaj nisme u rihapën shkollat shqipe në Ulqin dhe Anën e Malit, në fshatrat Kosiq, Katërkollë dhe Sukubinë. Gjatë kësaj periudhe, mësimi zhvillohej në kushte shumë të vështira. Mungonin abetaret dhe tekstet mësimore në gjuhën shqipe. Përgatitja dhe kualifikimi i mësuesve, ka qenë një problem që pengonte zhvillimin e arsimit kombëtar në gjuhën shqipe.

Mësuesit që bënin mësim ishin kryesisht nga Shkodra. Kjo nismë e qeverisë shqiptare mundësoi që për vitin shkollor 1940-1941, në Ulqin, Krajë dhe Tuz, të hapen e 14 shkolla fillore me 1809 nxënës dhe 30 mësues.[61] Në Anën e Malit u hapën 3 shkolla me 241 nxënës gjithsej. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe në periudhën e luftës pati një rëndësi

[57] Po aty, f.154.

[58] Akademia e SHRSH, *"Fjalori Enciklopedik''*, Tiranë, 2009, Kristalina-KH, f. 1390.

[59] Berisha,P., "Zhvillimi i shkollave dhe arsimi i shqiptarëve në Malin e Zi prej vitit 1878 deri në vitin 1988", Art club, Ulqin, 1997, f. 46.

[60] Luli, F., *"Mësuesit shqiptarë për arsimin shqip në Ulqin dhe trevat e tjera të Malit të Zi në vitet 1941-1944*", Ulqini në rrjedhën e kohës, Artclub, Ulqin, 2000, f. 159-169.

[61] Po aty, f. 163.

të veçantë për zhvillimin e arsimit. Pas Luftës së Dytë Botërore, krahas shkollimit në gjuhën serbo-kroate, u mundësua vazhdimësia e mësimit të gjuhës shqipe në komunën e Ulqinit. Në vazhdimësi u realizua edhe hapja e shkollave shqipe në fshatrat e Anës së Malit. Në fazën fillestare, fëmijët nuk e ndiqnin shkollën rregullisht, veçanërisht gjinia femërore për shkaqe, mentaliteti, kushtesh të vështira ekonomike dhe largësisë së shkollave nga vendbanimi. Në këtë hapësirë u hapen tri shkolla fillore, ajo e Katërkollës (Vladimirit), e Sukubinës dhe e Krythës, të cilat përfshinin fëmijët e të gjitha fshatrave të Anës së Malit. Një kontribut të vyer në ngritjen e shkollave dhe ndërtimin e objekteve të reja apo plotësimin e kushteve me bazë materiale dhe didaktiko – sanitare, kanë dhënë vetë banorët vendas,[62] duke treguar qartë dëshirën për shkollën shqipe. Me kalimin e viteve për t'u plotësuar nevojat e fëmijëve për arsimim, u hapën shkolla në disa fshatra. Kjo u bë për klasat fillore në të gjitha fshatrat si anekse të shkollës "Bedri Elez Aga" në Katërkollë.

Tabela e numrit të nxënësve sipas viteve shkollore

Viti shkollor	1964-1965	1979-1980	2004-2005	2014-2015
Numri i nxënësve	932	1158	630	471

Burimi:vitet 1964-65, 1979-80, 2004-05, Shaban Peraj[63] 2014-15, shkolla 9-vjeçare Katërkollë.

Tabela e mësipërme tregon se numri i nxënësve në shkollat e Anës se Malit ka pasur dinamikë të ndryshme. Numri i nxënësve në vitin shkollor 1979-1980, është rritur me 226 nxënës ose 24.2 %, në raport me vitin shkollor 1964-1965. Ndërsa këta tregues kanë pësuar rënie në nivelin më të ulët në vitin shkollor 2014-2015, me 471 nxënës ose 687 nxënës më pak në krahasim me vitin 1979-80. Këto ndryshime shpjegohen me shkallën e lartë të emigrimit, rënien e shtimit natyror të popullsisë së Anës së Malit, të cilat janë edhe arsyet kryesore të pakësimit të numrit të popullsisë në vitin 2011, me 2261 banorë ose 33,% në raport me vitin 1981.

Në vitin shkollor 2014-2015 në shkollën 9-vjeçare "Bedri Elez Aga", në Katërkollë së bashku me klasat anekse frekuentonin shkollën 471 nxënës nën përkujdesjen dhe mësimdhënien e 42 arsimtarëve.

[62] Kokaj,S., "Arsimi Shqip në Anën e Malit1945-1985", f. 59.
[63] Peraj, Sh., "Ana e Malit'', Camaj - Pipa, Shkodër, 2005, f. 99-100.

Nxënës anamalas që ndjekin arsimin e mesëm në gjimnazin e Ulqinit "Vëllazërim – Bashkim"[64] janë rreth 170 nxënës.

Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe mbyllja e kufirit solli pasoja të rënda për popullsinë anamalase, e cila u detyrua të shkëputeste lidhjet e fisnore, ekonomike, arsimore dhe kulturore. Popullsia shqiptare në Malin e Zi, u pengua në procesin e arsimimit dhe të kualifikimeve profesionale, duke pasur nivelin më të ulët në Jugosllavi.

Edhe pse pësoi një kalvar vuajtjesh, represioni dhe imponimi nga qarqet sunduese malazeze, popullsia shqiptare ruajti gjuhën, kulturën e nëpërmjet tyre edhe identitetin kombëtar. Në regjistrimin e vitit 2011[65], rezulton se vazhdonin shkollën e lartë 128 studentë, kishin nivel master 13 individë dhe kanë gradën doktor 3 të tjerë.

Vlerat arsimdashëse të kësaj treve

Arsimimi në gjuhën shqipe për popullsinë shqiptare në territoret e shkëputura nga trungu etnik, shënon një kalvar vështirësish dhe problematikash si në aspektin cilësor dhe sasior. Protestat e popullsisë shqipare në ish-Jugosllavi në vitin 1981, nxitën klasën intelektuale shqiptare të Malit të Zi, për ngritjen e ndjenjës së patriotizmit, frymën kombëtare, nëpërmjet kërkesave, që programi mësimor për nxënësit shqiptarë të jetë në gjuhën shqipe në harmoni me historinë, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Qeverisja serbo-malazeze u tregua mjaft e ashpër ndaj kësaj lëvizjeje, ku në emër të luftës kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, shumë mësues dhe intelektualë shqiptarë u larguan nga puna, madje edhe u burgosën në periudhën 1981-1984.[66]Shkëputja e Malit të Zi nga Republika Federale Jugosllave, akti i pavarësisë më 2006-ën, solli zhvillime dhe aspirata të reja edhe për popullsinë shqiptare. Zhvillimet e reja ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, në kuadër të fqinjësisë së mirë dhe procesit të përbashkët për t'u anëtarësuar në BE, kanë vendosur në një trend të ri sfidash, zhvillimin e arsimit shqip.

Kushtetuta e re e Republikës së Mali të Zi në kapitullin e **Të drejtave të veçanta të pakicave, Neni 79 pika 4,** garanton "*Arsimin në gjuhën dhe alfabetin e vet në institucione shtetërore dhe që programet mësimore të përfshijnë edhe historinë dhe kulturën e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera pakicë*".

---

[64] Gjimnazi Vëllazërim - Bashkim Ulqin.

[65] Census Montenegro 2011.

[66] Peraj, Sh., *vepër e cituar*, f. 92-93.

Shihet qartë, se ligji themelor mundëson, që krahas gjuhës shqipe, të mësohet dhe historia dhe kultura shqiptare në shkollat ku banon popullsia shqiptare. Programet dhe tekstet mësimore ekzistuese të lëndëve të identitetit kombëtar, nuk ua mundësojnë nxënësve shqiptarë, që të zhvillojnë lëndë mbi vetëdijen, përkatësinë, kulturën, historinë dhe traditën e tyre kombëtare, ashtu siç ua garanton ligji. Bashkëpunimi dhe marrëveshjet ndërshtetërore, do të mundësonin unifikimin e programeve dhe teksteve mësimore në të gjithë hapësirën mbarëshqiptare, duke përfshirë edhe shkollat shqipe në Malin e Zi.

Afërsia e vendbanimeve në të dyja anët e kufirit, në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar në fushat e ndryshme që nxiten nga proceset integruese, duhet të shohin si lehtësim dhe përparësi në vazhdimin e arsimit në shkollën 9-vjeçare Muriqan të nxënësve matanë kufirit. Shembujt janë të shumtë në zonat ndërkufitare me popullsi të njëjtë[67], por me hapjen e doganës së përbashkët Muriqan - Sukubinë janë lehtësuar mundësitë e ndjekjes së studimeve në shkolla shqiptare, kryesisht në universitete apo në shkollat e mesme jopublike.

Hapja e shkollës profesionale me drejtim bujqësor në Anën e Malit (të hapësirës shqiptare), do të shërbente edhe për nxënësit matanë kufirit, në krijimin e specialistëve në fushën e bujqësisë për vetë rolin që ka ekonomia bujqësore në jetën ekonomike anamalase. Synimet nuk janë të paarritshme, ndaj duhet vullneti i mirë nga ana e grupeve të interesit, eleminimi i burokracive dhe zbatimi i kornizave ligjore që mundësojnë realizimin e tyre. Bashkëpunimi ndërshtetëror, lehtësimi i procedurave të kalimit për nxënës dhe studentëve në doganë, unifikimi i kurrikulave mësimore, kuotat universitare për studentët shqiptarë, do të mundësonin përgatitjen dhe kualifikimin e një elite intelektuale miqësore bashkëpunuese, drejt sfidave të përbashkëta për në familjen evropiane

[67] Gabrovec,M., Melik,A., "Open borders with uncoordinated public transport: The case of slovenian-italian border" Europian Journal of Geography,volume 4, Number 4:78-87, Decembre, 2013.

The education in Albanian in Ana e Malit (The Republic of Montenegro) between hardships and challenges

ABSTRACT

The Albanian language and schools were born and developed through numerous hardships, sacrifices and assimilationist resistance throughout history. The interalbanian educational and cultural movement, has served as an important factor in the fight for freedom and independence in the motherland, and functioned as a national identity in the annexed territories. The assimilation and denationalization policies of the Albanian population outside the state border hampered the process of opening up and development of education in Albanian schools. Learning and education in non-native language and the high pressure to relinquish the mother tongue did not achieve the goals chauvinist of denationalization. The plans to assimilate and change the ethnic structure in the Albanian space took priority with the formation of national states in the Balkans. The Albanian population was the epicenter of these plans because " Montenegro wants a complete extermination of the Albanian element ". After more than a century from the partition of the mother tongue, the anamali population has maintained the language, tradition and culture as part of the Albanian belonging and identity. Of the 20 villages of this space, the Albanian language and ethnicity included 18 settlements, excluding the villages Megjyreç and Leskoc who speak Serbian- Croatian, representing the linguistic border of the Albanian and Serbian -Croatian. The new developments of Montenegro in the framework of the integration processes in the large European family, the implementation of the rights of the minorities and cross-border cooperation, have enabled new challenges in the development of education and culture for the Albanian population in Montenegro.

LITERATURA:

1. Akademia e SHRSH (2009): *"Fjalori Enciklopedik''*, Tiranë, Kristalina – KH.
2. Berisha, Palokë (2000): "*Shkollat dhe arsimi i shqiptarëve në territorin e sotëm të Ulqinit gjatë motmoteve*", Ulqini në rrjedhat e kohës, Ulqin.
3. Berisha, Palokë (1997): *"Zhvillimi i shkollave dhe arsimi i shqiptarëve në Malin e Ziprejvitit 1878 -1988''*, Artclub, Ulqin.
4. Census Montenegro 2011.
5. Draga, Nail (1986): "Popullsia e Anës së Malit", Kërkime gjeografike, Nr. 7, Prishtinë.

6. Draga, Nail (2001): “Shpallime gjeografike” , Art club, Ulqin.
7. Gabrovec, Matej., Melik, Anton (2013): “Open borders with uncoordinated public transport: The case of Slovenian - italian border” Europian Journal of Geography, volume 4, Number 4:78-87, Decembre.
8. Gjimnazi Vëllazërim-Bashkim Ulqin.
9. Hoti, Vehbi (2000): “*Aspekte të zhvillimit të arsimit shqip në Ulqin dhe në trevat e tjera në Mal të Zi në periudhën e Luftës së I Botërore”*, Ulqini në rrjedhën e kohës, Ulqin.
10. Kokaj, Syme: “Arsimi shqip në Anën e Malit 1945-1985”, Asociacioni Ulqini, Ulqin.
11. Luli, Faik (2000): “*Mësuesit shqiptarë për arsimin shqip në Ulqin dhe trevat e tjera të Malit të Zi në vitet 1941-1944*”, Ulqini në rrjedhën e kohës, Artclub, Ulqin.
12. Nopça, Franc (2007): “Udhëtime nëpër Ballkan”, Plejad, Tiranë.
13. Peraj, Shaban (2005): “*Ana e Malit”*, “Camaj – Pipa”, Shkodër.
14. Ziu , Trifon (2002): “*Oborret e Shkodrës*”, Shkodër, 2002.

Eljon DOÇE,
Universiteti i Tiranës

IN MEMORIAM- UMBERTO ECO

“Jini të fortë si heronjtë e Greqisë antike dhe shikojeni vdekjen drejt e në sy dhe pa pasur frikë”

Rastësia bëri që si Shekspiri ashtu edhe Servantesi të vdisnin në të njëjtën ditë të të njëjtit vit, pra plot 400 vite më parë, më 23 prill 1616 duke u bërë shkak shumë kohë më vonë që kjo ditë të shënohej si Dita Botërore e Librit dhe e së Drejtës së Autorit.
Mund të ekzistojnë me dhjetëra rastësi të tjera që mund të kërkoheshin në Republikën e Letrave për të përligjur themelimin e kësaj dite dhe shumë pak rëndësi kanë rrethanat apo arsyet se pse pikërisht vendimi për ta shënuar 23 prillin si Ditën e Librit u lidh me këtë rast.
Për ne, mjaft interesant është fakti që është zgjedhur një rastësi e cila nuk lidhet as me lindje, as me themelimin e ndonjë lëvizje letrare dhe as me botimin e ndonjë vepre madhore të letërsisë së përbotshme, porse me largimin nga jeta, pra me vdekjen e dy shkrimtarëve, nga më klasikët në atë që mund ta quajmë Republikë të Letrave.
Dhe, në fakt, kjo bën kuptim sidomos kur je në fushë të artit e sidomos në atë të letrave, për arsyen e thjeshtë se, në njëfarë mënyre, vepra e një autori fillon të jetojë, të jetojë vërtet, sidomos pasi ai vdes fizikisht, pasi ai nuk është më aty ta mbrojë apo justifikojë atë që ka krijuar.

Më 19 shkurt 2016 Umberto Eco vdes, duke lënë pas një trashëgimi artistike, studimore, kulturore dhe, në tërësi një dëshmi intelektuale për të cilën nuk është e tepërt të thuhet se është mbresëlënëse.
Në raste të tilla, kur një shkrimtar (edhe pse është shumë pak ta kufizojmë Eco-n vetëm përmes kësaj etikete) i këtyre përmasave largohet nga jeta biologjike, ndjenja e humbjes, e cila vërtet është e madhe, përsëri nuk mund të krahasohet me një ndiesi tjetër e cila zë vend mjaft shpejt në ndërgjegjet e individeve që e kanë njohur autorin: ndiesia e përjetësisë.
Paradoksi është që duket se është pikërisht vdekja ajo që i hap shkrimtarit portat e të qenit i përjetshëm pasi mistika apo aureola që ka rrerth vetes çdo shkrimtar i madh, si një qenie jo e kësaj bote, bëhet edhe

më e fortë pasi ai shkon të bashkohet me të ngjashmit e vet të letërsisë së përbotshme dhe të gjithëkohshme.
Tashme edhe Eco është bërë pjesë e kesaj mistike edhe pse duhet thënë që edhe në gjallje ai e ka pasur aureolën e vetë.
Ai jetoi një jetë intelektuale mjaft intensive dhe bëri një udhëtim i cili ishte gjatë gjithë kohës i lidhur me përvoja të pafundme leximesh dhe receptimesh, i lidhur me sprova dhe eksperimente shkrimore nga më të ndryshmet ku sistematikisht e ka ftuar lexuesin të bëhet pjesë e kësaj përvoje e cila i jep këtij të fundit (lexuesit) mundësinë për t'u përfshirë në një përvojë receptimi e perceptimi që e nxjerr atë nga kufijtë e kohës dhe hapësirës së vetë dhe duke e futur në përmasën e pafundme të botëve të leximit.
Eco jetoi në një kohë kur mendimi i përgjithshëm ka qenë edhe duket se ende është ai që kriza e leximit ka njohur vetëm rritje: ai jetoi dhe prodhoi në një kohë kur teknologjia dhe format e reja të komunikimit (ose më mirë me thënë, të çkomunikimit) vetëm e kanë larguar lexuesin prej receptimit estetik të botës dhe e kanë drejtuar atë drejt një qasjeje e cila vetëm konsumon në mënyrë të verbër një informacion tejet të përkohshëm.
Përpjekja e tij për të rigjetur lexuesin e humbur dhe pse jo edhe për të ndërtuar një lexues të ri duket se mbeti një shqetësim i përhershëm i tij.

Diku ai ka thënë "Për të **mbijetuar** në këtë botë lipsen bërë dy gjera, të bësh një fëmije dhe të shkruash një libër."
Eco nuk vdiq pa pasur fëmijë të vetë biologjikë, por sigurisht që ai la pasardhës edhe të një natyre tjetër, lexuesit që krijoi prej dekadash përmes ftesës së tij të përsëristur për t'u bërë pjesë e botës së leximit dhe përvojave shpirtërore dhe intelektuale që rrjedhin prej saj.
Sigurisht, jo të gjithë mund të zgjedhin të bëjnë një fëmijë dhe jo gjithkush mund të shkruajë një libër, por shumëkush mund të bëhet pjesë e një përvoje tjetër e cila është edhe ajo po aq krijuese se dy të parat dhe kjo është përvoja e leximit.
Nëse do ta mund ta rimerrnim këtë shprehje të Ecos dhe le ta rithoshim në mënyre pak më të ndryshuar ajo mund të ishte: për të **rijetuar** në këtë botë lipsen bërë dy gjëra: të bësh një fëmijë dhe të shkruash një libër.
Në fund, Eco, bashkë me Servantesin e Shekspirin, rijeton sot e gjithë ditën, përmes nesh.

Ligjëratë e mbajtur në Tuz, më 23 prill 2016

STUDIMORE

HISTORIKE

Pierfranco BRUNI

ITALO-SHQIPTARËT ISHIN NJË POPULL APO QYTETËRIM?

Historia e popullit arbëresh është një histori që gjen tek identitetet e kulturave mesdhetare një çelës leximi themelor. Realitete në Jug që kanë patur gjithmonë një kontakt me detin, pavarësisht vendosjeve të brendshme të popullsisë arbëreshe. Në fund të fundit shqiptarët, dje si dhe sot, vinin dhe vijnë nga deti. Në muajin shtator do të prezantohet një Skedë në ekspozitën e San Marcanos së Shën Xhuzepes, e realizuar nga zyra e trashëgimisë së Brindizit, Leces dhe Tarantos, nga Instituti Kazalini dhe nga Komuna- Sportel gjuhësor i San Marcanos. Italo-shqiptarët ishin një popull apo qytetërim? Një trashëgimi adriatike apo mesdhetare? Arbëresht janë një trashëgimi kulturore dhe njerëzore të bashkënatyralizuar dhe të mikpritur në zemër të Italisë së jugut, vendqëndrime të banorëve në shumë qendra. Struktura aloglote në Itali është e pasur me histori dhe elementë antropologjikë; në diversitetin e saj është gërshetuar indin tonë njerëzor dhe shoqëror, duka na magjepsur me zakonet, traditat, gjuhën. Dikush mendon se shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve të lashtë (nga Illyrios i biri i personazheve tipikë të mitologjisë greke), që banonin në gadishullin ballkanik nga kufijtë e Gjermanisë deri në Trakë e deri në brigjet e Adriatikut. Të tjerë janë të bindur se janë pasardhësit e Pellazgëve, njerëz autoktonë të atyre territoreve. Sigurisht që është ajo populsi, nga trysnia e popujve që përpiqeshin ta pushtonin gadishullin (celtët, shiitët, vizigotët, unët, ostrogotët dhe sllavët) gjetën strehë në malet e Shqipërisë, duke e ruajtur të pastër etninë e tyre. Emri i tyre ishte Albanë. Nuk është i sigurtë kuptimi etimologjik i emrit Shqipëri: disa mendojnë nga alba (agu), qytet romak dhe nga greqishtja nia, pra e re. Për gjuhëtarët modernë thekson studiuesi Bellinello, fjalva ka prejardhje nga rrënjët indoeuropiane alb dhe/ose alp që do të thotë lartësi apo mal (tezë që duket më e përshtatshme). Është e sigurtë se pas shekullit të XI ata u quajtën Arbër ose Arbëreshë dhe Arbëri krahina e tyre. Principata e Arbërit në Krujë ishte shembulli i parë i krijimit të një federalizmi feudal, i aftë t'i kundërvihej pushtuesve otomanë.

Po sot, me fjalën Arbëresh çfarë kuptojmë?

Kështu quhen popullsitë e gjuhës shqipe që jetojnë në Italinë jugore, të vendosur në Itali midis shekujve të XV dhe XVI, menjëherë pas vdekjes së Heroit të madh kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ata arritën ta ruanin identitetin e tyre kaq të plotë, saqë ende sot quhen shqiptarë. Kombi i tyre i shpërndarë në Itali quhet njëzëri Arbëri. Në ndryshim nga pjesa e shqiptarëve që jetojnë diku tjetër, në pjesën më të madhe myslimanë, arbëreshët janë katolikë. Nëse para pushtimit prej Perandorisë otomane të gjithë shqiptarët quheshin Arbëresh, pas emigrimit që humbi pjesë të popullsisë (300 mijë u vendosën në Itali), shqiptarët e lindur në Itali vazhduan ta përdorin emrin Arbëresh, ndërsa në Shqipëri morën emrin shqiptar. Vendet që regjistrojnë doke, zakone, tradita, gjuhë dhe histori arbëreshe në Itali janë 50. Në Pulja ndodhen tre, në Kalabri 33 komunitete arbëreshe. Pasuria kulturore e këtyre komunave përfaqësojnë një çelës leximi për një proces jo vetëm njohjeje, por mbi të gjitha vlerësimi dhe përfitimi, si në planin shkencor dhe atë didaktiko-pedagogjik. Njohja e pasurisë së tyre është njohje e territoreve në elementët e tyre të lidhjes midis së shkuarës dhe së tashmes dhe së tashmes dhe zhvillimit kulturor, nga traditat në proceset informuese. Një rrugëtim që ka të bëjë me identitetin e tyre dhe praninë e tyre të lashtë dhe aktuale në territore. Kjo ka lidhje me krahinën e Puljas, Kalabrisë, Siçilisë, Bazilikatës, Kampanias, Molizes dhe Abrucos.

Ka pasuri kulturore dhe dëshmi historike që ka një mundin e vet kulturor të shënuar, i cili i detyrohet një gërshetimi, jo vetëm të epokës që kanë mbi supe, por mbi të gjitha një vetëdije që vjen nga një ndërveprim qytetërimi. Kryesisht në disa realitete të Jugut kjo qënësi historike dhe qytetarë është thellësisht e përzjerrë me procese që janë etnike, antropologjike, fetare. Në këtë pikë i referohem pasurisë kulturore të zonave arbëreshe. Këto pasuri nuk kanë një strukturim të vetin të palidhur me historinë e monumenteve dhe arkitektonike greko-bizantine tradicionale, por takimi mes traditës dhe modernitetit greko-bizantin zhvilloi një realitet historik që ka tipare orientale. Dhe referimet që lexohen tek monumentet e vendeve shqipfolëse kanë, jo vetëm këtë referim grek dhe me gjurmë bizantine, por historia e trashëgimisë dhe e kulturës lidhet ngushtë me një identitet fetar. Njëlloj sikur pasuria kulturore të ishte shprehje e qëndrueshme e një kulti. Në të vërtetë përbëjnë një dëshmi të një shpirtësie, jo vetëm të një populli, por edhe të një kohe. Mendoni për përhapjen e mariane që lidhet me një strukturë të

kishës mëmë të evidentuar qartë me fasada të hapura dhe me hapësira përreth. Pra, ka një lidhje të ngushtë në lidhjet kulturore të zonave shqiptare të Italisë, mes trashëgimisë arkitektonike dhe kultit. Kjo do të thotë se pasuria kulturore përfaqëson, në territore të tjera, një shprehje të gjendjes liturgjike që shfaqet në simbologjitë e strukturave. Duhet saktësuar fakti se është kuptimplote për këto komunitete dhe lexohet si një e dhënë laike. Qendra historike është gati e banuar dhe qendra e banuar është pothuaj gjithmonë në qendrën historike. Një vizion i shkëlqyer i gjinisë regjistrohet në Çivita, por edhe në Farneta, në disa mjedise të San Marcanos së Shën Xhuzepes, në disa fshatra të Siçilisë fushore etj. Por historia e këtyre komuniteteve përjetohet si një dekodifikim i një procesi artistik. Në fakt kishat, apo manastiret janë depozita, jo vetëm të një aparati historik dhe arkitektonik me rrënjë apo stampa orientale, por përbëjnë pamjen e një projektimi të artit.

Kalabria është në qendër të këtij itinerari, nga provinca e Kozencës në Krotone dhe Katanxaro. Një udhëtim mes arbëreshëve të Kalabrisë është një udhëtim që na vendos në qendër të një lidhjeje mes Perëndimit dhe Lindjes. P.sh, kisha e Shën Marisë në Firmo është fotografia tipike që lidh bashkë thjeshtësinë dhe strukturën e kultit të qytetërimit shqipfolës. Ndërsa katedralja e Lugros është takimi mes stilit të rafinuar së Lindjes së Mesme dhe dëshirës për perëndizimin e artit. Një kulturë e llojit kryesisht bizantin. Bizanti u zhvillua si një kryqëzim mes romanikes dhe barokut. Pasuria kulturore në pjesën më të madhe në këto zona është pasuria e kultit. Historisë i qëndrojmë besnikë, por arti është diçka më shumë që pajtohet me besimin, përkundrazi historia pajtohet me kultin. Në Pulja ka tre komunitete arbëreshe, në provincën e Tarantos, në Shën Xhuzepe dhe dy në Foxha: Kieuti dhe Kazalvekio. Këtu gërshetohen kultura popullore dhe identiteti etniko-gjuhësor. Një proces qytetërimi që ka si bazë historike vlerën e traditës. Janë territore që rezultojnë nga një kulturë pakice dhe që ka një vlerë të madhe antropologjike. San Marcanoja është një prej atyre komuniteteve etno-gjuhësore, gjuha arbëresh e së cilës është një pasuri që duhet ruajtur dhe për të cilën po punohet me një projekt të përcaktuar, që në bazë të ligjit 482/99 hyri në projektet për shkollat e pakicavë gjuhësore arbëreshe me shkollat e veta. Ruajtja e identitetit kombëtar dhe e gjuhës italiane nuk vihet në diskutim. Në Jug ka sfumatura historike që duhen riparë në kontekste të reja. Mes komuniteteve të shumtë, ai abrëresh ka vlerën më të madhe.

Duhen marrë në konsideratë ato zona të Puljas, pranë detit Jon, që e kanë humbur gjuhën dhe traditat abrëreshe. Janë me origjinë italo-shqiptare

disa fshatra të provincës së Tarantos që dallohen nga riti greko-ortodoks, si Karozino, Faxhano, Montemezola, Rokaforcata, Shën Gjergji Jonik që e kanë humbur identitetin shqipfolës dhe dëshmitë që lidhen me kulturën arbëreshe janë të pakta.
Vetëm Shën Marcano i Shën Xhuzepes e ruajti traditën arbëreshe që është shumë e ndryshme nga tradita kulturore dhe fetare greko-ortodokse. Trashëgimia e tij italo-shqiptare ka rëndësi historike dhe duhet mbrojtur se është pjesë integruese e një procesi kulturor dhe ekzistencial. Është fshati me numërin më të madh të banorëve në lidhje me shtrirjen e Arbërisë, ndërsa Kalabria ka numërin më të madh të fshatrave arbëreshe, 33 të tilla. Këto komunitete nuk janë vetëm një dëshmi historike, por përbëjnë një udhë identiteti përmes së cilës duhen thelluar rrënjët dhe arsyet e një diaspore.

Bota shqiptare na përket brenda këtij shpirti të gjerë mesdhetar

Nuk janë vetëm identitet, pasuri kulturore e një memorieje që tregon historinë e një qytetërimi që është vetëm memorie. Janë gjurmët e një të ardhmeje që lexohet në përmasat e një marrëdhënieje themelore midis kulturës, ekonomisë dhe zhvillimit. Vetëm kështu këto komunitete arbëreshe mund të vazhdojnë ta tregojnë historinë dhe ta mbrojnë trashëgiminë strukturore, antropologjike të ideve. Historia e komuniteteve arbëreshe qëndron në aftësinë që të dimë ta ruajmë dhe vlerësojmë përmes simboleve që përbëhen prej strukturave. Këto janë dëshmitë e vërteta të një komuniteti, janë dëshmitë reale që e shënojnë të ardhmen. Të gjitha këto krahina ruajnë trashëgiminë e pakicave, duke mos harruar vlerat e bashkimit dhe të identiteteve të një tradite që flet për historitë e tyre të ndryshme. Arbëreshët janë histori, traditë, kulturë. Trashëgimia futet në një version të gjerë në planin e identitetit. Mbetet themelore lidhja mes vendeve që e praktikojnë gjuhën arbëreshe dhe ato ato që i kanë humbur doket, traditat, zakonet përveç gjuhës. Një lidhje që nënvizon shenja të veçanta në atë pasuri që nuk është vetëm kulturore, por edhe njerëzore. Në një përmasë të tillë historia e letërsisë mund të na ofrojë çelsa leximi kuptimplotë. Në planin institucional studimet do të thellohen edhe në komunitetet e tjera minoritare të pranishme në Itali, pikërisht që të bëhen krahasime jo vetëm historike, por edhe letrare. Janë 12 komunitetet etno-gjuhësore të njohura sot në Itali, të fiksuara nga ligjet në fuqi. Një hartë gjuhësore që përmban faktorë të rendit historik. Tradita gjuhësore e popujve përbëhet nga fenomene historike, antropologjike, artistike që sigurisht u referohen modeleve ekzistenciale

që rrjedhin nga procese kulturore të rrënjosura në ndërgjegjen e qytetërimit. Prej tyre padyshim gjuha është një pasuri që nuk u atribuohet individëve, por një qytetërimi që ia jep kuptimin komunitar një populli. Arbëreshët mbijetuan deri tani, sepse ndjenja e komunitetit ishte shumë e thellë. Nga ana tjetër veprimi i tyre u drejtua ndaj faktorëve kulturorë të cilët përfaqësojnë referime vlerësuese. Problemi qëndron në rekuperimin e identiteteve, përmes një njohje më të madhe që prek aspekte heterogjene që nga format antropologjike tek gjuha, nga pasuria kulturore tek zakonet. Por ruhet një lidhje themelore midis gjuhës, të folurave dhe dialekteve. Fjala nuk është vetëm një transmetim i proceseve shprehëse, apo të formave të komunikimit, përmban përmasa simbolike dhe transmetojnë vlera dhe kode historike. Fjala është një mbartës historik që merr vlera etike dhe ekzistenciale, përmbledh modele qytetërimi që mbeten në vetëdijen e identitetit të një populli. Kjo vihet re më shumë në ato kultura minoritare që paraqesin etni të ndryshme në lidhje me realitetin historik në të cilin jetojnë.

Rasti i komuniteteve arbëreshe është emblematik.

Arbëreshët janë një realitet për pasurinë gjuhësore që ruajnë prej pesëqind vjetësh, qoftë si dëshmi historike, qoftë si një dokument dhe jo vetëm një çelës leximi themelor që mban shenjat e përkatësisë. Në Itali përfaqësojnë jo një diversitet, por tregojnë praninë e një dygjuhësie prej origjinës së rrënjosur mirë, si dhe të strukturuar në zona të ndryshme të Italisë. Formojnë një urë thelbësore me kulturat e përmbytura të botës ballkanike dhe funksioni i ritit është dëshmia e transmetimit të një tradite fetare thellësisht të rrënjosur në ndërgjegje. Sot riti greko-ortodoks kryhet në 26 prej 50 komuniteteve. Bëhet fjalë për një të dhënë që ka, jo vetëm faktorë të rendit fetar, por pas faktit fetar, është mbi të gjitha një përfitim i vlerave të thella të vlerave kulturore të origjinës. Vetë forma e strukturave fetare të çon tek përmasat etike dhe estetike të formimit lindor. Kemi një kulturë italo-shqiptare mbartëse, por dhe një traditë kryesisht arbëreshe. Janë mbi 100 mijë arbëreshë të pranishëm në Itali, edhe pse në heterogjenin e vet kanë një ndjenjë të përbashkët të vendit. Arbëreshët thithën një formim dyfish, përveç të shprehurit në dygjuhësi që formoi mbartësit e dy modeleve. Nga kjo pikëpamje funksioni i pasurisë kulturore mbetet themelor, pasi bëhet shprehje e një dëshmie të qytetërimit që duhet trashëguar dhe transmetuar. Mes komuniteteve arbëreshë ka një fjalor që, edhe pse në bazë është homogjen, ndonjëherë ka larmi në lidhje me zonat territoriale. Në realitet këto komunitete, edhe

pse mbajnë një koherencë gjuhësore të vetën, thithën modele të pranishme në një territori me ndikime, jo vetëm gjuhësore dhe heterogjene. Pra, ka një përthithje të modeleve kulturore popullore dhe institucionale. Nuk kemi më një kulturë popullore organike, siç ishte përmasa etike e traditës fshatare, por një gërshetim që vjen nga shumë larg, por që këto kohë u zhvillua në fusha të ndryshme të formimit. Dihet se popujt nuk harrojnë dhe traditë nuk do të thotë vetëm një transmetim konceptesh, por mbi të gjitha qënësia. Po të mos ishte kjo qënësi e thellë, identiteti arbëresh do të kishte mbetur një model dëgjimi nostalgjik dhe sentimental. Pavarësisht 500 viteve të shkuara nga bujtja në Itali, arbëreshët ende janë një pasuri kulturore, kontributi i së cilës është depozituar në histori, por nga ajo histori mund të lexohet një motivim shumë më i lartë që i referohet një pranie të fortë të rrënjosjeve etike. Edhe në furtunat e historisë të Rilindjes, para dhe pas Bashkimit, arbëreshët ishin mes ithtarëve të bashkimit, edhe pse jetonin ekzistencën e tyre kulturore, historike dhe njerëzore të dyfishtë. Nuk ishin vetëm dëshmimtarë, por edhe protagonistë në ngjarjet historike që përgatitën dhe ndërtuan Bashkimin e Italisë.

Dygjuhësia e përforcon në fakt ndjenjën e përkatësisë. Arbëreshët e braktisën një atdhe, e humbën atë, prandja janë të vetëdijshëm për vuajtjet e diasporës. Në historinë e tyre ka elementë që përcaktojnë vetë origjinën e kulturës së Mesdheut, një zonë që gjithmonë realizoi takime midis qytetërimeve. Këtë takim letërsia e ka nënvizuar qartë mes popujve bregdetarë dhe kontinentalë. Prania e arbëreshëve na çon tek imazhet lindore që gjetën një armoni në një vend thellësisht të rrënjosur në një identitet mesdhetar. Por vetë arbëreshët dokumentojnë një sintezë historike dhe njerëzore që e qendërzon udhëtimin komunitar të një populli. Mbrojtja e gjuhës do të thotë qartësisht të mbrosh një pasuri trashëgimie, por ta shpëtosh në një process multimedial, multietnik, që do të thotë të krijosh gjurmë që synojnë ruajtjen e një kulture që nuk është më gojore, siç ishte në shekuj, por të shkruar, strukturore, urbanistike, bashkë në një rregull etik dhe estetik. Ja përse gjuha nuk është vetëm një kod alfabetik, por përmban shtigje identiteti që janë shprehjet e përkatësisë së një populli.

Përgatiti për botim,
Arjan Th. Kallço

Arjan Th. KALLÇO *
Akademia Ndërkombëtare Universum
Prof. Emilio BENVENUTO
Foggia, Itali

NËSE HISTORIA NDRYSHON GJITHMONË PARDON

Përmbledhje : Historia e një vendi dhe e një kombi është arena e debateve ku gjithmonë ka patur ide të shumta dhe të pafundme, të para këto nga këndvështrime të ndryshme gjatë rrjedhës së historisë, nga interesa të brendshme që lidhen me pushtetin dhe të jashtme që lidhen me ndikimin që ato kanë patur në jetën tonë. Faktori i jashtëm në një vend të vogël si Shqipëria ka luajtur shpesh një rol të madh dhe vendimtar për të ardhmen e tij dhe mbi të gjitha për ekzistencën dhe integritetin e vet. Historia që ne njohim flet qartë për ndihmën e padiskutuar që këto vende dhe të personaliteteve të shquara të tyre kanë dhënë në njohjen dhe respektimin e parimeve të kombeve, por flet edhe për synime dhe veprime të fqinjëve tanë të përhereshëm në dëm të inetersave tona kombëtare. A duhet rishkruar historia apo duhet hedhur dritë mbi ngjarjet e saj?

Summary: The story of a country and a nation is the arena ëhere the debate has alëays been diversity of many endless ideas, ëhich are seen from different angles during the course of history, from interests associated on the internal side ëith poëer and on the external side related ëith the impact they have had in our lives. The External factor in a small country like Albania has often played a major and crucial role to its future and above all for its existence and integrity. History that ëe are familiar ëith clearly shoës not only the undisputed help these countries and their prominent personalities have made in recognizing and respecting the principles of the nations, but also speaks to the goals and actions of our neighbours in permanent desire to damage our national interests. Should a reërite of history be considered, or should ëe shed light on its events?

Fjalët çelës : historia, ngjarje, personazhe, koha, vlerësim

Hyrje : Të flasësh për historinë e vendit tënd është një detyrë e të gjithë intelektualëve dhe historianëve. Por kur këtyre synimeve u bashkohen edhe studiues të huaj që kanë patur lidhje shpirtërore me Shqipërinë, atëherë të vërtetat historike ndriçohen më mirë dhe më drejt.
Studimet e ndryshme në arkivat e Italisë, Shqipërisë në të shkuarën dhe libri me kujtime i diplomatit anglez Barnes janë pikënisja e këtij studimi që shpresojmë të jetë interesant dhe i dobishëm për historiografinë shqiptare.

Objektivat : Të hidhet dritë mbi disa ngjarje që lidhen me Shqipërinë, duke u bazuar tek faktet shqiptare dhe kujtimet e diplomatëve të huaj që kanë jetuar në vendin tonë.
Arsyet : Shpesh flitet se historia jonë nuk është ajo e vërtetë për të cilën është shkruar në librat e historisë, prandaj rileximi i saj nga një këndvështrim tjetër dhe në kohë të tjera është arsyeja themelore e këtyre studimeve.

1. Vështrim kritik

Kanë kaluar mbi dy dekada që kur filluan edhe tek ne që t'i hedhin një shikim edhe historisë, ose siç quhet shpesh, rishikim të saj. Të gjithë historianët kanë të drejtën e tyre që të hyjnë nëpër skutat e historisë sonë dhe të mund ta zhbirrojnë atë, nëse ia dalin mbanë, duke na dhënë përgjigje të drejta, përsëri nëse është e mundur, lidhur me vërtetësitë e ngjarjeve më të rëndësishme të Shqipërisë. Por ndruhem se sado që të përpiqen të hedhin dritë mbi to, asnjëherë nuk do të arrijnë të na japin të gjithë të vërtetën, pasi e vërteta nuk fshihet në dokumentat e arkivave kombëtare, por në memorien kohore të brezave, që pas kaq vitesh, vështirë se mund të gjejë një përgjigje që kënaq të gjitha kërshëritë. E vërteta bazuar tek dokumentet është një version zyrtar i kohës, i mbrujtur thellësisht me anshmëri të theksuara interesash, bindjesh, këndvështrimesh. Thuhet se historinë e bën i fituari, prandaj që tek kjo thënie mund të zbulojmë karakterin relativ vërtetësisë së historisë. Në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë sonë Kombëtare, përvjetor që na mblodhi të gjithëve rreth një sofre, në vend që të na ndante, i propozova akademikut Italian, Emilio Benvenuto, që të shkruajmë disa artikuj që të lidhen me të gjithë këtë periudhë shekullore shqiptare, bazuar mbi faktet zyrtare që ai ka mbledhur gjatë jetës së tij të gjatë dhe shfletimit të shumë arkivave në Itali. Shpresojmë që të sjellim disa mendime, kurrë të

vërteta të pakundërshtueshme, në lidhje me raportet mes Italisë dhe Shqipërisë, që kanë qënë gjithmonë të panadra, kjo edhe në shumë raste për fatin tonë, pasi dihet fort mirë kontributi i arbëreshëve në këto raporte. Një prej fakteve të para që më propozoi është edhe periudha në vitet 1920-1921 që lidhet me formën e ardhshme institucionale në vendin tonë të kohës. Do të ndalemi pak më poshtë rreth kësaj çështjeje, pasi më parë do të sjell pjesë nga debate lidhur me historinë në dy prej vendeve që kanë bërë historinë e botës dhe sigurisht nënkuptohet edhe historia e një vendi të vogël si Shqipëria. A duhet riparë historia jonë? Si duhet riparë? Cilat janë kriteret e rishikimit të saj? Cilat momente të saj duhen riparë? - janë disa nga pyetjet që kanë vite që po bëhen. Të mundurit e Luftës së Dytë, tash po kërkojnë ta rishikojë tërësisht atë, duke patur edhe ndonjë mbështetje nga qarqe të ndryshme antishqiptare në disa vende që dikur ishin fuqitë e mëdha. Një e shkuar që rizgjohet nga mendje të sëmura, nuk premton asgjë të mirë, për më tepër kur bëhet fjalë për vendin tonë, pasi në historinë tonë përplasen shumë interesa të vendeve, ato edhe përreth nesh. T'i hapësh ato arkiva, do të thotë të zgjosh edhe ato ndjenja të dikurshme dhe synime që për një periudhë të gjatë kohe, kjo është merita e viteve nga 1944-1990, mbetën të përgjumura. Do të duhet të rihapen të gjitha ngjarjet që nga fillimi i shekullit për të riparë ngjarjet dhe gërshetimin e tyre tek ne, si dhe ndikimin që ato kanë patur. Historia e shkuar në ato vite, edhe sikur të ketë gabime, nuk mund të mos ketë, pasi nuk ka histori të kulluar, është një periudhë e mbyllur përfundimisht, pasi askush nuk mund ta çojë në bankën e të akuzuarve gjithë periudhën nga 1900 deri në vitin 1990, pasi edhe kalemxhinjtë e sotëm, do të duhet të çojnë në atë bankë, prindërit dhe të afërmit e tyre më parë, sesa të tjerët. Thënies se, a nuk e bëjnë historinë fitimtarët, si do t'i përgjigjen ata? Debatet e kota rreth historisë sonë do të duhet të na çojnë në pyetjen e madhe se, historia jonë është 100% e jona apo është bërë gjithmonë nga të tjerët, duke qënë vend i vogël dhe pjesë e koalicioneve dhe konjukturave?

Kush kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen – thotë G. Orwelli.

Historia duhet t'u mësojë njerëzve një ndjenjë perspektive dhe proporcioni – thotë Cannadine – duke u ankuar se në debate është polarizuar përreth pozicioneve të paluajtshme. Në një konferencë në Londër ku prezantoi librin e vet "*Tipi i duhur i historisë*", Cannadine pohoi : Ankimet për papërshtatshmërinë e mësimdhënies së historisë në shkollat angleze ekzistojnë qysh kur vetë ato filluan të flasin për historinë. Në Angli – theksoi autori – në ndryshim nga vendet e tjera të

Europës, studentët mund të vendosin ta ndërpresin studimin e historisë në moshën 14 vjeçare.
Nëse i referohesh historisë së Shqipërisë dhe synon të lexosh diçka që lidhet me gjendjen e vendit në vitin 1914, do të shohësh se, pas viteve ’90 ka edhe versione të ndryshme të këndvështrimeve për këtë ngjarje tragjike të fillimshekullit, Lufta e Parë botërore e zhyti vendin në një krizë të re, e ndikuar edhe nga konjukturat e kohës. Ushtritë e Austro-Hungarisë, Francës, Italisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë e zaptuan dhe pushtuan gati gjithë territorin e shtetit shqiptar që kishte vetëm 2 vjet që ishte krijuar pas shpalljes së Pavarësisë. Shteti shqiptar i vetëm në përballjen ballkanike, i mbetur dhe pa udhëheqje politike dhe ekonomike, për shkak të pushtimit të ri që e nxori jashtë loje atë, u zhyt bashkë me gjithë vendin në kaos. Në Konferencën e Paqes së Parisit, 18 - 21 Janar 19 zhvilluar pas Luftës së Parë Botërore, fshirja e përfundimtare e emrit të Shqipërisë nga harta ballkanike, u shmang kryesisht nga përpjekjet e Presidentit të Sh.B.A-së, Wilson, i cili e kundërshtoi hapur planin e Britanisë, Francës dhe Italisë për ndarjen e Shqipërisë midis fqinjëve të saj, dhe sidomos nga Delegacioni shqiptar që insistoi me forcë në ruajtjen e shtetit shqiptar. Kjo ishte gjendja e Shqipërisë dhe fasada që dukej dhe lexohej midis kronikave të shumta të kohës, por diçka tjetër gatuhej pas kuintave të pushtetit, duke e bërë më të vërtetë faktin se aparencat janë vetëm një llustër për t’i shfaqur të padukshme prapaskenat e brendshme dhe sidomos ato të jashtme, pa të cilat asnjë qeveri shqiptare e kohës nuk do të kishte siguri. Një hap pozitiv u hodh kur në dhjetor 1920 Shqipëria, me mbështetjen edhe të Britanisë së Madhe, çuditë e këtij vendi nuk kanë të sosur, u pranua në Lidhjen e Kombeve, duke fituar kështu për herë të parë njohjen ndërkombëtare si shtet vetëvendosës.

2. Shqipëria në vitet 1920-1921

Në vitet 1920-1921 problemi bazë në lëmshin e intrigave të brendshme, shoqëria shqiptare ishte e ndarë midis dy grupimeve politike të mëdha opoziatare, ishte e ardhmja e vendit. Grupimi i parë përbëhej prej forcave tradicionaliste shqiptare dhe orintimi i tyre politik qe thellësisht i djathtë. Mes emrave të familjeve të njohura ishte dhe ai i Ahmet Zogu, një pronar i vogël fisnor nga rrethi i Matit, i shkolluar në Stamboll dhe Austri, njeri që shquhej për ambicjet e tij për pushtet. Grupimi i dytë përbëhej nga progresistë me prirje demokratike të kohës dhe orientimi i

tyre politik qe i majtë. Në krye qëndronte Fan Noli, një peshkop ortodoks i edukuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pjesa më e madhe e dëshironte monarkinë, si mënyrë për ta shpëtuar vendin, bile dhe vetë parlamenti e pasqyronte këtë ndjenjë dhe secila palë propozonte zgjidhjen e vet. Njëra palë mendonte rikthimin e dinastisë së Vidit, me të birin e mbretit të parë, dikush tjetër ëndërronte një pric egjyptian dhe një e tretë Dukën e Montpensierit. Por monarkia angleze ishte më joshëse duke patur parasysh traditën dhe jetëgjatësinë e saj. Mendohet se shumica e deputetëve ishte për një anglez, por pa një marrëveshje të qartë për emrin. Askush nuk mendonte për emrin e një shqiptari si Zogu, ishte jashtë çdo mundësie, edhe pse në qarqet e ndryshme konsiderohej si i paradestinuar. Duke e menduar dhe e konceptuar humorin e kohës asnjë prej Fuqive të Mëdha nuk do ta kishte vendosur kurorën mbi kryet e tij. Ndoshta ishte ende i ri dhe i panjohur mirë prej tyre, por edhe sepse ai nuk kishte asnjë prejardhje fisnike. Për më tepër që ideja për një mbret shqiptar as që merrej fare në konsideratë, sepse nuk kishte ndonjë pjesëtar tjetër të familjeve shqiptare me emër, që të kishte fuqi dhe autoritet mbi të tjerët. Familja Doda e Mirditës ishte më e kuotuara midis të shumtave, por nuk kishte askënd që të mund të impononte personalitetin e vet mbi vendin, pasi edhe Prenk Doda dergjej në burgjet e Turqisë dhe nuk kishte fuqinë e duhur që të bëhej mbret. Konkluzioni që dilte ishte padyshim unanim për një të huaj, por me klauzola që të dukej si zgjedhja që do të bëhej nga vetë shqiptarët. Një detyrë të tillë nuk mund ta kryenin fuqitë e huaja, pasi diheshin kontradiktat mes tyre. Si anëtar i delegazionit të MPJ-me angleze në Konferencën e Paqes në Paris, Barnesi sugjeroi fronin e Dukës së Abrucos dhe kjo në atë kohë mund të ishte një zgjidhje gati e përkryer. Kështu do të mbetej e kënaqur Italia, e cila më pas do të shtyhej që ta braktiste Vlorën, sundimi i së cilës ishte një pengesë e madhe ndaj një drejtësie sado minimale që lidheshin me aspirat legjitime të Shqipërisë për një shtet të vetin. Për më tepër që Duka ishte njeri i zoti, i guximshëm, i aftë dhe mendohej ai i duhuri që mund t'ia kishte dalë mbanë dhe të kishte arritur sukses. Kjo ndeshte në kundërshtimin e pjesës më e madhe të të zgjedhurve në Parlament se ishte e prirur ndaj një monarku anglez. Anglia ishte fuqia fitimtare, por më e painteresuara në Ballkan dhe kështu ajo shihej nga vetë shqiptarët se do të kishte paanësi dhe do të mbornte interesat e Shqipërisë. Kishte edhe zëra të tjerë nga shqiptarë që e kishin parë Amerikën, flisnin për ndonjë miliarder amerikan që mund të bënte mrekullinë ekonomike si në vendin e tij. Sipas Kushtetutës në Shqipëri

kishte edhe një Këshill Drejtues me 4 të Urtë, sipas 4 feve, që funksiononte në mënyrë kolektive, si një monarki e vogël kushtetuese. Secili prej tyre ishte përfaqësuesi më i lartë i komuniteteve fetare të Katolikëve, Ortodoksëve, Muhamedanëve dhe Bektashinjve. Projekti në tryezat e tyre, por edhe të fuqive, synonte mbledhjen e një Asambleje kushtetuese që do të nxirrte një akt kushtetues dhe që do ta kishte sanksionuar një monarki, me gjitha të drejtat edhe të monarkut që do të kurorëzohej. Pas kësaj Këshilli do të kërkonte zgjedhjen e një drejtuesi të vetëm, të mos harrojmë se ishte e preferueshme të ishte anglez, për 5 vjet. Nëse ai do ta kalonte provën dhe do të tregonte me vepra rezultate të mira qeverisëse, do të ftohej nga Asambleja që të hipte në fron. Ishte një zgjedhje e arsyeshme në dukje, por edhe e pranueshme, por ky projekt nuk merrte parasysh ndarjet mes grupimeve dhe feve në Shqipëri.

3. Oferta për James Barnesin dhe Pegi Williamsin

Barnesi mbërriti në Shqipëri në këto kushte historiko-shoqërore në të cilat ndodhej Shqipëria. Ishte bërë një figurë popullore dhe gati kombëtare për shërbimet e shumta politike që i kishte bërë vendit në të shkuarën dhe për ato ekonomike që mund të kryente në të ardhmen. Emri i tij qarkullonte në qarqet diplomatike, poltike dhe konjukturale europiane si mbreti i mundshëm i Shqipërisë bashkë me atë të Herbertit. Barnesi u gjend përballë një mendimi dhe dëshire të tillë, mesa dukej bashkonte në një pikë të kënaqshme të gjitha zgjidhjet që parashtroheshin, bile u shty që ta merrte vërtet në konsideratë këtë mundësi. Një mbret që të ishte beqar nuk pranohej nga opinioni monarkist, por edhe nga vetë protokolli i pushtetit. Në Shqipëri ndodhej në një koinçidencë të përkryer me prapaskenat edhe një zonjushë angleze me personalitet të dukshëm, Pegi Williams. Kjo zonjushë u bë edhe një zonjë e nderuar e shoqërisë londineze, kur u bë gruaja e Ministrit finlandez në oborrin e Mbretit Xhorxh. Ishte një vjazë me shumë vlera që e bënin më të pranueshme ëndrrën e endësve të fatit të Shqipërisë. Në moshën 17 vjeçare kur shpërthehu Lufta e Parë 1914, shkoi në Zvicër dhe iu bashkua Kryqit të Kuq francez. Shërbeu në front pranë vijës së parë nën zhurmën dhe tmerret e luftës, mes shpërthimeve dhe predhave nga përleshjet. Pas luftës iu kthye jetës së saj monotone në një shtëpi të qetë në Londër. Ishte shumë e nderuar dhe dëshmimtare për këtë histori të saj ishin medaljet e shumta që kishte marrë. Një grua tepër

e guximshme që nga brenda i jehonte përvoja e viteve në luftë dhe që nuk dëshironte që të flinte mbi dafina. U fut në Kryqin e kuq amerikan dhe në vëmendjen e tij, një prej vendeve të veprimtarisë së tij, dukej se ishte dhe vendi ynë, kështu që zonjusha mbërriti në Shqipëri. Shpejt e mësoi gjuhën shqipe dhe lidhi miqësi me të gjithë shqiptarët e njohur, duke fituar simpatinë dhe respektin e tyre. Më pas hapi një shkollë në Tiranë, pastaj krijoi lëvizjen boy scouts që u përhap shumë shpejt. Vajzat dhe djemtë shqiptarë ishin të etur për përparësitë e edukimit dhe mundësitë që ofronte jeta moderne. I hiqej kështu shamija një vendi perëndimor që ishte mbajtur në errësirë nga turqit dhe perspektivat e lirisë ishin dehëse. Të rinjtë e adhuronin Pegin që u bë edhe shtojzovallja dobiprurëse e tyre. Pak km nga Tirana, dominuese mbi luginë dhe rrëzë Krabës, ndodhej kështjella veneciane e Petrelës e ndërtuar mbi rënojat e asaj romake. Kështjella u bë qendër e preferuar e shumë detyrave të vështira të Pegi Williamsit. Jeta e saj në kështjellë dhe simpatitë e shndërruan në një kryetare feudale ku organizonte shëtitje në të dhe njerëzit u miqësuan aq shumë, sa e quanin Dukesha e Petrelës, një titull që më vonë doli se ishte tepër i merituar. Por nuk mbaroi me kaq, pasi shkoi më tej dhe u bë gati një heroinë kombëtare. Kur shqiptarët sulmuan garnizonin Italian në Vlorë, ajo organizoi një shërbim sanitar, duke qënë në vijën e parë mes të plagosurve në zonat e luftimeve, majë kuajve me trastat plot me ilaçet e ndihmës së parë. Në këtë mënyrë ndihmonte të palgosurit, duke fituar ditë pas dite lavdi në vendin e udhëkryqeve të orekseve dhe prapaskenave. Më vonë kur Shqipëria u pushtua nga sërbët dhe ishin gati në Tiranë, ajo refuzoi që ta braktiste dhe bashkë me vajzat e tjera morën urdhërin që të shkonin në Durrës. Dëshironte të shkonte në front ku po organizohej rezistenca e fundit dhe vetëm ndërhyrja e Kombeve të Bashkuara me këmbënguljen e Italisë e penguan që të merrte pjesë në një tjetër fushatë lufte.

Në këto rrethana nuk duhet të çuditemi, përse emri i saj u propozua si një mbretëreshë e mundshme. Barnesi dhe Williamsi shoqëroheshin shumë bashkë, pasi në Tiranë kishte shumë pak anglezë, si në kështjellën e Petrelës, ashtu edhe në ndonjë lokalitet të bukur, aq sa u përhap zëri i një lidhje mes tyre apo deri edhe të fejuar. Parisë shqiptare kjo histori edhe disi e sajuar dhe e forcuar, dukej se ia kënaqte dëshirat e veta për një zgjidhje alla angleze të çështjes. Filluan të lëvizin të Katër të urtët që kjo lidhje të ligjërohej dhe t'i shkohej deri në fund idesë së nisur, pasi çasti e kërkonte një mbret në front ë kurorëzuar. I pari që hodhi hapin drejt ligjërimit të lidhjes ishte përfaqësuesi i ortodoksëve, Turtulis, i cili i

kërkoi takim Barnesit për një propozim të rëndësishëm. Mendohet se propozimi gati i miratuar nga 3 prej 4 Drejtuesve të Këshillit ishte një rast i mirë dhe po të ishte martuar me Pegin, do të kishte qënë një ngjarje me fat për Shqipërinë dhe lidhja e tyre mund ta kishte zgjidhur problemin insitucional. Por nga ana tjetër Barnesi, duke qënë katolik, mund të mbështetej edhe tek vota e peshkopit Bumçi dhe e Ahid Pashë Elbasanit, bektashi dhe që ishte kryetar i Këshillit dhe mik i Pegit. Edhe përfaqësuesi katolik u mundua që ta mbështeste këmbënguljen e Turtulisit dhe u premtoi se do t'i kurorëzonte në katedralen e Shkodrës. Vetë Pegi në shaka e sipër propozoi si kumbar Bajram Currin, udhëheqësin e kryengritjeve dhe muhamendan. Bajram Curri i informuar për këtë histori, tha se do të vinte personalisht me nja 100 burra në ceremoni. Barnesi në rrëfimet e tij e pranoi se u josh nga kjo ide, por lind pyetja, a do të martoheshin për arsye shtetërore? A do t'ia dilnin mbanë? Do t'ia vlente barra qeranë? Ideja filloi të përhapej dhe u duk se do të realizohej, pasi edhe Barnesi po quhej Duka i Petrelës. Por në të vërtetë nuk kishte asnjë gjasë që martesa e tyre të kishte sukses. Pegi edhe mund të qëndronte në Shqipëri, por Barnesi do të vinte me shkëputje, pasi ishte pagamarrës dhe jo i pasur.

4. Dy aspirantët për fronin e Qeverisë

Intrigat dhe kundërintrigat ishin tronditëse, ndryshonin nga dita në ditë. Askush nuk mund të jepte garanci dhe pozicioni i partisë së Nolit (po t'i hedhim një sy ëikipedias, enciklopedia on line, është turp, por ka shumë pak materiale për të, pothuaj vetëm një faqe për një prej personaliteteve më të mëdhenj shqiptarë, sh.a) po fitonte popullaritet si opozitar i ngjarjeve personale të Zogut që synonte drejt pushtetit. Ja se çfarë shkruhej për dyshen Noli - Zogu në atë kohë : Më 1924, midis Zogut dhe Nolit zhvillohej luftë, e cila nga nga larg dukej si një garë mes të mirës e të keqes. "Fan Noli simbolizonte dijen, demokracinë e përparimin; Ahmet Zogu përfaqësonte padijen, autokracinë e reaksionin. Konkursin e fitoi më i keqi", shkruante dikush në shtypin shqiptar të diasporës në atë kohë. (J.Tomes)
Por një vetëdije e qartë mendohet se e kishin edhe vetë protagonistët e revolucionit demokratik : "Gabuam Gurakuq" mendohet të kenë qenë fjalet e fundit të Nolit në token shqiptare. (P.Tako) Pas pak, anija me të dhe ministrin Luigj Gurakuqi në bord do t'i largohej me nxitim brigjeve

shqiptare. Forcat e rivalit të tij po afroheshin. Revolucioni i qershorit kishte dështuar. Noli kishte humbur. Arsyet tashmë janë të qarta dhe dihen nga historia shqiptare, por kjo humbje Nolit i kujtoi edhe diçka tjetër; se një politikan është me lehtë të tregohet idealist kur ndodhet në opozitë, sesa kur ndeshet me realitetin e ashpër të drejtimit të pushtetit. Këtë ai e mësoi nga përvoja e vet.
Historia botërore dhe e jona gjithmonë i ka gjykuar ngjarjet e saj më të bujshme dhe ky është parimi i pashmangshëm i brezave. A është gjykimi gjithmonë objektiv? Në shumicën e rasteve objektiviteti është më shumë subjektivitet, duke u nisur edhe nga pozicionet që marrin fituesit pas betejave të ashpra për pushtet ose pas revolucioneve, treguesit më të qartë të pakënaqësisë kolektive dhe të masave të gjera të popullsisë.
Zogu e Noli janë gjykuar, rigjykuar e do të rigjykohen përsëri. Kjo është natyra e historisë; çdo brez dëshiron ta shkruajë atë siç e sheh vetë dhe jo siç e kanë parë të tjerët para tij. (R. G. Collingwood)
Gjykime ndaj tyre nuk kanë dhënë vetëm historianët, por shpesh edhe politikanët duke treguar me vepra mbështetjen ndaj njërit apo tjetrit dhe duke e rritur më shumë konfuzionin në vlerësimet dhe gjykimet ndaj tyre. Një gjyq më i drejtë në dukje do të ishte ai mes vetë protagonistëve, por shpesh është tepër i rreptë dhe i dhunshëm që i çoi deri në urrjetje të hapur, me pasojë largimin e personalitetit më të spikatur politik, gjuhësor dhe letrar përfundimisht drejt Amerikës. Largimi i trurit ka patur gjithmonë një shkak, përndjekjen nga ana e figurave që në vetvete kanë patur gjithmonë kompleksitetin e të qënit të vegjël përballë kundërshtarëve. Akuzat dhe dënimet e rrepta ata nuk ia kursyen as njëri-tjetrit. Noli e dënoi “tradhëtarin, të shiturin tek serbët” me vdekje në mungesë, ndërsa Zogu e dënoi “ agjentin e Moskës, bishopin e kuq” me “syrgjyn gjallë.

5. Zgjidhja e Barnesit

T’i kthehemi historisë kur Barnesi më në fund vendosi për një zgjidhje tjetër, duke provokuar një këshill lufte. U mblodhën bashkë me disa drejtues monarkistë, Zogun, Turtulisin, Vrionin, Mitrovicën, dy Frashëllinjtë etj. Barnesi ekspozoi planin e vet dhe vuri re se ishin dakord për një monarki dhe si mbret në mos një mbretëror i familjes angleze, të paktën një i barabartë që të kishte ndikim apo edhe një ushtarak me përvojë por që të ishte edhe ekspert në politikë dhe

ekonomi, të ishte i guximshëm dhe i aftë. Zogu asnjëherë në atë çast nuk e shfaqi hapur mendimin e tij, ndërsa të tjerët e miratuan këtë projekt që ishte i mirë. Po të ecej sipas kushtetutës, do të ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur problemet dhe vetë Barnesi që kishte edhe një emër, do të ishte bërë këshilltar i tij dhe aftësitë e tij do të ishin në shërbim të kurorës mbretërore. Zgjedhja e tij ishte Duka i Atholl-it, lord fisnik që e deshte aventurën, përveç se ishte edhe një luftëtar trim dhe ekspert në ekonomi. Një Dukë çeltik, Barnesi mendonte se edhe shqiptarët ishin të tillë, një njeri me temperament të guximshëm dhe aventurier, do të ishte imponuar dhe do të kishte patur sukses në Shqipëri e cila ishte e ndarë në klane si dhe Irlanda. Duka e mirëpriti projektin dhe e mendoi si një detyrë për të udhëhequr një komb të ri drejt progresit, por nuk donte që të ishte mbret. Gruaja e tij nuk ishte deputete dhe ambicjet e saj ishin ende të paqarta, tek Shqipëria shihte një fushë të lirë për të shtrirë aftësitë e saja. Propozimin për të qënë për 5 vjet në krye të një kombi të ri vetëm njerëz të ndrojtur dhe të pashpirt mund ta refuzonin. Mospranimi i tyre që të hipnin në fron ishte e kuptueshme, pasi dukej si diçka qesharake kur oferta ishte e kushtëzuar dhe në fakt ishte e tillë. Pjesa më e madhe e miqve të Barnesit e miratuan zgjedhjen dhe duhej vetëm të prisnin aktin kushtetues. U zgjodh Asamblea kushtetuese , por u shmang diskutimi i formës së ardhshme kostitucionale për shkak të luftës së partive, të rivalitetit të grupeve dhe të nevojës urgjente që të rregulloheshin juridikisht disa çështje. Në këtë luftë u dalluan Noli dhe Zogu që po qëndronte mënjanë dhe vepronte për llogaritë e veta. Talenti i tij, guximi dhe prirja për komandim e bënin të domosdoshëm për partinë e tij. Taktika ishte që të vononte vendimin dhe që të bëhej më i njohur dhe me influencë. Por nuk ia doli dot shpejt dhe fati nuk i buzëqeshi, kështu që përfitoi partia republikane.

6. Shakaja tek hoteli Claridge

Pak ditë para se Barnesi të nisej për në Shqipëri, një gazetë Daily Mail doli me një titulll të madh : Shqipëria dëshiron një mbret. Preferohen fshatarë fisnikë anglezë. Gazetat e Lordit Rothermere e kishin marrë vesh të vërtetën. Zogu ishte Ministër i Brendshëm. Në një takim të rastësishëm, Zogu i tregoi se qeveria kishte marrë një pirg me letra të qytetarëve anglezë që synonin fronin e Shqipërisë. Ishin 72 letra që ia dorëzuan Barnesit që ndoshta përfunduan në arkivat e Ministrisë së Jashtme angleze që e çuditën

botën. Të gjitha letrat vinin nga lagjet e Londrës, dy nga Dhoma e Lordëve, një nga vëllai i një gjenerali dhe një nga Franca. Njërën prej tyre Barnesi e mësoi edhe përmendësh :
Qeverisë Shqiptare
Në përgjigje të lajmërimit tuaj në Daily Mail, kam nderin ta propozoj emrin tim si kandidat i fronit tuaj. Nuk jam personalisht një fisnik fshati, por vij nga një familje e tillë nga ana e nënës sime. Jam i gjatë 6 këmbë e dy gishta dhe 44 gishta gjoksin. Më intereson shumë mirëqënia e klasës punëtore. Besoj se jam më i përshtatshmi për rastin tuaj.
Me devotshmëri…

Kur u kthye në Londër Barnesi bëri një reng të bukur për aspirantë aventurierësh që mendonin se ishin kandidate të mundshëm për fronin në Shqipëri. Kishte marrë me vete fletë me logon e Ministrisë së Jashtme Shqiptare dhe u shkroi pretendentëve nga një letër ftesë me firmë, sikur të vinte nga Qeveria shqiptare që u kërkonte të prezantoheshin për një bisedë, pasi ishte marrë në konsideratë kërkesa e tyre. Do të paraqiteshin në një orë të caktuar dhe me veshje me dekorata, nëse kishin të tilla. Aspirantët vinin dhe kishte mes tyre që në vend të dekoratave, mbanin stemat e shoqatave sportive. Por ekzaltimi gazmor nuk kishin të sosur, pasi një prej bujtësve të hotelit, thirri njërin prej tyre, duke e ngatërruar me një kamarier.

7. Ndërhyrja e Lodrit Curzon

E gjithë ngjarja kulmoi me një bisedë me Lordin Curzon që Barnesi duhej të bënte me të. Lordi Atholl i telefonoi Barnesit se duhet të paraqiteshin në MPJ-me për një bisedë: në qendër ishte Shqipëria. Intriga ishte bërë një çështje ndërkombëtare. Lordi i priti dhe pyetjes se cili do të dëshironte të bëhej Mbreti i Shqipërisë, askush nuk guxoi ta pranonte. Ambasadori Italian i kishte treguar një numër gazetash të shtypit Italian, ku pohohej se njëri prej tyre ose të dy ishin konsideruar si kandidatë për fronin. U besua se ishte një makinacion i qeverisë angleze. Barnesi i dha të gjitha shpjegimet e tij të mundshme lordit Curzon dhe se ishte e vërtetë që një numër i konsiderueshëm i parisë shqiptare e vlerësonin që për të zgjidhur një problem insitucional, mund të emërohej Komisar i lartë një anglez për 5 vjet. Kishte patur kandidatë, por askush nuk kishte marrë propozimin formal. Ishin të gjitha montime gazetash.

Konkluzione

Historia e një kombi nuk duhet parë asnjëherë me eksese apo paragjykime të theksuara të njëanshme, për më tepër kur kjo histori është ajo e vendit të vet, ku më shumë se kurrë duhet objektivitet. Nëse dështojmë me këtë synim, atëherë nuk mund të hedhim kurrë dritë mbi një të kaluar që nuk është e jona në aspektin material, duke mos qënë dëshmimtarë të drejtprërdrejtë. Trajtimi i ngjarjeve është pashmangshmërisht e lidhur me atë që është shkruar në librat e historisë, por interpretimi i drejtë është vija ndarëse midis historianëve të vërtetë dhe atyre që janë tepër të njëanshëm. Historia jonë, për fatin tonë të keq, në shumë raste ka qënë e lidhur ngushtë me vendimet e fuqive të mëdha, edhe sot shihet qartë një qëndrim i tillë, duke nxjerrë dhe një herë në pah të gjitha prapaskenat që janë luajtur në kurriz të shqiptarëve. Kujtimet e Barnesit janë fakte që flasin vetë për këto qëndrime. Rrjedha e Historisë dhe natyra reale e njerëzve janë gjykata e vërtetë që vendos rreth shkaqeve të çdo sistemi filozofik, pra rreth të njëjtit system. Shkenca, si shenjti i legjendave, duhet të kërkojë padronin më të fortë. (Friedrich Julius Stahl)

Bibliografia

1) *Barnes J. S, Half a life left, England*
2) *Rochat G, Materiali per lo studio dell'Albania contemporanea, in Rivista di storia contemporanea, 1978*
3) *Akademia e Skencave e Shqipërisë, Historia e Shqipërisë*
4) *Internet, Historia e Shqipërisë, Shqipëria.com, 2003*
5) *Islami Selim, Frashëri Kristo, Buda Aleks, Historia e Shqipërisë, 1967*
6) *Borgogni Massimo, Tra continuita' e incertezza: Italia e Albania(1914-1939)…*
7) *Biagini A, Storia dell'Albania*
8) *Dell'Erba Nunzio, Storia dell'Albania, Newton Compton, Roma 2007*
9) *Internet, Rosselli Alberto, Viaggio nel paese delle aquile*
10) *Biagini Antonello, Storia dell'Albania contemporanea, Bompiani, 2005*

GJEOGRAFI

Prof. dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI

VEÇORITË HIDROGRAFIKE TË LUMIT BUNA

Përmbledhje

Zona e marë në studim është segmenti i Lumit Buna, i cili shtrihet që në fillimin e derdhjes së tij nga Liqeni i Shkodrës dhe deri tek bashkimi i tij me Lumin e Drinit, i cili shërben në formën e një shkarkuesi për Liqenin e Shkodrës. Ky studim ka për qellim të analizojë prurjet e lumit duke përdorur metodat analitike dhe empirike dhe duke testuar për periudha të ndryshme të kthimit të prurjeve. Ky studim sjell të dhëna të reja në vlerësimin e prurjeve të Lumit Buna në mënyrë që të eliminohet risku i tejkalimit dhe dëmtimi apo thyerjeve që mund t'i ndodhin argjinaturave të lumit si dhe projektimi i saktë i këtyre strukturave.

Devijimet artificiale të lumenjve dhe kur nuk paraprihen e nuk bazohen me studime multidisiplinore, janë të gabuara e me rrjedhime të padëshiruara ambientale, ekonomike e sociale.Të kësaj natyre janë ndërhyrjet në Drinin e Lezhës në fillim të viteve '50, të cilat jo vetëm nuk i dolën rezultatet e pritshme, por u shoqëruan me prishje të ekuilibrit ambiental dhe cënime të biodiversitetit të zonës.

Kështu u shtuan artificialisht sasia e ujërave të lumit Buna e bashkë me to u shtuan rastet e përmbytjeve, të shkarjeve e rrëshqitjeve të brigjeve, si dhe shtohet mundësia e prishjes së ekuilibrit hidrologjik: Bunë – Drin – Liqeni i Shkodrës. Kjo pasuri ujore (Drini i Lezhës dhe Gjadri) e administruar nga rrethi i Lezhës vihet në shërbim edhe të Malit të Zi.

Artikulli në mes tjerash analizon impaktin e ndryshimeve të veçorive hidrografike të lumit dhe detit: shkarkimi i Lumit Buna, qarkullimi i masave ujore në Gjirin e Bunës, thyerja e valëve, niveli i detit dhe dyndja e valëve të larta të baticave, akumulimi bregdetar dhe proceset erozionale etj., të cilat kushtëzojnë zhvillimet hidro – gjeomorfologjike të Deltës së Lumit Buna. Morfologjia dhe dinamikat e zhvillimeve hidro – gjeomorfologjike të Deltës së Lumit Buna kushtëzohen nga regjimi i lumit, regjimi talasografik i Detit Adriatik dhe nga ndryshimet klimatike.

Hyrje

Lumi i Bunës shtrihet në pjesën kufitare në pjesën jugore të Malit të Zi dhe Shqipërisë, në mes të kufirit të Komunës së Ulqinit dhe Komunës së Velipojës, pikërishtë Qarkut (Rrethit) të Shkodrës.

Lumi Buna është 44 km i gjatë dhe fillon në Liqenin e Shkodrës për t'u derdhur në Detin Adriatik. Lumi Buna është emisari i vetëm i liqenit të Shkodrës, i cili është më i madhi i gadishullit Ballkanik. Ai grumbullon ujërat e një pellgu të gjerë të një territori të theksuar malor. Meqënëse kuota e liqenit është vetëm 5 metra mbi nivelin e detit, Lumi Buna është mjaft i qetë. Në pjesën më jugore të periferisë së qytetit të Shkodrës pas 1.5 km, Lumi Buna bashkohet me kontribuesin e tij më të rëndësishëm, Lumin Drin. Derdhja e Lumit Drin në Bunë pengon shkarkimin e lirshëm të ujërave të liqenit dhe në disa raste, kur prurjet janë të mëdha krijon rrjedhje të ujit të Bunës në drejtim të kundërt. Drini është lumi më i gjatë në Shqipëri me një gjatësi totale prej 335 km. Ai ka dy degë të rëndësishme: Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Drini i Zi buron nga Liqeni i Ohrit në Strugë.

Kompleksi ujor Liqeni i Shkodrës – Bunë – Drini, përfaqëson një nga dukurite hidrologjike dhe mjedisore me interesante te Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe me gjerë. Dhe në këtë kompleks, Drini luan rolin kryesor.

Drini i sotëm, lumi më i madh i Shqipërisë dhe i dyti përsa i përket ujëshmërisë, pas Bunës, nuk ka qenë ai që është sot. Në grykën e Vaut të Dejës, duke marrë drejtimin e jugperëndimit, ai bashkonte me ujërat e tij edhe ato të lumit Gjadër dhe duke gjarpëruar nëpër fushat e Zadrimës, përbri qytetit te Lezhës i derdhte ato në detin Adriatik.

Në vitin 1846, gjatë një plote të jashtëzakonshme që shkaktoi përmbytje të mëdha, lumi Drin formoi një shtrat të ri që kaloi nga ana e Shkodrës dhe u bashkua me Bunën, rreth 1 km nën grykedaljen e tij.

Kjo ngjarje e shënuar hidrologjike, shënoi më pas e deri në ditët tona një çrregullim hidrologjik, hidraulik dhe mjedisor në Liqenin e Shkodrës dhe në zonën fushore ndërmjet lumit Buna dhe Drinit të Lezhës.

Në Liqenin e Shkodrës u prish rrënjësisht regjimi ujor. Si rrjedhojë e depozitimit të lëndës së ngurtë që sillte lumi Drin, gradualisht tabani i shtratit të Bunës filloi te ngrihet. U zvogëlua seksioni i gjallë dhe si pasojë u pakësua aftësia ujëheqëse e tij. Në të njëjtën kohë ujërat e Drinit bllokonin ose pengonin daljen e ujërave nga liqeni nëpërmjet lumit Buna. Këto bënë që të ngrihen mjaft nivelet e ujit në liqen, me disa

metra, duke përmbytur e zënë çdo vit e më shumë sipërfaqe të tjera, që së bashku kapin shifrën e disa dhjetra mijëra hektarëve.

Pozita gjeografike

Lumi Buna përshkon një pjesë të kufirit të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ajo del nga Liqeni i Shkodrës, tek ura e Bunës, në anën e majt të bregut të Bunës, në territorin e Shqipërisë: kodra e Rozafatit, (Mali i Taraboshit – Maja e Golishit – 656 m dhe Fusha e Oblikës në anën e djathtë), kodra e Bërdicës (60 m), Fusha e Mushanit, Suka e Dajçit (37 m), Suka e Samrishit, Mali Belaj (118m), Mali i Pentarit (74 m), Këneta e Pentarit, Këneta e Qasit, Mali i Bajsit (110 m), Mali i Reçit (167 m), Këneta e Bishalqinit, Suka e Pulajve dhe fshati i Pulajve, pranë grykëderdhjes (deltës) së Bunës; në anën e djathtë të bregut të Bunës, në territorin e Malit të Zi: Anamali (Fusha e Anës së Malit), Shullani (115 m), Liqeni i Shasit, Mali i Brinjës (153 m), Këneta e vogël, Suka e Shën Kollit (34 m) dhe fshati Shën Kolli , në afërsi të grykëderdjes (deltës) së Bunës.

LUMI BUNA

Origjina e Liqenit të Shkodrës dhe Bunës

Në Neogjen, Liqeni i Shkodrës ishte një gji deti, i tipit dalmat, vija bregdetare e të cilit në Miocen kalonte në Ulqin – Pistol (Pistulli – ver. M. H.) – Vladimir (Katërkollë – ver. M. H.), ndërsa në Pliocen arrinte në Plavnica – Podgoricë dhe më në lindje mbi Polvar e tjerë, ku janë gjetur sedimente fosilesh. Dalëngadalë deti u tërhoq dhe sipërfaqja e liruar nga deti u kënetizua dhe më pas u shndërrua në liqen duke u mbyllur në brendësi të tokës prej depozitimeve të Drinit, aty rreth fillimit të Kuaternarit. Liqeni lidhej me detin me një kanal të shkurtër uji, si të thuash fillesat e Lumit Buna, ndërsa vija bregdetare e atëhershme kalonte Tarabosh – Kodra Bushat – Lezhë. Edhe pjesa kontinentale që ekziston sot në perëndim të kësaj vije duhet të jetë formuar gjatë kësaj periudhe.

Liqeni i Shkodrës është zhvilluar në tre etapa:

Etapa e parë kur Liqeni ndodhej i mbyllur në një gropë të madhe, të formuar prej fundosjes tektonike. Në atë kohë Liqeni kishte sipërfaqe të madhe, deri në rrëzë të Alpeve dhe i zgjatur shumë drejt jugut.

Etapa e dytë, kur Liqeni zvogëlon dukshëm përmasat, për shkak të çarjes së Bunës dhe depozitimeve të shumta. Sipërfaqe të mëdha u këthyen në këneta e madje edhe në tokë të thatë. Në kohën e romakëve

Lumi Buna ishte një vazhdim i Lumit Moraça. Sipas Tit Livit (Titus Livius, 59 p. e. r. – 17 e. r.), cituar nga BRIOT, 1909, ky lum derdhej në një lum tjetër që quhej Oriundus (besohet se Drini) dhe se Lumi Drin kishte rrjedhjen nëpër Fushën e Torovicës, në Balldre dhe derdhej në det. Etapa e tretë i përket kohëve historike, kur Liqeni vazhdoi të rritej. BRIOT shkruan se, kjo dukuri, ka ndodhur për shkak të ndryshimit të rregjimit të derdhjes së Lumit Drini, herë nga Shkodra, herë nga Lezha dhe herë në të dy drejtimet. Për pesë shekujt e parë të erës së re ky regjim ka ndërruar 3 – 4 herë. Kështu ka ndodhur edhe pas shekullit të XV. Për një farë kohe në gjysmën e dytë të shekullit XV ky lum shfaqet i ndarë dyshë. Në shekullin e XVI kalon nga Lezha dhe në shekullin XVIII fillon e tenton drejt Shkodrës. Në fillim të shekullit të XIX, siç e paraqet harta e Turqisë Europiane e F. WEISS – it (1829), Liqeni i Shkodrës ishte shumë më i vogël se sa sot, me ishuj e fshatra në mes e më shumë me pamjen e një kompleksi kënetash. Në Grykën e Hotit kishte një rrip toke që e ndante këtë prej Liqenit. Së fundi në mes të shekullit të XIX, pikërisht në vitin 1846, Lumi Drin shfaqet i ndarë përsëri dyshë, nga Lezha dhe nga Shkodra për në Bunë.
Edhe Lumi Kiri po ashtu ka ndërruar regjimin e tij. Në antikitet ky lum kalonte nëpër Shkodër, për tu derdhur në Liqen. Në shekullin e XVII derdhej përsëri në Liqen, ndërsa prej vitit 1760 dihet se kalon në rrugën që ka edhe sot.
Lumi Drini dhe aluvionet e tij e kanë bërë Lumin Buna më pak të aftë për të nxjerrë ujë nga Liqeni. Rritja e Liqenit ka ndodhur edhe për shkak të lëvizjeve ulëse të brigjeve dhe mbushjes së tabanit të tij nga prurjet e shumta të lumenjve dhe përrenjve përreth.

KARAKTERISTIKAT TË PËRGJITHSHME TË BUNËS

Tërësia ujore Liqeni i Shkodrës – Lumi Bunë – Lumi Drin është një sistem hidrologjik mjaft kompleks dhe i ndërlikuar si nga ana hidrologjike ashtu dhe ajo hidraulike. Aty gërshetohet ndikimi i ndërsjellë i dukurive hidrologjike që karakterizojnë regjimin hidrologjik me ndikimin e ndërsjellë të mekanizimit të lëvezhes së ujërave nga Liqeni i Shkodrës në lumin Bunë e më tej, pas bashkimit me ujërat e Lumit Drin. Studimi i këtij mekanizmi përcakton në mënyrë të tërthortë llogaritjen e saktë të rrjedhjes ujore të Bunës e të Drinit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë zgjidhjen e problemeve të ndyshme inxhinierike të tërësisë ujore, përfshirë këtu ndikimin në të ardhmen të ndërhyrjeve të sotme inxhinierike në regjimin hidrologjik të këtij sistemi hidrologjik.

Buna rrjedh nga Liqeni i Shkodrës, tek ura e Bunës, ndërmjet kodrës së Rozafatit e Taraboshit. Menjëherë mbasi del nga ky liqen (rreth 1.5 km poshtë tij), Buna bashkohet me Drinin. Derdhja e lumit Drin në Bunë pengon shkarkimin e lirshëm të ujërave të Liqenit të Shkodrës dhe në disa raste krijon edhe rrjedhje me drejtim të kundërt. Gjatësia e Bunës është 44 km, ndërsa pjerrësia 0.08%. Për shkak të pjerrësisë së vogël dhe prurjeve të ngurta të lumit Drin Buna e ka ndryshuar disa herë shtratin e saj, e cila formon shumë meandre. Në det Buna përfundon me një deltë që është e përbërë nga disa ishuj aluvionalë (Ada 5.4 km2, Franc Jozefi etj).

Prurja mesatare shumëvjeçare e Bunës në dalje të Liqenit të Shkodrës është 320 m3/sek. Pasi merr Drinin, Buna bëhët lumi më ujëshumë i Shqipërisë dhe Malit të Zi (rreth 680 m3/sek). Kjo bën që ky lumë, nga shkalla e ujshmërisë, të renditet si i dytin në Pellgun e Adriatikut, pas lumit Po, si dhe të pestin në krejt Pellgun e Medheut, pas lumenjve Danubi, Nili, Rhone dhe Po. Prurja maksimale është 7500 m3/sek.

Në dalje nga liqeni Buna ka një modul vjetor të rrjedhjes ujore prej 61.7 l/s/ km2. Vlerat e larta të këtij moduli janë rezultat i reshjeve të shumta atmosferike në pellgun ujëmbajtës dhe i përhapjes së madhe të dukurive e proceseve karstike në të që kushtëzojnë përqindjen e lartë të ushqimit nëntokësor të saj (34% të rrjedhjes vjetore).

Regjimi i Bunës është shumë kompleks. Kjo lidhet me faktin që regjimi i saj lidhet shumë ngushtë me liqenin nga i cili del ai dhe me veçoritë e regjimit të Drinit, i cili siç u tha më sipër edhe nga ana e vet është shumë kompleks. Në këtë drejtim ndikojnë shumë sidomos bllokimi i grykës së Bunës nga valet e mëdha që formohen nën veprimin e erërave të fuqishme të perëndimit e veriperëndimit sidomos nga shiroku dhe nga baticat. Ndikim të madh ushtron Drini, me prurjet e tij të shumta, sidomos gjatë plotave, që shpesh pengojnë edhe rrjedhjen e lire të ujërave të Bunës. Në aftësinë përcjellëse të këtij lumi rol të madh luan edhe konfiguracioni i shtratit të tij, e sidomos ngushtimet, meandrimet dhe cektësia e tij. Cektësia është rrjedhim i mbathjes së shtratit të lumit nga prurjet e ngurta të Drinit dhe të Kirit. Gjatë periudhës së plotave më të mëdha, të cilat kanë një kohëzgjatje deri në 12 ditë, ujërat e bashkuara të Bunës dhe të Drinit, me një prurje maksimale mbi 7500 m3/sek, në të kaluarën dilnin jashtë shtratit dhe përmbytnin zonat përreth. Gjatë periudhës së pushtetit popullor anës brigjeve të Bunës u ngritën argjinatura të mëdha që kanë mënjanuar përmbytjet. Në mënjanimin e përmbytjeve në zonën përreth Drinit, Bunës dhe Liqenit të Shkodrës

ndikuan liqenet e mëdha artificiale të ndërtuara në lumin Drin, të cilat zvogëlojnë plotat dhe akumulojnë një pjesë të madhe të lëndëve të ngurta të këtij lumi.
Një rol të madh në regjimin e Bunës luan Liqeni I Shkodrës, i cili shërben si rregullator i fuqishëm i prurjeve të tij. Në saje të tij Buna është një nga lumenjtë me regjim relativisht më të rregullt të Shqipërisë dhe Malit të Zi, prurjet e së cilës pësojnë luhatjet më të vogla në krahasim me gjithë lumenjtë e tjerë të mëdhenj të Shqipërisë dhe Malit të Zi

Veçoritë të përgjithshme të sistemit ujor Liqeni i Shkodrës – Buna – Drini

Tërësia ujore Liqeni i Shkodrës – Buna – Drini, formon një system të vetëm hidrografik, që grumbullon ujërat e një pellgu me sipërfaqe të përgjithshme prej 19582 km2. Vetë Liqeni i Shkodrës ka një sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 5180 km2.
Duhet theksuar se llogaritjet e prurjeve për akse të ndryshme hidrometrike të tërësisë ujore Liqeni i Shkodrës – Lumi Drin – Lumi Buna në përgjithësi paraqesin një problem të vështirë, që kushtëzohet nga vete natyra e veçantë hidrografike e kësaj tërësie. Derdhja e ujërave të Drinit në shtratin e Bunës, menjëherë pas daljes së saj nga Liqeni i Shkodrës, jo vetëm që pengon shkarkimin e lirshëm të ujërave të liqenit në detin Adriatik, por në disa raste shkakton edhe rrjedhje në drejtim të kundërt. Në këtë nyje hidrike pengohet jo vetëm shkarkimi i ujërave të liqenit nëpërmjet Bunës, po e njëjta gjë ndodh edhe në Lumin Drin në derdhjen e tij. Në këto kushte në Bunë takohet rrymë e penguar ose ndryshe rrymë me presion të ndryshueshëm. Kjo gjendje nuk ndodh në çdo kohë, por vetëm në ato faza kur Drini sjell ujëra të shumta. Në bazën e të gjithë projekteve që mund të realizohen në këtë system ujor qëndron zgjidhja e problemit hidrologjik – hidraulik të nyjës, i cili konsiston në radhë të pare në vlerësimin e lakores së prurjes në kushtet e një regjimi jo uniform ose me presion të ndryshieshëm.

Rrjeti hidrografik

Pjesa veriore e rajonit të Shkodrës bën pjesë në pellgun hidrografik të Liqenit të Shkodrës. Kjo zone përbëhet nga formacione karbonatike dhe në pjesën fushore nga zhavorrishte. Si rrjedhojë, rrjeti hidrografik i kësaj hapësire karakterizohet nga rrjedhje të përkohshme. Nga ana tjetër, kjo zone është e pasur në ujëra nëntokësore dhe dalin shumë burime

karstike. Rrjedhjet kryesore janë Përroi i Vrakës, i Banushit, Rrjolli dhe Përroi i Thatë, të cilët të gjithë, derdhen në Liqen. Nga të gjithë këto përrenj, vetëm ai i Vrakës ka një rrjedhje të përhershme, të tjerët rrjedhin vetëm gjatë periudhës së shirave dhe përgjithësisht ujërat janë të pranishëm vetëm për disa orë deri në disa ditë. Pjesë e pellgut të Liqenit të Shkodrës është edhe Lumi i Cemit, i cili ndodhet në pjesën më veriore të këtij pellgu. Përroi i Cemit është degë e lumit Moraça, që rrjedh në Malin e Zi dhe derdhet në Liqenin e Shkodrës nga ky territori.
Nga Ana e Malit në territorin e Komunës së Ulqinit , në Bunë derdhen disa përrenj. Po përmendim disa prej tyre: Përroi i Thatë (3.5 km), Garuce (9.7 km), Përroi i Carinës (8 km), Përroi i Kravarit (7.5 km), Përroi i Rashtishës (9 km), Përroi i Brajshës (13 km) dhe Përroi i Millës (25 km).
Nga Liqeni i Shasit rrjedh kanali i Shëngjergjit, siç quhet në popull "vija e Shëngjergjit", e cila është e gjatë 2.2 km. Nëpërmes kësaj vije uji i Liqenit të Shasit derdhet në Bunë. Vija e Sjëngjergjit ka rrjedhje te përhershme dhe është deg e djathtë e lumit Buna.
Sheu i Megjureçit derdhet në Liqenin e Shasit i cili është i gjatë 21.9 km dhe buron në mes të Malit Kabeta dhe ati të Megjureçit (shpatet e Malit të Rumisë). Në anën e majtë të Bunës në territorin e Shqipërisë derdhet Vija (kanali) e Mërtemzës që ndodhet në mes malit dhe kënetës e Pentarit, Mali i Bajzës dhe të Reçit si dhe Liqenit të Mërtemzës.

Drini

Është lumi më i madh i Shqipërisë, me gjatësi 285 km dhe me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 14173 km2. Formohet nga dy degë kryesore: Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Drini i Zi buron nga liqeni i Ohrit dhe është i gjatë 149 km. Në territorin maqedonas merr degët: Saleska, Radika etj. Në territorin e Shqipërisë merr degë të shumta, si: Zalli i Homeshit, përroi i Murrës, përroi i Setës, Molla e Lurës, përroi i Banjave, Veleshica etj. Bashkohet me Drinin e Bardhë në liqenin e Fierzës.
Drini i Bardhë buron nga malësia e Zhlebit (Kosovë) dhe është 136 km i gjatë. Përshkon lugun e Dukagjinit, ku merr disa degë, si: Topluga, Bistrica e Prizrenit etj., dhe hyn në territorin e Shqipërisë në grykën e Vërnicës e derdhet në liqenin e Fierzës.
Vetëm rrjedhja e poshtme e Drinit të Bardhë i përket Shqipërisë, prej kufirit e në Kukës, ku bashkohet me Drinin e Zi. Të dy këta lumenj, me ujë të bollshëm, përbëjnë **Drinin** vetë, ose **Drinin e bashkuar**.

Drini i bashkuar, prej Fierzës deri në Vaun e Dejës merr pamjen e një vargu liqenesh si ai i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës. Në këtë gjatësi ai merr degë të shumta si: lumi i Krumës, Valbons, Curraj – Nikaj, Shala etj. Derdhet në lumen Buna. Lumi Drin dallohet për prurjen e madhe ujore (352 m3/sek), për prurje të lartë maksimale (mbi 5.000 m3/sek), për prurjen e madhe të ngurtë. Ka rezerva të mëdha hidroenergjetike.

Pothuajse 300 m si del nga ngushticat e tij, tek Vau i Dejës, Drini ndahet në dy degë. Ndarja e Drinit në dy degë është bërë në dimrin e vitit 1858 – 1859. Mendohet se kjo ndarje do të jetë shkaktuar nga Drini dhe nga lumi **Gjadër** – degë e Drinit. Pak vjet më parë Gjadri derdhet afër fshatit Gjadër, po sot ky lum ndjek shtratin e ri dhe derdhet po në Drin, afër Vaut të Dejës. Drini, pasi delte nga mallet, te Vau i Dejës, e ngadalësonte fuqinë e rrjedhjes duke lënë lëndët që sillte me vete sepse ujët nuk kishte fuqi t'i shpinte më tej, deri në det. Në këtë mënyrë shtrati i tij po ngushtohej gjithënjë e më shumë. Gjadri, nga ana e tij, në kohë vërshimesh sillte mjaft ujë, që pengonte rrymën e Drinit të ecte lirisht për në det. Kjo pengesë dhe të sjellurat e të dy lumenjve bënë që Drini të çajë një rrugë të re drejt Shkodrës dhe kështu u formua **Drinasa dhe Drini (Drini i vjetër).**

Drinasa, 13 km e gjatë, merr dy të tretat e ujit të Drinit dhe pasi merr nga e djathta **Kirin**, derdhet në Bunë, afër Shkodrës. Dega tjetër, **Drini i vjetër** merr vetëm një të tretën e ujit. Drini shkon drejt jugut dhe derdhet në det, në gjirin e Drinit.

Sektori i poshtëm shtrihet nga dalja prej Vaut të Dejës deri në derdhjen në Bunë. Shtrati i Drinit në këtë sektor zgjerohet deri në disa kilometra. Këtu ai ka ndryshuar disa here rrjedhjen, duke u derdhur here drejtpërdrejt në det e here në Bunë. Ndarja e tij e fundit në dy degë, në Drinin e Lezhës dhe në atë të Bunës, është bërë në mesin e shekullit të kaluar.

Rrjedhja vjetore e Bunës

Derdhja e ujërave të Drinit në shtratin e Bunës, menjëherë pas daljes së kësaj të fundit nga Liqeni I Shkodrës, jo vetëm që pengon shkarkimin e lirshëm të ujërave të Liqenit në detin Adriatik, por, në disa raste, shkakton edhe rrjedhje në drejtim të kundërt. Në këtë nyje hidrike pengohet jo vetëm shkarkimi i ujërave të liqenit nëpërmjet Bunës, po e njëjta gjë ngjet edhe në lumin Drin, në derdhjen e tij. Në këto kushte në Bunë takohet rryma e penguar e lumit, ose, siç emërtohet edhe ndryshe,

rryma me presion të ndryshueshëm. Kjo gjëndje nuk ndodh në çdo kohë, por në ato faza kur Drini sjell ujëra të shumtë. Për këtë në regjimin ujor të Bunës, në përgjithësi, dallohen dy faza kryesore, të cilat janë: a) Faza kur rryma e Bunës është e lirë, e pa penguar nga Drini; b) Faza kur rryma e Bunës është e penguar nga Drini, që do të thotë se rryma është me presion të ndryshueshëm.
Buna (bashkë me Drinin) kanë një vëllim mesatar vjetor prej 21.4 km3. Ky lumë për nga shkalla e ujëshmërisë përfaqëson një ndër lumenjtë kryesor të pellgut të Mesdheut.
Vlera e koeficientit të rrjedhjes e larta të tij takohen në Bunë (0.90). Kjo lidhet me mbizotërimin e formacioneve gëlqerore të karstëzuara në pellgun e tyre ujëmbledhës dhe me reshjet e shumta atmosferike.
Moduli i rrjedhjes në derdhjen e Drinit në Bunë është 24.8 l/sek/km2.

Rrjedhja e Bunës pas bashkimit me ujërat e Drinit

Për vetë kushtet e rrjedhjes së Bunës pas bashkimit me Drinin, shtrati i saj nuk ka kapacitet të tërheqë të gjithë sasinë e ujit që grumbullohet, sidomos në fazën me ujë shumë ndaj, një pjesë e rrjedhjes ujore në të kaluarën dilte nga shtrati dhe përmbyste ultësirën poshtë Daragjatit deri në afërsi të Obotit. Në këto kushte, në vendmatjen hidrometrike Buna – Dajç nuk kalon e gjithë sasia e ujit të Bunës Për të analizuar këtë gjëndje u bë krahasimi dhe analiza e prurjeve të matura. Në fillim u analizuara lidhja ndërmjet niveleve të Bunës në nyjen e bashkimit me Drinin dhe niveleve të ujit në Dajç për ato data që janë kryer matjet e prurjeve.
Nga analiza, del qartë ajo që u përmend më sipër se prurjet me nivelet nën kuotën 8.00 m abs. Janë pothuajse të barabarta për të dyja akset, ndërsa për nivele mbi këtë kuotë, prurjet në Bunë, pas bashkimit me Drinin, janë më të mëdha sesa për Bunën në Dajç. Nga këto prurje, një pjesë e ujit kthehet përsëri në shtrarin e Bunës, pas një rregullimi që pëson rrjedhja në ultësirën e përmbytur Daragjat – Obot, ndërsa pjesa tjetër nuk kalon në vendmatjen Buna – Dajç. Kjo bën që rrjedhja e Bunës në Dajç, në një farë mase, të jetë më e ulët.

Prurjet me të mëdha të plotave

Regjimi i prurjeve të lumit Buna në dalje të Liqenit të Shkodrës nuk ndodhet vetëm nën ndikimin e drejtpërdrejt të niveleve të vet liqenit, por edhe të rrjedhjes së Drinit. Si rrjedhoj prurjet maksimale të Bunës në dalje të Liqenit të Shkodrës janë më të vogla se ato të rrjedhjes natyrore të ujërave që derdhen në këtë liqen nga pellgu i tij ujëmbledhës. Kjo

shpreh efektin e saj edhe në lëkundjet e mëdha që pasojnë nivelet e ujërave të Liqenit të Shkodrës gjatë periudhave të ndryshme të vitit.
Prurjet maksimale në Bunë, vërehen kryesisht në muajt nëntor – dhjetor dhe më rrallë në janar – mars. Gjatë vitit shpërndarja e prurjeve ditore, karakterizohet nga rritje të herpasherëshme, si rezultat i shirave të rënë.
Prurja mesatare shumëvjeçare e Drinit (në derdhje në Bunë) është 352 m3/sek që i përgjigjet një vëllim vjetor prej 11.1 miliardë m3 ujë. Ky vëllim përfaqëson 26.9% të potencialit total ujor që formohet në sipërfaqen e përgjithshme të pellgut hidrografik të Shqipërisë.

Regjimi termik

Pas bashkimit të ujërave të Drinit me ato të Bunës vihet re një ulje e temperarurës së ujit të Bunës si pasojë e bashkimit me ujërat e Drinit, të cilët janë më të ftohtë. Në këtë mënyrë, temperatura mesatare e muajve më të ftohtë të vitit në Bunë, më pjesën e poshtme të rrjedhjes (Pulaj), është 6.6 grad C, ndërsa ajo e muajit më të ngrohtë 24.5 grad C, duke patur në këtë mënyrë një ulje mesatare shumëvjeçare prej 1.6 grad C.
Në Bunë, në pjesën e poshtme të rrjedhjes (Pulaj), temperatura mesatare shumëvjeçare – dimrit është 7.5 grad C, ndërsa ajo e stinës së verës 22.3 grad C. Vlerat më të larta ditore të temperaturës së ujit, ndryshojnë nga 18 grad C në 23.2 grad C, në rrjetin hidrografik të Moraçës, në 33.6 grad C, në vetë masën ujore të liqenit, ndërsa në Drin, para bashkimit me Bunën, temperatura më e lartë arrin 28.6 grad C.

Vështrim fiziko – gjeografik mbi pellgun ujëmbledhës i gjerë i Bunës

Buna porsa del nga liqeni bashkohet me Drinin. Ky i fundit për shkak të forces së tij të madhe në stinën e dimrit e kthen rrjedhjen e Bunës drejt liqenit, d.m.th. e kthen lumin nga emisar në affluent, gjë që rrit së tepërmi amplitudën e luhatjeve të nivelit të liqenit. Në luhatjet e mëdha të nivelit të liqenit nuk duhet mënjanuar ndikimi i Shirokut, i cili shtyn ujërat e liqenit nga bregu perëndimor në atë lindor. Amplituda e madhe e luhatjeve të nivelit të liqenit sjell ndryshime të ndjeshme të vijës së bregut lindor të liqenit dhe si pasojë edhe të sipërfaqes së tij. Nga hetimet e bëra në vend rezulton se distanca midis vijës së bregut të liqenit, në kohën e nivelit më të ulët të tij, dhe atij më të lartë është 300 – 500 m dhe sipërfaqja e liqenit rritet deri në 1.4 herë. Njëkohësisht me luhatjet stinore, liqeni pëson dhe luhatje vjetore të rëndësishme. Kjo bën

që niveli i tij të ngrihet vazhdimisht dhe si pasojë të zgjerohet edhe sipërfaqja e liqenit.
Historikisht gjurmët e zgjerimit të liqenit njihen qysh në shekullin XIII, kur Vranina nga gadishulli u kthye në ishull. Por kjo dukuri u shpejtua nga mesi i shekullit XIX kur një degë e Drinit u derdh në Bunë. Që prej asaj kohe, si rrjedhim i depozitimeve të shumta të Drinit në Bunë, filloi të ngrihet pragu i liqenit ku del Buna dhe kjo e fundit erdhi duke u bërë gjithnjë më pak e aftë për të zbrazur liqenin në det, veçanërisht në periudhën e shirave, kur Drini e detyron Bunën të kthehet në liqen.. Por meqenëse zgjerimi i liqenit ka filluar përpara derdhjes së Drinit në Bunë, në këtë zgjerim kanë ndikuar dhe depozitimet e bëra nga rrjedhjet e ndryshme të t'ujit, që përfundojnë në liqen, si dhe ulja e brigjeve të liqenit, si rrjedhim i lëvizjeve ulëse të zonës. Edhe regjimi i temperaturës së ujit të liqenit është origjinal, për shkak të cektësisë së ujërave të tij. Nga vrojtimet e bëra del se ndryshimi i temperaturës së ujërave sipërfaqësore dhe atyre të fundit të liqenit është aq i vogël sa mund të flitet për homotermi.
Fusha e Nënshkodrës përshkohet prej lemenjve më të mëdhenj siç janë Drini dhe Buna dhe nga përrenj të shumtë. Drini në fushën e Nënshkodrës është një lumë i plotujshëm me një prurje mesatare në Vaun e Dejës prej 320 m3/sek dhe me një koeficient të lartë rrjedhjeje (60 – 74%). Por prurja e tij ndryshon shumë gjatë vitit aq sa raporti midis prurjes minimale dhe asaj maksimale mund të arrijë deri në 1:10 dhe në rastet e skajshme akoma më shumë. Drini maksimumin kryesor e ka në dimër kur janë reshjet më të shumta dhe maksimumin e dytë në pranverë, kur shkrin dëbora.
Dega kryesore e Drinit është Gjadri që ëashtë një lumë i rrëmbyeshëm me fuqi të madhe gërryese. Regjimi i tij është aq i çrregullt sa disa herë në qershor e korrik nuk ka ujë. Ky lumë dikur e ka dëmtuar shumë Zadrimën me vërshimet e tij. Tani i është krijuar një shtrat i ri që e çon në Drin tek Vau i Dejës, e që këtej në Bunë.

Format akumulative fluviale e Lumit të Bunës

Lumi Buna dhe përrenjtë kurdoherë që bien shira sjellin me vete materiale të gërryera nga vendet e pjerrëta dhe të xhveshura. Ky material derdhet në det. Si rrjedhim i një erozioni të tillë, çdo vit, hidhen në det sasira të mëdha dheu të shume tokave pjellore.
Erozioni është më intensiv në pjesët e epërme të lumit Buna, atje është edhe shpejtësia e ujit më e madhe. Në rrjedhën e mesme erozioni vertikal

është më i dobët, ndërsa veprimi i erozionit anësor rritet dhe manifestohet në pjesën e poshtme të lumit, ku mbizotëron procesi i akumulimit të prurjeve të ngurta.
Lumi Buna rrjedh nëpër viset që përbëhen nga shkëmbinjtë gëlqerorë. Erozioni anësor dhe shpërlarja prej anëve të luginës është e vogël. Lugina në pjesën e epërme dhe deri diku në të mesmen, është e thellë dhe ka anë të rrëpinjta. Në shtratin të cilin ujëdhesa Ada e ndan në dy degë shihen sedimente e mëdha të rërës në formë të ishujve dhe të ujëdhesave të vogla.
Me veprimin e vet eroziv uji thellon shtratin e lumit, por njëkohësisht ai edhe e zgjeron shtratin e vet, domethënë shkakton edhe erozionin anësor i cili është më intensiv në pjesët e lakueshme të shtratit. Rënia e lumit është më e madhe në pjesën e epërme të rrjedhës, më e vogël në pjesën e mesme, kurse në pjesën e poshtme të lumit rënia është shumë e vogël.
Majtas dhe djathtas të Bunës dhe në drejtim të rrjedhës janë tarracat e lumit, rrafshinat e luginës. Ato janë mbeturinat e fundit të lumit të vjetër. Në rrafshinat e tarracave gjenden disa vendbanime fshatare, në pjesën e djathtë te luginës së Bunës (Shën Kolli, Shtoji Nelt (Shtoji i Epërm), Sutjelli, Qurkajt, Shën Gjergji, Fraskanjeli, Shtodra, Gorica etj.).
Në pellgun e lumit është rrafshina fluviale, në formë të valëzuar të hapësirës së madhe. Në formimin e kësaj rrafshinë fluviale rol të madh ka pasur proçesi i alterimit (denudacionit) që me erozionin anësor formon rrafshina të mëdha.
Mbi stomet e shtratit të lumit Buna shfaqen rrjedha të shpejta. Ato në shtratin e lumit kanë rënë nga anët e luginës. Janë të njohura rrjedhat e shpejta te meandra e Reçit, të ishulli i peshkatarëve, te Shën Gjergji, Fraskanjeli e në vende të tjera. Në vorbullat e mëdha të ujit sajohen thellësi të mëdha në shtratin e lumit Buna.
Përmes erozionit anësor të lumit, sajohet shtrati gjarpëror i lumit me shumë kthesa ose meandra. Meandrat më të mëdha gjenden te Shën Rroku, te Suka e Shën Levrenit, te Ura e Oblikut, në Daragjat, të Oboti, Gorica, Rrushkulli, Belajt, Fraskanjeli, Shën Gjergji, Qurkajt dhe te Reçi.
Me depozitimin e prurjeve të ngurta që bart rrjedha e lumit Buna, dhe i len aty ku fuqia bartëse zvogëlohet ose dobësohet krejtësisht, janë formuar disa forma akumulative të lumit, siç janë grumbujt e rërës, kurse në shtratin e lumit: manguret, stomet rërore nën ujë, kurse në luginën e lumit në det adet – ishujt (Ada e Ulqinit dhe e Franc Josefit) dhe delta.

Grumbujt e rërës janë sajuar në grykëderdhjen e lumit. Pas çdo shiu të furishëm, grumbujt e rërës shtohen me lym të ri. Lumi materialin e grumbulluar të rërës e bart përmes shtratit të vet.
Në disa vende të shtratit të Bunës janë të dukshme manguret, sidomos disa te meandri i Shën Rrokut, te Suka e Shën Levrenit, te Zusi, te Ura e Oblikut, te Sirqi, Mushani, Belajt dhe te Fraskanjeli.
Vendet e cekëta janë vende me thellësi të vogël të shtratit të lumit dhe përbëhen nga shtresat e rërës dhe të zhavorit. Këto vende gjenden më së shumti në pjesën e rrjedhës se mesme dhe të poshtme.
Stomet e rërës janë sajuar në ato brigje ku shpejtësia e ujit është më e vogël. Më së shumti stomet e rërës gjenden në brigjet afës Daragjatit, Sirqit, Mushanit, Dajçit, Samrishit, Urës së Geshit, Goricës, Shtodrës etj.
Ujëdhesat e lumit siç janë adet u krijuan me depozitimin e lymit në vendet e zgjeruara të shtratit të lumit dhe ku shpejtësia dhe fuqia bartëse e ujit zvogëlohet, kështu që lymi i lumit depozitohet. Në grykëderdhje lumi bart materiale të shumta dhe i derdh në det, aty batica dhe zbatica janë të vogla dhe kështu është sajuar delta e Bunës. Nga materiali i depozituar krijohet toka e re nëpër të cilën lumi Buna me dy degët e veta derdhet në det.
Në morfologjinë e bregdetit të ulët të Adriatikut një vend të rëndësishëm zënë deltat lumore. Gati të gjitha ato janë të tipit të thjesht, mbasi përbëhen vetëm nga një grykëderdhje lumore. Përjashtim bën vetëm delta e Bunës e përbërë nga dy grykëderdhje që ndahen nga dy ishuj të vegjël ranorë.
Tokat aluvionale mbulojnë tarracat e lumit Buna, si në në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të lumit. Lëvizja e ujërave nëntokësore kanë gradë të ndryshme mineralizimi (kripërash), prandaj, duke u ngjitur lart rrjedhës kripëzojnë sasi të ndryshme tokash. Toka të kripura gjenden në afërsi të detit, rreth kënetave brenda ujdhesës Ada, si dhe në rrjedhën e poshtme të Bunës.
Kripëzimi i tokës rreth grykës së Bunës është pasojë e infiltrimit të ujit të detit dhe e pranisë së ujërave nëntokësore në thellësi të vogël.
Në ujdhesën Ada ka edhe këneta të vogla dhe moçale që janë formuar me mbylljen e gropave të Lumit, dhe në ato vende ku shtresa ujëmbajtëse gjendet në një thellësi të vogël të sipërfaqes së tokës. Bimësia moçalore është tipike për vende të ulëta në rrafshinat aluviale të lumit që gjendet në lartësi të vogël mbidetare.

Ujdhesa e Adës

Ujdhesa Ada e Ulqinit u formua me fundosjen e një anijes. Më së pari u formua gradualisht stom rërë, pastaj u sajuan ishuj, dhe diçka më vonë u formua ujdhesa. Lajmi i parë i formimit të ujdhesës Ada daton nga viti 1882. Ada u formua në atë vend ku pat qenë fundosur një anije italiane (barka) nën komandën e kapitenit Naporelli. Rreth trungut të anijes u mblodh kallam, zhavorr, baltë dhe rërë. Ekziston informata zyrtare se shkuneri (tipi i anijes) "Merito", prej 64 tonelatash, pronë e Allgreti Antunit, nga Trogiri (Kroaci), në vitin 1859, u fundos në Bunë afër Shën Kollit.

Ujdhesa Ada e ka formën e trekëndëshit. Në drejtim kah lumi është i gjatë rreth 2.8 km, kurse në vendin më të gjerë, gjërsia arrin 1.8 km, dhe i lartë 3 – 4 m. Ujdhesa Ada në vitin 1897 është zgjatur për 1300 m, ndërsa zgjeruar për 900 m. Sipërfaqen e ka 5.4 km2. Kur ujdhesa sipërfaqen e vet e kishte më të vogël valët e detit vinin deri të Shën Kolli.

Ippen Theodori, konsul austro – hungarez, në vitin 1907 thekson se:"para 25 viteve në grykën e Bunës u formua ujdhesë e madhe". Kjo do të thotë, se ishulli në grykën e Bunës u formua në vitin 1882, që don të thotë se filloi të shihet jashtë ujit, çka i përgjigjet të vërtetës. Malush Çaushi, kapiten ulqinak, i lindur në vitin 1872 kishte dhjetë vjet kur filloi të lundrojë me anijet dhe shumë herë kishte qënë në stomin e rërës së Bunës, në të cilin atëherë ishte e mundur të uleshin dhjetë njerëz. Kujtimi i tij dhe viti i tij kur u lind përputhet me vitin e formimit të ujdhesës që e thekson Ippeni. Sipas shënimeve, stomi i rërës filloi të paraqitet mbi ujë rreth vitit 1882. Ky vit i formimit të ujdhesës pajtohet edhe me atë që Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufijve nga vitet 1881 dhe 1883, nuk e drejtoi vemendjen në këtë stom rëre, sepse stome rëre të ngjashme në Bunë kishte shumë.

Stomet e rërës pastaj dhe ishujt formohen aty ku talvegu i lumit është i dobët, pastaj në vendet ku rënia e lumit është më e vogël dhe rrjedha më e ngadalshme, si dhe atje ku uji është bajat. Stome rëre më se shumti formohen pranë nivelit më të lartë të ujit, kur lumi sjell sasi të mëdha të zhavorrit, baltës dhe lëndë të tjera. Aluvioni lumor në këto vende ndalohet dhe kështu formohen stome rëre dhe ishujt (adat). Kur niveli i ujit të lumit zbret, ishujt dalin përmbi nga uji i lumit dhe rreth tyre lumi degëzohet në dy ose më shumë mëngezë, varësisht sa ishuj ka, në këtë rast në dy mëngëzat e grykës së Bunës.

Në hartën e camotit e quajtur “Dintorni di Scutari”, rreth vitit 1571, përpara grykës së Bunës gjendeshin të vizatuar dy ishujt të vegjël, të cilët më vonë, ndoshta për shkak të përmbytjes së madhe, të jenë bashkuar përsëri me tokë, sepse në hartën e Cantelit përpara grykës së Bunës nuk gjendet i vizituar asnjë ishull dhe as ndonjë stom rëre. As në hartën e Coronellit në atë vend nuk është i vizituar asnjë ishull. Në hartën e këtij të fundit fshati Pulaj gjendet diçka më larg hyrjes në Bunë, kurse fshati Shën Kolli diçka më lartë se 1 km prej grykës, kurse tani prej grykës është larg rreth 3.5 km (rreth 3 km – ver. M. H.). Do të thotë se prej kohës së Coronellit gryka e Bunës shtrihej mjaft kah deti.

DELTA E BUNËS

Delta e Lumit Buna, e ndodhur në njësinë fiziografike Gjiri i Drinit, paraqet një dinamikë komplekse të ndikuar nga proceset e formimit dhe të reduktimit. Proceset e formimit të Deltës janë kryesisht me prejardhje lumore nga Kompleksi Hidrografik Liqeni i Shkodrës, Lumi Drin dhe Buna dhe kanë të bëjnë me furnizimin me ujë dhe sedimente. Ndërtimi i Kaskadës në Lumin Drin ka rregulluar pjesërisht regjimin e rrjedhjes dhe ka shkaktuar një pakësim të vëllimeve të sedimenteve të transportuara. Proceset e konsideruara të reduktimit të Deltës janë kryesisht me prejardhje detare dhe përfshijnë erozionin bregdetar, shtimin e rritjes relative të nivelit të detit, zvogëlimin e kohës së ardhjes së stuhive dhe ndryshimin e klimës së valëve. Ndryshimi i nivelit të detit merr në konsideratë baticën astronomike dhe meteorologjike, ngritjen nga gradienti i presionit atmosferik dhe ngritjen e induktuar nga valët tek vija e bregut.

Veçori gjeomorfologjike

Elementi i parë i rëndësishëm gjeomorfologjik i bregdetit Shëngjin – Gryka e Bunës është delta e Bunës. Siç dihet, delta është vepër e këtyre 150 – 200 vjetëve të fundit, lidhur me derdhjen e Drinit në Bunë, gjë që shumëfishoi erdhjen dhe depozitimin e materialeve. Delta përbëhet nga dy pjesët anësore kontinentale dhe nga dy ishuj në qendër, ishulli i Adës (1882) dhe ishulli i Franc Jozefit (1913). Ka një sipërfaqe prej 15 km2. Në territorin e Shqipërisë delta përbëhet nga pjesa kontinentale, që fillon pothuaj nga fshati Pulaj dhe zbret në bregdet, aty ku fillon edhe harku i bregut, deri në grykëderdhje. Përbëhet gjithashtu edhe nga ishulli i Franc

Jozefit dhe nga kordoni litoral që zgjatet nga bregu jugor drejt ishullit e që herë pas here e bashkon ishullin duke formuar gadishull.
Në këtë pjesë bregdetare sgfaqen dy tipet kryesore të relievit bregdetar: tipi i relievit të ulët akumulativ, i cili zë pjesën më të madhe të gjatësisë së vijës bregdetare, duke filluar nga plazhi i Ranës së Hedhun në jug deri në grykëderdhjen e Bunës, në 20 km gjatësi. Në të dallohen tre segmente që kanë ndryshime të pjesshme nga njëri – tjetri: plazhi i Velipojës në qendër; plazhi i Deltës në veri dhe plazhi i Ranës së Hedhun në jug, (si edhe plazhin në ishullin e Adës – ver. – M. H.).
Në bregdetin akumulativ, trashëgohen format karakteristike të veprimtarisë eoliane, dunat. Këto forma janë të përhapura kudo, por vrojtohen më shumë në deltën e Bunës brenda Rezervatit të Velipojës, më pak në plazhin e Velipojës si dhe në plazhin e Ranës së Hedhu, po ahtu edhe në plazhin e Adës dhe Plazhin e Madhë të Ulqinit. Në Ranën e Hedhun dunat arrijnë lartësinë 2 – 3 m.
Megjithëse fizionomia dominuese e bregut ranor të Velipokës është akumulimi, në segmentin e deltës së Bunës, që prej disa vitesh është shfaqur veprimtaria erozive e dallgëve. Kjo veprimtari ka prekur gjithë brigjet e ishullit të Franc Jozefit, kordonin litoral që lidh pjesën kontinentale të deltës me ishullin dhe gjithë plazhin e deltës. Ishulli i Franc Jozefit njihet vazhdimisht si i tillë që kur është krijuar, por para 5 – 6 vjetëve kordoni e takoi ishullin dhe e ktheu në gadishull. Rreth 2 – 3 vjet më parë kordoni u ça, u riformua ishulli dhe u intensifikua erozioni bregdetar. Kjo është një situatë e tillë gjeomorfologjike që në qoftë së vazhdon mund të çojë në zhdukjen e ishullit, brigjet e së cilit tërhiqen nga të gjitha anët. Siç është theksuar nga studiuesit tanë, erozioni është pasojë e pakësimit të konsiderueshëm të materialit të ngurtë që sjell Buna pas ndërtimit të liqeneve të mëdhenj mbi lumin Drin. Ky erozion po përhapet drejt jugut, duke e rrezikuar edhe plazhin e Velipojës (si dhe plazhin e Adës – ver. – M. H.).

Evolucioni historik i Deltës së Bunës

Në periudhat më të hershme, para disa shekujve, Kompleksi Hidrografik të Liqenit të Shkodrës, sipas dokumenteve historike, nuk ka qenë i tillë siç është sot. Ao formohej vetëm nga Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna me basen ujëmbledhës 5221 km katrorë. Në këto kushte, kur rrjedha e Bunës nuk ishte e rrëmbyeshme, pa shumë ngarkesë të lëndës së ngurtë, me nivelet e ujit në Liqenin e Shkodrës në kuota më të ulëta e më të qëndrueshme, Lumi Buna, duke qenë i lundrueshëm, nëpërmjet një

delte të thjeshtë një degësh, lidhte me rrugë ujore Detin Adriatik me Shkodrën dhe Podgoricën.
Në atë kohë Sistemi Hidrografik Drin – Gjadër, me sipërfaqe të basenit ujëmbledhës 14361 km katërorë, nuk kishte lidhje me Kompleksin Hidrografik të Liqenit të Shkodrës. Rrjedha e rrëmbyeshme e Drinit, pasi dilte nga lugina e Vaut të Dejës, bashkohej me rrjedhjen e Gjadrit dhe vazhdonte më tej nëpër fushën e Zadrimës dhe qytetin e Lezhës, duke përfunduar kështu në Adriatik në zonën e ulët bregdetare të Kune – Vainit me një delte të përbërë disa degëshe.
Si rezultat i depozitimeve të lëndës së ngurtë dora dorës u pakësua kapaciteti transportues i Drinit të Lezhës, duke shkaktuar kështu dalje nga shtrati të prurjeve të lumit dhe përmbytje në kohën e plotave të fuqishme. Meqenëse situata u përkeqësua gjithnjë e më shumë, ajo e detyroi Drinin e Lezhës të vihet në kohën e plotave në kërkim të një shtrati të ri, sipas një traseje me gradient gjatësor më të madh në drejtim të derdhjes në det. Në këtë mënyrë, Drini pak nga pak po tentonte që një pjesë të prurjeve të tij në kohën e plotave ta shkarkonte në Adriatik nëpërmjet Bunës.
Në vitin 1846, gjatë një plote të jashtëzakonshme, që shkaktoi përmbytje të mëdha, ndodhi një nga ngjarjet më të shënuara hidrologjike, ku Drini tashmë nëpërmjet një shtrati të ri (rreth 15 km i gjatë), i quajtur Drinasa, i bashkuar më tej me Kirin, u lidh me Bunën rreth 2.5 km më poshtë nga dalja e saj prej Liqenit të Shkodrës. Kështu, pas kësaj ngjarje, ujërat e Drinit rreth 1 km më poshtë nga dalja prej luginës së Vaut të Dejës ndaheshin në dy pjesë, më e pakta në shtratin e vjetër të Drinit të Lezhës dhe më e shumta në shtratin e ri në drejtim të Bunës.
Në kushtet e reja, si rezultat i futjes së Drinit në Bunë, filloi të përkeqësohet regjimi hidraulik i Kompleksit Hidrografik të Liqenit të Shkodrës. Në nëntor të vitit 1896, nga një plotë e madhe e Drinit, e vlerësuar në rreth 7000 m3/ sek, u përmbyt edhe ura mbi Drin. Nga depozitimet e lëndës së ngurtë, të sjella nga Drini, tabani i Bunës u ngrit, sidomos në zonën e bashkimit me Drinin. Po ashtu, u ngritën nivelet e ujit në Liqenin e Shkodrës dhe për pasojë u shtuan sipërfaqet e përmbytura të tokave bujqësore për rreth liqenit. Lumi Buna e humbi gradualisht aftësinë lundruese të tij.
Ky ndryshim i jashtëzakonshëm i kalimit të rrjedhjeve më të fuqishme nga Drini i Lezhës në Bunë u reflektua edhe në deltat e zonat bregdetare përkatëse. Kështu, ndërsa Delta e Drinit të Lezhës u transformua në

njëdegëshe, me sistemin lagunor Kune – Vain në të dy anët e saj, Delta e Bunës u nda në dy degë.
Nga studimi i ndryshimeve të vijave bregdetare përkatëse, për periudhën 1918 – 1990, në litoralin për rreth Deltës së Drinit të Lezhës kanë dominuar proceset e reduktimit ose erozionit bregdetar, ndërsa e kundërta ka ndodhur në litoralin për rreth Deltës së Bunës, i cili ka qenë në proces formimi ose avancimi të vazhdueshëm.
Një ngjarje tjetër e rëndësishme hidrologjike ishte edhe ajo e vitit 1963, ku më 13 janar prurja maksimale në Bunë arriti në 6060 m3/sek (4560 m3/sek nga Drini dhe 1500 m3/sek nga liqeni), e shoqëruar me përnbytjen e 30 mijë ha tokë për 22 ditë me radhë.
Në Kompleksin Hidrografik të Liqenit të Shkodrës janë shkaktuar ndryshme të rëndësishme, jo vetëm nga natyra, por edhe nga ndërhyrjet inxhinierike. Kështu, në vitin 1956 u mbyll plotësisht rrjedha për në Lezhë e prurjeve nga basenet ujëmbledhëse të Drinit dhe Gjadrit dhe u bë devijimi i tyre në Bunë. Me këto masa Drini i Lezhës mori formën e një kanali të madh kullimi për fushën e Zadrimës dhe u shtuan rrjedhjet e ujit e të lëndës së ngurët në Bunë. Por me ndërtimin pas vitit 1972 të Kaskadës Hidroenergjetike të Drinit, për shkak të rregullimit të rrjedhës së lumit në ujëmbledhësit e Vaut të Dejës, Komanit dhe Fierzës, u zvogëluan prurjet maksimale të plotave natyrore dhe akoma më tepër lënda e ngurtë që depozitohej në shtratin e Bunës dhe deltën e saj.
Nga krahasimi me metodën e gjeoreferimit i vijës bregdetare, të përcaktuar nga hartat topografike të viteve 1959 dhe 1986 me atë të imazhit satelitor 2007, duket qartë veprimi i proceseva të erozionit në zonën bregdetare me pranë degës kryesore të Deltës së Bunës dhe i proceseve të sedimentimit në zomën më larg saj.
Gjithashtu proceseva të erozionit i është nënshtruar bregu i majtë i degës kryesore, ndërsa proceseve te sedimentimit bregu i djathtë i saj si dhe dega sekondare, e cila tashmë është mjaft e dobët lidhur me aftësinë transportuese të prurjeve në det.

Veçoritë fiziografike dhe hidrodinamike të Deltës së Bunës

Zona bregdetare e Deltës së Bunës, ndodhet në bregun lindor të Adriatikut të Jugut, në Njësinë Fiziografike Gjiri i Drinit. Për gjatë vijës bregdetare të kësaj Njësie, rreth 83 km e gjatë, që kufizohet në Veri me Kepin e Mendrës (Ulqin) dhe në Jug me Kepin e Rodonit, ndodhen edhe grykëderdhjet e lumenjve Drin i Lezhës, Mat e Ishëm, si dhe lagunat e Vilunit, Kune – Vainit e Patogut.

Njësia Fiziografike Gjiri i Drinit përbëhet nga Nënnjësia Kepi i Mendrës – Kepi i Shëngjinit, ku ndodhet Delta e Bunës dhe nga Nënnjësia Kepi i Shëngjinit – Kepi i Rodonit. Nënnjësia Fiziografike e Deltës së Bunës, rreth 42 km e gjatë, ka 29% bregdet shkëmbor, 63% plazhe ranore dhe 8% depozitime deltaike.
Mjedisi i Deltës së Bunës është ndikuar jo vetëm nga ndryshimet apo ngjarjet e mëdha hidrologjike të përmendura më lartë, por edhe nga bashkëveprimi i proceseve hidrodinamike lumore dhe detare në zonën e grykëderdhjes.
Rritja e ngritjes relative të nivelit të detit, zvogëlimi i kohës së përsëritjes së stuhive dhe nfryshimi i klimës së valëve nën efektin e ndryshimeve klimatike nga ngrohja globale janë faktorë të rëndësishëm hidrodinamike të lidhur me detin që po ndikojnë në evolucionin sedimentologjik dhe gjeomorfologjik, jo vetëm të zonës bregdetare të Deltës së Bunës, por edhe në shumë zona të tjera.
Në kohë ndikojnë ndryshimet e nivelit të detit nga baticat astronomike dhe nga ngrohja globale e planetit. Siç dihet, në Detin Adriatik, me përjashtim të pjesës veriore të tij, amplituda mesatare e baticës astronomike është rreth 30 cm.
Rritja e nivelit mesatar të detit nga ngrohja globale, sipas të dhënave të vrojtimeve në shekullin e kaluar, ka rezultuar 15 cm, por sipas modeleve të parashikimeve, në shekullin në vazhdim mund të arrijë në 80 cm.
Rritjet e nivelit mesatar të detit nga gradienti i presionit atmosferik, nga erërat e forta me drejtimin nga deti në tokë dhe nga valët në zonën e sërfit janë konsideruar me ndikimin në hapësirë. Madhësia e rritjes së nivelit mesatar të detit nga veprimet e përbashkëta të valëve dhe të erës varet nga lartësia e valës në det të thellë, nga shpejtësia dhe kohëzgjatja e erës, nga konfiguracioni dhe batimetria e bregdetit. Përcaktimi korrekt i kësaj madhësie, e njohur si baticë astronomike, realizohet me anën e simulimeve numerike speciale.

Në vend të përfundimit

Duke analizuar karakteristikat hidrografike të sistemit ujor Liqeni i Shkodrës – Buna – Drini arrijmë në këto përfundime:
- Studimi hidrologjik i këtij sistemi duhet bërë në bashkëpunim me kolegët malazeze dhe shiptare. Ky bashkëpunim deri më sot nuk ka funksionuar ashtu siç duhet:

- Studimi hidrologjik bashkë me atë hidraulik i paraprijnë çdo lloj projektideje që lidhet me menaxhimin ujor të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit të Bunës;
- Luhatjet e mëdha të nivelit të liqenit përbëjnë një kërcënim serioz për ruajtjen e ekosistemit dhe biodiversitetit.
- Lugina e Lumit të Bunës dhe grykëderdhja e saj janë ndër rajonet me diversitet të madh gjenetik në ekosistemin e Liqenit të Shkodrës. Identifikimi i këtij biodiversiteti, karakterizimi i tij, vlerësimi i situatës aktuale dhe i trendeve të zhvillimit janë një nga fushat prioritare të studimit, të nevojshme për zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe programeve për mirë administrimin ekonomik të tij në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm rural të rajonit;
- Ndërhyrjet në biodiversitet dhe mjedis, të cilat mundësojnë zhvillime harmonike dhe të integruara në planet biologjike, gjenetike, ekonomike, sociale, të kulturës e traditës, janë themeli mbi të cilin duhet të ndërtohen strategjitë e zhvillimit ekonomik të ekosistemeve dhe planet e veprimit rajonal e ndërkufitar.

Literaturë

Kolektiv autorësh, Hidrologjia e Shqipërisë, Instituti Hidrometeorologjisë, Tiranë, 1986.

Kolektiv autorësh, Gjeografia fizike e Shqipërisë, (Në dy vëllime), Vëllimi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e studimeve Gjeografike, Tiranë, 1990.

Kolektiv autorësh, Gjeografia fizike e Shqipërisë, (Në dy vëllime). Vëllimi II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e studimeve Gjeografike, Tiranë, 1991.

Pandi Geço, Një vështrim i shkurtër fiziko – gjeografik mbi Ultësirën e Shkodrës, Studime Gjeografike, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1985.

Farudin Hoxha, Nderhyrjet e njeriut ne Drinin e Lezhes dhe rrjedhimet e tyre mjedisore, Simpoziumi III kombëtar i Gjeografisë: "Gjeomorfologjia e Aplikuar, Mjedisi dhe Turizmi Bregdetar në Shqipëri", Kumtesa, Qendra e Studimeve Gjeografike, 16 – 18 Tetor 1998, Tiranë, 1998.

Dhimitër Dhora, Liqeni i Shkodrës, Shkodër, 2005.

Mihal Kaso, Valbona Duri, Gentian Ruspi dhe Fatlinda Shkurti, Gjeografia, Tiranë, 2006.

Aqif Selfo, Gjeografia ekonomike e Shqipërisë. Për shkollat e mesme, Botim i pestë, Tiranë, 1967.

Trifon Ziu, Veçori gjeomorfologjike te bregdetit Shengjin – Gryka e Bunes dhe probleme mjedisore te tij, Simpoziumi III kombëtar i Gjeografisë: "Gjeomorfologjia e Aplikuar, Mjedisi dhe Turizmi Bregdetar në Shqipëri", Kumtesa, Qendra e Studimeve Gjeografike, 16 – 18 Tetor 1998, Tiranë, 1998.

Molnar Kolaneci, Bardhyl Shehu, Miriam Bogdani dhe Lorenc Zani, Karakteristikat hidrografike te sistemit ujor Liqeni i Shkodrës – Buna dhe Drini, Akademia e shkencave e Shqipërisë; Akademia e shkencave dhe të arteve të Malit të Zi, Konferencat shkencore: "Liqeni i Shkodrës – Gjendja dhe perspektivat, Librat 105, Vëllimi I, Podgorica – Shkodër, 2011.

Stavri Lami dhe Klodian Zaimi, Dinamika e deltës së lumit Buna në lidhje me detin Adriatik dhe kompleksin hidrografik të Liqenit të Shkodrës, Akademia e shkencave e Shqipërisë; Akademia e shkencave dhe të arteve të Malit të Zi, Konferencat shkencore: "Liqeni i Shkodrës – gjendja dhe perspektivat, Librat 105, Vëllimi II, Podgorica – Shkodër, 2011.

Maksut Haxhibrahimi, Osnove za razvoj boravišno - rekreativnog, kupališnog i nautičkog turizma u Ulcinju, Geografsko – turizmološka studija, Titograd, 1992.
Maksut Haxhibrahimi, Turistička valorizacija Šaskog jezera, Putovanja, List za turizam i hotelijerstvo, januar 2005, broj 41/42, godina VIII, Podgorica, 2005.
Maksut Haxhibrahimi, Rijeka Bojana, Geografski pregled, Geografsko društvo BiH, Sveska 28 – 29, 1984. i 1985., Sarajevo, 1986.
Maksut Haxhibrahimi, Turistička valorizacija Šaskog jezera, Godišnjak geografskog društva Crne Gore, br. 3, Titograd, 1981.
Maksut Haxhibrahimi, Rijeka Bojana, Geografski horizont, Geografsko društvo Hrvatske, godina XXII, broj 3-4, Zagreb, 1976.
Maksut Haxhibrahimi, Turistička valorizacija Bojane, Putovanja, List zs turizam i hotelijerstvo, novembar 2005, broj 45, godina VIII, Podgorica, 2005.
Maksut Haxhibrahimi, Ostrvo Ada na ušću Bojane, Putovanja, List za turizam i hotelijerstvo, avgust/septembar, broj 33/34, godina VI, Podgorica, 2003.
Maksut Haxhibrahimi, Ribolov na Bojani, Časopis Gorske staze, februar, broj 44, Podgorica, 2007.
Maksut Haxhibrahimi, Ihtiofauna Šaskog jezera sjeveroistočno od Ulcinja, Časopis Gorske staze, novembar, broj 42, Podgorica, 2006.
Maksut Haxhibrahimi, Bazat gjeografike e valorizimit (vlerësimit) turistik në grrykëderdhjen e Bunës, Dija, Revistë vjetore për shkencë, kulturë, art, nr. 4 – 5, viti V, Ulqin, 2007.
Maksut Haxhibrahimi, Bojana – slivnik sliva, Vijesti, Nezavisne dnevne novine, 09.02. 2010, Podgorica, 2010.
Maksut Haxhibrahimi, Rijeka Bojana, Geoekologija – XXI vijek – teorijski i aplikativni zadaci, Zbornik referata, Geoeko, Žabljak – Nikšić, 21 – 24, septembar, 2010, Žabljak – Nikšić, 2010.
Maksut Haxhibrahimi, Rijeka Bojana, Akademia e shkencave e Shqipërisë; Akademia e shkencave dhe të arteve të Malit të Zi, Konferencat shkencore: "Liqeni i Shkodrës - Gjendja dhe perspektivat, Librat 105, Vëllimi I, Podgorica – Shkodër, 2011.
Maksut Haxhibrahimi, Zoganjsko jezero, Tokovi, Časopis za naučna, književna i društvena pitanja, broj 1, Berane, 2012.
Maksut Haxhibrahimi, Ulcinjsko polje, Prilog poznavanju kraške hidrografije, Tokovi, Časopis za naučna, književna i društvena pitanja, broj 1, Berane, 2014.
Maksut Haxhibrahimi, Turistička valorizacija rijeke Bojane, Putovanja, Časopis za turizam, ekonomija, kultura i nauka, broj 74, godina XIX, februar 2016, Podgorica, 2016.
Maksut Haxhibrahimi, Turistička valorizacija Šaskog jezera, Putovanja, Časopis za turizam, ekonomija, kultura i nauka, broj 75, godina XIX, jun 2016, Podgorica, 2016.
Maksut Haxhibrahimi, Zoganjsko jezero, I dio, Putovanja, Časopis za turizam, ekonomija, kultura i nauka, broj 71, godina XVI, 2014/2015, Podgorica, 2015.
Maksut Haxhibrahimi, Zoganjsko jezero, II dio, Putovanja, Časopis za turizam, ekonomija, kultura i nauka, broj 72, godina XVI, maj 2015, Podgorica, 2015.
Maksut Haxhibrahimi, Formimi i ujdhesës Ada në grykën e Bunës, Koha, Revistë për art, shkencë, kulturë dhe çeshtje shoqërore, numri 5 – 6, viti VIII, Titograd, 1985.
Dinko – Bure Franetović, Historija pomorstva i ribarstva Crne Gore do 1918 godine, Titograd, 1960.
Hartat topografike – Cetinje 4, 1: 50000; Shkodra 3, 1: 50000; Lezha 1, 1: 50000.

Dr.Nexhat AVDIU

VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË LIQENIT TË SHASIT

Parathenie

Punimi me titull: **Veçoritë gjeografike të liqenit të Shasit** *synon të paraqes rëndësinë që ka ky liqen sëbashku më zonën për rreth në oaspektin gjeografik, hidrografike ne aspektin e biodiveristetit dhe ate mjedisore per komunen e Ulqinit.*

Detyra kryesore e punimit përqendrohet në njohjen sa me të mire te mjedisit gjeografike dhe vlerësimin e tyre, në gjëndjen e mjedisit etj. Te gjitha keto do te ndikojne ne valorizimin e liqenit te Shasit ne aspektin turistik me mundesi te zhvillimit te llojeve te ndryshme te turizmit si: eko-turizmin, turizmin mjedisor, turizmin kulturor etj.

Pozita gjeografike e liqenit te Shasit

Liqeni i Shasit shtrihet në pjesën verilindore të komunës së Ulqinit në një distancë gjeografike rreth 23 km dhe 16 km largë grykëderdhjes së Bunës.

Liqeni gjendet në mes Malit të Brisë në jugpërendim, kënetës së Fraskanjelit në lindje, Malit të Amullit e të Shasit në verilindje dhe Fushës së Brisë (Klleznës) në veriperëndim.

Si liqeni ashtu edhe e tërë zona përreth tij ka një pozitë të favorshme gjeografike pasi gjëndet në afërsi të qyteteve të njohura si: Ulqini, Shkodra dhe Tivari me rëndesi kulturo – historike, ekonomike, tregtare etj.

Veçoritë hidrografike të liqenit të Shasit

Prej kohërave të vjetëra liqeni i Shasit i ka dhururar me bujari popullsisë vendase pasuritë e tijë.

Përpos plazheve dhe bregdetit, liqeni i Shasit përbën një potencial mjaftë të rëndesishëm për zhvillimin e turizmit në komunën e Ulqinit.

Liqeni, si potenciali më i rëndesishëm natyror në zonën e Anës së Malit është më origjinë tektonike i krijuar në kohën e pleistocenit[68].

Pas liqenit të Shkodrës, liqeni i Shasit është kriptodepresioni i dytë në Mal të Zi[69].Nga të gjitha anet liqeni rrethohet me kodra karstike ose siç i quajnë banoret vendas “male” si nga: mali i Brisë në JP dhe mali i Amullit dhe Shasit në VL me lartësi mbidetare 60-100 m. Malet e

[68] Dr. N. Draga – Shpalime Gjeografike – Art Club Ulqin 2001 faqe 155
[69] Po aty

lartpërmendura ndërtohen prej shkëmbinjëve gëlqeror dhe dolomite[70], në të cilët është zhvilluar një veprimtari karstike teper interesante, ndërsa baza ose tabani i liqenit është i ndërtuar nga materiale flishore[71] dhe për këtë arsye liqeni qëndron si objekt i përhershëm me ujë. Si rezultat i kushteve gjeologjike baseni i liqenit të Shasit paraqet pjesën më të ulët të gropës tektonike të sinklinalit të Klleznës. Në pjesën veriore ky sinklinal kufizohet më kodrat e Shasit, ndërsa në pjesë jugore më malin e Mozhurit dhe Brisë[72]. Liqeni ka një shtrirje juglindje – veripërendim e cila ka ndikuar edhe në nivelin jo të njëjtë të ujit në tërë sipërfaqen e liqenit, duke ngjasuar me liqenin e Shkodrës.

Foto 1 . Pamje nga liqeni i Shasit

Liqeni ka një sipërfaqe prej 3.6 km² kurse gjatë periudhës së reshjeve në dimër dhe pranverë sipërfaqja e tijë shkon deri në 5.3 km². Gjatësia e liqenit është 3210 m, kurse gjërësia varion nga 1150-1500 m. Thellesia në pjesën qëndrore të liqenit është 6.5 m kurse maksimalja arrin deri në 8 m dhe ndodhet në pjesën jugore të liqenit në gropen karstike (burimin karstik) te i ashtuquajturi Syri i Begut. Sipërfaqia e ujit të këtij liqeni

[70] Enciklopedija Jugoslavije – Zagreb 1982, str. 704
[71] Po aty
[72] Dr.N. Draga, Dž. Hodžić-Socio-ekonomska studija oblasti Šaskog jezera 2010, fq.2

është 1 m mbi nivelin e detit. Në bazë të këtyre të dhënave rezulton se liqeni i Shasit rënditet i dyti në Mal të Zi.

Nga kjo rezulton se pjesa më e madhe e mases ujore të këtij liqeni është nën nivelin e detit Adriatik. Gjatësia e vijës ujore të liqenit të Shasit është rreth 8.6 km[73], ku te bie në sy disa plazhe piktoreske me zhavor dhe me gjatesi të vogel të cilat janë mjaftë interesante për tu vizituar. Vija bregliqenore e këtij liqeni nuk është shumë e përthyer pasi vetë liqeni është zhvilluar në shkëputjen tektonike. Sasia e ujit në basenin e liqenit te Shasit varion nga 15 deri në 17 milion m3 dhe kjo sasi mund të ndryshoj në varsi të reshjeve që bien në këtë zonë[74]. Gjithashtu si pasojë e reshjeve të shiut shpeshëherë vjen deri të ndryshimi i vijes kufizuese dhe sipërfaqes së liqenit ku më e theksuar është në veri-përendim të tij ku vjen deri të përmbytja e Fushës së Klleznës (Fusha e Brisë) si dhe në drejtim të Bunës më te cilin liqeni ka lidhje të vazhdueshme hidrografike dhe tepër specifike. Kjo ka të bëj më ate se gjatë rritjes së nivelit të ujit në lumin Buna një sasi e ujit depërton në liqenin e Shasit, ndërsa kur Buna arrin në kuotat minimale uji nga liqeni i Shasit depërton në drejtim të lumit Buna.

Përmes kanalit me gjatësi 1800 m i cili nga banoret vendas njihet si "vija e Shnjergjit" liqeni i Shasit komunikon me lumin Buna. Pra ky kanal ka rol të dyfisht në varsi të regjimit të reshjeve. Liqeni i Shasit ka një numër të konsiderueshëm burimesh nënujore të cilët e furnizojnë. Këto burime ndryshe njhen edhe si kroje ku më të njohurit janë: Kroni i Brisë, Kroni Çamë, Kroni Mazrek, Syri i Begut etj. Gjithashtu liqeni furnizohet me ujë edhe nga lumi i Bunës dhe përroi i Klleznës (Megjureçit),[75] me një gjatësi rreth 21 km[76] si dhe nga reshjet e shiut të cilët kanë një sasi rreth 1300mm reshje në vit[77]. Niveli maksimal i ujit në liqenin e Shasit arrin në muajt janar-shkurt, ndërsa niveli minimal është në muajin e gushtit si pasojë e mungesës së reshjeve.

Regjimi i ujit në liqenin e Shasit parasëgjithash ndikon në vetit fizike dhe kimike kryesisht në tëmperaturën e ujit. Si rezultat i lartësis jo të madhe mbi nivelin e detit dhe pozitës gjeografike tëmperatura e ujit në

[73] Mr. N.Avdiu – Aspekte Gjeografike te zonës ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi – Punim mikroteze – Tiranë , 2006 faqe 16 (doreshkrim)

[74] Dr.N. Draga, Dž. Hodžić-Socio-ekonomska studija oblasti Šaskog jezera 2010, fq.1

[75] Mr. N.Avdiu – Aspekte Gjeografike te zonës ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi – Punim mikroteze – Tiranë , 2006 faqe 16 (doreshkrim)

[76] Prof.Dr. B. Radojičić – Geografija Crne Gore, Prirodana osnova, Nikšić 1996, fq. 141

[77] Dr.N. Draga, Dž. Hodžić-Socio-ekonomska studija oblasti Šaskog jezera 2010, fq.2

liqenin e Shasit gjatë verës arrin deri në 28°C duke qenë mjaft e përshtatshme për larje, ndërsa gjatë dimrit tëmperatura bie ndjeshëm[78]. Ngjyra e liqenit të Shasit është e gjelbërt në të mbyllët, ndërsa shiqueshmëria në këtë liqen arrin nga 1-2m[79].
Zonat karstike që rrethojnë liqenin e Shasit kanë një bimësi tipike mesdhetare ku spikasin makijet dhe bimësia gjethërënëse. Fushat të cilat shtrihen pranë këtij liqeni kanë një bimësi të kultivuar dhe në pjesën më të madhe të vitit përmbyten nga ujërat e liqenit duke krijuar një peizazh të mrekullueshëm dhe vend ideal për shpendët shtegtarë, tč cilët këtë liqen e përdorin si stacion të fundit gjatë rrugës për në brigjet e Afrikës.[80]
Në anën tjetër liqeni shërben edhe si vend i përshtashëm edhe për shumimin e peshqeve migrator të cilët vijnë nga lumi i Bunës si dhe vënd për ushqimin e shpendëve të ndryshëm. Në këtë liqen krahas shpendëve të ndryshëm her pas herë takohen edhe pelikanet. Për këtë arsye ky liqen ka një rëndësi ndërkombëtare dhe më të drejtë është cilësuar si zonë IBA (Important Bird Areas).

Biodiversitetit dhe mjedisi gjeografik i liqenit të Shasit dhe rendesia e tije

Vlerat natyrore të liqenit të Shasit nuk mund të kuptohen pa biodiversitetin e rrallë të bimësisë, florës dhe faunës .
Rajoni ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Shqipërisë në rastin tonë (zona midis liqeniet të Shkodrës dhe grykëderdhjes së Bunës duke përfshirë edhe liqenin e Shasit)) njihen nga ekspertë të ndryshëm si një nga zonat më vlera të pasura natyrore dhe mjedisore të cilat po të ruhen dhe shfrytëzohen siç duhet do të ndikojnë dukshëm në zhvillimin socio – ekonomik të kësaj zone .
Liqeni i Shasit është një ”kopje“ në miniatur e liqenit të Shkodrës që sëbashku më lumin dhe deltën e Bunës, kënetën e Fraskanjelit, liqenin e Zogajve, kriporen e Ulqinit etj, përbëjnë një kompleks habitatesh e biotopesh mjaft të favorshme për rritjen dhe zhvillimin e një larmie organizmash bimore dhe shtazore[81]. Kjo është rezultat i veprimit të

[78] Po aty
[79] Po aty
[80] V.M.Spasojević – Crnogorska jezera, Podgorica 2007, fq. 135
[81] Prostorni Plan Opštine Ulcinj – Ministarstvo održivog razvoja i turizma Crne Gore, 2013 fq. 134

shumë faktorëve të favorshëm gjeografikë, gjeologjikë, ekologjikë dhe limnologjikë. Për këtë arsye liqeni i Shasit është shpallur si zona EMERALD dhe RAMSAR, duke u bërë pjesë e programit "Natura 2000" i prezantuar nga Bashkimi Evropian[82].

Foto 2. Pamje nga pjesa jugore e liqenit te Shasit

Liqeni i Shasit karakterizohet nga një diversitet i lartë ekologjik e biologjik. Diversiteti i lartë ekologjik i këtij liqeni është i shprehur me një larmi habitatesh e biotopesh që ka bërë të mundur praninë e shumë llojeve bimore e shtazore disa prej të cilave janë të rrala ose të kërcënuara nga faktorë të ndryshëm si: klima, erozioni si dhe nga faktori antropologjik si më kryesori dhe më shqetësuesi.

Diversiteti biologjik i liqenit të Shasit përfshinë:

1. Diversitetin ekologjik ose shumëllojshmërinë e habitateve e biotopeve
2. Diversitetin e specieve ose shumëllojshmërinë e specieve dhe kafshëve në një hapësirë të vogël
3. Diversitetin gjenetik ose shumëllojshmërinë e niveleve më të ulëta se specia si subspeciet, varietetet, racat, format etj.

[82] Po aty

Ndërsa diversiteti ekologjik i liqenit të Shasit përfshinë:

1. Ujërat e hapura të liqenit të cilat shërbejnë si strehë dhe vend rritje e riprodhim për shumë organizma bimorë e shtazorë si: alga, bimë ujore, peshq, amfibë, shpendë etj.
2. Bimësia kryesisht në tërë gjatësinë e bregut të liqenit përbëhen nga kallamishte, zhavare etj, të cilat janë mjaftë të pasura me insekte, molusqe, gjarpërinj të ujit, breshka të ujit, disa lloje bretkosash etj.

Brigjet shkembore në pjesën veriore dhe jugore të liqenit të Shasit paraqesin interes për strehimin, ushqimin e polenizimin e disa kafshëve dhe shpendëve.

1. Në disa sektorë të këtij liqeni takohen edhe disa miniplazhe që mundë të shërbejnë për zhvillimin e turizmit.

Diversiteti floristik:

Flora e hapësirës e liqenit të Shasit është mjaftë e pasur dhe karakterizohet nga elementë mesdhetarë si dhe disa lloje algash etj. Fauna e liqenit të Shasit karakterizohet nga një shumëllojshmëri e lartë në një hapësirë shumë të vogël gjë që përbën një nga veçoritë kryesore të këtij liqeni. Në liqen rriten rreth 23 lloje peshqish prej të cilëve më së shumti rreth 11 lloje u përkasin familjeve të krapit , pastaj peshq migrator të ardhur nga deti si: qefulli i verës, qefulli i vjeshtës, ngjala etj, si dhe disa specie të introduktuara gjatë viteve 70 si: karasi, ballgjëri etj. Karakteristikë për këtë liqen është se peshqit migrator futen përmes kanalit të Shëngjergjit i cili lidhet më lumin e Bunës por si rezultat mospastrimit të këtij kanali gjatë 15 – 20 viteve të fundit numri i peshqve migratorë ka rënë ndjeshëm.

Në pellgun e liqenit te Shasit rriten edhe amfibë, zvarranikë (reptilë) si breshka e ujit, gjarpërinj, bolla, hardhuca, zhapinjë, breshka e tokës etj.

Pastaj mbi 240 lloje të ndryshme të shpendëve ujore ku një numër i madh i tyre janë dimëruese dhe numrin më të madhë tyre e përbëjnë: rosat, çafkat, karabullakët, zhytësit, bajzat, pelikanet si dhe shepka e pyllit e cila rritet në hapësirën për rreth liqenit dhe në zonat kodrinore etj

Në këtë mënyrë liqeni i Shasit shërben si stacion ornitologjik i veçantë në këtë hapësirë. Si rezultat i numrit të lartë të shpendëve në një hapësirë të vogël liqeni i Shasit sipas specialistëve i plotëson kushtet që të regjistrohet në listen ”Ramsar si zonë moçalike me rëndesi ndërkombëtare”.

Foto 3. Menyra e peshkimit të krapit me rrjetë në liqenin e Shasit

Foto 4 . Pamje nga shpendetë që rriten në liqen dhe në rrethinën e Shasit

Përsa i përket gjitarëve vetëm lundërza ose vidra jeton në ujra, ndërsa në brigjet e ujërave dhe përreth zonës së liqenit të Shasit takohen disa specie të tilla si: lepuri, dhelpra, derri i egër, ketri, çakalli, iriqi, lakuriqi natës etj.
Duhet theksuar se hapësira përreth liqenit të Shasit ekologjikisht është e pastër pasi në afërsi të këtij liqeni nuk ndodhet asnjë objekt industrial si dhe nuk ekzistojnë ndërtime urbane pranë këtij liqeni.
Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit të liqenit të Shasit kërkon një impenjim më të madhë të institucioneve lokale dhe qeveritare qe ne fokus te tyre kane mjedisin dhe mbrojtjen e tij si dhe të OJQ – ve dhe të komunitetit vendas . Në këtë zonë e nevojshme është vendosja e sinjalistikës përkatëse si në afërsi të liqenit të Shasit, pranë rrugeve regjionale dhe lokale më qëllim informimin e komunitetit për faunën dhe florën që rritet në liqenin e Shasit dhe në zonën përreth.

Mjedisi gjeografik i liqenit të Shasit

Liqeni i Shasit sëbashku më ambijentin për rreth paraqesin vlera të mëdha ekologjike, mjedisore dhe turistike, ndonëse këto vlera janë lanur pasdore duke mos pasur një studim të mirfilltë në aspektin gjeografiko-turistik.
Duhet theksuar se rezultatet e hulumtimeve shkencore me të cilat disponojmë mbi gjëndjen e ambijentit janë relativisht të pamjaftueshme, andaj mungon numri egzakt i treguesve për shumë elementë të ambijentit.
Nësë bëhet një veshtrim i shkurtër i gjëndjes së ambijentit në liqenin e Shasit si potenciali më i rëndesishëm turistik në këtë zonë, mundë të konstatojmë se për shkakë të mungesës se një industrie të zhvilluar dhe të grumbullimeve të medha të popullsisë gjendja e mjedisit në përgjithësi është e mirë, ekologjikisht është e pastër ku një rol këtu ka luajtur edhe komuniteti i kësaj zone i cili me “fanatizem” e ka ruajtur dhe mbrojtur ambijentin e liqenit te Shasit .
Duhet theksuar se në zonën fare pranë liqenit të Shasit ka ekzistuar e ashtuquajtura "Ekonomija ushtarake" ku në kompleksin e saj ka përfshirë rreth 82 ha, nga të cilat 4.4 ha ishin komplekset e shtallave për rritjen e bagëtive si: (viça, mushqerra, dëma etj), pjesa tjetër ishte tokë pune ku hapsiren më të madhe e zinin kulturat për ushqim të bagetive (jonxh, foragjere, miser etj).[83] Si rezultat i shpërbërjes së ushtrisë

[83] M.Haxhibrahimoviq – Mogucnosti unapredjenja ulcinjskog turizma, magistarski rad fq. 100

jugosllave gjatë viteve '90-të erdhi deri te shkatërrimi i këtij kompleksi. Tani më ky kompleks sëbashku më stallat që deri në fillim të viteve '90-të ishte ndotësi i vetem në këtë zonë nuk paraqet ndonjë rrezik për mjedisin gjeografik në hapsirën e liqenit të Shasit.

Përveç liqenit, si potenciale të rëndesishme natyrore për zhvillimin e turizmit në këtë zonë janë edhe peisazhet kodrinoro-malore qe e rrethojnë liqenin siç është mali i Shasit në të cilin është zhvilluar një veprimtari karstike tepër interesante dhe atraktive për turistët e huaj dhe ato vendas.

Gjithashtu edhe klima e shëndetshme dhe ajri i pastër në këtë mjedis e alternuar nga një bimësi e larmishme shkurresh mesdhetare e deri tek druret e lartë si dhe siperfaqet e shumta bujqësore ia rrisin më tepër vlerat turistike liqenit të Shasit në veçanti dhe zonës së Anës së Malit në përgjithësi.

Një rëndësi në rritjen e diversitet të theksuar të liqenit të Shasit padyshim që ndikojnë edhe monumentet nga e kaluara kulturo – historike si ” Qyteti i Vdekur “ i Shasit që ndodhet në afërsi të këtij liqeni. Prandaj kjo pasuri e madhe natyrore e biologjike dhe kulturo - historike me vlera shkencore, turistike, edukative, praktike, pejsazhore e rekreative duhet të ruhet dhe mbrohet me ligj të veçantë nga shteti. Shfrytëzimi racional i liqenit (valorizimi turistik) i tij do të ndikonte dukshëm në ngritje ekonomike të komplet zonës së Anës së Malit.

Literatura :

Prof.Dr. B. Radojičić – Geografija Crne Gore, Prirodna osnova, Nikšić 1996

V.M. Spasojević – Crnogorska jezera, Podgorica 2007

Dr Djordje Drecun, Ribolovna osnova Šaskog jezera, Titograd 1986

Dr Milos Perović, Bar i Ulcinj, Niksic 1988

Dr. N. Draga – Shpalime Gjeografike, ART CLUB – Ulqin 2001

Enciklopedija Jugoslavije, Zagreb 1982

Dr. N. Draga, Dž. Hodžić – Socio-ekonomska studija oblasti Saskog jezera

Dh.Dhora, F.Sokoli, Biodiversiteti i liqenit të Shkodrës, Shkodër 2000

M. Haxhibrahimoviq – Mogucnosti unapredjenja ulcinjskog turizma, magistarski rad

Prostorni Plan Opstine Ulcinj – Ministarstvo odrzivog razvoja i turizma Crne Gore, 2013

A.Klosi – Artikull per Shasin 365 kamabanat e Shasit

P.Qiriazi, G. Hoxha, B.Kola – Gjeografia 3, Tirane 2007

N. Avdiu – Aspekte Gjeografike te zones nderkufitare midis Shqiperise dhe Malit te Zi, punim mikroteze, Tirane 2006

N. Avdiu – Potencialet turistike te zones se Ulqinit, punim diplome, Tirane 1997

SOCIALE

Majlinda KURT
Psikologe klinike

DHUNA NUK KA ARSYETIM – REFUZO ABUZIMIN

Fëmijët dhe personaliteti që nisë formimin tek ata e më pas i karakterizon, janë produkt i punës dhe angazhimit jo vetëm i prindërve apo i familjes por edhe i shoqërisë në të cilën veprohet apo funksionojmë. Meqenëse akoma sot, ‘rrahjet konsiderohen mjet pedagogjik – mjet disciplinimi, në këtë mënyrë fëmijët jo rallëherë i ekspozohen dhunës. Ushtruesi më i shpeshtë i dhunës konkretisht – fizike (rrahje, mbytje, djegje, shtërngim) dhe asaj psikologjike (të bërtiturit, sharjet, mallkimet, përdorimi i nofkave fyese etj) në shtëpi, mendohet të jetë nëna, ndërsa ushtruesi më i ashpër është babai; ndërkaq në shkollë këtë e bën kryesisht mësuesi, sidomos në aspektin emocional (kërcënimi me notë të keqe, përjashtimi etj). Nuk janë aspak më pak ushtrues dhune rethi social gjegjësisht shoqëria. Pra, pikërisht ata nga të cilët pretendohet që fëmija të ndjejë siguri, mbrojtje e përkrahje, të njëjtit janë abuzuesit.

Nga kërkime, anketime – investigime të ndryshme, arrihet në konkluzionin që:

Ndëshkimi (trupor) është ende i ndikuar nga besimi se vajzat i bën “moralisht në rregull” kurse djemt i ben “më të fortë”.

Ekzistojnë edhe modele të tjera abuzimi, aspak më pak të rënda e të cilat njësoj mbartin mori pasojash postraumatike, janë: dhuna seksuale, neglizhimi, shfrytezimi i fëmijes, bullizmi e dhuna online.

Abuzimi ndaj fëmijëve, sipas koncepteve bashkëkohore, rezulton si forma më e rëndë e përjetimit të traumës që në fëmijëri.

Dhuna mund të krijojë një gamë të gjerë problemesh të shëndetit mendorë dhe është gabim të mendohet se, në raste konkrete- dhuna fizike sjell vetëm pasoja fizike. Dhuna ndaj fëmijëve është dhunim i të drejtave të tyre - pengon në zhvillimin e potencialit te plotë, mbart pasoja si: humbja e besimit, vetvlerësimi i ulët, rënie suksesi – rezultatesh e arritjesh, devijime të ndryshme në sjellje e vepra, te cilat mund të pasohen me delikuencë. Si pasojë e ushtrimit të dhunës, vjen deri tek një sërë çregullimesh:

- dëmtimi i kapacitetit kognjitiv (dëmtimi linguistik, ngecje në zhvillimin e trurit si rrjedhojë e mungesë të stimujve pozitiv) dhe rikuperimi është i vështirë. Pamundësia për të kultivuar kapacitetin pozitiv përbën dëm të rëndë e afatgjatë.

- dëmtimi i kapaciteteve fizike të vazhdueshëm apo psikoorganik (personat ndaj të cilëve është abuzuar, janë më të prirë për të vuajtur nga sëmundjet kronike në moshë madhore: probleme me zemrën, sëmundje të mushkërisë, mëlçisë, kanceri, obeziteti, hipertensioni, dijabeti. Ndërkaq, pasojat në periudhë më të afërt janë: azma, problemet e tretjes, dhimbje koke etj).

- PTSD - çregullimi i stresit post-traumatik (izolimi, problemet e shëndetit mendor - depresion, çrregullime të ankthit, çrregullimet e të ushqyerit e deri tek vdekja- vetvrasja.
  Një i ri i cili ka përjetuar dhunë në fëmijëri, pasohet nga të vuajturit e nga me së paku një çrregullim psikiatrik. Stresi nga dhuna mund të shfaqet edhe në formë akute e rrjedhimisht dëmtohet imuniteti dhe SN/sistemi nervor).

- Probleme tjera të sjelljes (abuzimi me substanca, përfshirja në aktivitete seksuale me rrezik të lartë etj.)

Mënyra se si ne komunikojmë me fëmijët është model të cilin ata do ta përdorin në bashkëveprim me të tjerët. Andaj, jemi ne adultët të cilët në raste abuzimesh, në formë indirekte apo direkte i ngarkojmë barrë të rëndë shoqërisë në kuadër të shëndetin publik sepse: fëmijët e "edukuar" me dhunë sot, për 10-20 vite do jenë përbërësit e shoqërisë së dhunshme, abuzuese, shoqëri jo e shëndoshtë. Si rrjedhojë, cungohen mundësitë e fëmijëve viktima për të kontribuar pozitivisht në shoqëri e kjo bën që mbarëvajtja e gjithë komunitetit të jetë e prekur nga dhuna. Dëmtimet serioze rrisin rrezikun për paaftësi të përhershme -krijohet një rreth vicioz (i egër, barbar, i rrezikshëm, pamëshirshëm).
Faktorë të ndryshëm çojnë në ushtrimin e dhunës, ndër ta: kriza ekonomike në familje, papunësia, problemet e shëndetit mendor, abuzimet me substanca etj.

Fëmijët janë objekt dhe subjekt i dhunës prandaj nuk duhet hezituar përpara seriozitetit që të kontribuohet në çdo mundësi parandalimi të ushtrimit të dhunës ndaj të miturve.
E drejtë e fëmijës është gëzimi dhe të jetuarit e përjetuarit e situatave sipas moshës të cilës i referohen - përkasin. Duhet luftuar rastet ku është i dukshëm probabiliteti i shkurtimit të mundësisë që fëmijët të arsimohen, nuk iu duhet shkurtuar mundësia e marrjes së kujdesit të duhur e domosdoshëm shëndetësorë, t'iu lejohet të argëtohen, ta përjetojnë ndjenjën e të qënurit i dashur, pranuar, vlerësuar, të mbrojtur nga çdo rrezik i mundshëm. Në një shoqëri që kërkon mirëqënie e zhvillim, është i domosdoshëm sigurimi i mjedisit të lirë pa abuzime.

Si të parandalohet keqtrajtimi i fëmijëve:

- informimi dhe ndërgjegjësimi mbi të drejtat e femijëve, luajnë rol të rëndësishëm.

E drejtë e fëmijëve është shkollimi, argëtimi, gëzimi, marrja e kujdesit të duhur shëndetësorë; t'i mbrojmë, vlerësojmë, të kujdesemi për ta.

Sigurimi i një mjedisi të lirë nga dhuna për fëmijët është avantazhi kryesor në çdo shoqëri e që kërkon progres dhe mirëqenie. Prindërit duhen pajisur me shprehitë e mirëfillta të prindërimit, alternativat e disciplinimit, njohuri në fushën e identifikimit a zbulimit në kohë të rastit të përfshirë nga ushtrimi i dhunës apo abuzimi.
Personat e rritur përgjegjës për fëmijën (prindi, birësuesi, kujdestari etj.) nuk duhet të bëjnë lëshime kur është fjala për kujdesin e duhur ndaj fëmijës dhe nevojave të tij si në aspektin fizik (sigurimi i ushqimit, veshjes, higjienës) ashtu edhe në aspektin emocional (të shprehurit e dashurisë dhe moslejimi i mungesës të të njëjtit emocion) si dhe në planin edukativ (fëmijët duhen shkolluar dhe nuk falet për asnjë arsye tendenca e moslejimit të arsimimit).
Duhet të kontribuohet në ndryshimin e përceptimeve të vjetra të edukimit me qëllim që të eliminohet të ushtruarit e dhunës. Duhet bëre progres drejt eliminimit të sajë ndaj fëmijëve dhe të vemë në praktikë mënyra më adekuate te disiplinës – këshillim.
Veprimet e dhunshme nuk ndihmojnë në edukim, përkundrazi, ndikojnë negativisht në sjelljet e individit. Dhuna nuk justifikohet.
Të qenurit prind kërkon përkushtim të madh e njëkohësisht është angazhim me orar të plotë e që zgjatë minimalisht tetëmbedhjetë vjetë.

Prandaj, duhet mobilizuar me kohë me njohuritë e nevojshme për një prindërim të suksesshëm e me mbështetje të mirë.
Njëmijë ditëshi i parë i jetës është me shumë rëndësi për zhvillimin e trurit tek fëmija. Sygjerohet t'iu sigurohet fëmijëve ajo për çfarë kanë më së shumti nevojë- dashuri dhe përkujdesje nga ana e familjes e edhe rethi #Çastet E Para Numërohen - UNICEF.
FËMIJET BËHEN AJO ÇFARË NE IU MËSOJMË – TRANSMETOJMË:
Nëse një fëmijë jeton me kritikën, ai do të mësojë për të gjykuar
Nëse një fëmijë jeton mes dhunës, mëson edhe vetë që të rrahë
Nëse një fëmijë jeton mes frikës, mëson të jetë i shqetësuar
Nëse një fëmijë jeton me keqardhjen, mëson t'a ngushëlloj veten
Nëse një fëmijë jeton me tallje, mëson të jetë i turpshëm
Nëse një fëmijë jeton me xhelozine, ai mëson se çfarë është zilia
Nëse një fëmijë jeton me turpin, mëson të ndihet fajtorë
Nëse një fëmijë jeton në inkurajim, njeh vetë-besimin
Nëse një fëmijë jeton me tolerancë, mëson te njohë durimin
Nëse një fëmijë jeton me falënderim, mëson të vlerësojë
Nëse një fëmijë në jetë është i pranuar, mëson dashurinë
Nëse një fëmijë jeton me miratimin, mëson të dojë vetveten
Nëse një fëmijë jeton me njohjen, mëson sa është e mirë që të keshë një qëllim
Nëse një fëmijë në jetë mëson të ndajë (gjërat, sendet), kështu njeh bujarinë
Nëse një fëmijë bashkëjeton me ndershmërinë dhe drejtësinë,mëson për të vërtetën dhe drejtësinë
Nëse një fëmijë jeton me miqësi mëson se bota është një vend ku jetohet këndshëm
Nëse jetoni me paqe, fëmija juaj do të jetojë në paqe

© **Doroty Law Nolte**

EDUKOJINI DREJTË FËMIJËT: me fëmijët duhen përdorur fjalë nga të cilat ata nënkuptojnë pritshmëritë tuaja si prind. Ruajeni kontrollin dhe qëndroni të vetëdijshëm përpara problemeve personale në mënyrë që (si pa dashje) të mos i transmetoni edhe tek femijet tuaj. Qëndroni objektiv dhe jepini rëndësinë që i takon secilit problem, incident apo sjelljes.

PËRPIQUNI TË BËNI ALEANCË E JO TË KRITIKONI: Asnjëri nuk është i përsosur, kështu që as prindërit nuk duhen pretenduar që fëmijët të jenë të përsosur. Pranojini gabimet e tyre si mundësi prej të cilave do të mësojnë dicka –shifini si mundësi progresi. Fëmija duhet të jetë i përqëndruar në mënyrë që të kuptojë atë se çfarë i flisni në rastet kur kërkoni që të kryejnë një detyrë apo në rastet kur i'u përcillni ndonjë informacion.

KOMUNIKONI – jini transparent
DINI TË BËNI DALLIMIN MES DENIMIT DHE DISCIPLINIMIT: Si forma të kontrollit të sjelljes, dënimi nga disciplina kanë dallime të mëdha.
Le të zgjidhim e jo të vetkrijojmë konflikte. Çdo fëmijë meriton të rritet i lirë nga dhuna, neglizhenca dhe shfrytëzimi. Ne e kemi për detyrë që kjo e drejtë të respektohet. Dhuna ndaj fëmijëve është KRIM, dhe raportimi i saj një detyrë. Të përmiresojmë sistemet e mbrojtjes nga abuzimet, të avancojmë shërbimet e mbështetjes në përgjithësi.

Vlerëvsojuani përpjekjet. Ofrojuni ndihmë dhe mbështetje. Inkurajojini të jenë kompetent, lërini të sillen sipas moshës së tyre, trajtojini gabimet si të nevojshme për të realizuar procesin e të nxënit/mesuarit, lavdërojini për çdo sukses të arritur.

Le të shëndërrohemi nga shoqëria që toleron dhunën në shoqërinë e njerëzimit të vërtetë e jodhunues. Prindërit t'i bashkangjiten profesionistëve me qëllim kërkimi të zgjidhjeve të cilat do të mundësojnë edhe atyre edhe fëmijëve të rriten së bashku. #UNICEF

-Materiali, pjesërisht është bazuar në kërkime studimore brenda shtetit të Malit të Zi si dhe rajoni (Shqipëri, Kosovë, Serbi), nga ana e profesionistëve të shkencave sociale të cilët profesionin e vet e ushtrojnë kryesisht në shëndetësi dhe arsim. Nuk duhet lënë pa përmendur shoqatën e psikologëve në Mal të Zi e cila në bashkëpunim me UNICEF dhe shoqatën e prindërve, nën moton END VIOLENCE - punojnë në drejtim parandalimi të dhunës ndaj të miturve në mbarë shtetin tonë.

Arlinda SUKALIQI

KËSHILLA TË ARTA PËR TË RRITUR FËMIJË TË EDUKUAR

Mos prisni që fëmija juaj të edukohet vetë, jepeni atij shembullin më të mirë dhe mësojeni rregullat mbi të cilat funksionon kjo botë, sepse vetëm kështu do të rritet siç doni ju, i lumtur dhe i shëndetshëm në të gjitha aspektet.
Nuk është çudi përse shumë prindër ndihen konfuz rreth mënyrës se si të vendosin rregullat, si të aplikojnë pasojat, si të disiplinojnë fëmijët e tyre siç duhet, pa qenë as të ashpër dhe as tolerant më tepër se duhet.
Shpesh herë psikologë të shumtë këshillojnë të ndiqen disa "të verteta të thjeshta", të cilat përbëhen nga një grup i vogël udhëzimesh që duhet mbajtur mend e të cilat duhet ndjekur.

Mënyra se si prindërit sillen me fëmijet e tyre ndikon shumë në raportet që ata krijojnë më pas me shoqërinë.
Për të qenë në rregull me ndërgjegjen tuaj prondërore dhe të jeni një model sipas të cilit fëmija do të rritet ja disa këshilla që duhet ndjekur e aplikuar për të arritur atë që secili prind dëshiron për fëmijën e tij pra më të mirën:

1. Tregohuni i vëmëndshem me imazhin tuaj në sytë e tyre, nese doni që fëmija juaj mos të përseris të njëjtat gabime.
2. Tregoni me shembull nga vetja virtytet që duhet të marrë fëmija juaj.
3. Mos prisni nga fëmija që nuk e keni as ju.
4. Vendosni rregullat stabel dhe aplikoni pasojat kur fëmija juaj zgjedh që të mos u bindet rregullave.
5. Mbani parasysh se fëmijet nuk kanë lindur të pasjellshëm, ziliqar, mospërfillës, egoist etj.
6. Filloni ndryshimet pozitive duke dhënë shembullin për sjellje dhe vlera që dëshironi t'i shihni tek fëmija juaj.

Nëse deri diku ndiqni rregullat e përmendura më lartë, ju do jeni personi në të cilin fëmija mund ti besoj.
Ju kështu do merrni respektin dhe admirimin e tij. Ju do jeni modeli më i mirë i tij, një mësues dhe një hero. Duke ju parë ju ai thith çdo gjë që ju bëni.

Nëse bëjme një rezyme të përgjithshme të asaj të cilës u tha më lartë do të kuptojmë se thelbësorja e asaj se si rritet një fëmijë më mirë, do shohim se ndoshta numër një është thënja e famshme "merru me fëmijët" - çka nënkupton se ky është thelbi i të gjithave.
Kaloni kohë rregullisht me fëmijet tuaj, bëjuni pytje të hapura për veten, për mënyrën se si e shohin botën, dhe ndëgjoni më vëmendje përgjigjet e tyre.
Një këshillë tjetër jo më pak e rëndesishme është të qenit i dashur dhe i sjellshëm dhe kjo të thuhet me zë të lartë nëse duhet.
Të jesh mirënjohes dhe të japesh ndihmë poashtu është një veçori ose virtyt e cila ndikon pozitivisht në rritjen e mirë të tyre sepse njerëzit që e bëjnë zakon shprehjen e mirënjohjës kanë më shumë gjasa të jenë bujar, ndihmues, e të jenë më të lumtur e më të shëndetshem.

Të rritësh një fëmijë me të gjith këto virtyte ose cilësi ndonjëherë duket e vështirë, por nuk është diçka që secili prej nesh nuk mund ta bëj ose ta arrij. Asnjë punë tjetër nuk është më e rëndësishme apo më shpërblyese, prandaj prind të dashur mos i zhgënjeni ata.

TRADITË

Gazmend ÇITAKU

DETARIA E ULQINIT

Përmes dokumentave të paraqitura në Fotoalbumin e Ulqint të përgatitur nga Gazmend Çitaku

Pa dyshim se Ulqini si vend i lashtë bregdetar fillet dëshmuese qytetëruese të saja tërheqin që nga neoliti. Kur e them këtë dëshiroj të ju përafroj me gjetjet që janë bërë në Kalanë e Ulqinit e dëshmia më e mirë dhe më e fortë e kësaj periudhe është edhe fragmenti i figurës *Nëna e madhe*[84] e që është karakteristikë e kohës parailire apo më mirë të themi neolitit[85]. Kjo periudhë (6000 vjet p.e.re.) karakterizohet me zbutjen e kafshëve, fillimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore, peshkimin por edhe me përpunimin më fin të veglave të punës e që ishin prej guri traditë kjo e shërbimit me vegla guri të përpunuara vazhdon edhe në kohën e bronzit ku në hapsirën e komunës së Ulqinit kemi gjetje të veglave të tilla.[86]

Nëna e madhe, figurë parailire e kohës

Çekiç guri, i periudhës neolitike gjetur në fshatin Krythë të Ulqinit

[84] Pavle Mijović, Umjetničko blago Crne Gore, Beograd 1980, fig.27
[85] Aleksandar Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë 1990, fq. 430
[86] Banesa Popullore e Anës së Malit, Ulqin, 2016, fq. 24

së Neolitit gjetur në Kalanë e Ulqinit

Është shumë me rëndësi që të qartësohemi se Ulqini si vendbanim ka qenë gjithmonë këtu dhe se është i themeluar nga popullsia vendase. Gjetjet e murit ciklopik që datojnë nga shek. VI-V p.e.re., dëshmojnë praninë e etnicitetit ilir kurse në kronikat antike përmenden edhe periudha parailire si *Veccio Olcini* apo diçka e ngjashme. Falë pasurive natyrore, pozitës së përshtatshme gjeostrategjike dhe klimatike bëri që Ulqini në periudha të ndryshme kohore të pranojë në gjirin e vet edhe kolonistë nga vendet tjera si helenë, romakë e pse mos të themi edhe dalmatë. Këto kultura më së miri shihen në laramaninë e gjetjeve që nga *Nëna e Madhe, Murit Ciklopik, Altarit të Artemidës, Stemave të ndryshme familjare mesjetare, Altarëve hebre etj.*

Altari i Artemidës, shek. V p.e.re gjendet në Muzeun e Ulqinit

Kupa skyphos e stilit antik me figura të zeza në bazën e bardhë. Lartësia 7,2cm, gjerësia 12,6cm. Shek. V p.e.re gjendet në Muzeun e Sarajevës

Murit Ciklopik në Kalanë e Ulqinit, shek. VI-V p.e.re.

Perëndesha Atina gjetur në një gemë në Kalanë e Ulqinit, shek. V p.e.re.

Jeta pranë detit, ka bërë që këta banorë burim kryesor jetësor ta kenë detin dhe kulturat që mund të vilen nga ai si peshkimi, lundrimi, tregtia nganjëherë edhe piratëria. Se fiset ilire e me ta edhe ilirët-ulqinakë kanë njohur shumë mirë lundrimin dhe anijendërtimtarinë me të drejtë konkludon Stipçeviqi kur thotë se ilirët nuk morën as nga grekët por as nga romakët anijendërtimtarinë dhe lundrimin pasiqë ata kaherë e kishin zotëruar këtë veprimtari dhe se ishin të njohura Liburnat apo Lembet ilire të cilat me shumë sukses kopjohen nga romakët dhe futen në flotën ushtarake romake me po të njejtin emër Liburna. Nuk kemi dëshmi për faktin se a i quanin romakët të gjitha mjetet lundruese ilire me një emër apo (unë mendoj se po) ilirët kishin edhe anije të formave dhe madhësive të ndryshme.
Për, formën e tyre nuk kemi ndonjë të dhënë të detajuar dhe të saktë përveç atyre pamjeve të anijeve që gjenden nëpër monedhat ilire të Daorsëve, Mbretit Gent apo edhe të Scodrit dhe Lissosit.[87]

Vlen të theksohet se nuk ka dijeni për ngjashmërinë e anijeve që ndërtoheshin në bazenin e Neretvës (fisi ilir i Daorsëve) dhe atyre të Liburnave. A ishin të ngjashme apo të ndryshme nuk kemi të dhëna, por çka na shtyn të konkludojmë është ajo se brigjet e Adriatikut lindor, pra, aty ku jetonin ilirët edhe sot është, por edhe në shekujt e kaluar ka qenë, e shprehur anijendërtimtaria dhe anije të tipeve të ndryshme janë treguar mjaftë të suksesshme për lundrim.
Dikur edhe në Ulqin ka ekzistuar kantieri për ndërtimin e anijeve madje në periudha të ndryshme kohore, historianë të ndryshëm Ulqinin e identifikojnë si vend i cili kishte një numër të konsiderueshëm mjetesh

[87] A. Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë 1990, fq. 217

lundrimi e që nganjëherë ky numër edhe mund të ketë qenë mbi 250 mjete lundruese.[88]

Se Ulqini ka histori të bujshme detare nuk ka dyshim, pasiqë në të gjitha periudhat kohore Ulqini si qytet apo qytetarët e saj lojal pushteteve të kohës, merr apo marrin pjesë në beteja të ndryshme detare duke filluar që nga Lufta e Parë Iliro-Romake, Beteja e Lepantit (ulqinakët marrin pjesë në të dyja krahët luftuese)[89], Lufta Veneto-Osmane (1714-1718), pastaj kemi nga tradita gojore këngë mbi heroizmat e detarëve ulqinakë si ajo e Lika Cenit[90], Hysen Reizin[91], Haxhi Alisë etj.



"Urshaja e Detit" e Ismajl Becit

Ulqinakët duke i lidhur gjuha por edhe kombi historikisht kanë anuar dhe kanë mbajtur lidhje të ngjeshura kulturore me portet shqiptare kurse lidhje tregtare kanë mbajtur me Raguzën, Kotorin, Venedikun, Stambollin, Tarabulluzin, Aleksandrinë etj. Andaj edhe lidhjet familjare të ulqinakëve janë shumë të ngushta me Durrësin, Shkodrën. Familjen ulqinake psh. *Bilali* e hasim si në Ulqin, ashtu në Shkodër por edhe në Durrës. Ashtu edhe familjet Shurdha, Fani, Lazoja, Kapidani, Truma etj.

[88] Maksut Xh. Haxhibrahimi, Detaria e ulqinit nëpër shekuj, Ulqin 1994, fq. 89
[89] Noel Malcolm, Agjentët perandorak, Tiranë 2016, fq.
[90] Dr. Bahri Brisku, Gjurmime shqiptare, Tiranë 1994, fq. 130
[91] Po aty, fq.136



Familje zezake ulqinake (Shurdha)

Mua gjithmonë më kanë imresionuar tregimet mbi detin e veçanërisht përjetimet në kaltërsinë e detit dhe kjo ishte shtyesja kryesore që atëherë, pra në vitin 1999 të filloj edhe unë avneturën e eksplorimit të traditës detare ulqinake. Duke filluar me një rubrikë modeste në gazetën *KRONIKA* të quajtur *Mbledhim fotografi të vjetra të Ulqinit*, kjo iniciativë u bë shtysë kryesore që ngadalë ulqinakët të hapin arkat dhe në dritën e diellit të nxjerrin fotografi, dokumente, matriklla dhe llojlloj dëshmie për traditën e tyre lundruese, por jo vetëm.

Abdullah Ishmi (1867-1950)

Për një kohë të shkurtër fondi filloi të pasurohet aq shumë saqë në një moment vendosa të bëj një ekspozitë me fotografi dokumentare të Ulqinit pasi që dëshiroja që këtë sukses ta ndaja me bashkëqytetar dhe kjo u quajt *Ulqini dje dhe sot*, u mbajt në ambientet e Bibliotekës së qytetit në fillim të vitit 2002 dhe ishte një ngjarje kulturore deri atëherë e paparë dhe më e vizituara. Nga kjo ekspozitë u deshën vetëm 6 muaj e që fondi i dokumentacionit detar të dyfishohet dhe kjo bëri që të organizohet po më 2002 (pas 6 muajsh) ekspozita e dytë e quajtur *DETARIA E ULQINIT* komplet me fotografi, dokumente e dëshmi totalisht deri atëherë të panjohura për opinionin. Edhe kjo ekspozitë ishte ngjarje kulmore kulturore por që nga asnjë pushtet lokal nuk u njoft dhe as nuk u

përkrah në drejtim që nga këto iniciativa të lind diçka më serioze e pse jo një MUZE DETAR i Ulqinit.

Selim Shurdha, kapidan anije "Gloria" (1860-1954)

Traditën e lavdishme detare të Ulqinit e kam paraqitur në një monografi të tkurrur të quajtur *FOTOALBUMI I ULQINIT* ku për herë të parë dokumentohen anijet ulqinake, pronarët e tyre, çertifikatat për lundrim, dekoratat dhe lëvadatat për shkathtësitë e treguara etj. Për herë të parë prezantohet me fotografi kapidan Selim Shurdha, djali i tij, poashtu kapidan, Shabani, velanija e tyre Gloria, mariklla e Selim Shurdhës etj. Po ashtu të kompletuar me dëshmi paraqiten edhe Jakup Nimanbegu, Adem Tivari por edhe të tjerët.

Tani çdo gjë ishte më e lehtë, vizitat e ngrohta në familjet ulqinake i bëja me shkrimtarin për fëmijë Hajro Ulqinku ku ai traditën detare të familjes së vizituar e paraqiste me një artikull gazetaresk kurse unë me syrin artistik mundohesha të nxjerri në dritë ato që ishin më interesantet nga moria e dokumenteve. Duke falendëruar mikpritjen ulqinake u bë e mundëshme që Hajroja të bëj një cikël artikujsh për kapidanë, detarë, peshkatarë të cilët i përmblodhi në disa libra publicistikë kurse unë nxorra 2 monografi me fotografi dokumentare të cilat janë pasuri si për familjet ulqinake ashtu edhe për Ulqinin si qytet, Malin e Zi dhe mbarë kulturën shqiptare. Fotografitë dhe dokumentet me shumë kujdes i merrja i skanoja dhe ashtu të padëmtuara ua ktheja pronarëve të tyre legjitimmadje në shpenzime të veta ndonjë gjë që kishte shumë vlerë ua zmadhoja në mënyrë që ta ekspozojnë për më gjatë. Sot fondi im i fotografive dokumentare përbëhet prej një numri të konsiderueshëm të fotografive origjinaleve dhe kopjeve të cilat më kanë dhënë familjet ulqinake por kam edhe aso që i kam gjet nëpër hulumtimet e mia që kam ndërmarrë në periudha të ndryshme kohore nëpër arkivet e ndryshme duke filluar nga ato private në Ulqin, pastaj Shkodër, Tiranë, Dubrovnik madje një hartë të cilën kopjen edhe ia kam falur muzeut më ka ardhë nga Arkivi i qytetit të Frankfurtit (Gjermani). Me një fjalë mbledhja e dokumentacionit, kërkon sakrificë, kohë, dije e mbi të gjitha mjete materiale.

Detaria është një gërshëtim i shumë njohurive, të jesh detar i mirë duhesh të jeshë së pari i diciplinuar, guximtar, të njohësh detin, erërat, orientimin e ulqinakët i kishin dhe i kanë të gjitha këto tipare. Detaria nënkupton jo vetëm lundrim e peshkim por edhe ndërtimin, riparimin e anijeve. Prapë ulqinakët i kishin këto veti. Sot për fat të keq ndërtimin e anijeve e ushtrojnë më tepër si hobi për kohë të lirë e veçojmë Xhefko Kas'hoxhën, Adem Nimanbegun etj., të cilët e mbajnë të gjallë këtë trashëgimi.

Velanija "Mashala Sulejmanie", e Adem I Tivarit

Apeloj, në organet kompetente që sot kështë koha e fundit që të bëjmë diçka më shumë në zbulimin dhe prezantimin e trashëgimisë tonë detare. Të merret iniciativa për grumbullimin e gjësendeve për hapjen sa më të menjëhershme të një Muzeu Detar në Ulqin.

Kjo kumtesë u lexua në takimin për Detarinë e Ulqinit, organizuar nga Muzeu i Ulqinit më 03.05.2017

Muhamet NIKA

GJURMË LASHTËSIE NË DASMËN E ANËS SË MALIT

S'ka dyshim se njëri ndër faktorët që historikisht kushtëzoi zhvillimin dhe konstituivin e vlerave shpirtërore, është, akti i martesës, si moment me rëndësi në jetën e njeriut. Vetë karakteri i aktit, si dëshirë dhe nevojë për vazhdimin e jetës, kushtëzoi krijimin dhe zhvillimin e një sërë ritesh që lidheshin me besëtytnitë e periudhave të ndryshme historike, duke pasur një qëllim mbrojtëse nga fuqitë e dukshme dhe të pa dukshme natyrore e mbinatyrore. Gjykimi racional i historikut të tyre ofron mundësinë e konstituivit të vlerave njerëzore dhe të rindërtimit logjik të traditës së popullit, pasi që akti i martesës si dhe ritët që e shoqërojnë atë, s'janë gjë tjetër, por pasqyrim i të së kaluarës së popullit.

Me plotë gojë mund të themi se ky akt është më i vjetëri që shoqëroi natyrën e njeriut dhe mu këtu qëndron specifikimi i riteve dhe i rregullave martesore, të cilat duke pasur një specifikë të tillë mbijetuan nga lashtësia duke ngërthyer në vete elemente të lashta pagane. Vështrimi i tyre në planin horizontal dhe në planin vertikal, nxjerr në pah llojllojshmërinë dhe konvergjencat e tyre në hapësira të ndryshme shqipfolëse. Këtë përveç tjerash e konstaton edhe Abaz Dojaka.[92]

Duhet thënë se Ana e Malit është një tërësi etnologjike, etnografike e gjeografike dhe historike, që lidhë dy qytetet Shkodër e Ulqin, duke paraqitur kështu një pjesë të veçantë të basenit etnokulturor të nën Shkodrës i cili veçohet për zhvillim të bujshëm të formave etno-kulturore shpirtërore dhe andaj ka paraqitur një rezervat të pa eksploruar kulturor. Nëpër këtë trevë kalonin të gjitha rrugët e antikitetit, që lidhën qytetet Shkodër e Ulqin, me pjesët e tjera të botës. Andaj, e gjithë kjo lehtë jep për të kuptuar se edhe ritet martesore në strukturën e tyre janë të ngjashme me të përgjithshmen kulturore dhe me të veçantën kombëtare. Por në këtë larushi, hetohen mjaftë bukur edhe format burimore të dasmës Anamalas.

Gjatë këtyre riteve hetojmë se, organizimi ritmik i gjuhës, zërit, intonacionit, tempit dhe efektit gjestikulativetj, si forma shprehëse emocionale te shikuesi, zgjojnë kureshtje dhe interesim, por gjithnjë

[92] Abaz Dojaka, Ceremoniali i dasmës shqiptare, Etnografi shqiptare, Tiranë, 1979

duke i mundësuar atij përvetësim të kuptueshëm të porosive semantike. Përmes këtyre elementeve njeriu u jep kuptim të dëshiruar riteve të dasmës.

Riti martesor i gjarprit

Ky rit është gjithë njerëzor dhe pothuajse gjithëkulturor, me shtresat e veta historike e parahistorike. Por gjithsesi në rastin konkret, ka gjasa të përputhet me kultin kompleks pagan të para ardhësve ilir.[93]

Kulti i gjarprit përveç si rrëshqanor totemi, apo si roje e shtëpisë dhe e fisit; kujto legjendën e para ardhësit të largët të legjenda greke dhe domethënien e emrit parahistorik illyrjo- num duke e lidhë atë me bindjen se iliri ishte i lindur nga gjarpri..., ky zvarranik ka edhe disa fuqi magjike mbrojtëse të nuses nga syri i keq, apo nga fuqitë magjike.

Kështu besohet se gjarpri, duke qenë se ishte i pari i gjithë shtëpisë dhe fisit, ai mund ta mbrojë nusen, në se, mbytet dhe nëse dhembet e tij, mbështilleshin në një pece, dhe i mbante nusja një kohë të gjatë si nuskë për qafë- hajmali. Gjarpri që sakrifikohej do të duhej, të ishte i mbytur diku në fushë në mes të dy Shëngjergjave. Ky rit, ka lidhje direket me besimin e hershëm ilir, të cilët për tu mbrojtur nga magjitë, apo nga syri i lig, si masë preventive mbrojtëse, në hajmalitë e veta varnin për qafë dhëmbët e kafshëve të egra.[94]

Ngjashëm me këtë rit duket se është edhe ceremonia e mbytjes së gjarprit, te riti i thirrjes së shiut në Drenicë e Potgur. Me këtë rast, barinjtë e trevës, për të siguruar rënien e shiut, praktikojnë të mbysin një gjarpër dhe ta vënë atë në murriz. Me këtë masë ata janë të bindur se shiu do të bjerë shumë shpejt.[95]

Dukuria, nga studiuesi Ukë Xhema, është shpjeguar si akt i flijimit të paraardhësit të largët. Pa marrë, para sysh se është fjala për rite të kundërta nuk është vështirë për të kuptuar se kanë lidhje të njëjtë të largët.

Besimi në gjarpër, ruhet edhe të malazezët, çfarë tregon se etnogjenezën këta popuj e kanë shumë të përafërt ose të përafërt fare, mbase ata pas dyndjes sllave u asimiluan e më parë ishin shqiptarë – ilirë... Ritet, zakonet, dhe mënyra e jetesës, dihet se janë norma të cilat asimilohen, më vonë se gjuha e një populli, ose nuk asimilohen fare. Nga shumë zakone popullore të ngjashme ndër këto popuj, nga leksiku

---

[93] Aleksanër Stipçeviq, Ilirët, Historia, jeta, kultura, Prishtinë, 1980, f. 192

[94] Po aty,f. 192

[95] Ukë Xhemaj, Riti i "thirrjes" së shiut dhe riti i "ndaljes" së breshërit, Gjurmime albanologjike - Seria folklor dhe etnologji, nr. 15,Prishtinë, 1985, f. 33

gjuhësor dhe mentaliteti i tyre, veçoj fjalën vatra (zjarr), e nga adetet vajtimet e të vdekurit nga malësoret e këtyre dy popujve.. Diçka të tillë në të dy rastet e veçuara, nuk i kanë serbët, si popull fqinj. Kështu, fjala bie, serbët, zjarrit, nuk i thonë si malazezët, vatra, qe ka për konkordancë fjalën shqipe votra, por atij i thonë oganj dhe nuk i kanë të njohura këngët e vajtimit të burrave "Lelekanje", besimin në gjarpër ose këndimin e këngëve kreshnike me lahutë...

Simbolika e numrit tre* tri herë...

Simbolika magjike mrekullibërëse e të pështynës, tri herë të nuses, është një diçka që ndeshët si simbol në të gjithë simbolikën shqiptare. Me këtë rit mendohet se nusja largon fuqitë djallëzore që mund ta kenë zili atë. Po kur ndërmerret, nga nusja kjo masë mbrojtëse.?! Kjo masë mbrojtëse, nga nusja, ndërmerret kur vijnë krushqit në oborret shtëpisë së saj, për ta çuar në shtëpinë e dhëndrit.. Kur ndodh ardhja e krushqve..., nusja shqipton tri herë në vete vargjet rituale: ***ikni sorra, ikni shtriga/ vjen sadetja gjeraqina/ lumos hashi ju mos pishi / për mas mejet ju u grishi/ unë hanë e hyri / ju zi si kusi...***

Tematika e vargjeve është e qartë... Nusja shpreh dëshirën të fitojë mbi ta si gjeraqinë, dhe duke thirr hënën në mbrojtje, si perëndi ilire e nusërisë, shpreson që shkëlqimi i saj të bartet në te, kurse te krushqit, të bartet e zeza e kusisë?! Për të qenë sa më çudibërëse formula, nusja duhet para dhe pas shqiptimit të vargjeve ti pështyjë tri herë në vete, krushqit, pa u hetuar nga askush. Përmendim se me pështyrë, 3 herë, në të djathtë e në të mëngjër, sipas besimit të krahut, sigurohej largimi i shejtanit?!!

Shikuar, fenomenin e përdorimit simbolik të numrit 3, nga këndi historik, të aspektit krahasues, vërejmë se çështja lidhet, me vjetërsinë e numrit, të popujt e vjetër indoevropian... Çabej vëren, se: "Të popujt e shkallës së vjetër,dallojmë 3 numra: njëjësi, shumësi dhe duali.., gjithnjë sipas tij..." Çështja e shumsit, te popujt homerik, krijon konfuzion të plotë, ata nuk dinë të numërojnë mbi tre?! Kështu ngjet anë e kënd botës, të shumë, popuj primitivë.., andej nga tokat e zjarrta, janë aq primitivë, sa numërojnë deri në 3,..., nuk dinë të numërojnë më shumë, nuk kanë numrat, 5, 6, 7..., Kjo simbolikë si duket ka të bëjë me shkallën e ulët të zhvillimit të shoqerisë.5.

Elemente të lashta pagane ruan edhe adeti i sjelljes tri herë të nuses rreth fronit në shtëpinë e dhëndrit nga përcjellësi më i moshuar i fisit. Pas kësaj, ai i vë tri herë mbi kokë kësulën e tij. Vetëdija e të sjellurit

tri herë rreth fronit, ka për qëllim ti lus perënditë e vatrës se re, që anëtarin e ri të familjes ta pranojnë qetë dhe bukur, - pa shqetësim, kur se vënia e kësulës mbi kokë, lidhet me dëshirën që nusja të lindë djem... Sjellja rreth fronit, 3 herë, ka shpjegim me praktikën religjioze të sjelljes rreth fronit hyjnorë që bënë profetët, Ibrahim dhe Ismail në Qabe të urdhëruar nga Zoti..., e me këtë emitohet sjellja e melekve rreth fronit (në qiell..). Dallimi qëndron në atë se, të sjellurit rreth Qabes, nuk mbaron me 3 herë por duhet 7 herë, e kjo lidhet me simbolikën e numrit 7 të popujt Simit..., 7-shi ndër ta paraqet shumësin... kështu thuhet, psh. 7 qiej 7 toka, në kuptimin shumë qiej shumë toka.... Po kështu rri puna edhe në Indi, ku nusja duhet të sillet tri herë rreth zjarrit në shtëpinë e dhëndrit.

Riti i vënies së këmbës mbi babune dhe thyerja e pasqyres

Për nga qëllimi i saj me vlera interesante del edhe rregulla e vënies së këmbës mbi babune (karroqe) - masë drithi, si dhe akti i thyerjes së pasqyrues nga nusja me këmbën e saj të djathtë... Pasqyra, vihet mbi babune, në prag të shtëpisë së dhëndërit. Riti duket se është tepër i lashtë sepe ndeshët qoftë te shqiptarët e ritit mysliman, qoftë të shqiptarët e ritit katolikë. Ky rit, ndeshet edhe në trevat për rreth, deri në Ljare e Shestan, duke u bërë kështu, pjesë e trashëgimisë të bazenit kulturor të popullsisë për rreth malit të Rumisë?!

Vetë babunia si masë drithi simbolizon dëshirën e shtimit të bereqetit, që duhet të sjellë nusja në shtëpinë e re. Akti përcakton gjithashtu, funksionin utilitar të tijin,si dhe dëshirën e shtimit të krahëve të punës, që mendohet të sigurohet përmes vënies së këmbës mbi babune dhe vënies së kësulës në kokë të nusës si dëshir për të lindur djem... Vënia e kësulës, zakonisht bëhet, nga xhaxhai i saj që e përcjellë ate deri në shtëpi të nusës,ose nga një i moshuar i fisit.

Ndërsa, interesant duket se është edhe thyerja e pasqyrës, e cila është si mjet hipnotizimit dhe i bërjes së magjisë.

Thyerja e pasqyrës mposhtë të gjitha të ligat që vijnë nga zgjatimi i fytyrës së nuses nga shikimi në te, ky shikim që i ndodh nuses, din të jetë i rrezikshëm sepse fytyra e saj e vajzërisë me rrobat e nusërisë, bëjnë që ajo të ndryshojë si dita me natë në dukjen vizuale të saj... Kështu, besohet se pas shikimit në pasqyrë, pasi të jetë bërë nuse, mund të jetë e rrezikshme, sepse din të krijojë mpirjen e gjatë të sajën pas objekti të pasqyres... Kjo mendësi duket se është përvojë e ngurosur në popull, por si do që të jetë puna, kemi të bëjmë me rit produktiv magjik të paramenduar nga njeriu i thjeshtë.

Megjithatë, populli thotë "Mos rri gjatë në pasqyrë se të shitojnë "?!

Për fund, shtojmë se për ritin, me të cilin lidhet akti, ekziston edhe ai, një mallkim në Anë të Malit i cili thotë: "Mos e vuftë kamën në babune". Në kuptimin mos u martoftë?!! Duhet cekur, se tërheqia, më pas e babunes, kur nusja taketë vënë këmbën duhet të bëhet, detyrimisht, nga një grua e cila ka lindur shumë fëmijë dhe ate mundësisht djem.

Riti i gjuajtjes me vezë

Dëshira e ruajtjes së tipareve fisnore haset gjithashtu te riti i gjuajtjes së kalit të nuses (sot makinës), me vezë nga një anëtar i fisit të saj. Gjuajtja e vezës, bëhet në momentin e nisjes së nuses nga shtëpia me automjet. Gjatë këtij momentit dikush nga kushërinjtë e saj meshkuj e gjuan automjetin me vezë pasi të ketë thirr 3 herë në vete emrin e nuses.

Kjo masë ndërmerret për të siguruar që fëmija të ngjajnë nga veza (dajat), e jo nga dhëndri. Po nuk u ndërmor kjo masë fëmijët nuk do tu ngjasin dajave, por familjes së dhëndrit. Andaj dikush duhet që dikush të jetë vigjilentë që një punë e tillë të mos harrohet.

Ghithashtu, në këtë kohë, tërhiqet vërejtja, se mund të bëhehen edhe magjitë ndaj nuses. Në këtë rast, mund të merren tre gur dhe duke i kthyer, tinëz, mbrapsht. Nëse kjo bëhej, kishte rrezik që nusja, mund të divorcohej nga burri dhe të kthehej te prindërit si e pa fat.

Riti i qitjes pushkë

Derisa ritet e trajtuara patën qëllim mbrojtës nga fuqitë magjike, rregulla e qitjes pushkë nga përcjellësit e nuses ngërthen në strukturën e saj, përveç parimeve të tjera edhe gjurmë të grabitjes së femrave, si dukuri e dikurshme martesore që tash nuk bën jetë vepruese. Të qiturit pushkë në këto anë nuk është thjesht akt i pa sanksionuar në pikëpamje të normave morale e kanunore. Në kohën kur përcjellësit e nuses, kuptohet më të afërmit e saj qesin pushkë, zakonisht pezullohet muzika, lojërat, shakatë etj.

Gjithashtu gjatë asaj kohe nuk është e para pëlqyeshme të qesin pushkë dasmorët. Po të ndodhte një gjë e tillë, kjo do të kuptohej si ofendim për ta. Lidhur me këtë mund të supozohet se fjala është për një rregull të vjetër, gjurmët e së cilës çojnë në lashtësi dhe pikërisht në kohën kur martesat ishin të pa stabilizuara sa duhet, si kategori të modifikuara morale e etike. Një gjendje kësisoj, vetvetiu u imponon përcjellësve funksion të plotfuqishëm të veprimeve të tyre për mbrojtjen e nuses nga grabitësit e rrugëve.

Riti i thyerjes së gotave

Në këtë tërësi kuptimore do shpjeguar edhe rregulla e thyerjes së gotave të dollisë nga përcjellësit e nuses në shtëpi të dhëndrit. Sipas rregullës, thyhen numra tek, do të thotë, një, tri ose pesë gota. Shpjegimi i simbolikës së tillë është i diskutueshëm dhe mund të parashikohet se fjala është për rit mbrojtës simboliko-magjik, kuptimi i të cilit duhet kërkuar në simbolikën e numrit tek që respektohet doemos, por ndoshta edhe në karakterin e cakërrimit të gotave (dollisë) që pati në planin historiko-hapësinor, si tek ilirët, por edhe te popujt e tjerë të lashtë. Përpara thyhej vetëm filxhani i nuses, ose shishja që i shërbente asaj për të pirë ujë gjatë rrugës në shtëpinë e dhëndrit, kështu që mund të jetë fjala edhe për një rit të kohës së re.

Megjithatë, bazuar në dëshmitë e subjekteve popullore, kjo rregull si duket nuk është e kohës së vjetër. Subjektet e gjalla dëshmojnë se më parë nuk praktikohej një ceremoni e tillë rituale, pra nuk thyheshin fare gotat. Ajo që është më afër mendsh, momenti i cakërrimit të gotave përshkohet nga efekti, i cili u mundëson përcjellësve të shprehin qëndrimin e tyre, duke treguar se është fjala për dhembje, gëzim, pikëllim etj.

Riti i sheqerit dhe mjaltit dhe riti i hënës

Ky rit, vie në shprehje, në momentin kur nusja hyn në oborr, atëherë, plaka (vjehrra), shkon duke derdhur sheqer, ku pritet të shkelë këmba e nuses, duke aluduar që nusja të shkelë me këmbë të mbarë, si sheqer..., kurse ajo, të njëjtën gjë e bënë edhe vetë duke futur gishtat në filxhanin e mjaltit, që ia qesin te pragu i derës dhe pastaj me gishtat e vet prekë 3 herë çivitë e derës.

Për veç asaj që kemi cekur për ritin e hënës, duhet të mos lëmë pa përmendur, ritin e hënës i cili ndeshet në anë të Malit,në rastin, kur nusja arrin në oborr.. Duke e ditur se hëna është perëndeshë e grave e cila i merr në mbrojtje natën e martesës, duke bartur në trupin e tyre bukurinë e saj, për të siguruar këtë masë,asaj i këndohet: *"...Ulu mal sa t' dalin hana / t'nabajn drit për nesërmrama/ sa t'na shkojnë vashat për uj / janë nafaka e tjetër kuj../*

Përmbledhtazi, duhet cekur se ritet martesore të Anës së Malit, përveç formave të përbashkëta me ritet e tjera shqiptare, kanë edhe origjinalitetin e tyre, i cili bën të besosh se paraqesin pasuri me interes për folkloristikën shqiptare.

E gjithë kjo masë sigurie, e cila duhet të arrihet përmes riteve, dëshmon për konsideratën e madhe që ka individi shqiptar për

martesën, kultin e gruas që doemos identifikohet me bukurinë si cilësi dalluese e saj.

Gjurmët e martesave në grupe dhe grabitje

Ndër gjurmët e lashtësisë te këto rite duhen veçuar: gjurmët e martesave në grupe, gjurmët e martesave me rrëmbim dhe gjurmët me karakter të veprimeve magjike.

Gjurmët e martesave në grupe, cilësohen si karakteristikë shumë e lashtë e martesave të hershme, të cilat arrijnë sot të pandryshuara, që nga stadi i shoqërisë primitive. Përmes tyre
populli shpeshherë në mënyrë të pavetëdijshme ruan kujtesën
për formën më të ulët të dasmës gjatë organizimit të hershëm fisnor. Në këtë kuadër, edhe te shqiptarët e Anës së Malit ceremonia e dasmës ruan në vete rite të ndryshme të lashtësisë, por që janë të pashpjegueshme në të shumtën e herëve nga popullsia e kësaj treve. Këto gjurmë lashtësie radhiten në grupin e gjurmëve që më së paku përfillen sot në dasma, në krahasim me gjurmët e veprimeve të tjera magjike. Ndodh kështu sepse përfillja e tyre për kohën paraqet pengesë, ngase shihet që janë të stërvjetruara dhe pa domethënie.

Si gjurmë lashtësie në ritet e dasmave të rrethinës së Ulqinit, duhen cilësuar gjurmët e martesave në grupe. Kështu, kur dikujt i vdes vëllai, ai merr të shoqen e tij, ose dy vëllezër të një shtëpie martohen me dy motra po të një shtëpie. Duket se e këtij karakteri është edhe stolisja e vëllait të dhëndrit natën e dasmës.[96] Por, poligamia nuk ekziston të shqiptarët e kësaj treve; ajo ka ngjarë të praktikohet vetëm për çështje prestigji dhe krenarie familjare dhe për arsye të anës praktike të rasteve të fatkeqësive familjare kur femrës i vdes bashkëshorti dhe ajo mbetët me fëmijë të vegjël. Biologjikisht mund të vërtetohet se vetëm motra mund ti rris si fëmijët e vetë, fëmijët e motrës.

Në këtë trevë hetojmë edhe shenjat e martesës me rrëmbim (grabitje). Kjo më së miri shihet te riti që nusja të shkohet e të merret me sa më shumë krushq. Është gjithashtu evidente dhe domethënëse dalja e nuses nga shtëpia e saj duke e marrë për krahësh, rezistenca e saj, të qarat kur vijnë krushkat, pastaj kapja për krahësh kur zbret nga kali, përpjekja për të ikur kur kthehen të afërmit e saj në shtëpi etj.[97]

Besimi i bartjes së vetisë së objekteve; gjërave të zeza- gjymit, gurit dhe ujit...

[96] Po aty, f. 126
[97] Po aty, f. 126

Si dukuri interesante është edhe besimi që vetitë e këqija të objekteve përmes veprimeve magjike mund të përcillen në dukjen e nuses, pra në shkëlqimin e saj.

Kështu nusja për t' iu shmangur veprimeve magjike të kësaj natyre, në momentin kur e dëgjon zërin e krushkave, të cilat i këndojnë për të siguruar një shkëlqim (shërim) të bukurisë së saj, duhet të shqiptojë tri herë në vete këto vargje rituale: *Unë hanë e hyri, ju zi si kusi.* Me këtë veprim ritual, besohet se shkëlqimi i hënës do të përcillet në vete nusen dhe me këtë veprim do të sigurojë një bukuri më të madhe kur t'i hiqet duvaku, i cili ka qenë mjet mbrojtës nga syri i keq

Si dëshirë për shkëlqim të bukurisë është edhe ngjyrimi i penjve për hënë të re[98]. Ky veprim ritual siguron mbrojtjen nga gratë e liga magjibërëse etj. Është interesant edhe besimi se nuses në rrugë mund t'i qesin fulteren e zezë ose ndonjë send tjetër të zi, si p.sh. gjygymin (gjymin), me qëllim që ngjyra e zezë e tyre të përcillet në fytyrën e nuses. Për këtë shkak dikush nga përcjellësit e nuses duhet të jetë vigjilentë që para se nusja të vijë në shtëpi të re kryen veprime të këtilla, pra qitjen e sendeve me ngjyrë të zezë. Si parandalim nga veprimet e ngjyrës së objekteve të tilla (fulteres, gjymit etj.), praktikohet që nuses t'i lëshohen rrezet e pasqyrës në momentin para mbërritjes në oborr të dhëndrit nga të afërmit e shtëpisë, në mënyrë që rrezet e pasqyrës t'i evitojnë këto magji.

Ndër ritet mbrojtëse duhet vlerësuar edhe ritin e marrjes së tre gurëve nga këmba e djathtë e kalit të nuses, kur ai arrin në oborr. Gurët mbështillen në faculetë dhe nusja i fut në gjoks. Mendojmë se këtu takohemi me një kuptim metaforik të magjisë, ku besohet se fortësia e gurit dhe qëndrueshmëria e kalit do t' i mundësojnë asaj që të ketë qëndrueshmërinë e këtyre dy objekteve, kalit dhe gurit, me rastin e shkuarjes në shtëpi të re. Duhet thënë se kali është kafshë mbrojtëse dhe ruhet në besimin ilir ashtu si edhe guri.

Zakoni i shitblerjes së femrave

Si pasqyrë e mbeturinave të dikurshme të martesës patriarkale është edhe adeti i qitjes së parave në pajë të nuses. E kemi fjalën për të hollat që babai i dhëndrit i dhuron fëmijës që qëndron para pajës në kohën kur krushqit vijnë për të marrë nusen. Dhurimi i parave bëhet haptas, e sipas rregullit, babai i dhëndrit duhet t' i japë tri herë me dorë të tij para ose maksimalisht pesë herë. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë

[98] Bota shqiptare, Libër leximi për kursin e naltë të shkollës së mesme, Tiranë, f. 42,43 dhe 44

me nderimin e numrit tek. Dhënia e parave, siç duket, i ngjan më tepër një dhurate se sa një "blerjeje" të pajës. Në qoftë se fëmija dëshiron të marrë edhe më të holla, atëherë zakonisht dikush nga të afërmit e tij e largon atë duke i uruar babait të dhëndrit miqësinë e re dhe duke e falënderuar. Në qoftë se ky rit ka të bëjë me shitblerjen e femrave, atëherë kemi të bëjmë me një lidhje të kësaj norme me ritin e dikurshëm që ndeshet edhe ndër popujt e tjerë në fazat e ndryshme të zhvillimit historik. Mirëpo ajo që është e veçantë në krahasim me disa vise të tjera shqiptare, ku kjo rregull aty-këtu deri vonë ekzistonte ose ekziston, në Anë të Malit thjesht nuk mbahet në mend që të ketë ekzistuar si rit i tillë. Ky fakt tregon që ai ka pushuar moti të veprojë.

Ndër riterët tjera, të kësaj dasme, është edhe ***qitja pushkë (gjuajtja në shenj, si dhe kalërimi i kalit të nuses***. Ky dramacitet ndodhte, në momentin kur nusja arrinte në shtëpinë e dhëndrit. ngjarja zhvillohej deri sa nusja, të mos shpallej publikisht para dasmorëve, e cila gjë zakonisht zgjaste rreth një orë. Dalja e saj publike, lajmërohej me pushkë, dhe ky rast quhej, si çelje e derës së nuses...

Gjatë kësaj kohe për dëfrim dikush kalëronte kalin e nuses, ndërsa të tjerët, gjuanin shenjin me armë zjarri. Zakonisht gjuhej molla e bajrakut, që ndodhej mbi shtizë, të bajrakut të nuses, sytari më i mirë, që qëllonte, mollën, ishte i respektuar nga mjedisi. Këto loja zakonisht bëheshin për të mbushur kohën që ishte në dispozicion, deri sa hapej dera e odës së nuses.

Gjurmë të së drejtës së natës së parë.

Me arritjen e nuses, në shtëpi të dhëndrit, zakonisht, përfundonte dasma; miqtë dhe të ftuarit tjerë pas përshëndetjes me të Zotin e shtëpisë, largoheshin në shtëpia e veta...

Është interesantë të thuhet, se natën e parë, nusja nuk flenë me burrë, por kjo ndodhë tek, natën e dytë. Zakonisht, natën e parë, nusja flinte me të motrën e vëllait, apo me ndonjë kushërirë të afër, ose hallë..., ndërsa këtë natë, me të flinte edhe një fëmijë djalë, i cili i qiste nuses, ujë për të larë faqet në mëngjes, kurse për shërbim ajo i dhuronte atij një peshqirë, të holla apo diç tjetër, të ngjashme, që kish marrë nusja nga shtëpia e vet. Përse, nusja këtë natë nuk flinte me dhëndër?!

Ka pikëpamje të cilat cekin se këtë natë në kohën kur martesat ishin të pa stabilizuara sa duhet, në shoqëritë e lashta primitive ilire, që këtë natë, me nuse të ketë fjetur babai i dhëndrit, dhe kjo e drejtë dikur njihej si e drejta e natës së parë që sot mund të gjenet si relikt në

kulturat e popujve të vjetër. Por duke e ditur që ky veprim, nuk mbahet mend që të ketë bërë jetë vepruese, duke qenë tabu, ka arritur të mbijetojë kohët deri në ditët tona.

Dëshmi se dikur shqiptarët gratë i kishin të përbashkta nga koha Ilire?!

Dëshmi e gjurmëve të lashtësisë është edhe adeti në Anë të Malit që nëna në prezencën e bashkëshortit të vet fëmijës së vogël i thotë për të kunatin se "ky është babai yt", e të cilin në
të vërtetë fëmija e ka axhë.

Kjo nuk fyen askënd e me sa duket gjurmët e këtij veprimi çojnë në kohën e lashtësisë ilire. P.sh. dihet se liburnët gratë i kishin të përbashkëta dhe fëmijët i ushqenin bashkërisht deri në moshën 5 vjeçare, pastaj në vitin e gjashtë, mbasi i mblidhnin të gjithë fëmijët shquanin tek ata ngjasimet me burrat dhe secilin ia dorëzonin babait të vet. Secili baba që nga koha që merrte fëmijën e quante si djalin e tij.[99]

Ndikimit të magjive, nusja mund t'i nënshtrohet edhe pas martesës. Andaj, ajo duhet të ketë frikë dhe kujdes të posaçëm ndaj tyre. Për të shmangur magjitë, nusja kujdeset me kë kontakton dhe nga kush merr sende të ushqyeshme. Duhet të ruhet nga pirja e kafeve (mjet me të cilin zakonisht kryhen magjitë), të ruhet që të mos i humbasë "plaçkat", rrobat e trupit: trikon, këmishën etj.

Pasuria e riteve në këtë dasmë është shumë e begatë dhe e përsosur, por duke pasur parasysh hapësirën mbarëshqiptare, specifikat e riteve nuk ndryshojnë. Këtu trajtuam rite që janë të veçanta për dasmën e Anës së Malit ose që janë karakteristike për dasmën shqiptare në përgjithësi.[100]

Në fund, bie në sy që dëshira për shmangien e rrezikut konkret që mund të ndodh nga magjibërësit, është misioni kryesor i veprimtarive rituale te kjo dasmë, të cilat e bëjnë atë mjaft të hetushme nga të tjerat. Tradita e pasur e riteve të dasmës anamalase, ofron mundësinë e kundrimit të gjurmëve të lashtësisë, të cilat jetojnë në etnopsikologjinë e popullsisë duke u shfaqur në kohë me një pasuri simbolesh dhe metaforash, të cilat krijojnë lidhje emocionale e bindëse me lashtësinë.[101]

---

[99] Aleks Luarasi, Kuptimi dhe rëndësia e martesës, Sfinga nr. 6, Prishtinë, 2003, fq. 206

[100] Eqrem Çabej, Studime gjuhësore

[101] Demush Shala, Dispenca, Prishtinë, 1976, f. 123

Ali GJEÇBRITAJ

SIMBOLI I GJRPËRIT NË SHTËPITË E KRAJËS ORA E SHTËPISË

Thuhet në popull se çdo shtëpi ka gjarpërin e vet. Besohet se ata zakonisht janë të qetë. Gjatësia e tyre është e ndryshme, thuhet se mund të jetë edhe deri në dy metra. Shqiptarët i thonë “gjarpëri i shtëpisë” ose “Ora e shtëpis” bile edhe “Roja e shtëpisë”. Në Krajë termi “Ora e shtëpisë” është përdorur gjithmonë. Edhe sot e kësaj dite ky term për gjarpërin në shtëpi nuk është hequr nga fjalori. “Nuk bën ta mbytëni gjarpërin e shtëpisë sepse ai ruan shtëpinë nga të ligat na thonin prindërit tone kur në shtëpi dukej ndonjë gjarpër. Ai ruan shtëpinë nga të këqiat, të ligat na porositnin atëbotë. Ai ka punën e vet, ka udhën e vet. Nuk ka punë me ne, na thoshte gjyshja dikur. Ata dikur lëvizin nëpër shtëpi lirisht dhe askush nuk guxon t’i ngacmojë, kështu që shpesh herë janë gjetur nëpër teshat apo mbulesat e fjetjes, nën jastëkët, nëpër djepet e foshnjeve, e kështu me radhë, në turrë të dyshekëve. Besohet se dikur iu jepej qumësht në vendet e caktuara, ku gjarpëri i shtëpisë zakonisht e ka pasë daljen e vet. Thuhet nëse e mbysim gjarpërin e shtëpisë, në atë shtëpi ndodhin ngjarje të kobshme, u digjet shtëpia, mund të vdesë dikush prej anëtarëve të familjes, t’u haje ujku bagëtinë, të bjere rrufeja në shtëpi ose në stallat e bagëtive etj. Në bisedë me një grua të moshuar nëtëdhjetë vjeçare, ajo ndër të tjera më thot se" koka e gjarpërit të mbron nga magjia, falli, syri i lig, syri i keq” etj. Vajzat e bukura dhe nuset e reja të shtëpisë, me qellim që të mbrohen nga magjia apo syri i keq kanë mbartur kokën e gjarpërit, në qafë dhe në gjoks midis gjinjëve. Në fakt, kur dikush rastesisht gjate punës së përditshme në arë, duke korrur grurin, thekren apo elbin, mbyste ndonjë gjarpër, ia merrte kokën, të cilën sipas nevojës më vonë mund t’a mbante një vajzë ose nuse e re e shtëpisë. Koka e gjarpërit e mbajtur në qafë osenë gjoks midis gjinjëve është një ritual i trashëguar që nga ilirët, të cilët besonin në forcën mbrojtëse të gjarpërit. Gjarpëri edhe sot e kësaj dite tek shqiptarët konsiderohet si "roje e shtëpisë" dhe mendohet se secila shtëpi diku në themelet e saja e ka gjarpërin e vetë i cili e mbron shtëpinë. (Kjo s’ka si t ë mos ndodh edhe në Krajë, populli i së ciles trevë ka ruajtur në kujtesën e vet shumë gjëra nga parardhësit e tyre, fisit ilir, Labetëve). Prandaj kur ai paraqitet në oborrin e shtëpisë as nuk mbytet e as nuk

ngacmohet, por lihet i qetë. Pra, koka e gjarpërit tek shqiptarët e ka patur kuptimin e një objekti sigurie për individin dhe shtëpinë.
Dëshmi për këtë mitologji ilire paraqet edhe gdhendja e simbolit të gjarpërit në gurët e shtëpisë. Në Krajë ky fenomen haset gjithandej në shtëpitë e banimit. Në Ftjan në shtëpin familjare të Rmazan Marajt dhe në Markashaj, në Ostros të Madh në shtëpinë e Xafer Markashit. Kohë më pare shkova në Markashaj ku më priti i zoti i shtëpisë. I thash qellimin e vizitës time dhei i tregova se kam ardhur të shkruaj diçka , me porosi të dr. prof. Simë Dobrecit lidhur me shtëpinë e tij ku në gurë faqok është gdhendur gjarpëri. Për ta plotësuar rrefimin e tij Xhaferi ka ftuar që ta ndihmoj edhe nipi i kësaj shtëpie Ali Sylë Perashi.
Xhafer Markashi, ponjoll i kësaj shtëpie ku është e skalitur figura e gjarpërit në gurin e shtëpisë për hisorinë e kësaj shtëpie shprehet: “kjo shtëpi është ndërtur në fillim të shekullit të kaluar, para Luftës ballkanike të vitit 1912. Këtë dëshmi e plotëson nipi i kësaj shtëpie Ali Sylë Perashi i cili shton se nëna e tij ,Fatimja e cila ka dale nga dera e kësaj shtëpie me familjarët e tjerë ikën për të shpëtura nga ushtria malazeze në Shkodër në vjeshtë të 1912 –tës.
Themelet e shtëpisë i ka vënë Salë dhe Rexhë Markashi, dy djemt e Nezir Markashit. Në trungun katër brezash, siç më njohtojnë bashkëbiseduesit e mi, Sala le trshigimtarë dy fëmijë Xhafen i cili vdes i ri , ishte i fejuar dhe Hazizën, ndërsa Rexha katër djem, Selimin, Lezin,Musën dhe Nezirin. Për respekt dhe për të mos humbur emrin e Xhafës, Selimi, djali i Rexhës i vë emrin djalit të tij, Xhafer i cili jeton në këtë shtëpi edhe sot e gjithëditën. Nga ana tjetër pinjollët tjerë të kësaj shtëpie janë Sala i Musës i cili me djemt e tij jeton në Amerikë, në Ulqin e gjetiu.
Nuk duhet harruar se Sala, i biri i Nezirit, të cilit i vdes djali i ri, vritet më 1912 nga ushtria malazeze në prag të shtëpisë. Thuhet se ka bërë rezistencë për të ruajt shtëpinë nga djegëja. Aty thonë, Xhaferi dhe Aliu ka rënë dëshmor. Mulla Osman Brahimi, imam i xhamisë i cili është dorëzuar dhe nuk ka ikur në Shkodër aso kohe ka thënë se nuk e ka njohur Salën kur e ka varrosur nga masakrimi që i është bërë nga malazezët. Atëbotë, më 1912 u dogj kjo shtëpi dhe u masakrua Sala nga ushtria malazeze, por një pjesë e sajë ka shpëtuar pa u djegur e kjo pjesë pikërisht ka qenë ajo në të cilën ka qenë i gdhendur simboli i gjarpërit.
Përndryshe ku flasin për shtëpinë, Xhaferi thot se Rexha ka qenë mjeshtër i dalluar i ndërtimit. Murator , nuk i është gjetur shoqi në Ostros. Nga ana tjetër ka qenë edhe shumë intelegjent nga natyra, shton

Aliu. Përveç ndërtimit të shtëpive ai ka bër edhe një ubulë që ndodhet afër ublës së Krajës me thellësi 11 metër. Kjo ubulë njëhet si ubla e Rexhë Mrakashit. Është me shumë interes se ndërtuesi i shtëpisë në Markashaj, Rexhë Markashi edhe pse nuk ka dijt shkrim – këndim ka pasur intelegjencë të jashtzakonshme që t'i ruaj e t'i përcjell traditat e vendit dhe ta ruaj trashigiminë kulturore e shpirtërore të paraardhësëve të tij, ilirëve, gjë që e dëshmon simboli i gjarpërit në shtëpin e tij. Për ta ilustruar këtë fakt dëshmi e pamohueshme është se Salë Musa, nipi i tijë vazhdon rrugën e tij dhe të axhës së babes së tij,por tashti në një formë tjetër, kështu që në fillim të viteve tetëdhjeta formon grupin "Jehona e Krajës" për të cilin është folur e shkruar shumë. Për këtë ai dhe anëtarët tjerë të grupit denohen me shumë vjet burgim. Ndër ta edhe Ali Sylë Perashi, nip i kësaj shtëpia dhe bashkëbiseduesi im Xhafer Markashi
I frymëzuar nga kjo, si dhe nga shumë të dhëna tjera gojore që deshmojnë se simboli i gjarpërit, roje e shtëpisë në Krajë thura këtë poezi:

ORA E SHTËPISË

Në Ostros në Markashaj në
gur gdhendur me mjeshtri
Ruan shtëpitë
Në Ftjan nën Rumi
gdhendur për mrekulli
Mbi derë në gur
roje e shtëpisë
Në Krajë në Iliri
gjithmonë ka qenë
Ora e shtëpisë

Asnjë kafshë në simbolikën religjoze tek ilirët nuk ka luajtur rol të rendësishëm sa gjarpëri. Kjo kafshë misterioze, me formë të jashtzakonshme e cila pa zhurmë zvarritet dhe del nga thellësia e tokës aty ku jetojnë demonët dhe zotat e nëntokës, si edhe shpirtrat e të ndjerëve, i cili me kafshimin e vet mundet aty per aty ta mbyse jo vetem kafshen, por edhe vete njeriun, ka nxitur respekt.

Ali BARDHI

SIMBOLET DHE MOTIVET NË GURVARRET E ANËS SË MALIT - ULQIN

1. Simbole dhe motive të gdhendura në gurvarre me mbishkrime arabe-osmane në Anë të Malit - Ulqin

Element me rëndësi në gurvarret me mbishkrime arabe-osmane në trevën e Anës së Malit janë edhe simbolet dhe motivet dekorative të gdhendura. Nga 600 gurvarre me mbishkrime arabe-osmane, të trajtuara në librin "Varrezat në Anë të Malit - Ulqin", rreth gjysma e tyra i kanë të gdhendura simbolet e trajtuara më poshtë, si: gjysmëhëna, vula (myhyri) e Sylejmanit apo ylli me gjashtë cepa, ylli shumëcepash, svastika, shpata, kama (thika), selvia, lulja e jetës. Gjithashtu janë gjetur edhe dekorime të tjera, si gjerdani, lule dhe motive të ndryshme bimore etj.

Ndryshe nga simbolet e cekura më sipër të cilët janë gdhendur në gurvarret në trevën e Anës së Malit, simbolet me figura frymore si shqiponja, ujku apo të ngjashme me to, nuk janë përdorur. Simbolet me figurat e trupave qiellorë si ylli apo gjysmëhëna, të cilat janë përdorur edhe nga ilirët, i gjejmë të gdhendur në gurvarret e kësaj treve. Nuk dihet me saktësi arsyeja e mos shfrytëzimit të simboleve frymore, si shqiponja ujku apo të ngjashme me to, të cilat konsiderohen simbole të hershme të etnosit shqiptar. Në anën tjetër shohim se simbolet me figura frymore si shqiponja me dy koka, i gjejmë të gdhendura në shumë objekte fetare në Anadoll, si në Medresenë me Dy Minare (Çifte Minareli Medrese) në qytetin Erzurum, që i përket vitit 1253[102] etj. Kjo tregon se edhe pasi pranohet besimi islam, simbolet frymore vazhdojnë të kenë përdorim, sidomos në jetën e përditshme, duke filluar që nga periudha para osmane tek selçukët dhe për të vazhduar edhe më pas gjatë periudhës osmane.[103] Fakti që simbolet frymore si shqiponja, ujku etj. nuk i gjejmë në gurvarre dhe ceremoni mortore, vjen ndoshta për arsye se këto simbole frymore nuk duket të ketë patur ndonjë atribut apo kuptim që ka krijuar

[102] Luca Mozzari, *islam*, Electa, Venecia, 2002, fq. 147.

[103] Përdorimi i shqiponjës me dy koka rrjedh nga periudha bizantine. Duke qenë simbol i Perandorisë Bizantine ishte shenjë sovrani, prandaj shumë pri - cipata që u themeluan mes tyre edhe selçukët e përdorën atë.

domethënie për jetën e përtejme në këtë kohë, çështje që edhe mbetet të studiohet në të ardhmen.

E konsiderojmë me vend të trajtojmë shkurtimisht disa prej simboleve të gjetura në gurvarret e trajtuara. Në shtojcë kemi vendosur një tabelë e cila dëfton numrin e simboleve të gdhendura dhe vendndodhjen e tyre në fshatra (shih tabelën 20).

1.2. Gjysmëhëna (hilal)

Gjysmëhëna është simboli që është ndeshur më tepër në varrezat e trevës së Anës së Malit. Nga hulumtimi i bërë rezulton se janë gjetur dyqind e tetë (208) gjysmëhëna në gurvarret me mbishkrime arabe-osmane në këtë trevë. Gjysmëhëna ndeshet e gdhendur në pjesë të ndryshme të nishanit. Në të shumtën e rasteve, ky simbol gjendet i vendosur në krye të epitafit, vetëm në ndonjë rast së bashku me yllin gjashtëcepash.

Simboli i gjysmëhënës ndeshet që në lashtësi.[104]

[104] Gjysmëhëna është përdorur nga shumë qytetërime e popuj të ndryshëm të botës gjatë historisë, si tek sumerët, babilonasit, në Indi, Egjiptin e lashtë, Greqi, Romë, te shumë fise të vjetra turke etj. Gjysmëhëna rezulton të jetë përdorur edhe nga ilirët, gjatë periudhës para antike, edhe pse më rrallë. Këtë gjë e dëshmojnë disa gjetje arkeologjike në territorin e Gllasnicës, në Bosnjë, të gjetura në disa "tokëza". A. Stipçeviq pohon se është e vështirë të thuhet nëse kanë apo jo kuptim simbolik këto shtojca gjysmëhëne në këto tokëza. Mirëpo, për një tokëz duket se na jep të drejtë të mendojmë se së paku disa prej shtojcave paraqesin Hënën. (Aleksandar Stipçeviq, *ilirët*, Toena, 2002, fq,.290.) Qytetërimet dhe popujt e ndryshëm i kanë dhënë kuptime të ndryshme simbolit të gjys- - mëhënës, si p.sh. në periudhën antike gjysmëhëna ka simbolizuar Artemisën. Atë e kanë shfrytëzuar edhe shumë sundimtarë të Perandorisë Bizantine, si p.sh. Kostantini, i cili kryeqytetin e Perandorisë Bizantine, Konstandinopojën, ia dedikoi Dianës, perëndeshës së gjuetisë. Gjysmëhëna ishte simboli i Dianës. Në përmasa të mëdha, simboli i gjysmëhënës bëhet nga shek. XII i përdorur prej myslimanëve arabë në Azinë

Rëndësia e hënës apo e gjysmëhënës në fenë islame përmendet në disa versete Kur'anore (6:96/7:54/21:33). Gjatë historisë islame gjysmëhëna është vlerësuar prej myslimanëve si referencë e kalendarit hixhri, duke marrë kështu gjithnjë rëndësi për myslimanët dhe gjen përdorim të gjerë.

Simboli i gjysmëhënës me një ose me disa yje ka pasur domethënien e imazhit të parajsës-xhenetit në shumë shtete myslimane. Gjysmëhëna simbolizon rilindjen dhe pafundësinë, pasi për njeriun i cili vdes, me të vërtetë duket sikur ka përfunduar çdo gjë, por ai do të rilindë në një dimension të përjetshëm. Për këtë arsye, myslimanët e vendosin në gurvarret e tyre.

Edhe shkronja Nun e alfabetit arab, e cila ka formën e gjysmëhënës, ka marrë kuptimin e ringjalljes. Për këtë arsye janë përzgjedhur për t'u lexuar apo kënduar për të vdekurit ajetet e Kur'anit që janë me rimën e kësaj shkronje. Në një këndvështrim, kjo shkronjë ka edhe kuptimin e "peshkut" në arabisht, meqë në një ajet të Kur'anit peshku përmendet si simbol i jetës së pafundme.

1.3. Ylli gjashtëcepash (heksagram) apo vula (myhyri) e Sylejmanit

Vula-Myhyri i Sylejmanit (Paqja qoftë mbi të), ylli gjashtëcepash, apo ylli i Davudit (Paqja qoftë mbi të) haset shumë shpesh i gdhendur në gurvarret me mbishkrime arabe-osmane në trevën e Anës së Malit - Ulqin. Disa nga fotografitë me këtë nishan, të paraqitura më poshtë, janë gjetur në varrezat e fshatrave të Krythës, Millës, Katërkollës dhe Kalimanit, nga ku janë paraqitur në Shtojcë në tabelën e simboleve (shih tabelën 3).

Ky motiv është vendosur në pjesë të ndryshme të nishanit, por në të shumtën e rasteve ky yll gjendet i vendosur në krye të epitafit, e rrallë herë në fund të tij. Në krye të epitafit në të shumtën e rasteve ky yll (gjashtëcepash) është i gdhendur vetëm, në ndonjë rast së bashku me një apo me dy gjysmëhëna, ndonjëherë i vendosur brenda një rrethi apo edhe në fund të epitafit brenda një trekëndëshi. Ky motiv përdoret për të dyja gjinitë, si për meshkuj, edhe për femra. Te gurvarret për femra, të

---

e Vogël, prandaj edhe bëhet simbol i muslimanëve. Ky simbol thuhet se është përdorur në qëndismat dhe varëset e grave në Shqipërinë e Veriut. E. Durham pohon se gjatë udhëtimit të saj në Shqipërinë e Veriut çdo grua katolike mbante një gjysmëhënë të madhe me një yll argjendi të punuar me filigran, mbërthyer me kurorën e kësulës së rrafshtë. Shih. Azem Qazimi, *Fjalor i mitologjisë dhe demonvogjisë Shqiptare,* Plejad, Tiranë, 2008, fq. 159.

shumtën e rasteve përdoret edhe Lulja e Jetës gjashtëcepash që i ngjan yllit të gdhendur brenda një rrethi, e cila të lë përshtypjen e një motivi dekorues enkas për gjininë femërore.

Ky simbol, rezultat i formimit nga bashkëngjitja e dy trekëndëshave barabrinjës të ndërthurur mes tyre, ku maja e njërit qëndron lart, kurse e tjetrit poshtë duke formuar yllin gjashtëcepash.[105]

Në hapësirën e Ballkanit ky yll ndeshet edhe në periudhën bizantine.[106] Në trevat tona vula (myhyri) e Sylejmanit përdoret në shumë vende, objekte fetare, shtëpi, gurvarre, si simbol i personaliteteve dhe njerëzve të kohës. Yllin gjashtëcepash e ndeshim edhe në emblemën e Balshajve. Edhe Skënderbeu e familja e tij Kastriotët e kanë përdorur yllin me gjashtë cepa, gjë që shihet në stemën e tij, i vendosur sipër shqiponjës, brenda një rrethi.[107] Se nga është ndikuar Skënderbeu dhe Kastriotët, nuk dihet saktësisht. Rreth këtij fakti duhet studiuar më në hollësi nga historianët në të ardhmen. Shohim se në detarinë zyrtare në Perandorinë Osmane përdorej vula-myhyri i Hazreti Sylejmanit (Paqja qoftë mbi të) të cilin e ndeshim të përdorur në flamurin e Hajredin Pashë Barbarosës (1478-1546).[108]

---

[105] Ylli gjashtëcepash është përdorur nga qytetërimet e popujt e hershëm, si ai babilonas, maja, toltek, Amerika Qendrore, hindutë, hebrenjtë, lëkurëkuqët, proto-turqit e Uraleve, më pas edhe nga selçukët etj. Ylli gjashtëcepash duhet të jetë përdorur edhe nga ilirët. Gjetja e fundit e arkeologëve të Republikës së Kosovës është artefakti dhe eksponati më i rëndësishëm arkeologjik i gjetur në Kosovë, ylli gjashtëcepash, Lulja e Jetës dhe Pema e Jetës, të gjetura së bashku në një gur të gdhendur mermeri, një metër i gjatë dhe tridhjetë centimetra i gjerë, në të gjitha anët. Pas analizave të bëra, vjetërsia e këtij guri rezultoi të ishte i lashtë. Gazeta Bota Sot, dt. 17.04.2016.

[106] Në periudhën bizantine ylli gjashtëcepash ndeshet në ritet e ndryshme fetare. Në shek. X rezulton të jetë përdorur edhe nga bogomilët. Bogomilizmi rrjedh nga emri i themeluesit të këtij sekti në shek.X Bogomili (d.m.th. dashuroj Zotin), i cili që një prift nga Bullgaria. Bogomilët hodhën rrënjë të thella në Bullgari dhe që zgjati rreth pesë shekuj. Brënda një kohe të shkurtër ai u shndërrua në një lëvizje masive që përfshiu Bullgarinë, Maqedoninë, Serbinë, viset e Shqipërisë, veçanërisht Bosnjën. Prej andej ajo u përhap në brigjet e Italisë së jugut dhe drejt veriut, në Francë, Gjermani, etj. Bogomilizmi ishte një lëvizje shoqërore që drejtohej kundër zgjedhës feudale dhe pasqyronte, para së gjithash, protestën e popullsisë fshatare. Kjo lëvizje frymëzohej nga një lëvizje më e hershme, nga ajo e pavlikanëve, që ishte e përhapur në krahinat lindore të Bizantit në shek.VII-VIII.

[107] Lulëzim Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*. fq. 70; Kristo Frashëri, *Skënderbeu jeta dhe vepra*, Botimet Toena, Tiranë 2002, fq. 214; Lulëzim Lajçi, po aty, fq. 45.

[108] İskender Pala, "Mühr-i Süleyman" *dİa (Enciklopedia islame e dijanetit)*, v. XXXI, fq. 526.

Ajo që i ka shtyrë myslimanët e trevës sonë dhe të Perandorisë Osmane që ta përdorin një simbol të tillë është referimi te figura e profetit Sylejman (Solomon, shek. X p.e.r.). Kur'ani flet për fuqinë e profetit Sylejman të dhënë nga Zoti. (Sad, 35-38; Sebe, 11-13; Enbija, 79; Neml, 17) Po kështu nga hadithet e Profetit Muhamed (Paqja qoftë mbi të) mësojmë se para Kataklizmës (Kiametit) dallimi i jobesimtarëve nga besimtarët do të bëhet me vulën (myhyrin) e profetit Sylejman (Paqja qoftë mbi të).[109] Nga këto shohim se për vulën (myhyrin) e Hazreti Sylejmanit ka folur Profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të).

Nga historia e Profetit Sylejman (Paqja qoftë mbi të) mësojmë se kishte në unazë vulën (myhyrin) e tij. Në transmetime shohim se në unazë kishte të shkruar emrin e Zotit (Ismi Adham). Unaza e Profetit Sylejman ka pasur të gdhendur dy trekëndësha në drejtime të kundërta që formonin yllin gjashtë cepash. Kjo unazë u soll nga Ademi (Paqja qoftë mbi të) prej engjëllit Xhebrail në një ditë xhumaje.[110] Po kështu, edhe populli ynë e ruajti këtë botëkuptim fetar për vulën e Sylejmanit (Paqja qoftë mbi të), e cila u përdor nga myslimanët në hapësirën e shtetit Osman.

Ky yll në të shumtën e rasteve në gurvarre gjendet i vendosur në vend të "Përgjërimit-Yakarış" (***shih. Përgjërimi***), gjë që lë për të kuptuar se është përdorur si simbol i emrit të Zotit. Myhyri i Sylejmanit në të kaluarën qe përdorur edhe kundër syrit të keq dhe për këtë arsye ky yll ka qenë i përhapur kudo. Gjithashtu, në popull ka mbizotëruar mendimi se aty ku ndodhet Myhyri i Sylejmanit nuk mund të depërtojë djalli

[109] Ibn Maxhe, Sunen, Fiten, 31; Tirmidhiu, *el-Xhamiu`s-Sahih*, fiten, 21; İbn Kethir, Shih.Prof. Dr. Suat Yıldırım, *Peygamberimiz'in Kur'an Tefsiri*, 2014; Hasan I. Nahi, *Kurani i madhërishëm*, fq.Ixxv.

[110] Taberi, *Tarih-i Taberi*, v.I, fq. 532; Necmetin Ersoy, *Semboller ve Yorumlar*, fq. 177; Alparslan Salt, *Semboller*, fq. 34; Larousse Mali rečnik simbola, fq. 518.

(shejtani). Sipas një versioni tjetër, unaza e Sylejmanit është një ndër pesë gjërat që solli Ademi nga xhenneti në dynja.

Kultura shqiptare e ka pranuar si pjesë të vet vulën e Sylejmanit, simbol i lashtë që gjeti përdorim të gjerë si simbol i myslimanëve. Kjo është arsyeja që vulën-myhyrin e Sylejmanit (Paqja qoftë mbi të) e ndeshim në përdorim të gjerë, ndonjëherë në xhami, në objekte të ndryshme, në muret e shtëpisë, e më shpesh në gurvarre përkrah gjysmëhënës. Shqiptarët e kanë përdorur qoftë si fuqi spirituale, simbolike dhe qoftë vetëm si dekor.

1.4. Svastika

Në fotografitë e mëposhtme janë paraqitur tri svastika të gjetura në gurëvarret e varrezave në trevën e Anës së Malit. Njëra prej tyre, ajo me drejtim të akrepave të orës, është gjetur në varrezat e xhamisë së Selitës, kurse dy të tjera, me drejtim të kundërt të tyre, janë gjetur në varrezat e xhamisë së vjetër të Sukubinës dhe në xhaminë e Shtodrit.

Simboli i Svastikës ndeshet që në lashtësi.[111] Theksohet se svastika simbolizon rrethin rrezatues të diellit të mesditës; diellin në lëvizje etj.

Në Kur'an dy trupat qiellorë - dielli dhe hëna cilësohen llogaritës të kohës (En'am, 96) me të cilët llogaritet koha në fenë islame. Njëherit në Kur'an dielli me dritën e tij dhe hëna, koha, fiku, ulliri, etj. rënditen në mesin e gjërave mbi të cilat betohet Zoti. (Shems, 1-4; Tin, 1)

[111] Simboli i Svastikës ka qenë i përhapur në shumë qytetërime e popuj të lashtë, si në Iliri, Indi (Buda), Azi Qendrore, Turkistan, Mongoli, Lindjen e Largët, Tibet, Evropën Veriore, te keltët, etruskët. Me përjashtim të një a dy rasteve, ky simbol nuk është përdorur nga popujt semitë. Shfaqjen e shpeshtë të këtij simboli në artin popullor shqiptar, A. Stipçeviq e shpjegon me popullaritetin e këtij simboli tek ilirët parahistorikë në Ballkan, para se të formohej etnosi ilir. Edhe në Edirne është gjetur një svastikë e vjetër 2800 vjet (p.e.r.) e cila ngjason me ato që kemi gjetur në varrezat e cekura më lart, që nënkupton se svastika duhet të jetë përdorur edhe nga thrakët, fqinjët e ilirëve. Ekzistojnë dy forma svastike: njëra që lëviz në drejtim të akrepave të orës dhe tjetra në të kundërtën e tyre (suavastika). Mendohet se këto simbolizojnë mashkullin dhe femrën; aspektet diellore dhe hënore; diellin pranveror që lind dhe diellin vjeshtor që perëndon. Svastika me gemba të kthyer në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës, ka qenë në Indinë e lashtë simbol i dritës, i gëzimit dhe i jetës, kurse ajo me gemba në drejtim të kundërt (suavastika) ka qenë simbol i vdekjes dhe i fatkeqësisë. Të dy këto tipe svastikash ndeshen edhe në Iliri e në vazhdimësi, deri në fund të periudhës osmane. Fakti se në trevat tona suavastika gjendet më shpesh në objekte të karakterit funeral sesa svastika, ka të ngjarë që edhe tek ilirët këto dy tipe të svastikës kanë pasur të njëjtën domethënie si në Indi.

Ky simbol i trashëguar ndeshet në artin islam të trevave shqiptare, në motivet e ndryshme të qilimave gjatë periudhave të selçukëve dhe osmane, në zbukurimet e vizatimeve dhe në artin e bukurshkrimit. Motivet e Svastikës janë të vendosura edhe në xhaminë Xhuma në Iran dhe në atë të Tajnalit në Tripoli të Libisë, në të majtë të portës hyrëse në maozoleun e Ahmed Jeseviut (1093-1156). Kjo tregon për përdorim të gjerë nga myslimanët.

1.5. Shpata

Nga hulumtimi i bërë në varrezat e trevës së Anës së Malit rezultojnë edhe disa gurvarre që kanë të gdhendur simbolin e shpatës. Ato janë paraqitur në tabelën e simboleve në Shtojcë (tabela 3).

Simboli i shpatës është i vjetër, i cili ndeshet në qytetërimet dhe te popujt e lashtë duke i dhënë kuptime të ndryshme. Por një gjë është e pamohueshme se, para së gjithash, ky simbol ka kuptimin e drejtësisë, fuqisë, pushtetit, mirëqënies, ushtrisë etj. Kuptimi më i përhapur rreth këtij simboli është sundimi i drejtësisë dhe pushteti i të mirës ndaj së keqes.

Siç u cek më lart, janë të shumta simbolet dhe kuptimet rreth këtij objekti. Në Perandorinë Osmane njihet rasti i vendosjes së shpatës tek ushtarakët. Arsyeja që duhet t'i ketë shtyrë myslimanët e periudhës Osmane ta shfrytëzojnë këtë simbol mund të ketë qenë statusi i të ndjerit në shoqëri, gjë që vlen edhe për varret e Anës së Malit. Në gurëvarret ku kemi ndeshur simbolin e shpatës të gdhendur, kemi vërejtur se kemi të bëjmë me banorë vendas, të cilët dallohen prej identitetit të tyre.

1.6. Selvia

Nga hulumtimi i bërë në varrezat e trevës së Anës së Malit - Ulqin kemi ndeshur në motivin e pemës së selvisë, të gdhendur në tre gurvarre: njëri në varrezat e vjetra të xhamisë së Kravarit Nalt, tjetri në varrezat e xhamisë së Shasit dhe i treti në varrezat e xhamisë së re të Millës. Në të tre gurvarret, motivi i selvisë është i gdhendur në gurin e kokës, në anën e kundërt të epitafit. Po ashtu, në të tre gurvarret është gdhendur nga një gjysmëhënë në majë të selvisë.

Selvia llogaritet si e shenjtë në shumë qytetërime dhe popuj të lashtë.[112]

Motivi i selvisë, si nga pamja fizike ashtu edhe nga ajo biologjike, ka zënë vend të veçantë edhe në qytetërimin Islam. Mendohej se selvia i tërheqte erërat, ashtu si oxhaku i shtëpisë tymin. Poeti turk Nebi e shpjegon selvinë në aspektin fetar duke thënë: "Minarja në vend dhe selvia në fushë janë si gishti tregues i Shehadetit (Dëshmisë)".

Në traditën osmane selvia së bashku me pemën e hurmës kanë pasur domethënien e pemës së jetës. Në tasavufin islam (mistika islame) selvia ka qenë simboli i durimit (sabrit).

[112] Shenjtëria e selvisë ka lidhje me jetëgjatësinë e saj, duke simbolizuar përtëritjen dhe ndryshueshmërinë e vazhdueshme të stinëve. Selvia është përdorur në shumë qytetërime, në mënyrë të veçantë në ato mesdhetare, si tek ilirët, grekët, romakët, të cilët e mbillnin këtë pemë në varreza, për shkak të qëndrueshmërisë së gjatë të rrënjës së selvisë dhe blerimit të gjethëve të saj. Ky ka qenë shkaku që kjo pemë është përdorur si simbol në gurvarre. Edhe egjiptianët e lashtë e kanë përdorur selvinë që sillej nga veriu i Mesdheut. Në fillim, nga druri i selvisë ata bënin arkivolet e mumjeve. Në këtë mënyrë selvia u bë pjesë e pandashme dhe tipike për të vdekurit. Kjo gjë duhet të ketë qenë edhe arsyeja e mbjelljes së saj më pas.

1.7. Lulja e jetës

Lulja e jetës, siç njihet në botë, ndeshet edhe në gurvarret e trevës së Anës së Malit - Ulqin. Nga hulumtimi i bërë rezultojnë disa lule të jetës, të gdhendura në epitafet me mbishkrim osman në vendvarret e mëposhtme: një gurvarr në varrezat e Puzës në Shtodër; tre gurvarre në varrezat e xhamisë së Shasit; dy lule jete në një gurvarr në varrezat e xhamisë në Lamij; dy gurvarre në varrezat e xhamisë së vjetër të Krythës.

Lulja e jetës[113] është një simbol i përbërë prej rrathësh të mbivendosur. Rregulli qëndron në simetrinë për të krijuar një formë gjeometrike të ngjashme me një lule. Qendra e çdo rrethi përputhet me pikëprerjen e gjashtë rrathëve të tjerë që ndodhen në të njëjtin perimetër. Pozicioni i tyre formon një strukturë gjashtëkëndore të brendashkruar në një rreth më të madh. Lulja e jetës e gjetur në gurvarret e trevës së Anës së Malit është në formë konvekse dhe konkave (lugore dhe kodrinore).

[113] Lulja e jetës është përdorur pothuajse në të gjitha vendet e botës. Ajo ka pasur një domethënie kuptimplote gjatë historisë njerëzore. Atë mund ta gjesh në tempuj, art, dorëshkrime dhe kultura nga gjithë bota, duke filluar me tempujt e Egjiptit të lashtë, të paktën 6000 vjeçarë, në Kinë, Japoni, Indi, Turqinë e sotme, si edhe në periudhat e mëvonshme në Spanjë, Itali etj. Kjo lule është gjetur edhe në Kosovë, në një gur ku janë të gdhendur së bashku Lulja e jetës, Ylli i Davidit dhe Pema e jetës, për të cilin arkeologët e Kosovës pohojnë se është e vjetër mbi 4500 vjet. Kjo lule është gjetur e gdhendur edhe në mauzoleun (tyrben) e Haxhi Bektash Veliut.

Prej simboleve dhe motiveve të gdhendura në gurvarret me mbishkrime arabe-osmane në Anë të Malit - Ulqin trajtuam vetëm disa.

Simbolet dhe motivet e përdorura në varret myslimane me mbishkrime arabe-osmane në Anë të Malit - Ulqin të cilët ndeshen në një përdorim të gjerë në traditën dhe artin e myslimanëve të hapsirës së Perandorisë Osmane u përdoren me botëkuptimin që u dhanë muslimanët këtyre simboleve.



1.8. Dekorime të tjera



Tabela 20.

TABELA E SIMBOLEVE TË PËRDORURA NË GURVARRET
ME MBISHKRIME ARABE-OSMANE NË TREVËN E ANËS SË Malit - Ulqin

(1707-1956)

FSHATI	Gjysmëhëna	Myhyri i Sylejmanit	Ylli shumërremash	Svastika	Selvia	Shpata	Kama thikë	Lulja e jetës	GJITHSEJ
Bojk	6								
Brjashë	13					1			
Çapraj	1								
Draginë	3								
Kaliman	6	1				1			
Katërkollë	7	2	1			1	1		
Kllezën N	35		1			1	2		
Kllezën P	1								
Kravar N	10				1	2			
Krythë	41	2	2			2	2	2	
Kosiq									
Lamij	3		1					1X2	
Leskoc	13	1					2		
Megjureç	1								
Mërkot	19					3	3		
Millë N	14	1X2				2	2		
Millë P									
Pelinkë	10								
Rashtishë N	1								
Rashtishë P	5		1					2	
Selitë	2		1	1				1	
Sukubinë	1		6	1					
Sumaë	1								
Shas	8		2		1			3	
Shtegvashë	1								
Shtodër	6		6	1				1	
Totali	**208**	**9**	**21**	**3**	**2**	**13**	**12**	**11**	279

ARKITEKTURË

Korab KRAJA

UBLA E KRAJËS – MONUMENT MIJËVJEÇAR

HYRJE

Duke parë nevojën dhe domosdoshmërinë për të kontribuar diçka për trevën e Krajës, përkushtimi ndaj historisë dhe trashëgimisë kulturore të saj, ka shtyrë në hartimin e këtij punimi.

Ubla e Krajës është ndër veçantitë dhe ndër monumentet e rralla, dhe të vetme, e ndërtuar si e tillë, në rajon dhe më gjerë. Ndërtimet e ublave, duke qenë karakteristikë e këtij rajoni, kjo ubël, pra *Ubla e Krajës*, është monument historik, kulturor dhe arkitektonik identifikues për Krajën. Përndryshe, ndër të tjera, nëse deri tani nuk është konsideruar si e tillë, do të duhej të konsiderohej në të ardhmen si simbol i kësaj treve.

Ajo në vete ngërthen rrëbeshet e historisë, gëzimet dhe vuajtjet, fitoret dhe humbjet, të mirat dhe të këqijat e ndodhive në këto anë; është dëshmitare e kohërave të ndryshme, luftërave të përgjakshme, ndryshimeve të kufijve herë pranë e herë larg saj; kushteve të vështira për jetesë, shpërnguljeve të shumta, të njëpasnjëshme e të pandalshme; dhe kohët e fundit, mjerimeve ekonomike, shoqërore, sociale, kulturore e politike.

Ubla e Krajës, edhe pse dëshmitare e të gjitha këtyre ngjarjeve e ndodhive, ajo vazhdon të qëndrojë, tash e më shumë se njëmijë vjet, e heshtur, duke kontribuar me mënyrën e vet, për të si punë e vogël dhe e zakonshme, por për popullin si ndihmë për mbijetesë: duke i siguruar atij ujin e pijshëm dhe të bollshëm gjatë gjithë vitit dhe shekujve me radhë.

I. KRAJA – VEÇORITË GJEOGRAFIKE DHE HISTORIKE

A. Mbi pozitën gjeografike të Krajës

Kraja për nga natyra dhe kushtet klimatike është rajon i veçantë. Natyra është e gjallëruar, ndërsa ka klimë të mirë. Natyrën dhe klimën e saj e bëjnë më të bukur dhe më të përshtatshme për jetesë liqeni, buzë të cilit shtrihet Kraja dhe lartësia mbidetare e saj.

Kraja është trevë shqiptare e Malësisë së Mbishkodrës, e cila aktualisht gjendet nën juridiksionin e Malit të Zi, ajo shtrihet përgjatë bregut

jugperëndimor të Liqenit të Shkodrës dhe shpateve të maleve të Rumisë e Taraboshit, nga Cërmnica e deri në Shirokë.[114]

Kundruar nga aspekti tipologjik, kjo trevë ndahet në dy nëntërësi rajonale. Në anën perëndimore të saj shtrihet Shestani, i cili quhet edhe Ana e Sipërme ose Ana e Naltë, ndërsa në anën lindore të saj gjendet Kraja (në kuptimin e ngushtë), e cila ndryshe quhet edhe Kraja e Madhe ose Ana e Poshtme. Këto dy nëntërësi rajonale, të marra së bashku, përbëjnë Krajën në kuptimin e gjerë.[115]

Figura 1. Shtrirja e trevës së Krajës

B. Mbi të kaluarën e Krajës

Edhe Kraja ishte një nga trevat e ilirëve të lashtë. Këtu, sikurse në pjesën më të madhe të basenit të Liqenit të Shkodrës – **Labeatis lacus**, siç e quan Tit Livi, jetonin **pjesëtarët e fisit ilir me emrin *labeatë*** (labeates).[116]

Toponimi *Krajë* është shumë më i vjetër se toponimi *Mali i Zi* (sllavisht Crna Gora). Kraja përmendet qysh në Analet e Priftit të Dukles (1149), ndërsa toponimi i papërcaktuar qartë Mali i Zi (Crna Gora), për herë të parë përmendet në vitin 1318, në krisobulin e Mbretit Millutin. Në kohën kur Mali i Zi ishte pothuajse i panjohur, Kraja ishte madje edhe qendër arqipeshkvale.[117]

Sami Frashëri, kah fundi i shek. XIX, do të shkruajë se Kraja "është një nahi, që në kohë të fundit iu dha Malit të Zi dhe shtrihet në anën jugperëndimore të Liqenit të Shkodrës, gjegjësisht në veriperëndim të

[114] Koliqi, Hajrullah, (1993), *Kraja ndër mote*, f.13. *Figura 1*. Është marrur nga libri *Kraja ndër mote*, f.11.
[115] Po aty.
[116] Doli, Flamur, (2006), *Në një cep të Ilirisë – Arkitektura e lashtë*, f.142.
[117] Koliqi, Hajrullah, (1993), *Kraja ndër mote*, f.16.

Shqipërisë. Ajo së bashku me Tivarin dhe Ulqinin ka 376 kilometër katrorë, kurse popullsia është gati tërësisht shqiptare. Ka 16.000 banorë, pjesa dërmuese janë myslimanë."[118]

Treva e Krajës ishte e përfshirë në luftërat e para të pushtimit të tokave nga ana e malazezëve, kjo për arsye se ishte trevë kufitare me Malin e Zi.[119] Poashtu, Kraja ishte e përfshirë edhe në veprimtaritë dhe në luftërat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.[120] Dhe, padyshim, se nga gjiri i kësaj treve dolen shumë luftëtarë të zot të cilët mbrojtën vatrat e tyre dhe luftuan për mbrojtjen dhe lirinë e vendit.

Rol të rëndësishëm në kontributdhënien e historiografisë e letërsisë shqipe dha treva e Shestanit, si pjesë përbërëse e Krajës. Gjon Buzuku, nga kjo trevë, konsiderohet si autori i librit të parë për të cilin dihet se është shtypur në shqip (Meshari, viti 1555).[121]

Qendra kryesore në të kaluarën e Krajës për marrëdhënie ekonomike, shoqërore, kulturore, gjeografike, demografike, farefisnore dhe historike ishte Shkodra, sa që realisht përbëjnë një tërësi unike, të ndarë padrejtësisht.[122] Kraja e bënte tregtinë në Shkodër, sepse Shkodra ishte dhe është qyteti më i afërt i saj. Shumë tregtarë shkodranë shkonin nëpër fshatrat e Krajës për të blerë produkte të ndryshme bujqësore, blegtorale, lëkura kafshësh të buta e të egra etj.[123]

Popullsia e Krajës në të kaluarën kryesisht është marrur me bujqësi dhe blegtori. Kushtet klimatike dhe terreni kodrinoro – malor, me pak tokë punuese kanë ndikuar që popullsia të ketë kulturë bujqësore kryesore kultivimin e duhanit e jo edhe aq shumë kultivimin e drithërave. Në literaturën bujqësore është i njohur duhani i Krajës.[124] Ndërsa, popullsia e vendbanimeve pranë liqenit merret me peshkim.[125] Në këto rrethana ekonomia e kësaj krahine varej plotësisht nga qendrat urbane që

[118] Po aty, f.18.
[119] Shih: Koliqi, Hajrullah, (2014), *Kraja jonë*, f.95 – 100; dhe *Kraja ndër mote*, vep. cit., f.68 – 104.
[120] Shih: Belegu, Xhafer, (2008), *Lidhja e Prizrenit dhe veprimtaritë e sak 1879* -1881, f.108; dhe Rexha, Riza, (1998), *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, f.32, 40.
[121] Elsie, Robert, (2011), *Fjalori historik i Shqipërisë*, f.138. Shih edhe: Çabej, Eqrem, (1988), *Meshari i Gjon Buzukut*, f.22.
[122] Koliqi, Hajrullah, (2001), *Kraja e Shkodrës*, f.9.
[123] Po aty.
[124] Gjeçbritaj, Ali, (2013), *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, f.10.
[125] Draga, Nail, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Popullsia dhe vendbanimet e Krajës (1948 – 2011)*, f.197.

zotëronin tregun (veçanërisht nga Shkodra), çka pengonte zhvillimin e forcave prodhuese në vend.[126]
Pjesa perëndimore e Krajës iu dhurua Malit të Zi në Kongresin e Berlinit të vitit 1878 dhe pjesa tjetër e mbetur, ajo lindore, iu dhurua atij në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913.[127]

C. Mbi arkitekturën në trevën e Krajës

Në Krajë është i pranishëm ndërtimi profan, sakral dhe utilitar. Shtëpitë tradicionale janë të veçanta për nga formësimi i tyre në përshtatjen me terrenin, prej materialeve ndërtimore, si dhe nga tipologjia e tyre. Banesa popullore shqiptare, si një pjesë e rëndësishme e krijimtarisë popullore, është një tregues i rëndësishëm i natyrës së shoqërisë së kohës.[128] Kjo mund të vërehet edhe në ndërtimet e shtëpive në Krajë.
Janë të pranishme edhe objektet fetare, kishat dhe xhamitë, të cilat në kohëra të ndryshme shërbyen për qëllime të caktuara të vendasve. Këto u ndërtuan nëpër fshatrat e ndryshme, si dhe, disa prej manastireve u ndërtuan nëpër ishujt në Liqenin e Shkodrës.
Rreth liqenit të Shkodrës (Lacus Labeatis) jetuan labeatët (Labeates)[129]. Sigurisht që janë të pashmangshme mbetjet e ndryshme arkeologjike të këtyre banuesve të hershëm.
Gjetjet arkeologjike dhe studimet ilirologjike dëshmojnë se ilirët ishin një popull i lashtë dhe autokton i Ballkanit. Gjithashtu, edhe për praninë e ilirëve në trevën e Krajës ekzistojnë gjurmë dhe dëshmi relevante arkeologjike, etnografike, etnologjike etj. Për këtë dëshmon edhe fakti se, sikurse në shumë lokalitete të tjera ilire, ashtu edhe në Krajë (te Liqeni i Shkodrës) është gjetur një sëpatë ilire e tipit dalmato-alban.[130]
Edhe pse pellgu i Shkodrës, në pjesën më të madhe, nuk është arkeologjikisht i hulumtuar, informacionet e caktuara dëftojnë se brigjet e liqenit dhe prapatoka e tij në periudhat e ndryshme historike kanë qenë të banuara, për çka dëshmojnë mbeturinat e kulturës materiale të epokës së bronzit dhe hekurit: sëpatat e bronzit dhe tumulët në rajonin e Tuzit dhe të Krajës, nekropoli misterioz në lokacionin e Mjellës te Virpazari

[126] Shpuza, Jusuf, (2002 – 2003), Lemba Nr. 6 -7, *Patronime të trevës së Krajës në Shkodër*, f.63.
[127] Draga, Nail, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Populllsia dhe vendbanimet e Krajës (1948 – 2011)*, f.196.
[128] Baçe, A., Meksi, A., Riza, E., Karaiskaj, Gj., Thomo, P., (1980), *Historia e Arkitekturës Shqiptare*, f.439.
[129] Stipçeviq, Aleksandër, (2002), *Ilirët – Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, f.32.
[130] Koliqi, Hajrullah, (1993), *Kraja ndër mote*, f.26.

etj.[131] Gjithashtu është hetuar që edhe në Liqenin e Shkodrës ka anije antike dhe kulla nënujore.[132]



Figura 2. Shtëpia e Mehmet Isuf Gjenashit, Ostros i Madh, Krajë, 1956. Vizatim me perspektivë gjeometrike, Korab Kraja. Kohëzgjatja e vizatimit: 15 orë. Prishtinë, 15 shtator 2014

Në Shestan, shtëpitë me strukturë planimetrike *ovale* me morfologji hapësinore të tillë hasen edhe tek ilirët dhe më herët te pellazgët.[133] Tipet e kashtores rrumbullake – koshit të misrit, janë evidencuar në Shestan.[134] Lashtësinë e ndërtimeve në trevën e Shestanit të banuar qysh në parahistori, drejtpërsëdrejti e dëshmon edhe ndërtimi i objekteve ndihmëse, *sternave (ublave).*[135]

[131] Çilikov, Aleksandar, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Kontribut çështjes së studimit dhe restaurimit të një numri monumentesh sakrale në Krajë*, f.47.
[132] Brisku, Bahri, (2011), *Kusarët dhe detarët shqiptarë (Kontributi i tyre në autoktoninë kombëtare)*, f.160.
[133] Doli, Flamur, (2009), *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, f.69.
[134] Doli, Flamur, (2001), *Arkitektura tradicionale – popullore e Kosovës*, f.10.
[135] Po aty, f.70.

II. KRAJA SI VEND I UBLAVE

Edhe pse Kraja është një trevë që shtrihet gjatë bregut të Liqenit të Shkodrës, ajo në brendi është vend i thatë, pa ujë të gjallë. Për ta kompenzuar mungesën e ujit kranjanët qysh në lashtësi u detyruan të ndërtojnë ubla.[136]

Veçanti ndërtimore e kësaj treve të lashtë janë sternat, puset apo siç quhen në Krajë *ublat.* Ky term është i përhapur gjithandej trevës së Krajës, por mund të thuhet se është i njohur edhe në leksikografinë e shqipes. Fjala *ubël* në fjalorin e gjuhës shqipe shpjegohet në këtë mënyrë:

ÚB/ËL, ~LA *f. sh.* **~LA, ~LAT.** Gropë e madhe, që e hapim në vendet malore ku s'ka kroje për të mbledhur ujin e shiut zakonisht për bagëtinë. *Ubël e thellë (e cekët). Ujë uble. Pinë ujë në ubël.*[137]

Lashtësinë e ndërtimeve në këtë trevë e provon edhe ndërtimi i ublave, të cilat shërbenin për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë, në vende ku ai ishte shumë i pakët.[138]

Sterna e Shestanit (krahaso me ublat), e ndërtuar nga mjeshtrit shqiptarë, në aspektin e formës dhe të teknikës së ndërtimit **përkon plotësisht me sternën** e ndërtuar në qytetin **ilir – NIKAE**, në shek. IV-III p.e.sonë. Do të thotë se, teknika dhe struktura formësuese – hapësinore e **sternave** u trashëgua nga **ilirët** te **shqiptarët**, duke i ruajtur tiparet e saj ndërtimore të pandryshuara në kohë e hapësirë.[139]

A. Ublat e Krajës

Sigurisht që jo të gjitha ndërtimet janë dëshmi arti, por, pavarësisht nga vlerat artistike, përbëjnë dokumente shkencore me vlera të mëdha për studimin dhe dokumentimin e historisë.[140] Të tilla janë edhe ublat e Krajës. Jo të gjitha kanë rëndësi të posaçme formësuese, artistike dhe arkitektonike. Por, rëndësia e tyre historike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike është e pashmangshme.

Ndërtimi i ublave ishte i pashmangshëm në këtë trevë, pasiqë ishte burim i vetëm i sigurimit të ujit të pijshëm dhe ishte mënyrë e vazhdimit të jetesës përgjatë shekujve. Ublat u ndërtuan gjithandej Krajës, dikun si bashkësi, ndërsa dikun si të vetme. Pothuajse çdo fshat kishte nga një apo më shumë të tilla.

---

[136] Koliqi, Hajrullah (1993), *Kraja ndër mote*, f.47.
[137] Grup autorësh, (1981), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, f.2075.
[138] Doli, Flamur, (2001), *Arkitektura tradicionale – popullore e Kosovës*, f.11.
[139] Po aty.
[140] Meksi, Aleksandër, (2004), *Restaurimi i Monumenteve të Arkitekturës*, f.43.

Ublat u ndërtuan nga banorët si domosdoshmëri dhe njëkohësisht në shenjë bamirësie për fshatin, për banorët bashkëkohës dhe për brezat e ardhshëm. Zakonisht u emërtuan sipas personit që e ndërtoi, apo familjes të cilës i përkiste dhe sipas fshatit në të cilin u ndërtua.[141]

Figura 3. Ublat e Bolajve si bashkësi ublash. Fotografoi autori 2014

Në Krajë dhe Shestan ka tre lloj burimesh, të cilat janë në formë qypi: ublat që shërbenin për ujë të pijshëm dhe ishin ndërtuar në krye të vendit; ubla që shërbenin për të pirë bagëtia dhe ishin të shpërndara gjithandej; dhe, ubla që shërbenin për nevoja të përditshme njerëzore.[142]
Si shembull mund të përmendet *Ubla e Krajës*, *Ubla e Ljares*, *Ublat e Bolajve* etj.
Ubla e Krajës është më e njohura në Krajë dhe njëkohësisht është ndër monumentet më të vjetra. U ndërtua në vitin 1001 nga Kosara. Ubla e Krajës do të shtjellohet më gjerësisht mëposhtë, pasiqë është subjekt kryesor i këtij punimi.

[141] Për më tepër shih: Gjeçbritaj, Ali, Revista BUZUKU nr. 23 - *Ublat e Bolajve*, Ulqin, 5 prill 2007; si dhe Dobreci, Simë Gjon, Revista BUZUKU nr. 29 – *Pinçi – disa toponime*, Ulqin, 2 prill 2009.
[142] Vata, Rovena, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Miti i ujit në Krajë e Shestan*, f.350.

Ubla e Ljares gjendet në fshatin Ljare, Krajë. Atë e ndërtoi mbretëresha Helena, e cila për shkak të motit të lig, u detyrua të qëndrojë në Ljare. Për shkak të mikpritjes nga popullsia e Ljares, ajo ndër të tjera, në shenjë falenderimi, vendosi të ndërtojë një pus (ubël), për të cilin kishin nevojë ljarasit. Kjo ubël u ndërtua në vitin 1290. Për shkak të rrethanave të caktuara, ubla u mbyll dhe që nga koha e mbylljes së saj e deri në ditët tona nuk dihet vendndodhja e saj. Se ku gjendet kjo ubël e din vetëm nga një pinjoll brez pas brezi, dhe ai, vendas i fshatit.[143]

Ublat e Bolajve e përbëjnë kompleksin e ublave në të cilin gjenden dymbëdhjetë ubla pranë njëra-tjetrës në një hapësirë të caktuar. Këto ubla kanë arkitekturë të veçantë të ndërtimit. Mund të përmenden grykat e ublave të cilat janë të punuara me gurë masiv të latuar në formë qemeri. Sot këto ubla kanë ujë të mjaftueshëm dhe uji i tyre është i cilësisë së mirë, i pastër dhe i lejueshëm për pije. Në atë rrethinë, secila mëhallë – lagje ka ublen e vet të ndërtuar nga banorët.[144]

B. Uji si domosdoshmëri për jetë dhe miti i ujit në Krajë

Ndër faktorët kryesor për jetesë, përpos veshmbathjes dhe strehimit; marrëdhënieve shoqërore e kulturore; rolin kryesor e zë ushqimi, e sidomos uji. Uji ka rëndësi të posaçme në jetën e njeriut: për pije, ushqim, pastrim, për bluarje në mulli, në kohët e sotme në teknologji e makineri të ndryshme, lundrim mbi të, nxjerrja e ushqimit prej tij etj. Pra, shihet se uji është faktor dhe kusht jetësor. Pa ujë nuk ka jetë.

Kraja si vend i thatë, malor e kodrinor që është, këtë pasuri natyrore të burimit të ujit nuk ka mundur tu ofrojë banorëve të saj. Për këtë arsye banorët, siç u tha më lartë, u detyruan të gjejnë zgjidhjen e ujit, për nevoja të veta jetësore. Prandaj edhe ndërtuan ublat, me madhësi të ndryshme, ndërsa me forma të ngjashme. Ubla, thjeshtë si ujëmbledhës nga shiu, ndërsa disa tjera të pakta si burim i pashterrshëm i ujit.

Si burim kryesor i ujit të pijshëm, *Ubla e Krajës* ka rëndësi të veçantë jetike edhe sot. Legjenda thotë se, para rreth njëmijë viteve, këtë ubël e ndërtuan Gjon Vladimiri dhe Kosara, në fshatin Krajë, tash Ostros. Sipas legjendës, nga Shën Gjon Vladimiri ka mbetur gjurma e këmbës në një rrasë guri. Kur ka kërkuar ujë, banorët nuk kanë pasur për t'i dhënë dhe në vend të tij i kanë dhënë qumësht.[145]

---

[143] Për më tepër shih: Koliqi, Hajrullah (1993), *Kraja ndër mote*, f.48.

[144] Gjeçbritaj, Ali, (2013), *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, f.23, 24.

[145] Vata, Rovena, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Miti i ujit në Krajë e Shestan*, f.349.

Me interes është e dhëna se këtu ujë mbushnin vetëm gratë dhe vajzat. Bile ato kur shkonin në ubël visheshin më bukur se zakonisht dhe stoliseshin më mirë.[146]

III. UBLA E KRAJËS

Kraja edhe pse shtrihet përgjatë Liqenit të Shkodrës, ajo në brendi të saj është e thatë. Kjo dukuri ka ndikuar tek banorët e saj të ndërtojnë ubla. Ubla më e njohur, më e madhja dhe më e veçanta për nga struktura arkitektonike është padyshim *Ubla e Krajës*.



Figura 4. Ubla e Krajës

Ubla e Krajës mund të konsiderohet si monument arkitektonik, pasiqë bën pjesë në krijimet e epokave të ndryshme historike në lëmin e ndërtimeve, që pasqyrojnë veprimtarinë, aftësinë dhe artin e të ndërtuarit si: qendrat historike qytetare e fshatare, banesat popullore, ndërtimet civile, kulturale, shoqërore, kulti, administrative, mbrojtëse etj.[147]
Ky burim jete s'do mend se është i njohur jo vetëm në Krajë, por edhe më gjerë për vetë faktin se është një monument i lashtë historik për Krajën dhe popullin e saj.[148]

A. Historia e saj

Ubla e Krajës paraqet dëshmi historike të pamohueshme se këtu jeta nuk është zhvilluar nën nivelin e qytetërimit të kohës, por ka vazhduar pak a shumë ngjashëm sikur në krahinat tjera, por sigurisht me ndryshime të ndryshme, qofshin të dukshme apo të padukshme. Këtë nuk e dëshmojnë vetëm *Ubla e Krajës* apo *Kisha e Shën Mërisë*, por edhe rrugët me

[146] Gjeçbritaj, Ali, (2010), *Gjurmët e moteve*, f.17.
[147] Për më tepër shih: *Rregullore për mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike,* Revista Monumentet, (1972), Nr. 3, f.225.
[148] Gjeçbritaj, Ali, (2010), *Gjurmët e moteve*, f.164.

kalldrëme, mbishkrimet në varreza, si dhe shumë monumente të lashtësisë që hasen në këto anë.[149]
Princi dokleat Vladimiri ka pasur shtëpinë mbretërore dhe kishën e Shën Mërisë në vendin Krajë sipas të cilit edhe e ka marrë emrin mbarë territori i sotëm i Krajës. Në fshatin e quajtur Ostros janë ruajtur gërmadhat e kompleksit ndoshta më të vjetër fetar të këtij territori, manastirit të *Zonjës së Papërlyer të Krajës*[150], e njohur në popull me emërtimin si *Kisha e Krajës*.

Figura 5. Kisha e Krajës

Gjon Vladimiri (Shën Gjon Vladimiri, shenjtor i tokës arbërore)[151] ishte i martuar me princeshën Kosaren. Jetuan në Krajë dhe ngriten ngrehina, objekte kulti dhe arsimore në Krajë.[152]
Ndërtim i veçantë, i rëndësishëm dhe me vlerë historike është *Ubla e Krajës*, të cilën e ndërtoi Kosara në vitin 1001, fillimi i shekullit XI. Kjo e dhënë është e shënuar mbi sipërfaqen e mbuluar pas restaurimit të vitit 1995 me llaç çimentoje. Në të shkruhet:

U ÇEL – 1001 KOSARA
MEREMETIMI – 1995

[149] Gjeçbritaj, Ali, (2013), *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, f.17.
[150] Çilikov, Aleksandar, (2013), *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Kontribut çështjes së studimit dhe restaurimit të një numri monumentesh sakrale në Krajë*, f.49.
[151] Koliqi, Hajrullah, (2001), *Kraja e Shkodrës*, f.51-57.
[152] Koliqi, Hajrullah (1993), *Kraja ndër mote*, f.45, 51.

B. Konteksti hapësinor i saj

Ubla e Krajës gjendet në fshatin Ostros të Krajës. Në planvendosjen e saj gjendet në fund të oborrit të rrethuar me mur nga guri, përkatësisht në pjesën më të gjerë të tij. Situacioni i gjerë përbëhet nga rruga kryesore Ulqin – Krajë, e cila gjendet në anën jugperëndimore prej së cilës kalohet nga shtegu i ngushtë i shtruar me gurë apo kalldrëm të vjetër. Këtij shtegu i bëjnë hije pemët e vendosura në të dy anët e tij, në anën e majtë më shumë se në të djathten. Përtej rrugës kryesore janë shtëpitë e banimit, me etazhitet të ulët, kryesisht P dhe P+1 (përdhesë dhe përdhesë me një kat sipër). Ndërsa, në anën tjetër, gjegjësisht në anën nga ubla, gjendet objekti me destinim të servisit të automjeteve. Përreth lokacionit janë parcelat e pronarëve të ndryshëm, të cilat përdoren si tokë bujqësore. Ndërsa, pak më larg në anën juglindore gjendet *Kisha e Krajës*.

Nga ana lindore është shtegu tjetër i ngushtë, i cili shërben për banorët e fshatit fqinjë të atij drejtimi.



Figura 6. Situacioni i gjerë i Ublës së Krajës

Situacioni i ngushtë përbëhet nga shtegu kryesor dhe në anën e djathtë të tij, aty ku fillon zgjerimi i pjesës së rrethuar gjendet edhe një ubël tjetër,

por më e vogël, me thellësi rreth 11 m.[153] Qasje në lokacion, që mund të shihet edhe në figurën 6, mund të ketë nga pesë anët e tij.
Rruga e shtruar me gurë të mëdhej, të cilët, të vendosur njëri pranë tjetrit, përbëjnë kështu shtegun e ngushtë me rreth 90 cm të gjerë që shpie te hyrja jugperëndimore e ublës. Duket që ky shteg i gurëve lidh ublën kryesore, pra *Ublën e Krajës* me ublën e vogël në afërsi, e cila është e mbuluar me therra dhe barishte. Në anën veriore gjendet *lera*[154]e futur nën tokë, e punuar me shkallë të gjera. Në afërsi të saj është i vendosur *lugu*. Ky i fundit, mbushet me ujë dhe bagëtitë pijnë në të.
Është e rrethuar kryesisht me gjelbërim të ultë dhe të mesëm, ndërsa gjelbërimi i lartë është poashtu i pranishëm, por në rrethinën e ublës.

C. Forma, funksioni dhe karakteristika e saj

Në gjininë e arkitekturës popullore, vlera domethënëse e tyre shprehet, së pari, me tiparet e kompozimit vëllimor të veprës, pa mënjanuar trajtimin arkitekturor të jashtëm dhe të brendshëm, teknikat dhe materialet ndërtimore, si dhe trajtimin dekorativ të elementeve funksionale.[155]
Ubla e Krajës, si monument kulturor dhe historik, për nga formësimi vëllimor i saj, në vete ngërthen tipare të pastërta gjeometrike dhe arkitektonike, të punuara me shije dhe mjeshtri të hollësishme. Planimetria e saj është rrethore dhe është interesante sepse çdo element si shërbim funksional i nxjerrur si vëllim i posaçëm dhe kryesisht i dalur vertikalisht nga planimetria horizontale, ka shtrirjen pothuajse të njëjtë rrethore, por me rreze, kuptueshëm, të ndryshme.
Trajta rrethore e monumentit në fjalë, nuk mund të ketë qenë e rastësishme. Rrethi mund të konsiderohet simbol i bashkimit, sepse të gjitha poligonet e rregullta ngërthehen nga rrethi. Është gjithashtu simbol i pafundësisë, pa fillim dhe pa fund, i përsosur, simboli përfundimtar gjeometrik.[156] Kjo formë mund të interpretohet edhe me simbolika të ndryshme, psh. planimetria arkitektonike, gjatë përdorimit simbolik të saj, komunikon nëpërmjet formës së saj. Që nga koha

[153] Këtë ubël e ndërtoi Rexhë Markashi dhe njihet me emrin si *Ubla e Rexhë Markashit*. Tregoi Ali Gjeçbritaj, 5 shtator 2017.
[154] Gropë e madhe që mbushet me ujë për të pirë bagëtitë në kohën e thatësirës. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, (1981), f.965.
[155] Riza, Emin, (2013), *Arkitektura popullore dhe vlerësimi i saj*, f.8.
[156] Calter, Paul, *The Circle, The Wheel of Fortune & The Rose Window*, *https://www.dartmouth.edu/~matc/math5.geometry/unit9/unit9.html*, 1998

parahistorike dhe në shumë kultura, rrethi, me sugjerimet e planeteve dhe me paraqitjet tjera të natyrës, fitoi një rëndësi simbolike, mistike dhe u përdor në planimetritë e shtëpive, varreve dhe strukturave fetare.[157]
Forma rrethore e hapësirës arkitektonike të ublës në fjalë, mund të lidhet edhe me kultin e diellit apo të hënës, pra solar dhe lunar. Kjo për faktin se kranjanët në të kaluarën kanë trashëguar dhe praktikuar kultet e ilirëve, atë të diellit, gjarpërit etj. Me kultin e diellit lidhet tradita shumëshekullore e ceremonisë së pelegrinazhit të shenjtë të kranjanëve në malin e Rumisë, sipas të cilës burrat e kësaj treve, çdo vit në ditë të caktuar ngjiteshin herët në majen e malit Rumia dhe me të lindur dielli i faleshin atij.[158]
Disku është paraqitja më e rëndomtë dhe më e përhapur e Diellit. Që të gjithë ilirët e tjerë e kanë paraqitur Diellin më së shpeshti në formë të diskut, gjegjësisht të rrethit.[159] Pra, këtu mund të bëhet krahasimi dhe gërshetimi i dy burimeve themelore për jetë, atij të energjisë diellore: dritës dhe ngrohtësisë, si dhe ujit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për jetë, duke kombinuar formën arkitektonike dhe funksionin e monumentit me domosdoshmëritë përditësore.
Këtu ngërthehen më së miri ndër parimet kryesore në arkitekturë: forma përcjellë funksionin, apo funksioni formën? Nëse vështrohet me kujdes planimetria e *Ublës së Krajës* dhe format vëllimore të saj, mund të shihet se çdo gjë është e menduar para se të projektohet dhe çdo gjë është e realizuar duke iu përgjigjur nevojave të saj.
Siç dihet, ubla shërben për grumbullimin dhe mbajtjen e ujit. Dhe, në ubël shkohet për të mbushur ujë, në kohët e përparme, zakonisht, nga një, dy apo në grupe, kryesisht femra. Ujin nga ubla e nxjerrnin me kovë dhe me litar, siç thuhet në popull, nëntë pash[160] të gjatë. Pastaj me këtë ujë mbusheshin *buljerat.*[161]

---

[157] Pa autor, *Symbol of function, https://www.britannica.com/topic/architecture/Symbols-of-function*, 6 gusht 2017
[158] Koliqi, Hajrullah (1993), *Kraja ndër mote*, f.28.
[159] Stipçeviq, Aleksandër, (1983), *Simbolet e kultit te ilirët*, f.17.
[160] Largësia ndërmjet dy duarve me krahë të shtrirë anash plotësisht; masë gjatësie e barabartë me këtë largësi (rreth një metër e gjysmë). Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, (1981), f.1382.
[161] *Bucelë (bulirë).* Enë e drunjtë si fuçi e vogël, që përdoret për të mbajtur ujë. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, (1981), f.187, 196.



Figura 7. Planimetria e Ublës së Krajës

Forma arkitektonike dhe funksionale e kësaj uble ka mundësuar vendosjen dhe renditjen e këtyre buljerave në një hapësirë më të lartë për rreth 73 cm nga niveli i dyshemesë, kurse formësimi shkallor i saj, i cili ka shërbyer edhe si mbështetëse është i lartë rreth 56 cm sipër saj. Kjo pjesë gjendet në pjesën jugore të shtrirjes planimetrike të ublës. Ndërsa, në anën e kundërt, atë veriore, gjenden të ngulur kapëset metalike që kanë shërbyer për lidhjen e bagëtive transportuese të buljerave. Kjo pjesë e ublës është e lartë rreth 20 cm, ndërsa formësimi shkallor sipër saj është për 17 cm më i lartë.



Figura 8. Lugu për pirje të ujit nga bagëtitë

Ubla ka dy hyrje, njërën nga ana jugperëndimore, ndërsa tjetrën nga ana lindore. Hyrja jugperëndimore është 90 cm e gjerë nga ana e jashtme, kurse nga ajo e brendshme është 80 cm. Ky ngushtim vjen nga simetria koncentrike e formës rrethore, ku çdo element arkitektonik në këtë objekt, i përgjigjet pothuajse saktësisht qendrës së ublës, që është në këtë rast mesi i grykës së saj. Pra, këto elemente dhe projektimi i tyre janë të drejtuara nga qendra. Dhe në këtë mënyrë, këto elemente vëllimore, të paraqitura si krijime estetike dhe arkitektonike, ngushtohen nga ana e brendshme.

Forma e këtyre elementeve mund të shihet më qartë nga planimetria e paraqitur në figurën 7. Elementet e tilla, nga këndvështrimi planimetrik i

tyre kanë formë prizmatike me dy brinjë paralele, jashtë dhe brenda dhe janë të harkuara sipas rrezeve të caktuara.
Ngjitur me ublën, në anën e majtë të hyrjes jugperëndimore të saj, gjendet *lugu* në të cilin kanë pirë ujë bagëtitë. *Lugu* si element dhe pjesë përbërëse e kësaj uble, është i ndërtuar nga guri masiv, i përpunuar dhe i gdhendur në formë karakteristike (figura 8). Ka formë abstrakte të lugës, por sigurisht me dimensione shumë më të mëdha.

D. Arkitektura e saj

Arkitektura popullore është krijimtaria shumëgjinore e bashkëideuar dhe zbatuar prej mjeshtërve popullorë. Në krijimtarinë ndërtimore, sipas kriterit funksional dallojmë, banesat, ndërtimet mbrojtëse, ndërtimet e kultit, si dhe ato inxhinierike.[162]
Trashëgimia kulturore e një vendi a populli konsiderohet burim kulturor, politik dhe ekonomik. Në rrafshin doktrinar, monumentet dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore bashkë me peisazhet kulturore vlerësohen për nga vlera e tyre historike, arkitekturore, arkeologjike, artistike, fetare, ekonomike etj.[163]



Figura 9. Fasada perëndimore dhe lindore e Ublës së Krajës

Arkitektura popullore është fushë e veçantë e trajtimit të arkitekturës në përgjithësi, sepse ajo merret me ndërtimet tradicionale dhe historinë e objektit. Ajo është pjesë identifikuese e një populli sepse me të bëhet identifikimi i tij, krahasimi me popujt tjerë dhe dallimi në mes tyre.

[162] Riza, Emin, (2013), *Arkitektura popullore dhe vlerësimi i saj*, f.14.
[163] Jerliu, Florina, (2017)*Trashëgimia kulturore e Kosovës Konceptet dhe kontekstet e mbrojtjes*, f.7

Ubla e Krajës duhet të bëjë pjesë në trashëgiminë kulturore të Krajës. Këtë e kategorizojmë si të tillë sepse ka vlera historike, vlera për nga vjetërsia, vlera funksionale për kohën kur u ndërtua dhe për kohën e sotme. Trashëgimia kulturore është gjithë çfarë trashëgojmë në formë materiale dhe jomateriale nga gjeneratat e kaluara, për të cilën kujdesemi në të tashmen, me qëllim që t'ua lëmë trashëgim gjeneratave të ardhshme.[164] Ubla e Krajës, së bashku me ublat tjera, mund të thuhet se bën pjesë në ndërtimet tradicionale dhe padyshim, mund të thuhet se, është pjesë identifikuese e rajonit të Krajës. Ajo, me tiparet e veta arkitektonike, estetike, formësuese, me vëllime gjeometrikisht pothuajse të rregullta, për gjatë shekujve është pranuar si e tillë dhe tani nga banorët ruhet me fanatizëm. Ubla për nga formësimi ka arkitekturë të shkallëzuar dhe në të shihet loja e vëllimeve dhe e hije – dritës.

1. Fazat e ndërtimit

Ubla e Krajës u ndërtua në vitin 1001. I ka përballuar shekujve të ndryshëm, rrëbesheve dhe pushtuesve, poashtu të ndryshëm. Ajo, me shekuj me radhë u ka shërbyer banorëve të saj, që nga dita që është hapur. U ndërtua në fshatin Krajë (Krajna, Kroj) ku gjendej kroni, burimi i vetëm me ujë të bollshëm gjatë gjithë vitit.[165]
Sigurisht që gjatë viteve, me kalimin e kohës ajo mund të jetë dëmtuar. Për këtë arsye, me angazhimin e Bashkësisë Lokale të Ostrosit, në vitin 1995, iu bë një "restaurim" sipërfaqësor të pjesës së jashtme, duke mos prekur asgjë nga ndërtimet e mëparshme dominante me vlerë historike.[166] Datat u shënuan në pjesën sipërfaqësore në anën veriore të ublës.

2. Teknika e ndërtimit dhe materialet e përdorura

Mjeshtër popullor në fushën ndërtimore, emërtohet zotëruesi i mbarë proceseve për ngritjen e një ngrehine, duke u diferencuar me rritjen e llojshmërisë së ndërtimeve dhe kryesisht me shumimin e ndërtimeve me vlera të rëndësishme arkitekturore dhe teknike.[167]

[164] Jerliu, Florina, (2016), *Mbrojtja e trashëgimisë ndërtimore. Historia, konceptet teorike, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes*, f.1.
[165] Koliqi, Hajrullah, (1993), *Kraja ndër mote*, f.47.
[166] Gjeçbritaj, Ali, (2013), *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, f.19.
[167] Riza, Emin, (2013), *Arkitektura popullore dhe vlerësimi i saj*, f.13.



Figura 10. Prerja A-A

Materialet ndërtimore shpesh janë kushtëzim i ndërtimeve të ndryshme, se si do të qënd-rojnë ato, se si do të duken dhe çfarë forme do të kenë, si dhe çfarë pamje dhe teksture ato do tu japin ndërtimeve të ndry-shme. Edhe teknika e ndër-timit, ashtu si vetë kompozimi janë të kushtëzuara kryesisht nga fuqia ekonomike.[168]

Ndërtimi i ublave (sternave), që nga ilirët te shqiptarët, nga aspekti i teknikës dhe formës së ndërtimit përkojnë tërësisht. Poashtu, njëherësh, përmasat e tyre, thellësia dhe gjerësia u ruajtën gati të pandryshuara, që nga ilirët e deri në ditët tona.[169]



Figura 11. Prerja B-B

E tërë ubla është e ndërtuar nga gurët dhe *horasani*[170] si material lidhës i përfituar nga përzierja e të bardhës së vesë dhe tjegullës së shtypur.

Në majen e grykës së cilindrit, nga ana e brendshme e tij është i vendosur një rreth në formë unaze nga metali. Në këtë rreth të metalit shihen gjurmët e lugje-ve, kanaleve që i ka formuar lita-ri gjatë shekujve gjatë procesit të fërkimit të tij për nxjerrjen e ujit. Rrethi i metaltë, pas "restau-rimit" është kthyer në anën e ku-ndërt, me kanalet e tij gjurmuese nga ana e poshtme! (Figura 12)

[168] Suli, Leonard, (1985), *Arkitektura e banesës popullore në rrezomën e Delvinës*, Revista Monumentet Nr.29, f.123.
[169] Doli, Flamur, (2009), *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, f.70.
[170] *Llaç.* Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, (1981), f.692.

Ky veprim i tillë duhet të ketë ndodhur për shkak të mosdijes së "restauruesve", mesiguri fillestarë apo që nuk e njohin këtë drejtim dhe fushë specifike të vështirë dhe të ndjeshme, që kërkon profesionalizëm dhe njohuri. Por, që rrethi i metaltë nuk është dashur të rrotullohet, por të lihet në anën e tij fillestare, kjo nuk ka pasur nevojë për shumë njohuri profesionale!

Përndryshe, rrethi metalik është i vjetër sa vetë ubla.[171]



Figura 12. Rrethi metalik dhe gjurmët e lugjeve

Ubla është mbuluar sipërfaqësisht me një shtresë të llaçit të çimentos nga të gjitha anët e saj, përpos nga ana jugore e jashtme, ku është lënë tekstura e gurit. Edhe lugu, si pjesë përbërëse dhe e veçantë, është lënë në gjendjen e tij fillestare, pra me pamje natyrale të gurit masiv.

3. Rilevimi i *Ublës së Krajës*

Monumente historike janë të gjithë vendet, ndërtimet dhe sendet me vlerë, që lidhen me ngjarje të rëndësishme të historisë së popullit.[172] Prandaj, autori i këtij punimi, e ka parë të udhës, të bëjë rilevimin e *Ublës së Krajës*, vullnetarisht.[173] Rilevimi është forma bazë e dokumentimit grafik të monumentit.[174]

[171] Gjeçbritaj, Ali, (2013), *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, f.17.

[172] *Rregullore për mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike*, Revista Monumentet, (1972), Nr. 3, f.225.

[173] Rilevimi i *Ublës së Krajës* u bë në verën e vitit 2014 nga autori i këtij punimi, Korab Kraja, aso kohe student i Fakultetit të Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës. Rilevimi u bë me vetiniciativë, vullnet dhe dëshirë të autorit. I gjithë rilevimi u bë nga personi i lartëpermendur. Pastaj, i gjithë rilevimi është përpunuar në programet softuerike në kompjuter dhe ekziston edhe një modelim 3D në arkiven e tij.

[174] Jerliu, Florina, (2016), *Mbrojtja e trashëgimisë ndërtimore. Historia, konceptet teorike, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes*, f.139.



Figura 13. Pjesë rilevimi i planimetrisë

Duke e ndjerë nevojën që Ubla e Krajës të ruaj formën e saj edhe në të ardhmen, ashtu siç e ka në ditët e sotme, apo ndoshta në një kohë do të jetë e nevojshme që monumentet e trashëgimisë sonë kulturore të dokumentohen, është parë e udhës që paraprakisht të bëhet një *rilevim* i saj. Rilevimi i bërë (viti 2014, K.K.) quhet **rilevim paraprak (preliminar)**. Ky rilevim identifikohet me *rilevimin përnjohës* dhe ofron të dhëna më komplete në lidhje me komponentet e rëndësishme të monumentit apo lokalitetit. Është më i saktë dhe ofron gjithashtu të dhëna grafike metrike të bartura nga matjet e bëra.[175]

[175] Po aty, f.141. Për më tepër në lidhje me rilevimet, shih: Jerliu, Florina, (2016), *Mbrojtja e trashëgimisë ndërtimore. Historia, konceptet teorike, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes*, f.139-147.



Figura 14. Pjesë nga rilevimi i formave dhe vëllimeve

Nga rilevimi është arritur të bëhet njohja dhe matja e saktë e çdo këndi, elementi, perimetri, lartësie, gjatësie, gjerësie dhe thellësie e monumentit. Nga dokumentacioni i rilevimit, që mund të shihet në figurën 13, 14 dhe 15, mësojmë se perimetri i jashtëm i ublës është 2720 cm[176] (P = 27,2 m). Hyrja jugperëndimore, nga ana e jashtme është e gjerë 90 cm, nga ana e brendshme 80 cm, ndërsa thellësia e hyrjes nga ana e djathtë 90 cm dhe nga e majta 105 cm. Në dysheme është e ngritur një pjesë në formë të pragut 8 cm nga niveli i dyshemesë së ublës dhe i futur për 32 cm brenda nga ana e brendshme. Hyrja tjetër, pra hyrja lindore ka dimensione të gjerësisë nga jashtë dhe nga brenda 80 cm, ndërsa thellësia e saj nga të dy anët ka dimensionet 149 cm. Kjo e dhënë tregon se gjerësia e këtyre hyrjeve, apo kalimeve, përputhet më gjerësinë e hyrjeve standarde, 90 cm, dhe me këtë, shihet rëndësia e posaçme që i është dhënë kalimit të lirë pa pengesa.

[176] Të dhënat e matjeve në vazhdim do të shënohen në *centimetër*, si njësi matëse standarde për arkitekturë.





Figura 15. Pjesë nga rilevimi dhe skica përfundimtare e Ublës së Krajës. Rilevimi i parë u bë më 16 korrik, ndërsa rilevimi i dytë plotësues më 20 gusht të vitit 2014

Cilindri i grykës së ublës ka perimetër 552 cm, kurse diametri i saj është 175,5 cm. Trashësia e cilindrit është 20 cm. Lartësia e tij është 89 cm. Thellësia e ublës deri te maja e grykës së cilindrit, në bazë të matjeve, është 14,18 m (1418 cm).

Hyrja lindore është karakteristike sepse brenda saj ka shkallë me tri lartësi. Formësimi i tyre i përgjigjet piramidës së shkallëzuar në prerje, por me maje të shtypur. Edhe te këto shkallë, është interesante caktimi i lartësisë dhe i shkelësve të tyre. Dihet se sipas standardeve, lartësia e shkallës normale është nga 14 – 18 cm, ndërsa shkelësja rreth 30 cm. Edhe shkallët e ublës, kanë përafërsisht këto dimensione: shkalla e parë nga brenda, që shërben si prag, është e lartë 4 cm dhe ka gjerësi 33 cm. Shkalla e dytë është me lartësi 15 cm dhe e treta 14 cm, ndërsa shkelësja e shkallës së dytë është e gjerë 30 cm. Pjesa më e lartë e këtyre shkallëve është e lartë 14 cm, kurse e gjerë është 20 cm. Kjo mund të shërbejë edhe vetëm si ndarje e shkallëve të jashtme dhe atyre të brendshme. Pjesa e jashtme e shkallëve është e njëjtë sikur ajo e brendshme, pra e pasqyruar.

Shkallëzimet e ublës janë të pranishme në të dy anët e saj, përballë njëra-tjetrës. Shkallëzimi i parë, nga ana juglindore, ku është vendi i vendosjes së buljerave të ujit dhe ku është shfrytëzuar edhe për çlodhje, është i përbërë nga ulësja dhe mbështetësja. Ulësja është e lartë 73 cm, e gjerë

31 – 38 cm, ndërsa mbështetësja ka lartësi 56 cm dhe e gjerë rreth 60 cm. Këto dimensione ndryshojnë, varësisht ku janë bërë këto matje, pasiqë ndërtimi apo “restaurimi” nuk është bërë gjeometrikisht i përkryer.
Shkallëzimi i dytë, përballë të parit, është më i ulët. Në të janë të vendosura kapëset metalike për lidhjen e bagëtive dhe gjendet mbishkrimi i ublës. Shkalla e parë është e lartë 20 cm dhe e gjerë 30 cm, ndërsa e dyta, ka dimensione 17 cm në lartësi dhe 80 cm në gjerësi.
Edhe mbishkrimi U ÇEL – 1001 KOSARA / MEREMETIMI 1995 është i matur. Gjatësia e përgjithshme e këtij shkrimi është 190 cm, kurse gjerësia e të dy rreshtave arrinë 42 cm.
Lugu i ublës ka këto parametra: gjatësia e tij është 140 cm, gjerësia më e madhe është 70 cm, ndërsa ajo më e ngushta, në bisht të lugut, arrinë 34 cm. Trashësia e brigjeve të grykës së lugut në të tri anët e tij është 12 cm. Gjatësia e grykës është 77 cm, gjerësia 48 cm, ndërsa thellësia 25 cm.



Figura 16. Ubla e Krajës. Vizatim me perspektivë gjeometrike, Korab Kraja. Kohëzgjatja e vizatimit: 16 orë e 39 minuta. Prishtinë, 2 qershor 2017

PËRMBYLLJE

Ubla e Krajës si monument kulturor, historik dhe arkitektonik është trashëgimi e pakrahasueshme e popullit të Krajës në veçanti dhe popullit shqiptar në treva tjera në përgjithësi. Ajo do të duhej të mirëmbahej në periudha të ndryshme kohore, për shkak të dëmtimeve të mundshme që mund të vijnë nga faktori i kohës, kushteve klimatike apo edhe nga dora e njeriut.

Trashëgimia ndërtimore përfshin trashëgiminë arkitekturore, trashëgiminë arkeologjike dhe peisazhet kulturore. Trashëgimia e ndërtuar ndjek zhvillimin e jetës njerëzore nëpër kohë, prandaj edhe kur humb funksionin e vet burimor, ajo asnjëherë nuk e humb vlerën historike, kulturore dhe dokumentare, të lidhur me të dhe me vendin në të cilin është ndërtuar.[177]

Në të ardhmën, duhet të kemi kujdes në restaurimet e objekteve tjera me rëndësi kulturore e historike, sidomos në ndërhyrjet restauruese. Kjo e fundit, është ndryshim i qëllimshëm dhe mund të jetë vlerë e shtuar, përveç në rastet kur restaurimi nuk ndjek parimet e pranuara dhe veprimi ndërhyrës ekzekutohet keq.[178] Restaurimet duhet të kryhen nga profesionistët e fushës së restaurimit dhe konzervimit.

Situacioni duhet të mirëmbahet: bari të kositet, shkurret të hiqen, ndërsa pemët të krasiten. Në këtë mënyrë, pamja do të ishte më piktoreske dhe më tërheqëse për vizitorin. Ky monument, mund të shërbejë në të ardhmen si potencial i rëndësishëm i zhvillimit të turizmit në Krajë. Së bashku me shumë ubla të tjera, pothuajse të panumërta, Kraja padyshim që mund të quhet si vend i ublave. Trajtimi mirëmbajtës i tyre do të ishte në të mirë të banorëve.

Rëndësi të posaçme do duhej t'i kushtohej ndërtimeve të banesave tradicionale, pra shtëpive të vjetra tradicionale të ndërtuara nga guri. Këto shtëpi, me tipologji dhe funksion të veçantë, dita – ditës po shkojnë drejt zhdukjes. Ato po zbrazen nga banorët, për shkak të gjetjes së një jete me kushte më të mira jetësore, dhe në mungesë të zhillimit të jetës në to, mungon mirëmbajtja dhe mbikqyrja. Prandaj, këto shtëpi të gurta, me kalimin e kohës po e humbin fortësinë e tyre dhe bashkë me të edhe identitetin.

---

[177] Po aty, f.106.

[178] Jerliu, Florina, (2016), *Mbrojtja e trashëgimisë ndërtimore. Historia, konceptet teorike, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes*, f.17.

Shqetësim tjetër, jo i vogël, janë kishat e manastiret e ndërtuara qysh nga kohët e hershme nga shqiptarët, ndërsa, tani, në kohët e fundit janë uzurpuar dhe sllavizuar nga Kisha ortodokse serbe, si psh. ato në ujëdhesat e liqenit, *Kisha e Krajës* etj. Poashtu, nuk mund të mos përmendet edhe struktura nga metali në formë të kishëzës, e cila u vendos me helikopter në vitin 2005 në majën e malit të Rumisë. Kisha ortodokse serbe, edhe me këtë shembull ka fyer popullin shqiptar në përgjithësi, ndërsa kranjanët në veçanti, duke përdhosur edhe Ruminë legjendare!

Si do që të jetë, *Ubla e Krajës*, me strukturën, formën dhe pamjen e saj është pranuar nga populli dhe si e tillë, ajo shfaq tek ai mburrje dhe krenari, zgjon kujtimet e trashëguara brez pas brezi. Prandaj, thuhet se, *Ubla e Krajës*, si monument mijëvjeçar, e ndërtuar para njëmijë e gjashtëmbëdhjetë viteve, ruhet nga banorët me fanatizëm dhe si e tillë, ajo edhe sot e kësaj dite, iu shërben banorëve të saj, sidomos fshatrave përreth, duke iu dhuruar burimin më të rëndësishëm të jetës: ujin. Ujin e bollshëm dhe të freskët.

Prandaj, le të jetë *Ubla e Krajës* burim i pashterrshëm i ujit, vlerave kulturore, historike dhe kombëtare; me tipare të veçanta arkitektonike dhe estetike.

Literatura e përdorur:

Belegu, Xhafer, *Lidhja e Prizrenit dhe veprimtaritë e saj 1878 – 1881*, Shkup, VATRA, 2008

Brisku, Bahri, *Kusarët dhe detarët shqiptarë (Kontributi i tyre në autoktoninë kombëtare)*, Ulqin, Asociacioni Ulqini, 2011

Calter, Paul, *The Circle, The Wheel of Fortune & The Rose Window, https://www.dartmouth.edu/~matc/math5.geometry/unit9/unit9.html*

Çabej, Eqrem, *Meshari i Gjon Buzukut*, Prishtinë, Rilindja, 1988

Çilikov, Aleksandar, *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Kontribut çështjes së studimit dhe restaurimit të një numri monumentesh sakrale në Krajë*, Ulqin, Shoqata "Don Gjon Buzuku", 2013

Dobreci, Simë Gjon, Revista BUZUKU nr. 29 – *Pinçi – disa toponime*, Ulqin, 2.4.2009

Doli, Flamur, *Arkitektura tradicionale – populllore e Kosovës*, Prishtinë, Dukagjini, 2001

Doli, Flamur, *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, Shoqata për ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike – SHRTA, 2009

Doli, Flamur, *Në një cep të Ilirisë – Arkitektura e lashtë*, Pejë, Dukagjini, 2006

Draga, Nail, *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Populllsia dhe vendbanimet e Krajës (1948 – 2011)*, Ulqin, Shoqata "Don Gjon Buzuku", 2013

Elsie, Robert, *Fjalori historik i Shqipërisë*, Tiranë, Shtëpia botuese UEGEN, 2011

Gjeçbritaj, Ali, *Gjurmët e moteve*, Ulqin, Shoqata "KRAJA", 2010

Gjeçbritaj, Ali, Revista BUZUKU nr. 23 - *Ublat e Bolajve*, Ulqin, 5 prill 2007

Gjeçbritaj, Ali, *Shkolla në Krajë 1929 – 2009*, Ulqin, Asociacioni Ulqini, 2013
Jerliu, Florina, *Mbrojtja e trashëgimisë ndërtimore. Historia, konceptet teorike, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes*, Prishtinë, Libri shkollor, 2016
Jerliu, Florina, *Trashëgimia kulturore e Kosovës. Konceptet dhe kontekstet e mbrojtjes*, Prishtinë, Botime Artini, 2017
Koliqi, Hajrullah, *Kraja e Shkodrës (Gjurmë e gjurmime)*, Ulqin, Art Club, 2001
Koliqi, Hajrullah, *Kraja jonë (Qëmtime dhe grishje)*, Prishtinë, Libri shkollor, 2014
Koliqi, Hajrullah, *Kraja ndër mote*, Prishtinë, Lidhja e Historianëve Shqiptarë, 1993
Kostallari, A., Thomaj, J., Lloshi, Xh., Samara, M., Kola, J., Daka, P., Haxhillazi, P., Shehu, H., Leka, F., Lafe, E., Sima., K., Feka, Th., Keta, B., Hidi, A., *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, Rilindja, 1981
Meksi, Aleksandër, *Restaurimi i Monumenteve të Arkitekturës*, Tiranë, Shtëpia botuese UEGEN, 2004
Pa autor, *Symbol of function, https://www.britannica.com/topic/architecture/Symbols-of-function*
Rexha, Riza, *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Ulqin, Art Club, 1998
Riza, Emin, *Arkitektura popullore dhe vlerësimi i saj*, Ministria e turizmit, kulturës, rinisë dhe sportit, Tiranë, 2013
Rregullore për mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike, Revista Monumentet Nr. 3, Tiranë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, 1972
Shpuza, Jusuf, *Lemba Nr. 6 -7 – Patronime të trevës së Krajës në Shkodër*, Ulqin, Art Club, 2002 – 2003
Stipçeviq, Aleksandër, *Ilirët – Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, Tiranë, Botimet Toena, 2002
Stipçeviq, Aleksandër, *Simbolet e kultit te ilirët*, Prishtinë, Rilindja, 1983
Suli, Leonard, *Arkitektura e banesës popullore në rrezomën e Delvinës*, Revista Monumentet Nr.29, Tiranë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, 1985
Vata, Rovena, *Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve – Miti i ujit në Krajë e Shestan*, Ulqin, Shoqata "Don Gjon Buzuku", 2013

Arh.Suada ISMAILAGA dipl.ing.

SHTËPIA E PASHËS DHE BELEDIJA

Shtëpia e Pashës – pamja e dikurshme

Shtëpia e Pashës sot

Për ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre përmendoreve nuk është bëre asnjë hap me qëllim të përmirësimit të gjendjes që të ndalohet shkatrrimi ose shembja e mundshme e tyre.
Shtëpia e Pashës ndodhet në afërsi te mureve të Kalasë, xhamisë së Pashës, në veri të shkollës fillore "Boshko Strugar".

Objekti është ndërtuar në mesin e shekullit të XVIII, më saktë rreth vitit 1742 dhe paraqet të gjitha karakteristikat e shtëpiave të pasura të tipit mesdhetarë osman.
Arkitektura tradicionale e shtëpisë së Pashës paraqet vulën e vlerave të trashëgimisë kulturore që tregon për mënyrën e jetesës së asaj kohe.

Dispozitat e objektit
Nga të katër anët shtepia është e lirë.
Fillimisht ka qenë e vendosur në mes të parcelës së madhe me një ndarje karakteristike me hyrje në oborr përpara dhe bahçen e shtëpisë në pjesën e pasme e regulluar në menyrë tradicionale me shumë gjelbërim. Oborret e shtëpiave të pasura siç është shtëpia e Pashës ka qenë e shtruar me kalldram.
Sipas dokumentacionit të bazës gjeodezike të vitit 1951 vijmë tek përfundimi se objektet në parcelat përreth në veri dhe perëndim janë

ndërtuar më vonë pa leje dhe duke mos percjell stilin arkitektonik të këtij objekti.

Shtëpia e Pashës i takon tipit të planit qendror të shtëpisë qytetare së pasur me grupimin e dhomave rreth hajatit i cili ka qenë në qendër të shtepisë.
Për rreth hajatit kanë qenë të orjentuara dhomat si dhe çardaku.
Organizimi i planimetrisë përbëhet nga 2 pjesë: Përdhesa e mbuluar me pullazin me katër ujëra dhe strehë të cektë, kurse kati i dytë i pjesërishem formon dhomën me çardak në formë katrori me pullaz me katër ujëra dhe strehë të theksuar prej druri te përpunuar që përreth kishte një element dekorativ e cila i dha një pamje karakteristike të arkitekturës osmane.
Përdhesa është me gjatësi 20.5 m, e gjerësi 12.50m
Pjesa e çardakut është e dimenzioneve 7.0 x 7.0 m , me lartësi 3 m që përmban një dhomë të madhe e cila ka karakterin e shtëpiave të pasura qytetare të asaj periudhe.

Shtëpia ka këto ambiente
-Bodrumi ose ahri i cili ka qenë i ndarë në tre pjesë, ku është i vendosur mulliri i vjetër i vajit i punuar në mënyrë primitive.
- Përdhesa e cila përmban tre dhoma për banim; dy kuzhina, qilari, dy toalete, banjo dhe korridor të gjërë.
-Një pjesë e katit të përdhesës vazhdon si kat i parë dhe paraqet dhomën e madhe me çardak të dimenzionit 7.0 x 7.0 m , lartësi 3 m e cila ka qenë dhomë kryesore dhe është thirër ***oda e musafirëve***.
Me traditë secila shtëpi e pasur ulqinake ka pas një dhomë të këtij lloji për musafir që në mbrendësi ishte e pajisur me miner, me tavane të përpunuara prej druri, me nisha në mure, sergjene, dritare druri me dy hapje, me disa ndarje horizontale me parmak nga ana e brendshme.
Shtëpitë e pasura të asaj kohe janë dalluar më mënyren e lyerjes së fasadave. Materiali i cili është përdorur në atë periudhë ka qenë gëlqerja e cila është përzier me të kuqin e vezëve ku ka fituar ngjyren e kuqërremtë. Intensiteti i kësaj ngjyre është mvarur nga sasia e vezëve.

Gjendja egzistuese
Nga tërmetet e viteve 1968 dhe 1979 është dëmtuar dukshëm.
Në objektin egzistues janë bërë ndryshimet pa leje.

Janë shtuar shkallat prej betonit, janë hap hyrjet anësore dhe në këtë mënyre objekti është ndarë në disa pjesë banimi dhe dukshëm është ndryshuar fasada me përmasa horizontale të dhomës me çardak si dhe zgjerimi dhe pozita e dritareve .
Në vitin 1952 si përmendore e kategorisë së parë është përfshirë në juridiksion të Entit republikan për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës në Cetinë.

Në vitin 1992 komisioni i Entit për mbrojtje monumenteve kulturore të regjistruara, gjatë vizitës të këtij objekti ka hartuar një raport për gjendjen e kësaj vlere kulturore.
Është konstatuar se përfundimisht janë prishur dy tavane shumë të bukura në dru, të ndërtuara para 275 viteve.
Janë evidentuar dëmtimet. Është dhënë vlerësimi i gjendjes dhe propozimi i masave të mbrojtjes së tavanit me vlera autentike të asaj periudhe.
Pas konservimit të tavanin ai është zhvendosur në Muzeun etnografik ku paraqet një nga detajet e dhomës ulqinake orientale.



Tavani si detaj i arkitekturës orientale është shumë i rëndësishem për objektin e Shtëpisë së Pashës, ka formën e katrorit ku pjesa qendrore kalon në një lloj kupole të ngritur.
Në bazën e katrorit gjendet i vizatuar tetëkëndëshi.

Hapësira e trekëndëshave që formohet mes anëve të katrorit dhe tetëkëndëshit është i rethuar me kornizë me motive prej konopi te përdredhur.
Brendësia e trekëndëshave është plotësuar me ornamente (dekorime) simetrike floreale.
Nga pjesët e skajshme dërrasat e vendosura vazhdojnë në formë të rrezeve të cilat në drejtim të qendrës ngushtohen.
Pjesa qendrore e tavanit është gjithashtu një tetëkëndësh më i vogël me kornizë trekëndëshash, që brenda tyre gjithashtu janë të plotësuar me ornamente (dekorime) të gdhendura floreale.
Pasi që tavani është mjaft i dëmtuar, pjesërisht shihet se panelet e saj prej druri janë përberë nga dërrasat e ngushta të vendosura në strukturë rrethore. Në kurorën e vogël të kupolës është vendosur një rozetë dekorative ku është e ruajtur bërthama origjinale ku është varur llampa për ndriçimin qendror të dhomës.
Për shkak të tendencës së theksuar të dëmtimit, është humbur autentika e këti kompleksit banesor.
Tavani sot ndodhet në Muzeun etnografik kurse Shtëpia është në gjendje të para-shkatërrimit.

B E L E D I J A

Pazari, Medreseja dhe Beledija

Beledija sot

Lokacioni i objektit ndodhet në qendër të çarshisë, nën Kullën e sahatit që është ndërtuar në vitin 1754.
Në afërsi të saj kanë qenë të vendosur edhe objekti i vjetër i pazarit ose mezgjahu, medreseja dhe xhamia që së bashku kanë formuar një kompleks objekteve të cilat gjithashtu prezentojnë disa nga simbolet e qytetit të Ulqinit të asaj periudhe.
Dikur në këtë objekt ka qenë e vendosur Komuna dhe adninistrata e qytetit tonë.
Në vitet e 60-ta aty ka qenë Gjykata komunale si dhe komiteti i partisë komuniste.
Në fillim të shekullit 20, ka dominu mbi Çarshinë e Ulqinit, si ndërtesa më e bukur me madhësinë e vet dhe më lartësin e kateve p+1.
Pronarët e objekteve përreth Çarshise kanë vepruar ashtu siç kanë dashur vet. Dyqanet egzistuese të asaj periudhe të cilat me tradite kanë qenë në katin përdhe janë ngritur në dy ose tre kate duke mos përcjellur arkitekturen autentike dhe stilin e këti kompleksi me pjerrësi të cative, streha të gjëra punuara me dru, poziten dhe dimenzionin e dritareve etj.
Në këtë mënyrë është zën pamja e objektit të Beledijes dhe ka humbur bukurija e carshisë se dikurshme me stilet e lloje-llojshme.
Sot Beledija fatkeqësisht është total e shkatërruar ashtu edhe carshija e Ulqinit ka humbur pamjen cila ka karakterizuar rregullat urbanistike te asaj periudhe.

Duke marrë parasysh se është ndërtuar në kohë të sundimit otoman prapë se prapë nuk është ne regjistrin e Pasurive të mbrojtura kulturore. Për këtë edhe nuk janë të ruajtura dokumentet e shkruara ku do të ishin përshkruar në detaje pamja e dikurshme e brendësisë së objektit.
Nga foto-dokumentacioni i ruajtur shihet qartë pamja e dikurshme e jashtme me renditjen e dritareve dhe çatinë me streha të gjëra që janë karakteristike për atë periudhe.
Objekti është mjaft i dëmtuar nga termeti i vitit 1979.
Sot është në kompetencat e pushtetit vendor dhe kurrë nuk është bërë adaptimi dhe rindërtimi, por është lënë si rrënoje që e prish pamjen e kësaj hapësire.
Për shkak te pozitës së mirë, përmasave ekzistuese dhe lartesis së kateve, lind ideja që në të njëjtin vend, duke përcjellë themelet e vjetra dhe pamjen autentike nga foto-dokumentacioni, të hartohet projekti ideor, pastaj projekti kryesor dhe të realizohet rindërtimi i këtij objekti.
Idea që me rekonstruimin dhe revitalizimin e objektit të Pashës dhe Beledijes duke percjell kushtet konzervative, të vehet në shërbim të qytetit.
Si funksion të jetë rezidencë për pritje të mysafirëve dhe të permbante një galeri të qytetit, salla konferencash, bibliotekë, salle multimediale, promovime librash dhe kështu qyteti i Ulqinit do kishte objekte reprezentative të cilat i mungojnë.
Përveç kësaj kjo do të ngriste edhe vlerat turistike me prezentimin e arkitekturës tradicionale osmane.

PORTRET

Mustafa CANKA

KADI MUJALI - JETA E KUSHTUAR BESIMIT DHE MËSIMIT

Me të vërtet është vepër bujare dhe e lavdërueshme të rikujtojmë mësuesit tanë, njerëzit e devotshëm, ato të cilët bënë që qyteti ynë të përmendet për të mirë dhe për dije. Ato që kanë këtë dhunti, siç thotë Sunduesi i botëve, kanë dhunti të pafund.

Një nga njerëzit e tillë ishte padyshim edhe hafiz Hysejn ef. Mujali. I lindur në vitin 1854, në zemër të Çarshisë, në kohën e lulëzimit më të madh ekonomik të Ulqinit, kur qyteti kishte 200 dyqane dhe po aq anije në Mesdhe, në kohën kur ka lulëzuar spiritualiteti islam, i cili u kurorëzua me Mevludin fenomenal të hafiz Ali Riza Ulqinakut, i cili ishte në një gjeneratë me hafiz Mujalin.

E ai ishte i destinuar të ec rrugës së fesë, sepse rridhte nga një familje e devotshme. Të rikujtojmë se stërgjyshi i tij, haxhi Sulejman Mujali, e ndërtoi xhaminë qendrore të Mezgjahut, në vitin 1728.

Mësuesi i bashkëqytetarëve tanë ishte dijetari i madh islam, patrioti, delegati i Lidhjes së Prizrenit për regjionin e Shkodrës, hafiz Salih ef. Hylja, gjersa tek hafiz Tirana ef. Mujali e përfundoi shkollën e hivzit, gjegjësisht e mësoi Kur'anin përmendësh.

Shpejt filloi punën në Bashkësinë islame, të vetmin institucion i cili kishte mundësi të tubojë Ulqinakët, mbasi që ky qytet i takoi Malit të Zi në vitin 1878, gjegjësisht 1880.

Pra, hafiz Mujali nuk dëshiroi, si shumë të tjerë, ta braktisë vendin e vet të lindjes. Mbeti këtu, me familjen dhe bashkëqytetarët e tij, e ndau të keqën dhe të mirën, i ndihmoi njerëzit të ruajnë shpirtrat e tyre, thirri në besim dhe mësim, mirëkuptim dhe solidaritet.

Me punë dhe dedikim të palodhshëm fitoi popullaritet të madh tek Ulqinakët. Ishte imam, mualim, ndërsa në vitin 1897 u zgjodh kadi. Në këtë funksion ishte plotë 22 vite, deri në vitin 1919, kur u emërua për myfti të Ulqinit. Në këtë detyrë ishte deri në vitin 1923, kur u pensionua.

Patjetër është me rëndësi të theksohet konteksti i ndërlikuar politik, shoqëror dhe ekonomik në të cilin hafiz Mujali ka vepruar gjatë shërbimit të tij në Bashkësinë islame. Do të përmend vetëm se që nga

viti 1880 deri në vitin 1934, pra 54 vite të plota, kur filloi punën Kriporja, e shpejtë pas kësaj u ndërtuan hotelet Republika, Jadran dhe Koop, gjegjësisht Galebi, Ulqini në të gjithë fushat stagnoi. Qyteti ynë kishte në fillim të viteve 30 të shekullit të kaluar më pak se katër mijë banorë, dyfish më pak se, për shembull, në vitin 1876.

Në këto rrethana të gjykosh sipas sheriatit, të jesh i drejtë, në paqe me Zotin dhe njerëzit, ishte, ndoshta, puna më e vështirë në botë. Por, dija dhe fisnikëria e kadiut, autoriteti të cilin e gëzonte në popull dhe pushtet, ia lehtësoi misionin e tij.

Hafiz Mujali ka arsimuar gjenerata të Ulqinakëve, u kujdes për xhami dhe pronë të vakëfit. Përveç me fëmijët e tij, prej të cilëve djali Seidi ishte hafiz, kohën më së shumti e kalonte me libër. Shkruante dhe fliste në gjuhën shqipe, malazeze, turqishte, arabe dhe persiane.

Vdiq në moshën 86 vjeçare, gjegjësisht në vitin 1940.

Lus Allahun, Gjithëmjaftueshmin dhe Mëshirëplotin, që të fal atë dhe neve. Amin.

(Fjala e rastit e mbajtur në Qendrën kulturore Ulqin me 10. mars 2017)

Gani KARAMANAGA

KULLA E HOXHË BUSHATIT

Kulla e hoxhë Bushatit ka qenë ndërtesë e vjetër monumentale në mesin e Kalasë. Çdo turist i cili ka hyrë në Kala është ndaluar përpara kësaj shtëpie-kulle. Shumë piktorë e kanë piktoruar. Si fëmijë, më ka mbetur në kujtime piktorja e moshuar e cila ka ardhur disa vite në Kala dhe gjithmonë përsëri e ka pikturuar kullën e hoxhë Bushatit.

Më kujtohet figura e ***Musa ef.Bushatit*** *(1876-1955)* në Pazarin e gjytetit. Ishte imam i dalluar me autoritet të veçantë. Prej martesës me motrën e molla Sulejman ef. Peshkut ka pasur një vajzë (Shemsija e cila jeton në Shkodër). Prej martesës së dytë me Laçen, nga familja e Resulbegëve ka pasur gjithashtu një vajzë (Xhemilja) e cila ka ndërruar jetë. Përveç obligimeve në xhami ka mbajtur edhe mektebin në shtëpinë e vjetër në Kala (sot është aty kancelaria e muzeut).

Pas vdekjes të mulla Musa ef. Bushatit familja e ku ka qenë e martuar vajza e dytë Xhemilja së pari e ka shitur oborrin ku blerësi *Hashim Milla* ndërtoji shtëpinë familjare. Më vonë është shitur edhe kulla- shtëpia e vjetër. Pronari i ri ishte *Rexhep Goga*.

Bashkëshortja e Musa ef. Bushatit Laçja ka qenë e detyruar fillimisht të vazhdoji për të jetuar në shtëpinë e vjetër në Kala ku mëpërpara ishte familja e *Zejnel-Nelo Resulbegut.* Më vonë, komuna i ka dhënë Laçes një banesë të vogël në lagjen Totosh. Kështu, Laçja e lindur në shtëpinë e Resulbegëve në breg të detit në Lima, dhe mandej duke jetuar pas martesës në kullën e madhe në Kala, ishte e detyruar që pleqërinë ta kalonte në një dhomë largë detit e Kalasë.

Tërmeti prej vitit 1979 kullën e hoxhë Bushatit e rrënoj. Atë ditë humbi jetën edhe djali i vogël i Rexhep Gogës *Agroni* (1966). Më vonë, familja Goga e rindërtoji kullën-shtëpinë, por ajo humbi karakteristikat e mëpërparshme.

Rexhep Goga ishte pronari i ri i kësaj shtëpie, monumentale në Kala. Ka qenë kopshtari i parë në mirëmbajtjen e lulishteve të qytetit. Njeri i qetë, ka pasur një gjë karakteristike: prej shtëpisë së tij e cila ishte në buzë të Kalasë gjithmonë është ulur dhe ngjitur nëpër bedenin e Kalasë përmes një rrugice të ngushtë nën shtëpinë e tij.

Rudi (Ruzhdi) Goga (1948- 2017) ka jetuar në këtë shtëpi. Pikturat e para dhe ato tjerat i krijoi në Kala. *Rudi Goga*, u lind në vitin

1948 në qytetin e Ulqinit. Është diplomuar në Akademinë e Arteve në Prishtinë, në klasën e akademikut Muslim Mulliqi, në vitin 1979. Ka mbaruar studimet pasuniversitare në Dyseldorf të Gjermanisë, me profesorët e njohur gjermanë, Rolf Sokenhajm (Sockhenheim) dhe Jozef Bojs (Joseph Beuys). Ekspozitën e parë vetjake, të titulluar Kulla e Ballshajve, e hapi në Ulqin në vitin 1978 e cila më pastaj do të pasohej nga një numër i madh ekspozitash dhe aktivitetesh artistike, brenda dhe jashtë vendit. Gjatë karrierës artistike, Goga numëron rreth 65 ekspozita personale dhe po aq kolektive, jo vetëm në Ulqin dhe brenda kufijve të Malit të Zi, por edhe në Gjermani, Holandë, Francë, Nju Jork, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri. Punimet e tij gjenden në galeri dhe koleksione private, në vende të ndryshme të Evropës, ku piktori ka ekspozuar. Ndërkohë Goga numëron edhe disa çmime, mes të cilave në vitin 1991 merr çmimin vjetor të Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve Art Club, Ulqin, në vitin 1995 shpërblimin kombëtar "Onufri", Tiranë, në vitin 1998 shpërblimin e Shoqatës së Juristëve të Malit të Zi, Podgoricë. Rudi Goga ishte njëri ndër themeluesit e Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve Art Club dhe si vlerësim të meritave dhe veprës madhore që krijoi, në vitin 2014 Art Club botoi monografinë kushtuar krijimtarisë së begatë artistike të tij.

Si mjek i ri disa herë e vizitova nënën e Rudi Gogës, Meleqen. Rudi mi dhuroi dy pikturat e tija më të parat në krijimtarin e tij.

Shumë më vonë, në fillim të vitit 2003 Bashkimi krijuesëve shqiptarë në Mal të Zi organizoj ekspozitën e piktorëve shqiptarë nga Mali i Zi. Kjo ekspozitë u mbajtë dy here në Ulqin, Tuz, Shkodër, Tiranë. Për here të parë piktorët shqiptarë ishin prezent në Bilardën e Cetinës. Rudi Goga ishte prezent në këtë ekspozitë.

Akademiku *Zuvdi Hoxhiqi* botoi në gazetën ditore "Pobjeda" një kritikë lidhur me këtë ngjarje. Rudi Goga nuk ishte fare o kënaqur me shkrimin e Zuvdiut.

" *Rudi më duket i çuditshëm"* iu drejtova Zuvdiut.

"Da nije pomalo čudan, ne bi bio tako dobar slikar"

(Mos të ishte pak i çuditshëm nuk do ishte aq piktor i mirë). Ky ishte konstatimi i akademikut Zuvdija Hoxhiq Berisha..

"Do të kaloj shumë kohë që të lind edhe një piktor si ka qenë Rudi Goga" më tha Hajro *Ulqinaku.*

. 

Musa ef. Bushat(1), Kulla e Hoxhë Bushatit(2 dhe 3) dhe Kulla e rrënuar pas tërmetit(4)

Rudi Goga

Ullini-pikturë nga vitet e shtatëdhjeta

(Nga libri në dorëshkrim „Pazari i gjytetit“)

IN MEMORIAM

RUDI (RUZHDI) GOGA
1948-2017



Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut

Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut

Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut

Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut

Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut



Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut



Nga koleksioni privat i Gazmend Çitakut

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 16/2017, viti XV, Ulqin

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi
Kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Redaktor teknik:
Gazmend Çitaku

Kontakti
E-mail: ***bkshmz@yahoo.com***
Bashkëpunëtorëve u jemi mirënjohës për ndihmesa.
Artikujt duhet të jenë të regjistruar në WORD dokument.
Duhet të jenë të lekturuar dhe të korrektuar.
Nuk duhet të jenë të faqosur e as të dizajnuar.

Shtypi
PRESS STUDIO
ULQIN, 2017

Tirazhi
300 Copë